monumentet



DO NOT COPY

2/1983

DO NOT COPY

Kopertina e parë:
Butrint, SARANDE
Teatri i qytetit shek. IV-III p.e. sonë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

2 / 1983 (26)

KOLEGJIUMI I REDAKSISE

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7

Tirazhi 1200 Formati 70x100/12 Stash: 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik. Shtypshkronja «Mihal Duri» – Tiranë

PASQYRA E LENDES

Faqe

ARTIKUJ

Ali Muka

Vështrim mbi fshatrat Strellc i Epër (Deçan) dhe Nivokaz (Gjakovë) (Karakteri i vendbanimeve dhe ndërtimet popullore) 5

Dilaver Kurti

Urat e gurta në Mat 31

Emin Riza

Përvoja e derisotme mbi qëndrimin karshi fazave të ndërtimit në banesën popullore 47

Isuf Sukaj

Arkitektura e banesës me hajat në qytetin e Kavajës 57

Aleksandër Meksi

Kishat mesjetare të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut 77

Naum Pritti

Organizimi i vogël dhe trevat e muratorëve stinorë të Kolonjës. 119

Fatbardha Shkupi

Zbukurimorja e ndërtimtarisë së kultit në qytezën e Vithkuqit gjatë shekujve XVIII-XIX 123

Petrit Basha

Ujësjellësi i Prrenjasit në Sulovë të Gramshit 145

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

ARTICLES

PAGE

Ali Muka

Aperçu sur les villages de Strellc i Epër (Deçan) et Nivokaz (Gjakovë) (Caractère des centres habités et des constructions populaires) 29

Dilaver Kurti

Les ponts en pierre de la région de Mat 43

Emin Riza

L'expérience acquise jusqu'à ce jour sur l'attitude envers les phases de construction de l'habitation populaire 55

Isuf Sukaj

L'architecture de l'habitation à porche dans la ville de Kavaja 73

Aleksandër Meksi

Les églises moyenâgeuses de l'Albanie centrale et de l'Albanie du Nord. 115

Naum Pritti

La petite organisation et les contrées des maçons saisonniers de Kolonja 122

Fatbardha Shkupi

L'art décoratif dans la cité de Vithkuq, au cours des XVIII et XIX siècles. 141

Petrit Basha

L'aqueduc de Prrenjas à Sulovë de la région de Gramsh 147

DO NOT COPY

monumentet

Ali MUKA

DO NOT COPY

VËSHTRIM MBI FSHTATRAT STRELLC I EPËR (DEÇAN) DHE NIVOKAZ (GJAKOVË)*

(Karakteri i vendbanimeve dhe ndërtimet popullore)

I. Të dhëna me karakter historiko-etnografik

Brenda **Rrafshit të Dukagjinit** që shtrihet në perëndim të **Fushës së Kosovës** bëjnë pjesë disa njësi etnografike. Një e tillë është Reka. Ajo fillon nga Bistrica e Deçanit e fshati Deçan dhe arrin deri në Gjakovë. Në Rekë hyjnë të gjitha vendbanimet rrëzë Bjeshkëve të Nemuna, përfshirë edhe ato që shtrihen gjatë rrugës Deçan-Gjakovë[1]. Brenda vetë Rekës dallohen disa rrethina më të vogla, siç janë Vokshi, Reka e Dushkajës, Reka e Keqe etj[2]. Fshati Nivokaz bën pjesë në rrethinën e fundit së bashku me 16 fshatra të tjerë[3].

Strellci i Epër ndodhet midis Deçanit dhe Pejës dhe populli e grupon me fshatra të tilla si: Strellc i Poshtëm, Lëbusha, Luboniq, Raushiq, Logje, Dubovik, Prapaçan, Isniq e ndonjë tjetër[4]. Madje kur bëhet fjalë në popull për pesë bajrakët e Pejës, një ndër ta është edhe ai i Strellcit. Ky bajrak përfshinte fshatrat: Strellc i Epër, Strellc i Poshtëm, Logjë, Lëbushë, Luboniq dhe Raushiq[5].

Të dy fshatrat në shqyrtim janë të vjetra. Kjo dëshmohet edhe në dokumenta. Strellci përmendet në fshatrat që i takonin në shek. XIV feudit të Deçanit. Teritori i sotëm ndërmjet Bistricës së Pejës dhe asaj të Deçanit, formonte një zhupë e cila njihej me emrin Hvosna ose Hvostna[6]. Strellci në atë kohë kishte 70 shtëpi. Si një ndër fshatrat që i është dhuruar manastirit të Deçanit, me Strellcin ishin në atë kohë edhe dy lagje të veçanta, nga të cilat njëra (Lëbusha) kishin 9 shtëpi[7]. Në shek. XV Strellci bënte

*) Në vitin 1977 gjatë një ekspedite shkencore të kryer në Kosovë qëndruam edhe në fshatrat Strellc i Epër dhe Nivokaz. Artikulli që sjellim mbështetet në materialin e mbledhur prej nesh në atë kohë. Përveç të dhënave nga literatura, janë shfrytëzuar edhe raportet e ekspeditës së vitit 1972 të A. Gjergjit dhe A. Dojakës të cilët gjithashtu kanë qenë në Strellc të Epër. Të dhënat e tyre botohen për herë të parë. Të dy kolegët me këtë rast i falenderoj.

1) M. Krasniqi: **Krahinat etnografike të Kosovës** «Konferenca Kombëtare e Studimeve etnografike». 28-30 Qershor 1976, Tiranë, 1977 faqe 119.

2) **Po aty.**

3) Këto fshatra janë: Botusha, Mulliqi, Shishmani i Bokës, Brovina, Morina, Kosharja, Punasheci, Shishmani i Rrafshit, Babajt e Bokës, Juniku, Stublla, Berjau, Dushnjet, Potok i Mulliqit dhe Smolicë. Për këtë shih edhe A.E. dok. 1037/17 dhe dok. 929/47.

4) A.E. dok. 1037/17, fq. 26.

5) **Po aty,** faqe 15.

6) M. Tërnava: **Shqiptarët në feudin e Deçanit në vitet 30 të shek. XIV sipas Krisobuiës së Deçanit,** «Shqiptarët dhe trojet e tyre». Tiranë 1982, faqe 214.

7) S. Novakoviç, **SELO.** Beograd 1943, faqe 118-119 (Citohet sipas përkthimit shqip që ndodhet në A.I.H).

pjesë në nahijen e Pejës, dhe pa dy lagjet që thamë numëronte gjithsej 60 shtëpi[8].

Edhe Nivokazi përmendet ndër dokumenta të shek. XV. Sipas këtyre dokumentave, ai bënte pjesë në nahijen e Altun-ilisë dhe kishte gjithsejt 37 shtëpi[9]. Krahinëza ku ndodhej ky fshat qysh në shek. XV njihej me emrin Rekë dhe shtrihej në veri të Gjakovës së sotme.[10]

Nga shqyrtimi i të dhënave dokumentare është vënë re se fusha midis Gjakovës dhe Junikut ishte në shek. XV një truall i banuar nga Shqiptarë. Pra popullsia e fshatrave të përfshira në Altun-ili ka qenë në pjesën dërmuese shqiptare[11]. Gjithashtu është vënë re ndër dokumenta se emrat e banorëve të fshatrave të Zhupës së Rekës, për nga origjina pothuaj janë të njëjtë me ato të Zhupës së Hvosnës[12].

Me shumë interes paraqitet edhe karakteri i taksave që paguanin banorët e këtyre fshatrave. Nëpërmjet tyre konfirmohet në mënyrë akoma më bindëse se popullsia masive shqiptare e trevës së Altun-ilisë ishte një popullsi e ngulitur që merrej jo vetëm me blegtori, por në radhë të parë dhe kryesisht me bujqësi[13]. Për ilustrim le të shqyrtojmë sado shkurt taksat në akçe që paguante fshati Nivokaz në shek. XV[14]. Konkretisht ai paguante Ispenxhe 297, grurë (barrë 18) 540, thekër (barrë 23) 460, tagji, elb etj (barrë 23) 368, mel (barrë 5) 100, lin 80, musht (subur 8) 160, mullinj të rajave sasia 2, akçe 60, (taksa) e frutave 6, e bletëve 14, e perimeve 28, e govatës 20, e barit 140, e druve 56, dhe bidati i (derrave) 24. Duke krahasuar taksat që pasqyrojnë veprimtari bujqësore me ato të veprimtarisë blegtorale, vërejmë se raporti arrin 1 : 10 në favor të së parës. Kjo dukuri flet jo thjesht për praninë e bujqësisë si një degë e ekonomisë por edhe si më e zhvilluara në raport me të gjitha degët e tjera. Madje indirekt këtë e konfirmon edhe prania e dy mullinjve për bluarjen e drithit që sipas taksës lihet të kuptohet se punonin gjatë gjithë vitit. Po të kemi parasysh numrin e shtëpive të fshatit, gjithsejt 37, prania e dy mullinjve dhe puna e pandërprerë e tyre gjatë vitit, nuk është diçka e papërfillshme. Sidoqoftë karakteri i taksave hedh dritë të qartë mbi karakterin kryesisht bujqësor të ekonomisë. Pra banorët e këtij fshati kanë qenë me kohë të ngulitur aty.

Zona ku përfshihet Reka e Keqe rezulton e pasur në fusha të ndryshme të kulturës popullore. Aty ruhen të gjalla begati me interes në fushën e folklorit, të muzikologjisë dhe të onomastikës[15]. Përveç një numri këngësh kreshnike, këngët lirike të hetuara, janë konsideruar si margaritarë të lirikës sonë popullore. Po ashtu materiali toponimik, etnonimik, sidomos ai i lidhur me Bjeshkët e Nemuna, nga afërsia e Deçanit e gjer në Qafë të Morinës, vlerësohet si mjaft arkaik dhe ajo që është më e rëndësishmja, pothuaj thjesht shqip. Ka ndër to toponime të lidhura me emra personazhesh të këngëve kreshnike si: **Vorri i Mujës, Leqet e Mujës, Vorri i Imerit t'Mujës** (në Gurrat e Zeza të Bjeshkëve të Nemuna) e të tjera me gojëdhëna. Për mikrotoponimet është vënë në dukje se një pjesë përmenden kryesisht në krisobulën e Deçanit, që i përket shek. të XIV. Po ashtu janë ruajtur në trajta të moçme e primare disa mikrotoponime latine, si **Këlkere, Kilkere, topilla** (në Nivokaz) etj. Në Nivokaz janë hetuar edhe toponime të tilla si «kishëza» dhe «Therra e kishës»[16].

Edhe nga shqyrtimi që u është bërë burimeve kishtare serbe, është vërejtur prania e etnosit shqiptar në Kosovë gjatë shekujve XIII-XIV[17]. Në këtë rast me interes janë antroponimet e sjella nga fshati Strellc, siç janë **Beroje**[18], dhe **Prek Çela** (në trajtën Prekoçel – banor i Strellcit) e **Curri** (në trajtën **Cur** – banor i Lëbushës që në atë kohë ishte lagje e Strellcit)[19]. Kujtojmë se Curri sot përbën një nga vëllazëritë më të mëdha të Strellcit të Epër, vëllazëri që i përket fisit Krasniqe.

8) S. Pulaha, **Të dhëna onomastike mbi elementin shqiptar të krahinave të Sanxhakut të Shkodrës në fund të shek. XV.** «Studime historike» 4, Tiranë 1972, faqe 181.
9) **Po aty,** faqe 198.
10) M. Ternava, **Vep. cit.,** faqe 215.
11) S. Pulaha. **Nahija e Altun-ilisë dhe popullsija e saj në fund të shek. XV.** «Gjurmime albanologjike». Seria e shkencave historike I. 1971, Prishtinë 1972, faqe 195.
12) M. Ternava, **Vep. cit,** faqe 215.
13) S. Pulaha, **Vep. cit,** faqe 200.
14) **Po aty,** faqe 212.
15) S. Gashi, **Nga ekspedita shkencore hulumtuese në katunde të Vokshit e të Rekës së Keqe.** «Gjurmime albanologjike» Seria e shkencave filologjike V-1975, Prishtinë 1976, faqe. 221-224.
16) **Po aty,** faqe 223.
17) S. Gashi, **Prania e etnosit shqiptar në Kosovë gjatë shekujve XIII-XIV në dritën e burimeve kishtare serbe.** «Shqiptarët dhe trojet e tyre», Tiranë 1982, faqe 239-264. M. Ternava, «Shqiptarët në feudin e Deçanit» vep. cit., faqe 211-223.
18) M. Teranva, **Po aty,** faqe 214.
19) S. Gashi. **Prania e etnosit...,** Vep. cit. f. 244.

DO NOT COPY

Duke shqyrtuar dokumentat turke të shek. XV, S. Pulaha, ka vënë re se të gjithë banorët e Altun-ilisë në të cilën bënte pjesë edhe Nivokazi ruanin edhe në shek. e XVI emrat tipike shqiptare që kishin në shek e XV[20].

Së fundi është konstatuar se në fund të shek. XVI, në zonën e Pejës dhe të Altun-ilisë, në fshatrat ku mbizotëronte antroponimia shqiptare, islamizimi ka qenë një proçes i zhvilluar[21].

Në ditët tona në komunën e Deçanit dhe të Gjakovës pjesa dërmuese e banorëve vazhdojnë të jenë shqiptarë. Në vitin 1971 në komunën e Deçanit kishte 94,2% shqiptarë ndërsa në atë të Gjakovës 93,1%[22].

II. Pozita e vendbanimeve. Kushtet natyrore-gjeografike dhe ekonomia.

Në ditët e sotme Strellci i Epër bën pjesë në Komunën e Deçanit ndërsa Nivokazi në atë të Gjakovës. Në vështrimin fiziko-gjeografik fshatrat e këtyre komunave hyjnë në pellgun e Drinit të Bardhë. Ndërsa Nivokazi ndodhet në basenin e Erenikut, Strellci përfshihet në atë të Bistricës së Deçanit. Për këto basene tradita popullore njeh si kufi ndarës Qafën e Shkozës. Në perëndim të tyre ngrihen malet e Shkëlzenit dhe të Junikut. Në Erenik, që përgjithësisht përshkon krahinën e Rekës, derdhen edhe mjaft burime dhe afluentë të vegjël. Prurjet e tyre të gurta e të rrëmbyeshme, kanë sjellë përherë me vete aluvione, të cilat në zonat e rrjedhjeve të «qeta», janë depozituar, duke formuar rrafshina aluviale. Populli emrin «Reka e Keqe» e lidh me vërshimet e shpeshta e dëmprurëse të Erenikut.

Vërshimet e depozitimet në këtë zonë paraqiten me karakter shekullor. Një pjesë e mirë e fshatrave, në periferi të Rrafshit të Dukagjinit, janë vendosur në terrene të tilla të formuara nga shtresa të trasha e të hershme aluviale. Karakteristikë e këtyre fshatrave në ditët tona është se ato janë të mbledhura[23], dhe me gjelbërim të mirë. Të tillë fshatra vëren, përveçse në rrëzën e Bjeshkëve të Nemuna, edhe buzë rrugës Pejë-Gjakovë. Tipik në këtë drejtim është konsideruar edhe Strellci[24]. Dukuria e mësipërme, lidhur me karakterin e trojeve ku janë vendosur vendbanimet, ka favorizuar zhvillimin e bujqësisë. Jo rastësisht është vënë re se në rrafshinat aluviale të Rekës, sidomos misri jep relativisht prodhim të lartë[25].

Burimet e ujit, lumenjtë dhe përrenjtë janë shfrytëzuar edhe për mullinj e dërstila. Për dërstila sidomos kanë qenë të përmendur Juniku dhe Vokshi. Mullinjtë ishin të vendosur në katin përdhe të banesës ose në ndërtesë të veçantë. Duke filluar qysh nga Gjakova në lumin Erenik dhe në lumin Trava, ka pasur mullinj të shumtë. Në popull njihen katër lloje mullinjsh: **«me tre gurë», «me dy gurë», «me një gur»** dhe **«mulli-mokër».** Ky i fundit ndërtohej në mal, përdorej në rast luftrash e rreziqesh dhe punonte «në të thatë». Ai kishte një mokër me përmasa të mëdha që mund të vihej në lëvizje nga dy deri tre vetë. Këta mund të bluanin e shumta nga 10 kg. secili në ditë[26].

Klima dhe faktorë të tjerë gjeografikë e natyrorë, kanë ndikimet e tyre në drejtime e degë të caktuara të ekonomisë tradicionale. Ato kanë favorizuar, p.sh., rritjen e kultivimin disi më shumë të kulturave të tilla të «lagështa» si misri, pemët, perimet etj; ndërsa ujrat e rrjedhëshme, kanë lehtësuar disi përballimin e stinës së thatë.

Një rol të rëndësishëm në jetën e banorëve të këtyre anëve, kanë luajtur edhe bjeshkët. Përpjekjet për shfrytëzimin e tyre brenda kushteve e mundësive, përbëjnë një dukuri me tradita që vazhdon ende në ditët tona. Nuk është e rastit që gati çdo fshat i Rrafshit të Dukagjinit, i ndodhur në afërsi, ose në rrëzë të bjeshkëve, ka pasur me kohë pjesën e vet, kullotat dhe pyllin e vet[27]. Madje populli i ka «përjetësuar» këto pjesë edhe me emrat e atyre që i kanë shfrytëzuar tradicionalisht. Kështu, dëgjon të flitet rëndom e natyrshëm nga të moshuarit: «Bjeshka e

20) S. Pulaha; **Elementi shqiptar sipas onomastikës së krahinave të Sanxhakut të Shkodrës në vitet 1485-1582.** «Shqiptarët dhe trojet e tyre», Tiranë, 1982, f. 361. Nikovazi si fshat përmendet në faqen 344 të këtij punimi.
21) **Po aty,** faqe 362.
22) Zhvillimi i Kosovës; 1966-1977, Prishtinë 1978, faqe 339.
23) Q. Lleshi, **Gjakova dhe rrethi i saj,** Përparimi nr. 6. Prishtinë 1959, faqe 418.
24) M. Krasniqi; **Tipizimi i katundeve në Kosovë e Metohi,** «Përparimi» 1-2, Prishtinë 1962; faqe. 13.
25) Q. Lleshi, Gjakova..., **Vep. cit,** faqe. 426.
26) Populli edhe sot kujton rigjallërimin e mullinjve «mokër» sidomos në kohën e Austrisë, në vitet njëzet të shekullit tonë. Austria bllokoi të gjithë mullinjtë me ujë dhe fshatarët u detyruan të kthehen tek kjo formë e vjetër e primitive e blojes.
27) Shih, edhe **Kosovo nekad i danas,** Grup Autorësh, Beograd, 1973, faqe. 627-628.

Pojoz

Deçanit», «Bjeshka e Vokshit», «Bjeshka e Strellcit» etj.

Këto bjeshkë janë të veshura me bimësi. Fjala vjen, pjesa malore e Deçanit hyn në radhën e viseve më të pasura me pyje. Bimësia paraqitet e ndarë në tre breza kryesorë. Në rrëzë të maleve e deri e shumta 1000 m mbi nivelin e detit, shtrihet brezi i gjetherënësve. Më lart vjen brezi i konifereve, ndërsa brezin e fundit e zë formacioni i barit[28].

Bjeshkët janë shfrytëzuar si kullota verore. Për qëllime të tilla atje janë ndërtuar e ndërtohen stane. Populli njeh dy lloje stanesh: **stanet e ulta,** dhe **stanet e epra.** Të parat ngrihen në lartësinë mbidetare rreth 1400-1500 m, ndërsa të eprat arrijnë deri në kuotën 1900 m[29]. Tradicionalisht në stanet e ulta shkohet nga fundi i pranverës. Të moshuarit e Strellcit thonë: «në stane shkohet në muaj të Shëngjergjit». Në këto stane merret me vete edhe një pjesë e familjes, për të cilën ndërtohej një banesë përdhese me një ose dy kthina ku jetonin edhe barinjtë. Kjo banesë njihet më shumë me emrin **tëbanë.** Pranë saj ndërtohej edhe një vathë për bagëtinë, e njohur me emrin **«torishtë».** Këto ndërtime realizohen me lëndë druri dhe kanë karakter përdorimi stinor. Në stanet e epra shkohet vetëm nga mesi i verës dhe qendrohet deri aty nga muaji tetor. «Kur sosej vera e nuk kishte më bar, ktheheshim nga stanet», thonë të moshuarit e Strellcit[30].

Një praktikë e tillë, e njohur që herët në këto anë, vazhdon deri në ditët tona. Këtu është fjala jo vetëm për fshatrat në shqyrtim e pellgun ku ndodhen ata, por edhe për zona të tilla malore siç është Rugova. Në fshatrat e kësaj zone pjesa më e madhe e familjeve ngjiten në stanet e ulta. Atje ndërtojnë tëbanën dhe torishtën (Fig. 1). Vendosja e familjeve pranë e pranë të krijon përshtypjen e mëhallave të vogla me ndërtime përdhese prej druri. (Fig. 2 dhe Foto 1).

Të gjithë faktorët që përmendëm, kanë lënë gjurmën e tyre në pozicionin e vendosjes së vendba-



Fig. 1

28) Q. Lleshi, Deçani, **Vështrim antropogjeografik** «Përparimi», 1-2 Prishtinë 1960. faqe 75.
29) Q. Lleshi, **Vendbanimet në Kosovë-Metohi,** «Përparimi, Nr. 4; Prishtinë 1960, faqe. 265-266 etj.
30) Në korrik të vitit 1980 pata rastin të shkoj në fshatin Bogë të Rugovës. Përveç studjuesve nga Kosova ishin edhe etnografët F. Haxhiu e A. Dojaka. Pjesa më e madhe e familjeve ishin ngjitur në stane. Ne bëmë një vizitë të shkurtër në stanin e ulët të një familjeje, ku u takuam me disa nga antarët e saj. Ajo nuk ishte e vetmuar. Në afërsi ishin vendosur edhe disa familje të tjera, aq sa të krijohej përshtypja e një mëhalle të vogël fshati. Aty mësuam se barinjtë me bagëtinë kishin kaluar në stanet e epra.

DO NOT COPY



Fig. 2

nimeve dhe në karakterin e ekonomisë. Këto dukuri vërehen qartë në Strellc. Ai, i marë në tërë shtrirjen e tij, përbëhet nga bjeshka në krye, më poshtë vjen fshati si truall i ngushtë banimi dhe arat e livadhet. Të moshuarit e Strellcit dinë ende të tregojnë me saktësi përbërësit dhe kufijtë e kësaj tërësie. Shtrirja e këtij vendbanimi, është një dëshmi bindëse e karakterit të dyfishtë bujqësor e blegtoral të ekonomisë. Arsyetime të tilla mund të bëhen edhe për Nivokazin. Ndonëse shtrihet në rrafsh dhe ndodhet jo në rrëzë të bjeshkëve, ai ka pjesën e tij atje, që e ka përdorur për ato qëllime si edhe fshatrat e tjerë. Bjeshka e Nivokazit ndodhet midis bjeshkës së Botushës dhe asaj të Junikut.

Megjithë kushtet e favorshme gjeografike-natyrore është vërejtur në ditët tona, se bujqësia dhe blegtoria, ushtrohen pa organizime e veprime të gjera shkencore e të planifikuara. Shembull tipik në këtë drejtim përbëjnë vendbanimet e komunës së Deçanit. Kjo komunë hyn në radhën e më të pazhvilluarave në Kosovë[31]. Mjafton të kujtojmë që të ardhurat mesatare për një banor në këtë komunë janë dyfish më të vogla se mesatarja në tërë Kosovën[32]. Nuk është e rastit që mjaft banorë të saj kanë shkuar për punë në Gjermaninë Perëndimore, Austri, Zvicër etj. Nga ky fenomen nuk ka bën përjashtim as Strellci[33].

III. Karakteri i vendbanimeve. Roli i faktorëve shoqërorë dhe Historikë

Strellci i Epër dhe Nivokazi, paraqiten si fshatra të grumbulluar. Prej tyre më shumë na ka tërhequr vëmendjen Nivokazi, i cili është vendosur në një terren krejt të rrafshët. Për nga numri i banesave më



Foto 1

31) Kosovo nekad i danas, **Vep. cit,** f. 630-631.
32) **Po aty,** faqe 630.
33) A.E. Dok. 929/47.

DO NOT COPY



Fig. 3

i madh është Strellci, i cili në vitin 1972, numëronte 300 të tilla[34].

Nivokazi në prag të luftës së dytë botërore nuk ka pasur më shumë se 40 shtëpi. Banesat në të dy fshatrat janë të grupuara në mëhalla, por nuk përjashtohet edhe prania e banesave të veçuara. Ndërmjet banesave që i përkasin një mëhalle dhe ndërmjet vetë mëhallave ka toka, shumica të punueshme, një pjesë e të cilave shfrytëzohen për drithra ose si kopshte e bahçe për perime e pemë. Në periudhën e verës gjelbërimi është i dendur. Më tipik në këtë drejtim është Nivokazi. Rrugët përgjithësisht jo të drejta (Foto 2) dhe të gjëra, ndajnë mëhallat nga njëra-tjetra, ose veçojnë grupe banesash. Ndodh që muret rrethuese të oborreve të banesave kufizojnë këto rrugë kalimi (Fig. 3). Në këto raste në përgjithësi banesat i tregojnë «shpinën» rrugës, duke pasur lidhje të drejtpërdrejtë me të nëpërmjet portave të hyrjes, karakteristike jo vetëm në këto fshatra, por në mbarë Rrafshin e Dukagjinit (Foto 3).

Është e njohur që fshatrat e Rrafshit të Dukagjinit përbëhen në shumicën dërmuese, nga një ose disa fise. Këtë dukuri e shohim edhe te grupi i fshatrave ku bën pjesë Strellci i Epër. Kështu, në këtë grup, vërejmë fshatra të përbërë nga një fis i vetëm siç janë: Strellci i Epër (Krasniqe), Strellci i Poshtëm (Shaljanë), Lëbusha (Kastrat). Të tjerë fshatra të këtij grupi përbëhen nga tre deri në pesë fise. Të tillë janë: Logja (Morinë, Shalë, Kastrat), Prapaçani (Shalë, Krasniqe, Berishë), Luboniqi (Krasniqe, Berishë, Morinë, Thaç, Gash), dhe Raushiqi (Kastrat, Morinë, Krasniqe, Berishë dhe Shalë)[35]. Në Nivokaz mbizotërojnë gashjanë, por nuk mungojnë edhe Krasniqe. Ndërsa në Junik është vërejtur prania e tetë fiseve[36]. Mjaft nga këto fise që takojmë aktualisht në Kosovë, kanë vazhdimësi edhe brenda kufijve të sotëm politikë të Shqipërisë. Prania e të njëj-



Foto 2



Foto 3

34) Po aty,
35) Po aty.
36) Kosovo nekad i danas, faqe. 259.

DO NOT COPY

tit fis në më shumë se një fshat, dëshmon se në rrjedhë të historisë ka pasur lëvizje të brendshme të popullsisë, kryesisht brenda trojeve etnike të saj, dukuri kjo e njohur jo vetëm në këtë trevë.

Në fshatrat e Rrafshit të Dukagjinit janë të pranishme thuajse kudo **vëllazëritë.** Fjala vjen në Strellc (që përbëhet nga fisi Krasniqe) kemi dy të tilla: **Nikaj** dhe **Curri.** Prania e vëllazërive brenda kuadrit të fiseve në zonën e Rekës është vërtetuar edhe nga të dhëna gjuhësore[37]. Mbiemra të tillë karakteristikë si Ibërhysaj, Osdautaj, Rexhademaj etj, flasin pikërisht për ekzistencën e vëllazërive brenda fiseve.

Vëllazëritë më në zë, formojnë bazën e rritjes dhe zgjerimit në çdo fshat të mëhallave. Kështu në Strellc të Epër, mbi bazën e vëllazërive Nikaj dhe Curri, kemi të pranishme dy mëhalla, prej të cilave më e madhe është ajo e Nikajve. Ndërsa në ndonjë fshat, ku është i pranishëm një numër i madh fisesh, mëhallat kryesore janë formuar deri edhe mbi bazë fisi. Një dukuri e tillë vërehet në Junik, ku nga tetë fise të pranishme, janë formuar gjashtë mëhalla. Në disa raste studiuesit kanë vërejtur se mëhallat kanë marrë përveç emra familjesh në zë dhe emërtime gjeografike[38]. Ndodh që mëhalla të caktuara të fshatrave janë shkëputur nga fshati mëmë dhe kanë formuar fshat më vete. Kjo dukuri është vërejtur në ato raste kur mëhalla për nga vetë pozicioni i saj, disi larg nga pjesa tjetër e fshatit, e favorizonte shkëputjen.

Një dukuri tjetër shoqërore, është edhe prania e familjeve të mëdha dhe nga ana tjetër, proçeset e shpërbërjes së tyre të herëpashershëm[39]. Ndërsa prania e familjes së madhe ka çuar edhe në praninë e kompleksëve të mëdha të banimit, shpërbërja e saj ka qenë një nga burimet e rëndësishme, që ka ndikuar në rritjen e mëhallave. Familjet e reja të ndara nga familja mëmë, përveç rasteve që jetojnë për një kohë edhe nën një çati me të, janë vendosur në afërsi të kësaj të fundit. Terreni i përshtatshëm i ka favorizuar dukuri të tilla.

Familja e madhe është ende në ditët tona një fenomen që vihet re në këtë zonë. Duke iu referuar Strellcit, në vitin 1972 rreth 90% e familjeve ishin me mbi 5 antarë. Në këtë fshat ka pasur familje edhe me 15 kurorë[40]. Kjo është një dukuri jo vetëm e këtij fshati. Thuajse në të gjithë fshatrat e Deçanit e të Gjakovës ka ende mjaft familje të mëdha që kanë edhe 30-60 antarë në përbërjen e tyre[41]. Është vërtetuar edhe prania e familjeve të veçanta akoma më të mëdha. Tipike në këtë drejtim është familja e H. Shehut në fshatin Nivokaz, që i kishte kaluar të 100 antarët[42]. Në vitin 1962, ajo ka pasur 90 antarë[43]. Po të jetë kështu, kjo familje aktualisht paraqitet si një nga më të mëdhatë në Kosovë. Po ashtu familja e Zh. Hasanit në Dushkajë të Gjakovës më 1959 ka pasur 92 antarë[44]. Sipas një raporti të një ekspedite shkencore të vitit 1977, është gjetur në një fshat të Hasit një familje me 123 antarë[45]. Një tjetër në Has në vitin 1973 ka pasur 98 antarë[46].

Prania e familjes së madhe në Kosovë, nuk është një «mbetje» që vazhdon të qëndrojë për inerci, ose thjesht për forcë të traditës. Në radhë të parë këto janë shkaqe të natyrës ekonomike, por jo më pak të rëndësishme janë edhe arsyet shoqërore, historike e deri etnopsikologjike[47].

Nuk është e rastit që me gjithë ato kushte të favorshme gjeografike e natyrore, degët kryesore e jetike të ekonomisë karakterizohen nga prania e pronës së vogël dhe nga mos aplikimi në gjërësi i masave të përparuara agroteknike. Madje në kushtet e gjendjen e fshatit kosovar familja është e detyruar ende që mjaft nga nevojat e jetesës t'i zgjidhë brenda ekonomisë shtëpijake. Copëzimi i familjes do të sillte me vete edhe copëzimin e pronës, gjë që e

37) M. Krasniqi, **Gjurmë e Gjurmime,** Prishtinë, 1979, f. 117.
38) M. Krasniqi, **Tipizimi i katundeve...., Vep. cit,** faqe. 14.
39) Për sa thamë po sjellim një shembull nga Strellci i Epër. Familja e H. Zenelit në fillim të shekullit tonë numëronte 50 antarë. Aty nga fillimi i viteve 30, ajo u nda në tri pjesë dhe në fillim të viteve 60-të, të tjera familje të reja dolën prej saj. Kështu, deri në vitin 1972, vetëm prej këtyre familjeve ishin krijuar 6 shtëpi të reja. Vetëm njëra prej këtyre familjeve të ndara numëronte 15 veta në vitin 1972. Për këtë shih. në A/E, Dok. 929/47.
40) A.E. Dok. 929/47.
41) M. Krasniqi, **Gjurmë e Gjurmime,** vep. cit. f. 204-205.
42) Gjatë qëndrimit aty mësova se pranë kësaj familjeje kishte qëndruar një periudhë një studiues nga vendet nordike, duke përjetuar nga afër karakterin, jetën dhe strukturën organizative të kësaj familjeje.
43) **Kosovo nekad....,** faqe 270.
44) M. Krasniqi, **Gjurmë e gjurmime,** faqe 205.
45) **Rezultatet e një ekspedite kërkimore-shkencore në teren,** «Gjurmime albanologjike» Seria e shkencave filologjike, VII-1977, Prishtinë 1978 faqe 227.
46) M. Krasniqi, **Gjurmë.....,** faqe 251.
47) **Po aty,** faqe 221.

Dokument

dëmton familjen ekonomikisht. Në këto rrethana familja fshatare në Kosovë e ndjen nevojën që të ketë sa më shumë krahë pune. Krahu më i sigurt i punës është djali se ai edhe mbas martesës mbetet në shtëpi. Është e njohur shprehja: «Nuk është zot shtëpie ai që ka qe, por ai që ka djem»[48]. Kjo shprehje me një gjuhë të qartë e konçize popullore, le të nënkuptosh se shtëpinë e familjen nuk e mbajnë «qetë» por në radhë të parë njerëzit. Kjo është njëra anë që tregon se kërkesa për meshkuj është parë si një domosdoshmëri ekonomike. Një anë tjetër të saj e nxjerr në dritë vetë historia e Kosovës. Kjo histori është dëshmitarja më e paanshme që tregon se, pa mohuar rolin e jashtëzakonshëm të femrës, mashkulli është dashur sa për punë, aq edhe për luftë kundër çfardo lloj pushtuesi.

Nga i gjithë materiali që parashtruam del e qartë se në fizionominë e fshatrave kanë lënë gjurmë, prania e fiseve, vëllazërive dhe e familjes së madhe. Jeta ka treguar se në rrjedhë të historisë kohezioni ndërmjet këtyre hallkave ka qenë, para së gjithash, nevojë. Ky kohezion, në tërë mënyrat e shfaqjes së tij, ka lënë gjurmën e vet në karakterin e vendbanimeve. Kushtet fiziko-gjeografike kanë favorizuar dukurinë e mësipërme. Sundimet e huaja, turbullirat, shqetësimet e trazirat që ato kanë bartur e bartin me vete, e kanë diktuar dhe kthyer këtë kohezion në një nevojë jetike. Është ky kohezion që ka luajtur e luan një rol të rëndësishëm si mburojë ndaj luftës për çkombëtarizim dhe asimilim që ka zhvilluar pa ndërprerje edhe borgjezia serbomadhe e vjetër apo e re qoftë.

IV. **Tradita ndërtimore. Materialet, mjeshtrit dhe teknika e ndërtimit**

Materiali i mbledhur dëshmon se ndërtimet popullore në Strellc e Nivokaz shënojnë arritje të rëndësishme. Prapa këtyre ndërtimeve, që nuk janë as akt i njëhershëm ndërtimor dhe as të së njëjtës shkallë realizimi, gjen shprehjen e vet një traditë, jo vetëm e pasur por edhe e qëndrueshme në kohë.

Qënia ende në këmbë e mjaft banesave të vjetra, që i përkasin shekullit të kaluar flet për dy dukuri të rëndësishme: **Së pari** në soliditetin e tyre kanë luajtur rol materialet ndërtimore si: guri dhe druri. Burime për sigurimin e gurit kanë qenë e mbeten shtratet e lumenjve dhe të përrenjve. Gati secili fshat ka pasur «zallin» e tij. Aty fshatarët kanë siguruar përveç gurit dhe rërë e zhavorr. Ky lloj guri është përdorur gjërësisht në Nivokaz, jo vetëm në banesa, por edhe në muret rrethuese. Një burim tjetër i rëndësishëm dhe përherë i shfrytëzueshëm për gurë, kanë qenë rrëzët e bjeshkëve. Në rrëzë të bjeshkëve duhet të ketë disa lloje gurësh. Fjala është jo vetëm për gurin e zakonshëm gëlqeror, por edhe për gurë dekorativë. Në vendet më të rëndësishme të mureve të banesës janë përdorur edhe gurë me ngjyrë siç është fjala për një gur me ngjyrë pembe, disi si rozë. Këto lloj gurësh, sipas shenjash duhet të jenë punuar relativisht me lehtësi, gjë që ka favorizuar përdorimin e tyre. Të tillë me ngjyrë të bardhë e rozë (pembe) janë përdorur në banesat e Nivokazit. Ato siguroheshin në «Shkozën e Botushës», e ndodhur në mes të Botushës dhe Mulliqit. Në rrëzë të saj ka gur me ngjyrë që shfrytëzohet jo vetëm nga Nivokazi, por edhe nga Botusha, Brovina e deri në Punashec. «Gurorja» nuk është më shumë se një orë larg nga Nivokazi. «Kalo Erenikin me ker e bi m'ta», thotë populli.

Një material tjetër që ka gjetur përdorim të gjerë në ndërtimet popullore është edhe druri. Burim i rëndësishëm kanë qenë pyjet e pasura të bjeshkëve. Përdorimi i gjërë i drurit fillon që nga ndërtimet e thjeshta me karakter stinor dhe arrin deri tek elemente të rëndësishëm konstruktivë e arkitektonikë të banesave. Fushë të gjërë përdorimi, ai ka pasur në orendi e pajisje të brendëshme. Për këto tradita mëson mjaft gjëra me interes edhe në Strellc. Banorët të flasin natyrshëm për mjaft nga llojet e drurëve, vendin e qëllimin e përdorimit dhe cilësitë e secilit. Ato njohin e përdorin drunj të tillë si: gështenja, ahu, çetina, molika, bunga, lajthia, qarri, shkoza, etj. Drurin e gështenjës e quajnë si-



Foto 4

48) Shih edhe Kosova nekad... fq. 269.

DOKTORATË

domos të përshtatshëm për trenj dyshemeje, po ashtu për dyer e dritare. Druri i çetinës i reziston mirë lagështirës dhe përdoret për pajisje e orendi të tilla si tinarë, korita, lugje etj. Ai përdoret gjithashtu në ndërtimin e koshave të drithit dhe të dyerve të oborreve. Ahu që ka vetinë të çahet drejt, përdoret gjërësisht në banesa, veçanërisht në elemente zbukurimoré. Kur është fjala për bungën, druri i tij duke qenë i fortë pëlqehet ashtu si ai i gështenjës, për trarë dyshemeje ose çatije. Ndërsa thuprat e lajthisë përdoren në gjerdhe oborresh apo për të realizuar kosha të ndryshëm me thurje. Po ashtu në formë thuprash, për gjerdhe përdoret edhe shkoza. Për hunjtë e gjerdheve ka qenë i kërkuar gjithashtu druri i dëllinjës, sepse është i fortë dhe i reziston lagështirës.

Në këto fshatra njihet mirë e gjërësisht edhe përdorimi i gëlqeres, duke u prodhuar nga vetë vendasit. Në Nivokaz janë përgatitur në vend edhe tjegullat e lugta. Kjo traditë vazhdon deri në ditët tona, ndonëse ka filluar përdorimi i tjegullave të fabrikës që blihen në treg.

Për transportimin e këtyre lëndëve nga vendi i marjes deri në truallin e ndërtimit, ka një traditë të hershme që vazhdon të përdoret deri në ditët tona. Lënda e drurit për ndërtim pritet në periudha të caktuara të vitit, dhe pasi i hiqet lëvozhga në vendin e prerjes, që «të mos e hajë krimbi», transportohej pranë truallit ku do të realizohej ndërtimi. Ajo nuk përdorej me tu prerë; por lihej për tu tharë të paktën 6 muaj e deri në një vit. Për transportimin e saj nga bjeshka në rrafsh shfrytëzohej pjerrësia e terrenit. Pastaj me anë pajisjesh (Foto 4) të ndërtuara në formë slitash, lënda tërhiqej ose me kafshë ose nëpërmjet lumenjve, në ato zona ku ishte e mundur[49]. Për transportimin e materialeve përgjithësisht e të lëndës së drurit veçanërisht zbatohet ende tradita e vjetër e ndihmës kolektive[50]. Për transport është përdorur gjërësisht edhe qerrja me katër rrota. Gëlqerja pasi sillej në vendin e ndërtimit, hidhej në gropa të hapura posaçërisht dhe pasi shuhej, mbulohej me dhe. Koha më normale e qëndrimit të gëlqeres në gropë ishte pesë vjet. Kjo bënte që gëlqerja të siguronte cilësinë e ndërtimeve.

Qënia ende në këmbë e mjaft banesave të vjetra në këto fshatra flet edhe për një dukuri të dytë, po aq të rëndësishme. Përdorimi i materialeve të



Foto 5

forta e të qëndrueshme në ndërtim ka rëndësinë e domethënien e vet. Por ajo që i ka bërë ndërtimet të qëndrojnë në kohë, duhet parë e lidhur në mënyrë mjaft organike edhe me mjeshtrin ndërtues. Në banesat e të dy fshatrave, duket se dora ndërtuese ka bartur mbi «supet» e veta një përvojë të gjatë pune mjeshtërore. Disa nga këto ndërtime radhiten ndër realizimet më të arritura jo vetëm të banesës popullore në Kosovë, por në mbarë banesën fshatare shqiptare të trashëguar nga e kaluara.

Në të dyja këto fshatra ashtu si në mbarë Rrafshin e Dukagjinit, kanë punuar mjeshtrit e njohur të Shqipërisë Verilindore, dibranët. Këta mjeshtra vinin gjithnjë në formë grupi. Ata vinin nga fundi i prillit dhe largoheshin aty nga fundi i tetorit. Disa nga emrat e mjeshtërve më në zë kujtohen edhe sot. Me mjeshtrin dibran, ndërtonin vetëm banesën si karabina. Punimet e brendshme në banesë, kryesisht elementet prej druri, dhe ndërtimet ekonomike në oborr, janë bërë me mjeshtra brenda krahinës. Ndërkohë, edhe më parë, por veçanërisht në dekadat e fundit, kanë filluar të ushtrojnë mjeshtërinë e muratorit edhe njerëz nga vetë fshatrat e këtij pellgu. Kjo është karakteristike sidomos e familjeve të mëdha. Në këto familje vërehet prania e mjeshtërve me profesione të ndryshme. Ata punojnë e plotësojnë në radhë të parë nevojat e brendshme të familjes[51].

49) Një praktikë e tillë është e njohur, fjala vjen, edhe në fshatin Junik. Për këtë shih edhe Q. Lleshi, **Juniku..., Vep. cit,** faqe 85.
50) Shih edhe A.E....., dok. 1037/17.
51) M. Krasniqi. **Organizimi i jetës shoqnore në një familje të madhe në rrethin e Pejës.** «Përparimi» Nr. 5; Prishtinë, 1959. Vetëm brenda kësaj familjeje autori i artikullit në fjalë ka gjetur katër muratorë dhe pesë zdrukthëtarë.

Mjeshtër të punimit të drurit ka pasur dhe ka sot e kësaj dite në fshatrat që shqyrtojmë[52]. Në Strellc kanë qenë të njohur në punimin e drurit mjeshtër nga familja Hocaku[53]. Po ashtu i njohur nga ky fshat ka qenë edhe Sadik Sadria, veçanërisht për cilësinë e lartë artistike me të cilën përgatiste kutitë e kafesë[54]. Siç është vënë në dukje nga studjuesit kosovarë, mjeshtra të punimit të drurit ka pasur e ka sidomos në fshatrat rrëzë Bjeshkëve të Nemuna, qoftë në Rekë e Voksh ashtu edhe në rrethinat e Pejës, përfshirë dhe Strellcin[55].

Përvoja e gjatë në punimin e drurit duket në ele-



Fig. 4

52) Përveç pohimeve të banorëve, në Nivokaz, në vitin 1977 pata rast të shoh në punë e sipër një mjeshtër të vjetër, që po punonte për zbukurimin e një ode të re miqsh. Ndonëse i moshuar ai po nxirrte nga duart e tij një punë me të vërtetë mjeshtërore. Mjeshtri që i kishte kaluar të 60-tat qysh në rini ishte marë me këtë punë.
53) M. Krasniqi. Gjurmë e gjurmime, **Vep. cit,** faqe 459.
54) **Po aty,**
55) **Po aty,** faqe 458-459.

BOOK COPY

DO NOT COPY



Foto 6



Foto 7

mentet funksionalë, arkitektonikë e konstruktivë të banesës, siç janë dyshekllëket prej druri, portat, dyshemetë, shkallët dhe në mjaftë orendi dhe pajisje. Kjo traditë duket në ndërtimet ekonomike në oborr, e deri tek ato me karakter stinor në stane. Kujtdo që ka pasur rastin të shohë një oborr banese fshatare në Rrafshin e Dukagjinit nuk mund të mos i ketë lënë mbresë ndërtimi i koshit për drithë. (Foto 5). Një nga dukuritë që të tërheq vëmëndjen në ndërtimin e tij është përdorimi i purtekave për gardh, jo një nga një por në formë tufe. Këto tufa të valëzuara i japin mjaft bukuri ndërtimit, duke të lënë përshtypjen e gërshetave të pafund.

Dukuria e dytë duhet parë e lidhur me përdorimin e një teknike ndërtimi të tillë që ndihmonte në jetëgjatësinë e ndërtimeve. Kjo dukuri sigurisht nuk mund të shihet e shkëputur prej mjeshtrit ndërtues, i cili vërtet realizonte kërkesat e porositësit, por përvoja e tij kishte vendin e saj të merituar.

Këtu duam të vëmë në dukje dy gjëra. Përdorimi i llaçit të gëlqeres në muraturën e gurit përbën një dukuri shumë të rëndësishme. Veçanërisht cilësia e lartë e gëlqeres në kushtet kur është përdorur edhe guri i lumit për ndërtim, e ka thënë fjalën e vet. Po ashtu punimi i kujdesshëm i qosheve dhe i kornizave nën çati, apo i hapsirave të dyerve dhe të dritareve janë disa nga dukuritë që flasin për përvojë të pasur në fushën e artit të të ndërtuarit. Një dukuri tjetër është edhe realizimi i strukturave të qëndrueshme qoftë në çati, qoftë në strukturat mbajtëse ndërmjet kateve. Edhe në këto dukuri zgjedhja e materialit dhe realizimi i strukturave kërkonte një përvojë të mirë në njohjen e vetive statike të drurit, dhe realiteti tregon se kjo nuk ka munguar. Mjeshtri zakonisht i donte të gatëshme pranë vendit të ndërtimit, sidomos gëlqeren e shuar, gurin dhe lëndën e drurit. Të moshuarit vënë në dukje se ustai i kërkonte të zotit të shtëpisë sa ta bënte trashësinë e themelit. Ky i fundit hiqte pushkën nga krahu dhe thoshte: «Themeli të jetë i trashë nga shuli i pushkës e deri tek gryka» pra, të paktën 80 cm trashësi. Po ashtu ustai kërkonte të dinte në se i zoti i shtëpisë kishte siguruar lëndë të fortë për çati. Elementët kryesorë të kësaj të fundit bëheshin prej gështenje ose frashëri. Më shumë preferohej gështenja se «nuk lakohet» dhe «nuk e han gja» pasi «asht e hidhët» që do të thotë se asaj nuk i hyn krimbi.

V. Oborri i banesës dhe ndërtimet ekonomike.

Oborri i banesës në mbarë Rrafshin e Dukagjinit përbëhet nga sheshi ku është ndërtuar banesa me të gjitha ndërtimet ekonomike pranë ose rrotull saj (Fig. 4). Ky kompleks ndërtimi është i rrethuar me gardhe të llojeve të ndryshme ose me mure guri. Oborri i banesës e ka sipërfaqen e madhe. Po ashtu rrethimi i tij nuk bëhet njëlloj nga të gjitha anët si nga përkujdesja, ashtu dhe nga lloji i materialit të përdorur. Për nga lloji i materialit, rrethimet më të thjeshta të oborreve janë ato me gardhe ferrash ose shkurresh të prera. Një mënyrë tjetër rrethimi ku zakonisht fillon e rritet edhe shkalla e përkujdesjes janë ato me gardhe purtekash.

Ky lloj gardhi bëhet i lartë dhe njihet me emrin «gardh kunorë». Purtekat përdoren të holla e në formë tufe si në rastin e koshave të misrit. Në mjaft

DO NOT COPY



Foto 8



Foto 9



Fig. 5

raste, sidomos nga familjet e varfëra, ky lloj gardhi kombinohej me ferra, duke bërë të vështirë kapërcimin e tij. Këto forma rrethimi të oborrit vazhdojnë të përdoren edhe në ditët tona veçse ato i gjen të kombinuara ose ndërmjet tyre ose me rrethimin me mure guri. Rrethimi me mure guri ka fituar me kohë përparësi të dukshme (Foto 6), sidomos në ato anë të oborrit që familja e ka ndjerë pasigurinë. Lartësia e këtyre mureve ka arritur deri në 2.5 m. Kur familja pranë banesës ka edhe ara, bahçe e kopshtije, në varësi të ndodhjes së tyre e të lidhjes së oborrit me to, rrethimi i këtij të fundit nga ai krah bëhet më i ulët dhe jo me të njëjtën shkallë përkujdesjeje. Në këto raste një rrethim i sigurtë bëhet më në thellësi, ku mund të përfshihet edhe kopështi brenda. Kufizimi i oborrit të banesës nga ana e kopshtit bëhet edhe me gardh të ulët, që në gjuhën e popullit quhet **gardh lepurak** (gardh që e kapërcen lepuri). Gardhi nuk qendron më shumë se 5-6 vjet, prandaj herë pas here ribëhej pjesë pjesë. Në ndonjë rast rrethimit me gardh i bëhej strehë në formën e një çatije dyflegërshe. Për parandalimin e hyrjeve nga gardhi, hunjt në pjesën e sipërme bëheshin me majë.

Forma e rrethimit më karakteristike dhe më solide, e përdorur në këto dy fshatra dhe në mbarë Rrafshin e Dukagjinit është ajo me mure guri. Ky mur si nga materiali nga teknika dhe nga shkalla e përkujdesjes, nuk mbetet më mbrapa atyre të banesës (Foto 7). Një dukuri të tillë e gjejmë shpesh në Nivokaz. Lartësia dhe gjatësia e madhe, dëshmon që për realizimin e mureve familja ka qenë e detyruar të bënte shpenzime jo të vogla. Vërtet është përdorur materiali rrethanor, por shpenzimet për realizimin e mureve me gurë kanë qenë më të mëdha se të atyre me gjerdhe. Përdorimi i tyre lidhet edhe me kushtet e pasigurisë shoqërore.

Më shumë përkujdesje në realizimin e murit rrethues u kushtohet qosheve dhe hapsirave ku lihen portat. Po ashtu në shumicën e rasteve muri mbulohet me tjegulla, duke realizuar një çati të thjeshtë dyflegërshe. Vëmëndjen në muret rrethuese ta tërheqin portat. Ato, qoftë në Nivokaz ashtu edhe në Strellc, karakterizohen nga i njëjti konceptim dhe thuajse nga e njëjta përkujdesje. Përveç banesës, brenda oborrit përfshihen edhe një numër ndërtimesh ekonomike. Numri, karakteri, qëllimi i përdorimit dhe shkalla e realizimit të tyre ndryshon në varësi të gjendjes ekonomike të familjes. Në ndërtime të tilla hyjnë: **koshi për misër, pozllomi** ose shtalla, **hambari për drithë, çaraniku** ose (fllaniku) **lama e sanës** etj. Prej tyre gjithnjë të pranishëm janë koshi për misër dhe pozllomi (ose shtalla).

1. **Koshi për misër** (Foto 8). Shpesh quhet edhe



Foto 10

koshi i drithit e sidomos **koshi i kollomoqit,** pasi tradicionalisht aty është mbajtur misri në formë kallinjsh të pa shkoqur. Ky ndërtim për nga zgjidhja planimetrike e volumore, materialet ndërtimore dhe destinacioni, të kujton gazhdaren e përdorur në mjaft zona të vendit tonë. Konstruksioni bazë i koshit është një skelet druri i realizuar me binarë dhe i ngritur mbi një bazament me gurë (Fig. 5). Bazamenti zakonisht bëhet me mure guri të thatë. Skeleti që, vendoset mbi të, kurorëzohet me një çati dyflegërshe, që më shumë mbulohej me kashtë thekre ose tallë (quhet kashta e misrit), e deri edhe dërrasa të përgatitura në formë «lugu». Kohët e fundit, sidomos nga familjet në gjendje, kanë gjetur përdorim të gjërë tjegullat e vendit e deri edhe ato të fabrikës. Koshi bëhet rreth 1 m gjërësi e 1.5-2 m lartësi. Në gjatësi ai varion nga 5 m në 25 m. Skeleti vertikal mbajtës është i ndërthurur me binarë të hollë horizontalë, të vendosur nga brenda dhe që kapen në skelet me kllaposje. Për këtë mënyrë lidhjeje vendasit thonë: «gojohen drunjtë njëri me tjetrin». Boshllëku vishej nga brenda me gardh purtekash. Më të vonshme paraqiten rastet kur skeleti me binarë vishet nga brenda me dërrasa të ngushta në formë ripienash, më shumë të vendosura horizontalisht.

Misri futet në kosh nga sipër, nëpërmjet hapësirash të lëna posaçërisht, ndërsa zbrazja bëhet nëpërmjet dy «dyerve» të vogla të lëna zakonisht afër njërat-tjetrës, në njërën nga ballet e mëdha të koshit (Foto 9).

Pozicioni i vendosjes së koshit në oborr ndryshon. Madje ka raste që koshi mund të jetë shumë i gjatë, ose familja të ketë disa kosha të vegjël. Megjithatë për vendosjen e tij në oborr, me kohë është

Protected copy

kristalizuar një traditë, sipas së cilës ky ndërtim ekonomik shërben si një kufi orientimi për hyrjen e njerëzve në banesë. Nga njëri krah kalojnë njerëzit e shtëpisë, ndërsa nga krahu tjetër hyn miku, i cili edhe hyrjen për në banesë e ka të veçantë.

I ngjashëm për nga funksioni me koshin, është edhe **hambari i drithit.** Edhe ky ngrihet mbi një bazament me mur të thatë guri. Ndërtohet në afërsi të «lamës» për shirje, kur familja ka pasur të tillë brenda në oborr. Mbi bazamentin me gurë ngrihet një skelet druri i veshur me dërrasa të trasha. Gjatë ndërtimit tregohet kujdes për të lënë pika ajrosjeje. Me planimetri thuajse katrore, hambari brenda realizohet me disa ndarje. Këto shërbejnë për të depozituar jo vetëm grurë por edhe ndonjë prodhim tjetër, si elb, etj. Përmasat në plan mund të shkojnë 5 x 5 m, ndërsa lartësia shkon zakonisht rreth 2 m. Gruri mbahej në hambar jo nga të gjitha familjet mbarë, por nga ato që ishin në gjendje të mirë ekonomikisht. Drithi aty nuk depozitohej për përdorim të menjëhershëm. Përveç masave të domosdoshme për ajrosje natyrale dhe kontrollit të herë pas hershëm, ishte e rëndësishme që gruri të mos depozitohej para kohe, kur kokrra nuk e kishte arrirë ende pjekurinë e nevojshme në arë. Kjo kërkesë qëndronte po ashtu edhe për misrin që depozitohej në kosh.

2. **Pozllomi.** Zakonisht ndërtohet i mbështetur në murin rrethues të oborrit. Në shumicën e rasteve është përdhes, por tek familjet në gjendje të mirë ekonomike arrin dhe dy kate. Shembujt përdhes, më të përhapurit, paraqiten të mbyllur, ose pjesërisht të hapur. Në rastin e parë (i mbyllur) përdoret për mbajtjen e dhive dhe të lopëve. Në rastin e dytë (pjesërisht i hapur) realizohet me tre faqe mur dhe me ballin e përparmë të hapur. Kur pozllomi përdoret për mbajtjen e deleve, ai bëhet edhe tërësisht i hapur, vetëm me çati, pasi të moshuarit thonë se «delja nuk mërdhin». Kur pozllomi është dy katësh, kati i dytë (gjithmonë me ball të hapur) shfrytëzohej për tharjen e duhanit, i cili ka qenë kultivuar mjaft në këto anë.

Nuk përjashtohen edhe rastet kur në pozllom janë sajuar ndarje, të cilat familja i përdorte për qëllime të ndryshme. Sidoqoftë në shumicën e rasteve pozllomi të kujton një hajat të hapur në ballin e përparmë e të mbyllur nga të tri anët e tjera. Çatinë zakonisht e ka me një flegër, por ndodh që ta ketë edhe me dy të tilla. Realizimet më të thjeshta të pozllomit janë ato me gardh purtekash dhe me çati të mbuluar me kashtë. Me interes janë edhe pozllomet e realizuara me mure guri e të mbuluar me tjegulla. Vendi i vendosjes në oborr, zakonisht shihet i lidhur edhe me pozicionin e portës së hyrjes. Në mjaft raste mbahet parasysh që erërat e forta t'i bien në «shpinë». Thuajse me të njëjtat qëllime funksionale është **pojata** veçse ajo është e mbyllur nga të gjitha anët dhe vendoset më shumë pranë «lamës së sanës». Ky ndërtim përdoret sidomos për strehimin e bagtisë gjatë dimrit. Ndërtohet me gardh ose me dërrasa të trasha që veshin një skelet mbajtës vertikal. Pojata, që është përdorur si kasolle bagëtishë, të kujton ndërtimet e thjeshta për banim, përdorur nga familjet e varfëra. Gjurmët e një përdorimi të tillë janë gjetur edhe në vitin 1972 në Kosovë (Foto 10)[56]. Ndërtime të tilla si pozllomi dhe pojata janë të njohura gjërësisht e jo vetëm në këtë zonë.

3. **Çarraniku.** Ka karakter përdorimi stinor, kryesisht në verë. Këtë ndërtim ekonomik dëgjon që ta quajnë edhe fllanik. Kjo fjalë në Rrafshin e Dukagjinit me sa duket ka hyrë vonë. Sipas gjuhëtarëve, fjala çarranik përdoret në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Drenicë, kurse fjala fllanik përdoret sidomos në Moravën e Gilanit[57]. Çarraniku shërben për mbajtjen e qumështit. Ai është një ndërtim i thjeshtë me bazë 4 x 1 m, i bërë me gardh dhe i mbuluar me kashtë. Kjo është forma më e zakonshme e Çarranikut. Brenda tij bëheshin rafte në të gjitha anët, prej të cilave i pari ngrihej të paktën rreth 90 cm nga toka. Në këto rafte, të njohura edhe me emrin «polisa», ishin vendosur korita druri. Sipas të moshuarve koritat bëheshin edhe prej ahu pasi «nuk lëshon kurfarë lëngu». Në to hidhej qumështi, i cili lihej aty deri në dy ditë. Koritat ishin të cekta. Ato bëheshin të tilla që të «mbanin tamblin në fllad». Në ditët tona takon çarranikë të realizuar me dërrasa; madje mjaft të ngritur nga toka me mure guri dhe në të cilët, përveç tamblit, mbahet edhe bulmeti. Një funksion të tillë në të kaluarën e kanë kryer edhe dollape druri të ngritur gjithashtu me këmbëza nga toka. Të tilla realizime njiheshin edhe me emrin «qilar»[58].

Përveç ndërtimeve që shqyrtuam më sipër, në oborrin e banesës është i pranishëm edhe **bunari,** pusi i ujit të pijshëm. Po ashtu nuk mungon vendi i mbajtjes së pulave, i njohur më shumë me emrin «kotec i pulave» por edhe me emrin «koçek». Në

56) A.E. Dok. 929/47.
57) K. Halimi, **Disa fjalë nga e folmja popullore,** «Përparimi», nr. 9, Prishtinë 1960, faqe 621.
58) Shih edhe A.E. Dok. 1037/17.

Botoja



Fig. 6

këto raste kur oborri lidhet me baçen, në një zonë ndërmjet tyre, liheshin për ruajtje gështenjat kokrra (me gjithë gjemba) në formë grumbujsh në të ashtuquajturit **«kotar»** ose **«thark».** Fjala është për një gropë të hapur në tokë, duke zgjedhur një vend të thatë. Aty hidheshin gështenjat me gjithë «therra». Gështenja duhet të ishte pjekur mirë qysh në pemë, përndryshe kalbej. Pasi hidheshin në gropë, mbi to viheshin degë e gjethe e pastaj mbuloheshin me dhe. Prej andej nxirren sipas dëshirës me **grabuj,** një lloj sfurku me dhëmbë të përkulur. Tharkët janë të njohur edhe në Pukë e në Malësinë e Gjakovës.

Në oborr është gjithashtu një nyje sanitare dhe vendi i druve të zjarrit.

Përsa i përket ruajtjes së produktave të tjera, sidomos të pemëve e perimeve ekziston në këto anë një traditë e pasur. Fjala vjen, bostani (shalqini) ruhet, deri në prodhimin e ri, në **hambarin e drithit** (i futur brenda në grurë). Ndërsa rrushi ruhet në hi. Ky hidhej në «sandukë» prej druri dhe brenda në ta rrushi. Mjaft nga pemët më parë depozitoheshin në «tavanin e kullës». Për këtë qëllim sipër trarëve të çatisë së kullës vendosen afër njëra-tjetrës dërrasa të trasha. Mbi to hidhet një shtresë e hollë dheu. Përmbi të hidhet kashtë e thatë dhe mandej vendosen pemët. Nga hatllat hyn erë që i mban të freskëta, por nuk mungon edhe ndonjë baxhë në çati. Me një mënyrë të tillë ruhet edhe rrushi. Në të gjitha këto raste dy janë kërkesat themelore të diktuara nga një përvojë e gjatë njohëse: Së pari, shmangia e lagështirës dhe së dyti, produktet duhet të kenë arritur pjekurinë e plotë në natyrë, ende të pakëputura nga pema, ndryshe qëndrimi i tyre për një kohë të gjatë pa u dëmtuar, nuk ka asnjë garanci. Populli thotë «po nuk janë mbledh në kohën e vet,



Foto 11

DO NOT COPY



Fig. 7



Foto 12



Foto 13



Foto 14

pemët kalben kurse bereqetin e han miza e nuk rron».

Theksojmë se jo të gjitha oborret në këto fshatra paraqiten të njëjta si për nga ndërtimet e përfshira në to, ashtu edhe për nga shkalla e realizimit të tyre. Fjala vjen, në familjet e dobëta ekonomikisht oborri është i varfër. Aty, produktet e ndryshme ruhen brenda në kthinat e kullës. Për këto qëllime shfrytëzohen jo vetëm divanhania, nën çatia, ahuri i bagëtisë me sajime këndesh të ndryshme, e deri dhe ndonjë nga qilarët e fjetjes.

Ndërtimet brenda oborrit diferencohen në radhë të parë në përputhje me funksionet që kryejnë. Në përputhje me funksionin kryesor, ato kanë edhe ka-

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

rakter të ndryshëm e të larmishëm zgjidhjesh e deri realizimesh. Kjo bën që e thjeshta dhe e përbëra të qëndrojnë pranë njëra – tjetrës, të plotësojnë njëra tjetrën duke materializuar kështu bashkarisht kërkesat e familjes.

Ndërmjet këtyre ndërtimeve me karakter e funksione të ndryshme janë të pranishme edhe sipërfaqe të lira. Ato në zgjidhjet më të arritura nuk janë spontane e të lëna vend e pa vend. Përveçse shërbejnë si ndërlidhëse, për lëvizje në drejtime e qëllime të ndryshme, të nevojshme për veprimtarinë e familjes, disa prej tyre, në periudha të ndryshme të vitit shërbejnë edhe si vende depozite e deri përpunimi materialesh të ndryshme apo prodhimesh bujqësore. Madje në oborr, fëmijtë e vegjël nganjëherë të shumtë të familjes, të moshuarit e paaftë për punë dhe gratë, kalojnë, në periudhën e ngrohtë të vitit një pjesë të mirë të ditës.

VI. **Banesa dhe karakteri i saj**

Qysh në kontaktet e para me Strellcin dhe Nivokazin, gjurmuesit të arkitekturës popullore i tërheq vëmendjen qënia ende në këmbë e mjaft banesave të vjetra. Ato paraqesin hallka të ndryshme zhvillimi të një tipi, të përhapur gjërësisht në Rrafshin e Dukagjinit e që njihet në popull me emrin «kullë»[59]. Si kohë ndërtimi mjaft nga këto banesa i përkasin shekullit të kaluar dhe dekadave të para të shekullit tonë. Kjo nuk përjashton edhe ndërtime të mëvonshme të të njëjtit karakter. Në ato raste, kur në fshatrat që shqyrtojmë banesa e vjetër ka pësuar ndonjë ndryshim, ai nuk paraqitet thelbësor. Pra, nuk ka ndryshuar karakterin e saj si tip. Ky karakter është i lexueshëm si në formulimin e jashtëm, ashtu edhe në atë të brendshëm, si në oborr e murin e tij rrethues ashtu edhe në banesë, në elemente të rëndësishëm funksionalë, arkitektonikë e konstruktivë të saj.

Për nga zhvillimi planimetrik e volumor në Strellc e Nivokaz kanë gjetur përdorim më të gjërë dy variante: Banesa me dy kate (Fig. 6) dhe **banesa me tri kate.** (Foto 11). Ndërsa varianti i parë paraqitet mbizotërues në Strellc, varianti i dytë duket më shumë i përhapur dhe me arritje më të shënuara në Nivokaz. Kompozimi planimetriko-volumor në të dy variantet, ndiqet me lehtësi. Tipar dallues i këtij kompozimi është zgjidhja e ngjeshur dhe racionale e planimetrisë së çdo kati. Po ashtu, konceptet e njëjta në diferencimin funksional të kateve, e deri në karakterin e kërkesave që duhet të plotësojë çdo kat, kanë gjetur mishërim në secilin variant. Këto dukuri i vënë të dy variantet në një emërues të përbashkët.

59) Është vënë në dukje nga studjues të tjerë, se shek. XIX është koha e përhapjes masive të këtij tipi në mbarë Rrafshin e Dukagjinit. Për këtë shih sidomos M. Krasniqi, **Kulla në Rrafshin e Dukagjinit,** në «Gjurmë e Gjurmime», Prishtinë, 1979, f. 326-365., P. Thomo, **Banesa fshatare e Shqipërisë Veriore,** Tiranë, 1981, faqe 100-130.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10

Kështu, shembujt e banesës dy katëshe karakterizohen nga një zgjidhje thuajse e unifikuar në kompozimin planimetrik e volumor, e sidomos në destinacionin e kateve. Kati përdhes ka shërbyer për strehimin e «kalit të shalës» dhe të qeve të punës, ndërsa kati i dytë për jetesën e familjes. Përpos kësaj dukurie, si më e zakonshmja, në një shembull dy katësh në Strellc (Fig. 7), vumë re, në katin përdhes, praninë e një mulliri të vjetër bloje, që punonte me ujë. Sipas banorëve, të tilla banesa me mulli kishte edhe të tjera në Strellc. Ideja për vendosjen e mullirit në katin përdhes të banesës e ka paraprirë qysh në fillim mjeshtrin ndërtues. E themi këtë, pasi dihet se për vetë mënyrën e funksionimit të mullirit me ujë, ai kërkon një pozicion të caktuar përkundrejt rënies me rrjedhje të lirë të ujit përveç punimeve të nevojshme nën truallin e dyshemesë së banesës. Realizimi me sukses i kësaj kërkese në rastin konkret të sugjeron idenë e familjarizimit të gjatë, pra e aplikimit të hershëm të banesave me mulli në katin përdhes në këtë zonë. Me shumë gjasë mullinjtë në Strellc mund të jenë ndërtuar edhe mbi bazë vëllazërie. Mulliri që përmendim nga Strellci ishte i tipit, «me një gur». Pikërisht të tillë mullinj janë vënë shpesh në katin përdhes të banesës. Ata paraqiten dy llojesh: **mullinj për grurë** e **mullinj për misër.** Në një shikim të zakonshëm nuk kanë asnjë ndryshim të rëndësishëm nga njëri-tjetri. Diferencimi përcaktohet nga shkalla e «rrafjes» së gurit për bloje.

Në banesën me mulli vëmendjen ta tërheqin edhe dukuri të katit të sipërm ku jeton familja. Kështu në divanhane ngjitesh me shkallë të brendshme



Fig. 11

druri nga mulliri ose me shkallë të jashtme. Këto të fundit, të realizuara me gurë janë mbyllur anash me dërrasa, e nga sipër janë mbuluar me një strehë të pjerrët, duke dalë kështu në formën e një galerie.



Fig. 12

Në vazhdim të sheshpushimit të këtyre shkallëve është vendosur nyja sanitare, dhe po nëpërmjet këtij sheshpushimi lidhesh me divanhanen. Pjesa e poshtme e kësaj nyje sanitare del në formë pilastre. Në divanhane është formuar një kthinë në pjesën përballë shkallëve që vijnë nga mulliri. Në këtë kthinë është përfshirë edhe një pjesë e dysheklëkut (Foto 12). Hapësirat e saj përveçse janë modifikuar në formën e dritareve të zakonshme me xhamllëqe, janë të pajisura nga jashtë me kapakë dërrase, që hapen nga poshtë lart në formën e vetulloreve (Fig. 8).

Ndër banesat e vjetra dy katëshe të Strellcit vëmëndjen na e tërhoqën edhe dy shembuj të tjerë, që nga banorët ende në ditët tona njihen me emrin «çardak» (Foto 13). Këtu po shqyrtojmë shkurt njërin prej tyre. Në një vështrim të përgjithshëm banesa karakterizohej nga kati përdhes me mure guri, llaç balte e breza druri, dhe nga kati i sipërm i ndërtuar i gjithi prej druri (Fig. 9). Muret perimetralë të katit të sipërm, formoheshin nga një skelet vertikal, i veshur me dërrasa të trasha horizontale (Foto 14). Këto janë të «gojuara» në binarët e skeletit vertikal që thamë. Ndërtimi i gjithë katit të sipërm, me lëndë druri, është tipari më thelbësor që e dallon këtë banesë nga një banesë e zakonshme dykatëshe e këtij fshati. Në zgjidhjen kompozicionale dhe funksionale ajo nuk paraqet asnjë ndryshim thelbësor

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Foto 15



Foto 16

prej tyre. Edhe disa gjurmë modifikimesh të bëra me kohë, nuk kanë ndryshuar asgjë nga dukuria e mësipërme. Fjala vjen, megjithëse hapësirat e dyshekllëkut janë mbyllur me dërrasa, podiumi i lehtë i brendshëm dhe kollonat e vogla prej druri me jastëkët që i kurorëzojnë janë dëshmi bindëse e pranisë së tij më parë. Po ashtu bien në sy edhe një palë shkallë të jashtme druri që me kohë ishin nxjerrë nga përdorimi. Edhe ndarjet e brendshme ishin realizuar në përputhje me nevojat.

Data e ndërtimit të kësaj banese nuk dihet me siguri. Në Strellc e konsiderojnë si një nga më të



Foto 17



Foto 18

DO NOT COPY



Fig. 19



Fig. 20

vjetrat e fshatit.[60] Po të marrim si bazë të dhënat e banorëve, të cilat për karakterin e banesës dhe gjendjen e saj, duken normale, arrijmë në përfundimin se banesa në shqyrtim i përket ndofta fundit të shek. XVIII dhe me siguri fillimit të shek. XIX. Kujtojmë se për shembuj të karakterit që përshkruam më sipër, është vënë më se njëherë në dukje,[61] se përbëjnë një hallkë të hershme në proçesin e zhvillimit tipologjik të banesës në këto anë. Kjo është konfirmuar edhe nëpërmjet analizës së zhvillimit tipologjik të banesës së fortifikuar në Rrafshin e Dukagjinit.[62] Një shembull tjetër, me sa duket i ngjashëm me «çardakun» e Strellcit, është gjetur në fshatin Lëbushë, dhe është konsideruar si «kulla më e vjetër»[63]. Një të tillë M. Krasniqi e ka gjetur në Lugun e Leshanit (Pejë), në fshatin Jabllanicë.[64] Prania e çardakut edhe në Strellc, hedh dritë qoftë për ekzistencën në kohë të tij ashtu edhe për shpërndarjen territoriale që ka pasur në të kaluarën. Në ditët tona «çardaku» ka mbetur një dukuri e rrallë.

Më i qartë e me zgjidhje më të unifikuar jo vetëm planimetrike e volumore, por edhe funksionale,



Fig. 21

60) Një e moshuar e familjes (në moshën 77 vjeç në vitin 1977 – A.M.) disi na orientoi. Ajo kishte ardhur nuse në këtë shtëpi në moshën 19 vjeç. Në atë kohë kishte dëgjuar mëse një herë nga të moshuarit se banesa ishte ndërtuar para 150 vjetësh nga ustallarë dibranë.

61) M. Krasniqi, **Tipat e shtëpijave në Kosovë-Metohi dhe ndryshimet e tyre në kushtet e reja shoqërore,** «Përparimi» 7-8, Prishtinë, 1962, f. 460-461.

62) P. Thomo, **Banesa e Rrafshit të Dukagjinit Kosovë,** «Kultura popullore», nr. 1, Tiranë, faqe, 49-68.

63) R. Ibrahimi. **Puna e ekspeditës shkencore në Rrafshin e Dukagjinit.** Gjurmime albanologjike. Seria Folklor dhe etnologji. VII 1978, Prishtinë 1978, faqe 315. Ndofta autori e ka fjalën për atë «çardak» që përshkruan nga ky fshat P. Thomo në artikullin e sipërcituar f. 45.

64) M. Krasniqi. **Gjurmë e gjurmime,** Vep. cit. f. 341. Në fotografinë e botuar autori ka vënë shënimin: Ky tip shtëpie me kat i paraprin tipit të kullës në Rrafshin e Dukagjinit.



Fig. 22

paraqitet varianti trekatësh i banesës në këto dy fshatra (Fig. 10, 11). Ky karakter i unifikuar i zgjidhjes, vërehet veçanërisht në katin e tretë. Për nga ideja e shfrytëzimit edhe dy katet e tjera kanë respektivisht tipare të unifikuara. Veçse në to, në përputhje me nevojat e lindura ose të diktuara qysh në fillim, ndarjet e brendshme dhe destinacioni i tyre mund të ndryshojnë nga një shembull në tjetrin. Në katin e tretë, kemi divanhanen e gjërë që paraprin odën e burrave. Elementi më i rëndësishëm i divanhanes është podiumi i njohur me emrin dyshekllëk (Fig. 12). Mbyllja nga jashtë e këtij elementi është bërë ose me lëndë druri të përpunuar (Foto 15, 16) ose me gurë (Foto 17), gjithashtu të punuar. Të dyja këto mënyra i takojmë rëndom në të dy fshatrat.



Fig. 23



Fig. 24



Fig. 25

DO NOT COPY

Përveç pranisë së shkallëve të brendshme në mjaft banesa të Nivokazit vëmë re praninë e shkallëve të jashtme (Foto 18) që kanë lidhje me një hyrje të veçantë për në katin e tretë. Hapësirat e lëna në formë vargu në dyshekllëk, shohin përgjithësisht nga rruga; kurse dritaret e pranishme në odën e burrave, shohin gjithnjë nga pjesa e brendshme e oborrit. Në mjaft banesa të Nivokazit të tërheq vëmëndjen prania në mure jo vetëm e frëngjive të zakonshme me seksion drejtkëndësh, por edhe e të tillave me seksion rrethor (Foto 19), madje me diametër disi të madh. Një frëngji të tillë patëm rastin ta shohim edhe në një odë burrash, në «ballin» e vogël, në krahun nga rrinte i zoti i shtëpisë.

Ajo që të tërheq vëmëndjen më shumë në banesën trekatëshe të këtyre fshatrave, veçanërisht në Nivokaz, është përkujdesja disi më e madhe në formulimin arkitektonik dhe një realizim disi më i arrirë në zhvillimin tipologjik. Po ashtu, ndërsa karakterizohen nga konceptime të njëjta në zgjidhjet planimetrike e volumore, mjaft banesa trikatëshe në Nivokaz duken jo vetëm me përmasa e sipërfaqe më të mëdha shfrytëzimi për banim, por më solide në planin ndërtimor.

Krahas dyshekllëkut prej druri vërejmë të jetë përdorur mjaft edhe dyshekllëku prej guri. Në rastin e parë banesat natyrisht i gjallëron në pamjen e jashtme kontrasti që krijohet nga përdorimi i dy materialeve dhe sidomos nga shkalla e përkujdesjes në elementet prej druri. Kjo përkujdesje arrin deri në strehën e çatisë që e kurorëzon dyshekllëkun. Si veçori dalluese në realizimin e dyshekllëkeve me perde guri, është futja në përdorim e një lloj guri dekorativ, me ngjyrë të bardhë dhe me ngjyrë pembe. Ky lloj guri është përdorur jo vetëm në perden e jashtme të dyshekllëkut por edhe në qoshet e banesës (Foto 20), në konturin e dritareve (Foto 21), dhe të dyerve, në kornizat e çatisë e deri në imitimin e brezave të drurit në muraturën e gurit (Foto 22). Ngjyra dhe mundësitë e daltimit të këtij guri kanë rritur jo pak efektet estetike në formulimin e jashtëm të banesave.[65]

Edhe në strehët e çative vërehet një larmi zgjidhjesh. Në mjaft strehë vërejmë një kornizë të mbyllur me dy rreshta gurësh që dalin nga plani i mureve në mënyrë të shkallëzuar. Në të njëjtën kohë vërehen edhe strehë të hapura prej druri që dalin dukshëm nga plani vertikal i mureve. Këtu nuk është fjala vetëm për banesa ku është i pranishëm dyshekllëku i drurit, por edhe në banesa të tjera që nuk e kanë fare atë.

Po ta shohim banesën të lidhur me familjen, të dy variantet që sollëm përfaqësojnë ose banesën e një familjeje të zakonshme ose vetëm «kullën» për familjen e madhe. Lidhur me këto të fundit, (familjet e mëdha) problemet e banimit në këto dy fshatra janë zgjidhur kryesisht me ndërtimin përngjitur kullës, (nga një krah i saj), të «shtëpisë së gjatë». Shtëpija e gjatë si kudo në Rrafshin e Dukagjinit, edhe në këto fshatra, është bërë gjithmonë një kat më e ulët se vetë kulla. Tipike në këtë drejtim ishte shtëpija e gjatë dykatëshe e H. Shehut në Nivokaz, e cila kishte një numër të konsiderueshëm qilerësh. Ndërkohë, në Strellc na u dha rasti të shohim një banesë katërkatëshe. (Foto 23)[66]. Edhe kjo banesë (përveç arsyeve të tjera shoqërore për të cilat është ndërtuar), me përmasat dhe numrin e shumtë të niveleve të banimit që përmban, i ka shërbyer një familjeje të madhe. Dëshmi bindëse është numri i madh i qilereve ende të pranishëm në katin e dytë dhe të tretë të saj. Deri edhe kati i katërt, dukej se në një kohë është shfrytëzuar për qëllime të tilla. Kjo kullë, si pas banorëve ka pasur edhe dy «karollhane», të cilat qysh kur u dogj banesa në vitin 1909, nuk u bënë më. Kjo dukuri, pozicioni i vendosjes, volumi i pastër dhe i mbyllur prizmatik, frëngjitë, soliditeti i lartë i mureve, përkudesja në realizimin e tyre, hapësirat e pakta të ndriçimit në çdo kat dhe prania vetëm e shkallëve të brendshme, e bëjnë këtë banesë një nga shembujt me karakter të theksuar fortifikues për kohën e vet. Të tilla në Strellc kanë qenë vetëm dy.

Nga shembujt e banesave që trajtuam më lart del e qartë se nuk mungojnë hallka të hershme në rrugën e zhvillimit të banesës. Fjala është konkretisht jo vetëm për çardakët, por edhe për mjaft nga banesat dy dhe tri katëshe të këtyre fshatrave; për të ardhur deri tek banesa katërkatëshe, që me siguri i përket, të paktën çerekut të fundit të shek. të kaluar.

65) Me sa duket i tillë do të jetë edhe guri i përdorur në Junik, fshat kufitar me Nivokazin. Për këtë shih Q. Lleshi **Juniku – Kontribut për hulumtimin e katundeve të mëdha të Rrafshit të Dukagjinit.** «Glasnik Muzeja Kosova. Prishtinë, 1970, f. 110.

66) Kjo kullë sipas banorëve, në vitin 1909 është djegur nga xhonturqit pasi aty u strehua për disa kohë si mik patrioti dhe luftëtari i shquar Isa Boletini. Disa gjurmë modifikimesh që dallohen ende në afërsi të strehës së çatisë, duhen parë të lidhura me djegien e më sipërme. Për djegien e kësaj kulle shih edhe A.E. dok. 929/47. Po ashtu për të ka shkruar edhe M. Krasniqi, madje ka botuar edhe fotografinë, ku në diçiturë, duke e quajtur gabimisht trekatëshe, shkruan për djegien e saj më 1909 shih M. Krasniqi; «Gjurmë e gjurmime», **Vep. cit,** faqe. 360.

Një dukuri tjetër që të tërheq vëmëndjen në Strellc e në Nivokaz është se edhe në banesa të ndërtuara relativisht vonë, vërehet ideja e ruajtjes së mjaft koncepteve të vjetra tradicionale jo vetëm në zgjidhjen e brendshme funksionale, por deri edhe në formulimin arkitektonik të jashtëm, përfshirë edhe oborrin me muret rrethues dhe portën e hyrjes. Tipik në këtë drejtim është banesa trekatëshe e ndërtuar në Nivokaz, që mban të skalitur edhe datën e ndërtimit, vitin 1938 (Foto 24) si dhe një banesë dykatëshe, e ndërtuar vonë, në Strellc të Epër (Foto 25).

*
* *

Strellci i Epër dhe Nivokazi hyjnë ndër fshatrat e vjetra të Rrafshit të Dukagjinit, të banuara me vazhdimësi të pandërprerë nga shqiptarë. Ata nuk janë bërë herë tjetër objekt i ndonjë shqyrtimi të veçantë. Tiparet që i karakterizojnë këto vendbanime, si në vështrim urbanistik ashtu dhe në atë arkitektonik, nuk janë të veçanta nga mbarë fshatrat e tjerë të kësaj treve. Për rrjedhim materiali i sjellë i shërben plotësimit të tablosë njohëse të arkitekturës dhe vendbanimeve fshatare në mbarë Rrafshin e Dukagjinit. Realizimet që shënojnë në fushën e ndërtimeve popullore këto fshatra, flasin për një traditë të pasur, që karakterizohet nga tipare të qarta unitare, si shprehje dhe pasqyrë e një popullsie me mënyrë jetese e zakone të njëjta të të banuarit.

Aty dallojmë nga ndërtimet e thjeshta e me karakter stinor përdorimi, siç janë ato në stane e deri tek banesa e fortifikuar tre dhe katër katëshe. Brenda tyre shohim edhe të tilla që mund të radhiten pa asnjë ndroje ndër realizimet më të arritura të arkitekturës sonë tradicionale fshatare.

Këto ndërtime kanë qenë të kushtëzuara nga një kompleks faktorësh. Realizimet e shkallëzuara në kalimin nga një oborr në tjetrin, e deri nga një banesë në tjetrën, e shprehin këtë karakter të kushtëzuar. Jo vetëm faktorët ekonomikë e gjeografikë-natyrorë, por edhe rrethanat historike e shoqërore, kanë lënë vulën e tyre. Ndërtimet kanë qenë kushtëzuar nga këta faktorë, në varësi të shkallës së përparësisë që kanë marrë, në kohë e në hapësirë, edhe në raport me njëri-tjetrin. I tillë është, fjala vjen, faktori ekonomik që me gjuhën e tij, ka diktuar një shtresim të qartë shoqëror që është pasqyruar në ndërtime. Ky shtresim duket që tek madhësia e oborrit, numri e karakteri i ndërtimeve që përfshihen në të, karakteri i rrethimit, për të arritur tek banesa, ku e gjen shprehjen më të koncentruar. Faktori ekonomik i mpleksur dhe i paraprirë nga faktorë historikë e shoqërorë, kanë bërë që sidomos gjatë shek. XIX dhe gjysmës së parë të shek. XX., jo vetëm në Strellc e Nivokaz, por në mbarë Rrafshin e Dukagjinit të jetë përhapur banesa e fortifikuar e tipit kullë. Studimet kanë vërtetuar se këto tipare banesa e Rrafshit të Dukagjinit, i fitoi si rezultat i përpunimit të pandërprerë të banesës paraardhëse. Dhe një prototip i tillë për kullën ka qenë banesa e njohur në popull me emrin «çardak».

Të dy fshatrat qoftë në vështrim urbanistik, ashtu dhe në planin arkitektonik, ndonëse kanë mjaft gjëra të përbashkëta, nuk paraqesin arritje të niveluara, por ruajnë, në cilindo aspekt, individualitetin e tyre. Ndërkohë, pa mohuar arritjet e arkitekturës popullore në Strellc, Nivokazi, hyn në radhën e atyre fshatrave në Rrafshin e Dukagjinit, ku realizimet e ndërtimeve popullore në përgjithësi dhe të banesës në veçanti, përbëjnë nga arritjet më me vlerë. Ky është një tregues që tërthorazi flet për praninë e një zhvillimi ekonomik relativisht më të lartë në raport me Strellcin. Kështu, në Nivokaz, ndërsa nuk mungojnë shembuj banesash që përfaqësojnë hallka më të hershme të zhvillimit tipologjik, shembujt ku karakteri mbrojtës e fortifikues është më i arrirë e me një shtrirje më të gjërë në masën e fshatarësisë, janë më të shumtë. Kujtojmë fjala vjen që të dy variantet e banesës, por veçanërisht ai trekatësh, këtu paraqitet deri edhe me përmasa më të mëdha në zhvillimin planimetriko-volumor. Po ashtu ky variant shënon edhe një përpunim më të arrirë arkitektonik. Përdorimi në mënyrë të veçantë i gurit dekorativ me ngjyrë, u ka dhënë më shumë monumentalitet banesave të Nivokazit. Në këtë rast përvoja e mjeshtrit ka gjetur mundësi të mëdha realizimesh më të spikatura. Janë këto arsyet që na shtyjnë të themi se mjaft shembuj banesash në Nivokaz, duke i qëndruar besnik traditës në planin tipologjik, pra në kompozimin planimetrik e volumor, shënojnë arritje lidhur me një pasurim disi më të ndjeshëm të repertorit të përpunimit arkitektonik e konstruktiv të banesës.

Mjaft tipare të arkitekturës së këtyre fshatrave, lexohen qartë jo vetëm në mbarë Rrafshin e Dukagjinit. Ndërthurja vërehet edhe me arkitekturën popullore të mjaft zonave të tjera brenda e jashtë kufijve të sotëm politikë të Shqipërisë. Këto lidhje duken më të qarta e më të spikatura me masivin qendror dhe atë verilindor të Shqipërisë Veriore. Si e tillë edhe arkitektura e këtyre dy fshatrave, me arritjet, karakterin dhe vlerat e saj, përbën një nga dëshmitë e forcës krijuese të mjeshtrit shqiptar të ndërtimit.*

* Fotografitë nr. 5, 8, 10, 13, 25 janë sipas A. Dojakës të marra prej tij në vitin 1972. Fotografia nr. 4 është sipas S. Shkurtit. Fotografitë e tjera janë të autorit. Skicat janë punuar nga F. Zarshazi nën drejtimin e autorit.

DO NOT COPY

Ali Muka

DO NOT COPY

APERÇU SUR LES VILLAGES DE STRELLC I EPER (DEÇAN) ET NIVOKAZ (GJAKOVE).

(caractère des centres habités et des constructions populaires)

RESUME

Cet article, au moyen de faits accumulés sur le terrain, en 1977, et de données tirées de la littérature scientifique, donne une vue historique et architectonique relativement large sur deux villages de Rrafshi i Dukagjinit (Kosove), dont l'un, Strellc i Epër, fait partie, actuellement, de la Commune de Deçan, tandis que l'autre, Nivokaz, fait partie de la Commune de Gjakove.

Des sources documentaires, il résulte que ces deux villages sont anciens. Strellc est mentionné depuis XIVe siècle, comme un village appartenant au domaine de Deçan, et comptait 70 maisons à l'époque. Nivokaz aussi est cité dans des documents datant du XVe siècle. Il faisait partie de la région d'Altun-Ilia et comptait en tout 37 maisons.

Quant aux habitants, les sources documentaires confirment que depuis le XVe siècle ces villages étaient habités dans la partie écrasante par des albanais. Le caractère des taxes prélevées au XVe siècle nous permet de croire que cette population était installée sur son propre territoir depuis longtemps et s'occupait non seulement d'élevage mais tout d'abord et surtout d'agriculture. Cela est illustré par l'examen des données sur le village de Nivokaz. Il en résulte que les taxes reflétant l'activité relevant de l'élevage et celles reflétant l'activité agricole, sont dans le rapport de 1 à 10.

La zone incluant ces deux villages est riche aussi dans le domaine de l'onomastique. Le matériel accumulé dans ce sens non seulement est archaïque, mais aussi presque simplement albanais sur le plan linguistique. De même on a conservé dans leur forme ancienne et primaire quelques micro-toponymes latins. Les sources documentaires confirment que dans la zone, qui inclue ces deux villages, au XVIe siècle prédominait l'anthroponymie albanaise.

Plus loin, on apporte des données sur la position physique et géographique de ces deux villages, qui à nos jours se présentent rassemblés. Le terrain, où ils sont installés le climat, les sources hydriques, le versant de la montagne etc. ont manqué aussi bien le caractère de l'urbanisme des villages que les directions fondamnetales de l'activité économique. Ainsi, Strellc, pris dans toute sont étendue, se compose du versant au-dessus, plus bas du village, en tant que territoir étroit d'habitation, et des champs et prairies. Cette étendue est un témoignage convaincant du double caractère agricole et d'élevage de l'économie.

A l'intérieur du village, les habitations sont rassemblées en quartiers. Les familles les plus importantes forment, dans le cadre des descendances, la base de l'expansion des quartiers, dans chacun des villages qu'on examine.

Un autre phénomène est la présence de grandes familles. Si l'on se réfère à Strellc, on s'aperçoit qu'en 1972, plus de 90% des familles comptaient plus de cinq membres. Il y a eu même des familles de plus de 15 couples. A Nivokaz, la famille H.SH. comptait plus de 100 membres.

La présence de la grande famille dans le village de Kosova est un phénomène bien connu, qui continue à persister non pour des raisons d'inertie ou par la force de la tradition. Ce sont des raisons déterminées qui le soutiennent. Tout d'abord ce sont des raisons économiques, mêlées de facteurs sociaux et historiques.

De tels facteurs, comme la présence de tribus, des lignées de parenté à l'intérieur d'eux et de la grande famille, ont laissé leur empreinte sur la physionomie des villages en question. La vie a démontré qu'au cours de l'histoire la cohésion entre ces maillons a été tout d'abord un besoin. C'est cette même cohésion qui a joué et continue de jouer un rôle important, comme un bouclier contre les luttes de dénationalisation et d'assimilation qu'a menées sans arrêt notamment la bourgeoisie grand-serbe ancienne ou nouvelle.

Les constructions populaires traditionnelles à Strellc et à Nivokaz marquent des réalisations importantes. On y trouve l'expression d'une riche et persistante expérience. L'existence des constructions anciennes élevées au siècle passé et au début du XXe siècle, témoigne au moins de deux phénomènes importants: premièrement, *dans leur solidité, un rôle particulier revient aux matériaux de construction utilisés;* deuxièmement, *cette solidité doit être considérée liée de façon assez organique avec le maître constructeur. Dans les habitations des deux villages en question tout particulièrement, on s'aperçoit de la grande expérience du maître. Certaines de ces constructions peuvent être comptées sans hésitation aucune parmi les réa-*

lisations les plus réussies non seulement de l'habitation populaire de Kosove, mais de toute l'habitation rurale albanaise hérité du passé. Les constructeurs de ces habitations ont été les maitres renommés albanais de l'Albanie du Nord-Est, les habitants de Dibra. Les travaux intérieurs à l'habitation, ainsi que les constructions économiques ont été réalisés par d'autres maitres, originaires du village ou de la zone.

Le nombre, le caractère et la destination des constructions d'une famille sont exposés clairement dans la cour de l'habitation. L'ensemble de ces constructions est entouré d'une haie ou d'un mur de pierres. D'habitude la cour a une superficie assez grande. L'enceinte la plus solide utilisée est celle à murs de pierres, laquelle, soit du matériel employé, soit de la technique et des soins prêtés, est du même niveau que les murs de l'habitation.

A part l'habitation, dans la cour sont inclues une série de constructions économiques. L'article traite de la manière de réalisation de ces constructions, ainsi que des buts et du mode d'emploi.

L'habitation et son caractère sont traités de façon relativement plus large. Sur le plan typologique l'habitation construite dans ces deux villages, se présente avec des traits nets. De nombreux exemples d'elle présentent divers maillons de développement d'un type d'habitation, répandue largement dans le Rrafshi i Dukagjinit, et qui est connue dans le peuple sous le nom de «Kullë» (tour). Du point de vue planimétrique et volumétrique, à Strellc et à Nivokaz, sont utilisés surtout deux variantes: l'habitation à deux étages et celle à trois étages. Alors que la première variante semble prédominer à Strellc, la seconde semble plus répandue et présente des réalisations plus réussies à Nivokaz.

En ce qui concerne les grandes familles, les problèmes de logement, ont été résolus en construisant la longue maison adjointe à la tour, mois ayant un étage de moins qu'elle.

Dans ces villages, ne manquent pas les exemples représentant des maillons anciens du développement de l'habitation, telle l'habitation connue sous le nom «tchardak» par le peuple. De tels exemples ont été découverts à Strellc.

Le matériel apporté dans cet article complète d'avantage le tableau de l'architecture des centres habités ruraux dans le Rrafshi i Dukagjinit. Les traits caractérisant Strellc et Nivokaz, tant du point de vue de l'urbanisme que de celui architectonique, ne sont ni particuliers, ni uniques, par rapport aux autres villages de cette contrée. Les constructions se présentent avec des réalisations graduées. On y rencontre depuis les constructions simples et de caractère saisonnier, comme les parcs, jusqu'à l'habitation fortifiée de trois et de quatre étages. Dans cette réalité se reflète nettement la division sociale, les facteurs historiques et sociaux, mêlés à ceux économiques ont fait qu'au cours du XIXe siècle, non seulement à Strellc et à Nivokaz, mais aussi dans tout le Rrafshi i Dukagjinit, l'habitation fortifiée de type de «Kullë» s'est répandue. Les études d'auteurs albanais ont certifié que l'habitation de Rrafshi i Dukagjinit a pris ces traits dans l'élaboration continue de la maison précédente. Un tel prototype pour la tour a été l'habitation connue sous le nom de «tchardak».

Les deux villages, soit du point de vue de l'urbanisme que de celui architectonique, bien qu'ayant assez de choses communes, ne présentent pas des réalisations uniformes. Sans vouloir nier les valeurs de l'architecture populaire à Strellc, ses réalisations à Nivokaz sont relativement plus réussies. Ceci témoigne indirectement d'un développement économique un peu plus élevé à Nivokaz. L'usage de la pierre décorative de couleur a rendu plus monumentales les habitations de Nivokaz. Dans ce cas, l'expérience du maître a trouvé de plus grandes possibilités de réalisations. Ainsi, pas mal d'habitations à Nivokaz, tout en restant fidèles aux traditions sur le plan typologique, dans la composition planimétrique et volumétrique donc, marquent des réussites, en ce qui concerne l'enrichissement un peu plus sensible du répertoire de l'élaboration architectonique et constructionnelle de l'habitation.

Nombre de traits de l'architecture de ces villages sont remarqués clairement dans tout le Rrafshi i Dukagjinit. On relève aussi des liens avec l'architecture populaire de beaucoup d'autres zones à l'intérieur, aussi bien qu'à l'extérieur des frontières politiques actuelles de l'Albanie. Ces liens apparaissent plus nettement dans le massif central et dans celui du Nord-Est de l'Albanie du Nord. En tant que telle, l'architecture, à Strellc et à Nivokaz, avec ses réalisations, son caractère et les valeurs qu'elle contient, constitue l'un des témoignages de la force créatrice du maître albanais de la construction.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Dilaver KURTI

URAT E GURTA NË MAT

Krahina e Matit gjendet në masivin qendror, midis vargmaleve Skënderbeg dhe Dejë e Balgjaj duke u ndërlidhur me bregdetin, fushat bregdetare dhe krahinat në shpinë të saj nëpërmjet qafave të maleve. Këto qafa janë në perëndim Qafë Murriza e Qafë Shtama, në lindje Qafë Bualli e Qafë Murra. Në veri rruga depërtonte nëpërmjet grykës së Matit, aty ku bashkohet lumi i Matit me Fandin, duke pasur si pikë kalimi Kulmen e Dervenit.

Në jugë rruga që nisej nga Tirana, si kalonte në shkallën e Tujanit futej në portën e parë të Matit, në Qafë Murrizë, zbriste poshtë në Xibër, e aty degëzohej në dy arterie nga të cilat njëra zbriste bri kalasë ilire të Xibërit në Qafë Shkallë për në Dars dhe Mat, kurse tjetra nga Xibëri për në Gur të Bardhë, Urën e Vashës mbi Mat, Klos, Plan të Bardhë e nëpër Qafë Buell në Dibër. Porta tjetër e rëndësishme që e përshkonte Matin përmes, ishte rruga që vinte nga Dyrrahu antik, në Verë, Prozë, Zgërdhesh, Cudhi, prej nga kalonte nëpër Qafë Shtamë për Mat, Urëselitëz, Frankth, Muzhakë, Qafë Portë (Komsi) Hurdha e Kaikes mbi Mat, Ura e Banjës, Burgajet, Kodra e Shpjetrit, Lis, Mali i Shënmërisë, Vigj, Stellush për në Dibrën e poshtme e më tej në Kosovë.

Këto rrugë i shërbenin karvaneve dhe tregjeve të Matit. Krahina e Matit me unitet kulturor etnografik, gjeografik, kishte katër tregje në secilën nga katër njësitë që shërbenin. Për mikrokrahinën e Rranxës, tregu ishte në Komsi, në Derjan për Prellin, në Lis për Përtejujtë dhe në Stragj (Klos) tek Pazari i Urës për Krye-Matin. Midis këtyre tregjeve më i vjetri dhe i dokumentuari, që në vitin 1467[1] dhe shekullin e XVII[2], është ai i Lisit, ku ishte dhe qendra e krahinës deri më 1922. Midis këtyre tregjeve, Lisi dhe Klosi kishin masat dhe peshën e vet, që njiheshin brenda dhe jashtë krahinës.

Të dhënat që na jep folklori dhe ato të mbledhura ndër të moshuarit flasin për lidhjen reciproke të tregjeve të Matit me krahinat fqinjë të Elbasanit, Durrësit, Tiranës, Krujës, Lezhës, Shkodrës, Dibrës, Kukësit, Ohrit, Manastirit të Gostivarit, Tetovës, Prizrenit, Gjakovës, Pejës e Prishtinës. Në Mat tregtoheshin prodhime të shumta bujqësore e blegtorale, lëndë druri e poçeri. Në Mat gjithashtu ishte industria shqiptare e prodhimit të barutit që furnizonte sidomos tregjet e krahinave të mësipërme[3].

Këtu do të trajtojmë urat që ndodhen në rrjetin rrugor që lidhte krahinën e Matit me ato fqinjë, të cilat janë studiuar në vend apo mbi bazën e të dhënave gojore[4] kur gjurmët mungojnë apo janë të

1) S. Pulaha, **Lufta shqiptaro-turke në shek. XV (Burime Osmane) Tiranë** 1968, f. 330.
2) I. Zamputi, **Relacione,** Vëll. I. (1610-1634), Tiranë 1962, dok. 36 (34-38).
3) D. Kurti; **Zeja e punimit të barotit në Mat,** Etnografia shqiptare, nr. V, Tiranë 1974, f. 213-229. D. Kurti, **Les poudreries de Mati,** Etnographie Albanaise, Tiranë 1976, f. 245-256.
4) D. Kurti: **Shënime etnografike nëpër Mat,** (1962-1967). Dorëshkrim në arkivin e Institutit të Kulturës Popullore Tiranë, Sektori i Etnografisë, f. 18-19; 38, 58, 62, 65-67, 95, 100, 102 dhe D. Kurti, **Toponimat e Matit,** 1963-1966. Dorëshkrim në arkivin e Institutit të Gjuhë-Letërsisë Tiranë, f. 10, 16, 19, 23.
Për urat e Gurit të Bardhë përveç të dhënave që kemi mbledhur na kanë ndihmuar edhe mësuesit Rakib Lasku dhe Rakib Hoxha, të cilët i falenderojmë. Shih dhe shkrimet tona: **Urat mesjetare në Mat,** Gazeta Bashkimi 23 Maj 1976, **Urat e gurta në Mat.** Revista «Ylli», nr. 9; Tiranë 1982; f. 15.

DO NOT COPY



Fig. 1

pakta. Të dhëna për to jepen nga K. Ulqini (për urat e Vashës, Skurës, Hoxhës e Shnaprendes[5]) dhe së fundi nga V. Shtylla[6].

Urat e rrjetit rrugor që përshkonte Matin ndodhen kryesisht në rrjedhën e sipërme të lumit Mat (Fig. 1), aty ku ky lumë del nga kanioni i fundit, në Klos. Ato kanë qenë ndërtuar prej guri e prej lëndë druri. Mjaft prej tyre me kalimin e kohës janë rrënuar kështu që prej disave ruhen vetëm gjurmët apo emri i tyre në popull.

Urat janë vepër e mjeshtërve vendas, të cilët kanë ndërtuar dhe banesat popullore. Për ndërtimin e urave fillimisht sigurohej gëlqerja e stazhionuar, së paku tre vjeçare, pritej lënda e nevojshme për armaturën dhe pajtoheshin mjeshtrat. Urat janë ndërtime të përbashkëta të popullit të një katundi, lagjeje e fisi prandaj dhe baza materiale sigurohej bashkarisht, ndërsa vlera e punës u paguhej mjeshtrave nga persona të ndryshëm.

Urat e gurta në Mat shtrihen nga Krye-Mat ose në Klosin e sotëm: 6 në katundin Guri i Bardhë, 3 në Klos, 1 në Dars, 1 në Bersh 1 në Patin, 2 në Gurrë të Vogël dhe jashtë trevës së sipërme, 1 në Frankth. Shtrirja e tyre, ndjek itinerarin e rrugëve të karvaneve ose «Udhës së Madhe» siç quheshin nga populli këto rrugë. Sot ruhen në këmbë dhe funksionojnë 9 ura, kurse 7 të tjerat janë rrënuar. Midis tyre 3 kanë qenë mbi lumin Mat, kurse 13 të tjerat mbi degët e tij.

URAT QË RUHEN NË GJENDJE TË MIRË, gjithsejt janë 9. Pesë prej tyre gjenden në Gur të Bardhë, ndërsa të tjerat në katundet Klos, Dars, Patin dhe Gurrë të Vogël. Populli ato i njeh me emrat Ura e Vashës, Ura e Skurës, Ura e Kulmares, Ura e Hoxhajve, Ura e Allamanit, Ura e Halilajve, Ura e Shahinit, Ura e Shën e Premtes.

Për ndërtimin e urave fillimisht është zgjedhur vendi, aty ku kalonte rruga, me shmangie sipas terrenit. Vendi për ngritjen e urës është zgjedhur shkëmbor me brigje të larta ose të ulta ku janë hapur dhe themelet e këmbëve të urës. Më tej është ngritur armatura, mbi të cilën janë ndërtuar qemerët e urës. Gurët me të cilët janë ndërtuar urat janë gëlqerorë, ranorë apo shpani (çmërsi). Gurët i janë nënshtruar daltimit dhe kanë formë kuadratike të rregullt, me përmasa 50-60 cm gjatësi, 40-45 cm gjërësi, 15-20 cm trashësi. Për ndërtimin e një ure me përmasa mesatare, siç është ajo e Skurës janë dashur 800 blloqe kuadratikë të daltuar.

Ura e Vashës gjendet mbi lumin Mat, midis katundeve Klos dhe Guri i Bardhë në kanionin e fundit, para se lumi të dalë në luginë. Ura ndërlidh dy brigjet e lumit Mat dhe ka qenë i vetmi mjet komunikimi në rrjedhjen e sipërme të lumit të Matit.

Ura është me një hark dhe në anën e djathtë të rrjedhës ka një dritare shkarkuese. Këmbët e saj janë vendosur në dy brigjet shkëmbore të lumit, në malin Vërrith shpatulla e djathtë dhe malin Dish e majta. (Fig. 2, 3). Kjo urë është 11 m e gjatë hapësira e dritës midis dy këmbëve është 7 m dhe lartësia e harkut nga pasqyra e ujit po 7 m. Harku i urës është i

5) K. Ulqini, **Gjurmime etnografike në trojet e Skënderbeut,** Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore, nr. 2, Tiranë 1961, f. 187-188.
6) Në vitin 1980 V. Shtylla ka bërë një ekspeditë në urat e Gurit të Bardhë.

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

ndërtuar me qemer të dyfishtë. Gjërësia e trasesë së urës është 2.8 m dhe është shtruar me gurë e rrasa. Harku i saj është gjysëm rrethor dhe është punuar me gur gëlqeror të latuar e të skuadruar. Të dy anët e qemerëve janë përforcuar me ganxha hekuri. Në faqen e djathtë të shkëmbit kur vjen nga Guri i Bardhë duken gjurmët e vendit ku ka qenë fiksuar një kushtim që bënte fjalë për ndërtuesit dhe kohën e ndërtimit të saj.

Ndërtimin e urës së Vashës në këtë pikë e ka diktuar kalimi i rrugës së rëndësishme të karvaneve, që nisej nga Durrësi e fushat bregdetare për në Tiranë, Shkallë Tujani, Qafë Murrizë, Guri i Bardhë, Ura e Vashës, Klos, Flani i Bardhë, Qafë Buall për në Dibër. Kjo urë ka mbajtur mbi shpatullat e saj gjithë barrën e karvaneve të rrugës për në Dibër e cila e lidhte Dibrën me bregdetin nga merrej kripa e produktet e tjera. Ura e Vashës është ndërtuar pasi është shembur një urë tjetër e gurtë, rrënojat e së cilës shihen në brigjet e lumit Mat, disa metra poshtë saj. Ura e Vashës nuk ka pasur këtë emër, ajo quhej Ura e Skurës. Ajo është sinonim i urës me emrin Ura e Vashës, që gjendej jo shumë larg saj, në Sheun Dish, degë e majtë e Matit, dhe që sot quhet Ura e Skurës ose Ura e Vogël. Por duke qenë më e rëndësishme dhe emri Ura e Vashës më simbolik, ka përvetësuar emrin e urës në fjalë duke u njohur si e tillë në gojën e kalimtarëve.

Urën e Vashës e ka ndërtuar Haxhi Hajrulla Skura nga lagja Mansaj e Gurit të Bardhë. Sipas gjeneologjisë së familjes së tij, del se ky njeri ka jetuar afërsisht para 250 vjetëve, pra dhe ura i përket shek. XVIII. Ndërtimi i urës prej tij është bërë si vepër bamirësie. Për këtë urë flet dhe K. Ulqini. Si kohë të ndërtimit të saj na jep fillimin e shek. XIX dhe si ndërtues njeh Lime Tuskën nga Guri i Bardhë, i cili në fakt është ndërtues i Urës së Skurës.

Duke e krahasuar me urat e tjera të Matit, Ura e Vashës nga ana teknike dhe tipologjike përkon me Urën e Hoxhajve, Kulmares, Skurës në Gur të Bardhë dhe të Shën e Premtes në Gurrë të Vogël. Kurse jashtë Matit ajo ngjan me fazën e dytë të shtesës në Urën e Mesit në Shkodër dhe sidomos me Urën e Kamares në Librazhd[7]. Rëndësi ka se këto dy ura dihen se kur janë ndërtuar. Atë të Mesit e ka ndërtuar Mehmet Pashë Bushati në shek. XVIII. Kurse Ura e Kamares ka pasur një kushtim dhe datohet në vitin 1715.

Ura e Skurës gjendet mbi përroin Dish të Gurit të Bardhë disa metra në perëndim të Urës së Vashës. Ura është vendosur mbi dy shpate shkëmbore të ulëta buzë rrjedhjes së përroit. Ajo formohet nga një hark rrethor me qemer të dyfishtë (Fig. 4).

Ura është e ndërtuar me gurë të bardhë gëlqerorë kuadratikë me forma të rregullta e të daltuara. Për të dy qemerët është treguar i njëjti kujdes në

7) V. Shtylla, **Disa ura të vjetra prej guri në vendin tonë,** Monumentet, Nr. 11, Tiranë 1976, f. 223-224, Gj. Kroqi, V. Duka **Urat e gurit në Shqipëri.** Nga thesari i arkitekturës sonë, Nr. 10, 1981, nr. 1, 7.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

gdhendjen, ndërtimin dhe trashësinë e tyre. Lidhja e tyre është bërë me llaç gëlqereje, duke shkelur qemerin e sipërm mbi të poshtmin rreth 10 cm. Hapësira midis dy shpatullave të qemereve dhe bregut është mbushur dhe niveluar me gurë. Ura e Skurës është e gjatë 9 m, e gjërë 2.50 m. Trashësia e qemerit është 0.90 m, kurse lartësia nga kulmi i qemerit te pasqyra e ujit 5.50 m dhe hapësira midis dy këmbëve 5.50 m.

Këtë urë e ka ndërtuar një vajzë e pamartuar Hasime Tuska nga lagjja Laskaj e Gurit të Bardhë. Ndërtimi i kësaj ure lehtëson kalimin e karvaneve në shërbim të Urës së Vashës gjatë itinerarit të rru-



Fig. 6



Fig. 7

gës së madhe nga Tirana për në Mat dhe Dibër. Këtë e vërteton edhe fakti, që në hapësirën afër urave ndodhen rrënojat e hanit të Sinës, kurse në Vërrih ka rrënoja mesjetare. Ndërtimi i Urës së Skurës lidhet me fundin e shek. XVIII dhe fillimin e shek. XIX.

Ura e Kulmares ndodhet në Gur të Bardhë mbi Sheun Dish. Kjo urë nuk është në funksion të udhës së madhe, por të udhës së katundit të Gurit të Bardhë, e cila e lidh lagjen Hoxhaj me Malin Dish, prandaj quhet Ura e Lopëve pasi shërben për kalimin e bagëtive dhe shfrytëzimin e malit.

Ura e Kulmares (Fig. 5, 6) është ngritur mbi një breg të lartë shkëmbor dhe ka pjerrësi të theksuar nga krahu i majtë në të djathtë. Këmbët e saj janë vendosur në shkëmb të gjatë dhe ashtu si urat e tjera formohen me një hark gjysëm unazor me qemer të dyfishtë të shkallëzuar. Gurët janë prej shtufi dhe kuadratikë të lidhur me llaç gëlqere. Hapësira midis dy shpatullave të qemerëve dhe bregut është e mbushur me gurë duke i dhënë përparësi punimit të fasadës së jashtme. Ura e Kulmares është e gjatë 11 m kurse gjërësia e saj shkon 2.50 m me trashësi të qemerëve 1.50 m. Kjo është një ndër urat më të larta në Mat. Kulmi i qemerit të saj është i lartë 14 m. nga pasqyra e ujit, kurse hapësira midis dy këmbëve arrin 8 metra. Kjo urë ka një stil ndërtimi me urat e Vashës e të Skurës vetëm se këtu lidhja e gurëve me llaç gëlqereje është më e dobët.

Edhe Urën e Kulmares thuhet se e ka ndërtuar si vepër bamirësie vasha Hasime Tuska nga Guri i Bardhë. Ky është një gjest i rrallë në fushën e ndërtimeve inxhinjerike për emrin e një vashe në malësi. Ndërtimi i urës i përket fundit të shek. XVIII dhe fillimit të shek. XIX.

Ura e Hoxhajve (Fig. 7) ndodhet në lagjen e Poshtme Hoxhaj të Gurit të Bardhë, mbi përroin me emrin Zalli i Laskajve që ndan lagjen Hoxhaj nga ajo Laskaj të cilat dhe e mirëmbanin atë. Përroi mbi të cilin gjendet ura është degë e Sheut Dish.

Këmbët e kësaj ure janë vendosur mbi brigje të ulta shkëmbore. Ura ka një hark të shkallëzuar gjysëm rrethor. Trupi i saj është ndërtuar me qemer të dyfishtë ashtu si gjithë urat e përshkruara më sipër. Ajo është ndërtuar me gurë të bardhë gëlqerorë të daltuar. Traseja e urës është shtruar me rrasa guri dhe breza të tërthortë gurësh, ashtu si Ura e Allamanit në Klos. Përmasat e kësaj ure janë të njëjta me ato të Skurës. Pra gjatësia e saj është 9 metra, gjërësia 2.50 m, trashësia e qemerëve 0.90 m. Lartësia e qemerit nga pasqyra e ujit është 5.50 m, ndërsa hapësira midis dy këmbëve 5.50 m. Për nga forma,



Fig. 8

teknika dhe përmasat është e njëllojtë me Urën e Skurës, kurse nga lidhja me llaç me atë të Vashës mbi Mat.

Urën e Hoxhajve mbi Mat thuhet se e ka ndërtuar Met (Mehmet) Hoxha, (Hasa) nga lagjja Hoxhaj e Poshtme e Gurit të Bardhë dhe sipas breznisë llogaritet të jetë ngritur afërsisht para 220 vjetëve, pra në fundin e shek. XVIII.

Ura e Hoxhajve. Gjendet në pjesën e sipërme të Gurit të Bardhë, në lagjen Kodës dhe njihet me dy emra, Ura tek Gurrat në Kodër, pasi aty zënë fill gurrat nga buron Sheu i Lezedrës, ose Ura e Hoxhajve, sepse aty ndodhet familja me mbiemrin Hoxha, që njihet si ndërtuese e saj.

Ura ngrihet mbi një qemer rrethor. Kjo është një ndër urat më të vogla, e ndërtuar me gurë çmërsi, me një gjatësi 6 m dhe gjërësi 1.85 m. Trashësia e qemerit është 0.3 m dhe hapësira e dritës së tij ndryshon nga 1.2 deri në 1.8 m, lartësia e kyçit mbi nivelin e ujit është 0.8 m.

Ndërtimi i kësaj ure në këtë vend është kushtëzuar nga dy faktorë, kalimi mbi të i rrugës së karvaneve që vinte nga Tirana për në Mat dhe Dibër në itinerarin që kemi përshkruar për Urën e Vashës mbi Mat dhe komunikimin e lagjes me malin. Ura është mjaft e mirëmbajtur dhe merr vlera të veçanta si nga teknika ashtu dhe nga materiali me të cilin është punuar. Në këtë lagje V. Shtylla ka evidentuar gjurmë kalldrëmi të hershme mesjetare para osmane, mbeturina këto të rrugës nga Tirana për në Dibër[8].

8) V. Shtylla, **Rruga e vjetër Durrës-Dibër,** Gazeta «Bashkimi» 6 Gusht 1982.

DO NOT COPY

Kjo urë thuhet se është ndërtuar në fillim të shek. XIX nga Mehmet dhe Ali Mikli (Hoxha) nga lagjja Kodës e Gurit të Bardhë, ku gjendet ura. Ajo është restauruar nga mjeshtri gurabardhas Hamit Karaj.

Ura e Halilajve është ndërtuar midis katundeve Dars, Bel e Fullqet, mbi degën e majtë të lumit të Matit me emrin Sheu i Xhabzës i cili buron nga Xibëri, pikërisht në rrjedhjen e poshtme të tij, rreth 500 m, mbi bashkimin me Matin, midis Darsit e Fullqetit. (Fig. 8).

Ura është ngritur në një vend shkëmbor mbi dy brigje të larta. Ajo është ndërtuar me gurë shtuforë të daltuar në formë kuadratike të lidhur me llaç gëlqereje. Ajo formohet nga një hark dhe një dritare plotësuese në bregun e djathtë. Harku i saj është i shtrirë dhe i thyer në mes. (Fig. 9). Trupi i urës formohet nga një qemer i dyfishtë me trashësi 0.80 m. Gurët e qemerit të parë që formojnë shtratin e urës janë punuar me kujdes dhe kanë përmasa më të mëdha. Trashësia e tij është 0.55 m. Qemerit të dytë që shkel të parin, me trashësi 0.25 m, i është dhënë më pak kujdes. Harku i urës ka një gjatësi prej 15 m, gjërësia midis dy këmbëve të saj është 11 m, kurse lartësia nga pasqyra e ujit arrin 9 m. Traseja e rrugës ka një gjërësi 2.60 m dhe është e shtruar me gurë e pllaka gurësh lumi. Për të orientuar kalimtarët, për vetë lartësinë e urës, në të dy anët e mesit të urës dhe fillimit të këmbëve mbi trase është ngulur nga një çift gurësh. Për të plotësuar boshllëkun që formohet në bregun e djathtë, mbi urë është shtuar një hark i vogël plotësues, i cili ka një dritare. Ky hark i vendosur mbi shpatullën e urës, ka një gjatësi 4.50 m duke e rritur kështu gjatësinë e përgjithshme të urës në 19.50 m. Ky i fundit formohet nga një qemer me trashësi 0.40 m. Lartësia dhe gjërësia e dritares janë 1.70 m dhe 1.10 m.

Ura e Halilajve thuhet se është ndërtuar nga një pjestar i fisit të Halilëve, emri dhe koha e të cilit nuk mbahet mend. Në vështrimin e sotëm ajo duket se i ka shërbyer ndërlidhjes së katundeve Dars e Fullqet dhe atyre përreth. Por po të shikojmë rrugët që gërshetohen dhe ndërlidhen në këtë pikë, në mvartësi dhe të kohës kur ajo është ngritur, del se ajo ka pasur rëndësi me përmasa të mëdha krahinore dhe ndërkrahinore. Në të dy anët e urës gjenden gjurmët e katër kalldrëmeve të meremetuar dhe të rindërtuar kohë pas kohe. Njëri prej tyre, mbi urën në të ngjitur të Darsit quhej «Kalldrëmi i vjetër» dhe ruante tiparet e trasesë së një rruge mesjetare[9].

Funksioni i kësaj ure dhe i rrugëve me kalldrëme ka qenë në shërbim të rrugës së karvaneve, që vinin nga Mati në disa drejtime. Rruga që vinte nga Durrësi e Tirana, thamë se degëzohej në dy arterie, njëra prej tyre nëpër Gurë të Bardhë, Ura e Vashës për në Dibër, kurse tjetra si binte në Xibër kalonte nëpër Qafë Shkallë bri kalasë ilire të Xibërit në Dars, tek ura e Pazarit të Urës në Klos dhe ajo e Halilajve në Dars. Prej këtej rruga degëzohet në katër drejtime. Njëra prej tyre, zbriste 500 m poshtë dhe binte mbi lumin Mat, aty ku është Vau i Fullqetit, një pikë e rëndësishme kalimi, që depërtonte



Fig. 9



Fig. 10

9) D. Kurti, **Kala e qyteza të panjohura në Mat,** Monumentet, nr. 18, Tiranë, 1979, f. 84, 85, 88.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12

në rrjedhën e djathtë të Matit për tek Ura e Allamanit në Klos. Pikërisht tek Vau i Fullqetit, aty ku sot është ngritur ura e varur, duken në shkëmbin rënor vrima, që kanë shërbyer për ndërlidhjen e dy brigjeve me lundra e trape në të kaluarën, deri sa nuk ishte ngritur ura tek Pazari i Urës në Klos, rreth 1 km, larg tyre. Dega tjetër merrte sipër në Fullqet, Bel, Unjate, Ftu, Gurrë e Madhe, Gurrë e Vogël, Ura e Shën e Premtes, Frankth për në tregun e Komsisë. Nga tregu i Komsisë nëpër këtë itinerar shkohej në Pazarin e Urës në Klos dhe më tej për në Dibër.

Ura e Halilajve nga forma, teknika, elementët arkitektonikë ka veçori nga urat e tjera të Matit. Këto veçori duken në harkun e saj të hapur dhe të thyer në mes, në zmadhimin me një hark të vogël plotësues, në përputhjen e dy qemerëve njëri mbi tjetrin. Ajo nuk është ndërtuar në një kohë me urat e sipërme të Gurit të Bardhë dhe është ndër urat më të vjetra që gjenden sot të pa dëmtuara në Mat. Mendojmë se kjo urë duhet t'i përkasi kapërcyellës nga shek. XVII në shek. XVIII.

Ura e Allamanit. Në rrjedhjen e djathtë të Matit, midis Bejnit dhe Pleshës rrjedh Sheu i Bejnit. Aty ku ky përrua derdhet në Mat, në të hyrë të qytetit të Klosit ndodhet Ura e Allamanit. Kjo urë është ngritur mbi një taban shkëmbor prej shtufi rënor buzë rrjedhjes së përroit (Fig. 10). Ajo përbëhet nga një hark me qemer të dyfishtë. Ashtu si tek urat e tjera qemerit të parë i është dhënë përparësi në përmasat e gurëve, zgjedhjen e punimin e tyre. Ura është ndërtuar me gur shtufi rënor, kuadratik të daltuar dhe të lidhur me llaç gëlqereje. Traseja e urës është shtruar me gur e rrasa lumi. Kalldrëmi i saj përshkohet në mënyrë të tërthortë në çdo 0.80-1 m, me breza gurësh në formë shkallareje. Brezat e gurëve tek kjo urë dhe tek ajo e Hoxhajve në Gurë të Bardhë, janë gjithashtu të rëndomtë në urat e Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut. Ura e Allamanit ka një gjatësi

prej 16 m. Trashësia e përgjithshme e qemerit është 0.90 m. Midis tyre qemeri i parë është 0.60 m, kurse i sipërmi është 0.50 m. Gjërësia e trasesë shkon 2.60 m. Largësia e qemerëve midis të dy këmbëve 11 m, kurse lartësia nga kulmi i qemerit në pasqyrën e ujit 5.50 metra. Përmasat e gurëve të qemerit të parë janë 0.60 m x 0.30 m x 0.25 m.

Ndërtimi i urës në këtë vend, ka lidhje me udhën e madhe që përshkonte Matin nga jugu drejt veriut gjatë rrjedhjes së djathtë të tij e cila ishte arteria kryesore dhe më e fuqishme për ndërlidhjen e brendshme të krahinës. Pikërisht nëpërmjet saj ndërlidhe-



Fig. 13

shin mikrokrahinat dhe tregjet e tyre. Nëpër këtë urë kalonin karvanet që vinin nga Tirana e Dibra, të cilët nga jugu depërtonin drejt veriut. Por kjo urë ndërlidhte edhe një rrugë tjetër, tregun e Klosit me Lisin e Stellushin, nëpërmjet itinerarit Klos, Pleshë, Cërujë, Patin, Rrapi i Celës, Kurdari, Gjarlish për Lis ose djathtas në Vinjoll e Stellush dhe më tej për në Peshkopi, Dibër e Prizren. Ura e Allamanit është një ndër urat që përdoret në masë edhe sot.

Ura e Allamanit, sikurse dihet nga emri, është ndërtuar nga një pinjoll i derës feudale të oxhakut të Allamanit nga Kurdaria, që e shtrinte sundimin e semtit të tij deri në Klos. Koha e ngritjes dhe emri i ndërtuesit nuk dihet. Për sa i përket teknikës së ndërtimit, përmasave të trasesë dhe qemerëve me breza të tërthortë, ura ka ngjashmëri me Urën e Hoxhajve në Gurë të Bardhë. Përveç këtyre ngjasimeve, ajo ka disa elementë të përbashkët, të cilat datohen të shek. XVIII dhe XIX[10]. Për këto ngjasime mendojmë se ajo i takon shek. XVIII.

Ura e Shën e Premtes gjendet rrëzë malit të Gurrës, vazhdim i atij Skënderbeg në rrjedhjen e sipërme të Sheut të Lusës, midis katundeve Gurrë e Vogël dhe Frankth. Ka marrë këtë emër, pasi aty afër gjenden rrënojat e një kishe mesjetare me emrin e Shën e Premtes.

Ura është ngritur mbi një mjedis malor, në këmbët e malit mbi dy shpatet e larta shkëmbore të përroit[11]. Ura formohet nga një hark rrethor dhe është ndërtuar me qemer të dyfishtë. Trupi i saj është ngritur me gurë të bardhë gëlqerorë (Fig. 11), me forma të rregullta kuadratike dhe të daltuar. Këmbët e urës janë vendosur në taban shkëmbor (Fig. 12). Dy anët e qemerit të poshtëm janë ndërlidhur me pllaka hekuri ose ganxha. (Fig. 13). Ura e Shën e Premtes është e gjatë 10.50 m ka gjërësi 2.50 m dhe trashësi qemeri 0.80 m. Hapësira e dritës midis dy këmbëve është 6 metra, kurse lartësia e kulmit të qemerit nga pasqyra e ujit shkon 9 metra. Kjo pas Urës së Kulmares, së bashku me Urën e Halilajve janë nga urat më të larta në Mat.

Ndërtimi i kësaj ure, është i lidhur me rrugën që ndërlidhte tregun e Klosit me atë të Komsisë. Kjo rrugë si degë e rrugës së madhe që vinte nga Durrësi nëpër Zgërdhesh, Qafë Shtamë, Komsi për në Mat degëzohej në Komsi me një arterie nëpër Zu-

10) GJ. Kroqi, V. Duka, **Urat e gurit në Shqipëri,** Nga thesari i arkitekturës sonë, nr. 10/1981, nr. 2, 7, V. Shtylla, **Një urë e vjetër prej guri në Krujë,** Revista «Ylli», nr. 21/1982, f. 14.

11) Degët e lumit Mat kanë tre sinonime, në Krye-Mat (Klos) me emrin Sheu. Në Kurdari e Gurra, Lusë-sa, në Rranzë e Prell, Zall-i në dallim nga Prroska, Prroi dhe lumi Mat.

DO NOT COPY

shakë, Frankth, Ura e Shën e Premtes; Gurrë e Vogël, Gurrë e Madhe; Mishtër, Unjate, Bel, Fullqet, këtu binte tek Vau i Fullqetit për në Klos, ose kalonte mbi urën e Halilajve për në Dars për tek ura Pazari i Urës në Klos. Këtu rruga të çon për në Gurë të Bardhë djathtas, ndërsa majtas për në Dibër. Të moshuarit tregojnë se në itinerarin e kësaj rruge, nga Komsia në Klos janë ngritur 4 xhami të baraslarguara nga një orë rrugë në këmbë përkatësisht në Komsi, Frankth, Gurrë e Madhe – Mishtër e Dars. Gjatë itinerarit të rrugës, në shërbim të së cilës është ura, duken gjurmë kalldrëmesh mesjetare. Këto shihen në Frankth, në të dy anët e urës në Gurrë të Vogël dhe sidomos gjatë rrëzës së malit, nëpër vendin e quajtur «Shkëmbijt Hamzije» në dy Gurrat dhe në Bel e Dars.

Lidhur me ndërtimin e urës, thuhet se atë e ka ngritur Jashar Kadriu nga Gurra e Madhe, për të ndërlidhur zonën e Gurrave e të katundeve përreth me tregun e Komsisë. Koha e ndërtimit të saj përkon me fillimin e shek. XIX. Nga ana tipologjike dhe teknike e ndërtimit kjo urë përkon me urat e Gurit të Bardhë në Mat.

Ura e Shahinit në Patin gjendet mbi Sheun e Madh, i cili buron nga mali i Balgjajt. Si përshkon Patinin ai bie poshtë në Bërshi, duke mbledhur dhe ujra të tjera. Në rrjedhën e poshtme të tij, aty ku bashkohet me Matin, emërtohet Sheu i Balës dhe bëhet degë e djathtë e tij.

Ura është ngritur mbi dy shpatet e larta shkëmbore të prroit me përbërje shtufore, në afërsi të lagjes Çelaj. Ura formohet nga një hark me qemer të dyfishtë dhe është ndërtuar me gur shtufor të skuadruar të lidhur me llaç gëlqereje. (Fig. 14). Kjo urë është më e vogël se të tjerat. Këtë e ka diktuar vetë mjedisi ku ajo është ngritur. Gjatësia e saj është 6 m; kurse hapësira midis dy këmbëve 4.50 m. Gjërësia e trasesë është 2 m, kurse trashësia e të dy qemerëve 0.80 m. Lartësia nga kulmi i qemerit në pasqyrën e ujit është 7.60 m.

Ndërtimi i saj është kushtëzuar nga kalimi i rrugës në këtë hapësirë që ndërlidhte tregun e Klosit me atë të Lisit, duke kaluar nga Klosi në Pleshë, Cërujë, Patin, Kurdari, Gjalish për Lis ose Vinjoll, Stellush nëpër Qafë Murrë për në Dibër. Në itinerarin e rrugës, sidomos në Patin tek Rrapi i Çelës e në vende të tjera gjenden gjurmë kalldrëmesh në përshtatje me terrenin.

Këtë urë e ka ngritur një i quajtur me emrin Shahin, nga oxhaku i Çelajve në Patin. Koha e ndërtimit të saj, duke u bazuar dhe në teknikën dhe tipologjinë e saj, i përket kapëcyellës midis shek. XVIII-XIX. Ura është në gjendje të mirë dhe në përdorim të përditshëm nga banorët.



Fig. 14



Fig. 15

URAT E RRËNUARA. Përveç urave të mësipërme që janë në gjendje të mirë dhe në përdorim të përditshëm edhe sot, kemi gjetur gjurmët e disa urave të rrënuara, për të cilat do të japim të dhëna të pjesëshme. Numëri i këtyre urave të evidentuara arrin në 6 dhe ato shtriheshin në trevën e urave të tjera. Këto ura kanë qenë 2 mbi lumin e Matit dhe 4 të tjerat në degët e tija. Që të gjitha kanë qenë në shërbim të udhës së madhe pra të karvaneve. Me vetë kalimin e kohës dhe rrënimin e tyre ka humbur emri e për rrjedhojë edhe historiku i tyre duke vështirësuar kështu pasqyrimin e të dhënave për to.

Sipas rrënojave njëra prej këtyre urave ka qenë në veri të Urës së Vashës mbi lumin e Matit, disa

POOR COPY

metra poshtë saj. Gjurmët e kësaj ure duken në bregun e djathtë të lumit dhe pas prishjes së saj, është ndërtuar Ura e Vashës. Koha e ndërtimit dhe ndërtuesi i saj nuk dihen por kuptohet që ajo është më e lashtë se ajo e Vashës.

Ura tjetër mbi lumin e Matit, ka qenë aty ku janë rrapet e sotëm shekullorë në Klos, në vendin e quajtur «Pazari i Urës». Kjo hapësirë ndodhet midis vendit ku bashkohet Sheu i Rrapave që vjen ndërmjet Klosit e Bejnit në lumin e Matit. Kështu tregu gjendej midis dy ujrave, atij të Matit dhe Sheut, mbi të cilët ishin ngritur përkatësisht nga një urë. Ky treg siç e kemi cilësuar ndërlidhej me rrugë me gjithë Matin dhe krahinat e tjera, sidomos me Dibrën e Tiranën dhe mund të themi se ka qenë pika nevralgjike që ndërlidhte rrugët mbi të cilat ndodhen urat.



Fig. 16

Në funksion të këtij tregu dhe të rrugëve gjenden edhe një rrjet hanesh për bujtjen e kalimtarëve si në Xibër Hane, Gurë të Bardhë, Fshat, Klos, Plani i Bardhë midis të cilëve njihen Hani i Sinës, Lleshit, Allushit dhe të tjerë. Sipas dëshmive të moshuarve, kjo urë ka qenë me tre harqe dhe dy dritare shkarkuese në mes. Gjatësia e saj shkonte rreth 34 metra, pra ishte ura më e madhe dhe më e rëndësishme në Mat. Një hark të daltuar e kemi parë në këmbë në vitin 1950, por më vonë është prishur nga lumi.

Ura ka qenë shtrirë në bregun e djathtë të sotëm të lumit Mat dhe shkonte drejt perëndimit, por tani lumi e ka lënë këtë shtrat dhe ka shkuar më tej në perëndim, duke e mbushur hapësirën me zhavorr. Gjatë vrojtimit mundëm të kapim tre pikat e këmbëve të saj. Në cepin lindor gjurmët e bazamentit të këmbës kishin përmasat 4 x 4 m (Fig. 15). 22 metra larg kësaj pike ndeshëm gjurmë muresh të një trakti tjetër që në sipërfaqe dukej me përmasat 2 x 2 m. Më tej 10 m larg tyre, gjetëm një trajt tjetër, ndoshta i këmbës perëndimore, ku dhe këtu pjesa e dukshme ishte 2 x 2 m. Kjo urë sipas gojëdhanave është shkatërruar nga përmbytjet e mëdha në fillim të shek. XX. Pas kësaj kohe është rindërtuar prej druri nga familja e Voshit në Klos por përsëri është shkatërruar.

Duke gjykuar nga toponimi «Pazari i Urës» mësojmë se tregu që bëhej këtu ka qenë në funksion të urës dhe se e mori emrin nga ura. Pra ura vetë është më e lashtë se tregu. Por jo larg saj, aty ku sot është qyteti i Klosit bëhej pazari, vendi quhet Stragj, që përkon me fjalën shqipe tregj-u-treg. Paralelizëm të tillë gjejmë edhe në Komsi, Maja e Stregjut, vend përsëri ku bëhej tregu. Në funksion të pazarit kanë qenë edhe rrapet shekullorë, të cilët bënin hije dhe disa prej tyre janë edhe sot. Urën tek «Pazari i Urës» thuhet se e ka ndërtuar familja e Allamanit, paraardhësit e së cilës dokumentohen që në shek. XVI.

Ura tjetër e rrënuar, ka qenë rreth 2000 m larg dhe përkarshi Urës së Pazarit të Urës, mbi Sheun e Rrapave që vjen midis Bejnit e Klosit. Ura gjendej disa metra në veri të urës së sotme të rrugës automobilistike që të çon nga Klosi për në Bulqizë. Gjurmët e saj shquhen në bregun shkëmbor të anës së djathtë. Kjo urë ka fizionomi të plotë, por rreth viteve 30, mbeturinat e saj u përdorën për ndërtimin e rrugës automobilistike, që kalonte përbri. Asgjë nuk dihet rreth përmasave dhe historikut të saj. Nga ana tjetër nuk dihet nga cila urë mori emrin tregu që gjendej midis dy ujrave dhe midis dy urave me të cilat ishte lidhur në mënyrë të pazgjithshme. Në rrjedhën e poshtme të Sheut të Balës në katundin Bërshi, degë e djathtë e Matit kemi ndeshur mbeturinat

DOKTORATURA



Fig. 17



Fig. 18

e një ure tjetër. Gjurmët e saj duken pak metra mbi urën e rrugës automobilistike nga Burreli për në Klos, në krahun e djathtë të përroit, kurse në anën e majtë duken gjurmë kalldrëmi. Kjo urë i shërbente rrugës që përshkonte krahun e djathtë të rrjedhës së Matit, duke u nisur nga Klosi në jug e drejt veriut nëpër luginë, ku degëzohej e ndërpritej nga rrugë të tjera.

Poshtë Urës së Shën e Premtes në Gurrë të Vogël, po mbi të njëjtën degë të Matit, Lusës, ka qenë një tjetër urë e quajtur Ura e Lezjes. Kjo urë i shërbente katundit për shfrytëzimin e pyjeve dhe të kullotave përtej rrjedhës së përroit. Për të thuhet se e ka ngritur fisi i Lasjes në atë kohë me atë të Shën e Premtes. Mbeturinat e saj nuk ruhen.

Sipas të dhënave gojore ura e fundit nga e cila nuk ruhen gjurmë ndodhej në katundin Frankth. Edhe kjo si ajo e Lezjes i shërbente rrugës që ndërlidhte dy tregjet Klos-Komsi.

Këto ura janë rrënuar dhe atëhere kur rruga e karvaneve dhe tregu i Klosit humbën rëndësinë e tyre, nuk i rindërtuan dhe mirëmbajtën më, dhe si pasojë dhe sot duken vetëm gjurmët ose ruhet kujtimi i tyre. Urat e tjera që siguronin lidhjen midis katundeve, në sajë të kujdesit të popullit i qëndruan kohës dhe erdhën deri në ditët tona.

Rëndësinë dhe gjallërinë e rrugëve të karvaneve tregu i Klosit e humbi me goditjen e parë që pësoi në vitin 1910 kur ekspeditat turke prishën punishtet e barotit që ndodheshin në këtë zonë.[12] Me ndërtimin e rrugëve automobilistike në vitet 30 të këtij shekulli karvanet e humbën krejtësisht rëndësinë. Kështu këto ura mbetën vetëm për ndërlidhjen e katundeve midis tyre.

*
* *

Nga sa parashtruam më sipër, mund të arrijmë në disa përfundime lidhur me kohën e ndërtimit të urave të gurta në Mat, ndërtimin, tipologjinë dhe datimin e tyre.

Urat e gurta në Mat u ndërtuan në përshtatje me kushtet ekonomike dhe historike të kohës. Ato janë vepër e vendasve. Ndërtimi i tyre u kushtëzua me lulëzimin e tregut dhe të rrugëve që rriheshin nga karvanet. (Fig. 16, 17). Ndërlidhja krahinore Durrës, Tiranë, Mat, Dibër, krijonte një arterie të fuqishme nga lëviznin mallrat dhe karvanet. Pika më nevralgjike ku kalonin këto mallra transit ishte Krye-Mati ose Klosi i Sipërm, ku gjenden dhe urat. Të tërheq tepër vëmëndjen fakti, që këto ura ndodhen pikërisht në hapësirën ndërmjet katundeve edhe punishteve të barutit. Prandaj duket se edhe baroti u dha rrugëve dhe urave jetën e tyre, mbi të cilat transportohej buka e armëve për të mbrojtur lirinë dhe atdheun.

Koha e ndërtimit të shumicës së urave përkon me shek. XVIII dhe fillimin e shek. XIX, kohë në të cilën lulëzuan dy pashallëqet e mëdha shqiptare ai

12) D. Kurti, **Zeja e punimit të barutit në Mat,** vep. cit.

DO NOT COPY

i Bushatllinjve të Shkodrës dhe ai i Janinës. Në se do t'i vështrojmë nga ana tipologjike dhe teknike urat e Matit kanë tipare të përbashkëta me urat e vendit tonë. Këto tipare përputhen me urat e krahinave fqinjë Krujë, Librazhd, Shkodër, Tiranë etj.

Ndërtimi i tyre i është përshtatur kushteve të terrenit. Megjithatë ai është zgjedhur, duke preferuar brigjet shkëmbore të cilët jo vetëm u jepnin fortësi e jetëgjatësi, urave por edhe mundësi të bëheshin sa më pak shpenzime. Vetëm Ura e Pazarit të Urës është ngritur në mjedis të butë, tokë zhavorr, kurse 15 të tjerat mbi brigje të fortë ose të ulta shkëmbore.

Midis urave të sipërme më e gjatë ka qenë ajo tek Pazari i Urës pastaj vijnë me radhë Ura e Halilajve, Allamanit, Vashës, Për lartësinë e tyre dallohen Ura e Kulmares, Halilajve dhe Shën e Premtes. Trupi i këtyre urave është ndërtuar me gurë të daltuar kuadratik dhe me qemer të dyfisht, dukuri dominuese dhe specifike për Matin. Për ndërtimin e tyre janë shfrytëzuar materialet rrethanore (gurë gëlqerorë, shtuforë dhe çmërsi) që gjendeshin në vendet ku janë ngritur urat. Gjithashtu urat e Matit dallohen për trashësinë e qemerit të tyre që lëviz nga 0.80-1.60 m.

Midis urave të Matit, 15 prej tyre formoheshin nga një hark, kurse 3 të tjera me 2-4 harqe. Trupi i tyre formon një gjysëm rrethi unazor. Vetëm ura e Halilajve, ka një hark të hapur dhe të thyer në kulm. Shtresa e urave është përgjithësisht me gurë (Fig. 18) e rrasa pa një kriter të dukshëm. Dallohen për veçori specifike Ura e Allamanit dhe ajo e Hoxhjes, ku përveç kalldrëmit, traseja ndërpritet nga breza të tërthortë në formë shkallareje për të lehtësuar kalimin e karvaneve. Gjithashtu qemeret e Urës së Vashës dhe asaj të Shën e Premtes janë ndërlidhur me ganxha hekuri.

Të gjitha këto elemente i vërejmë tek urat e vendit tonë, prandaj urat e Matit në teknikën e ndërtimit dhe tipologjinë e tyre kanë një unitet.

Në Mat përveç urave të gurta ka pasur dhe një rrjet të dendur urash prej druri. Ato gjenden dhe sot dhe ndërlidhin katundet midis tyre. Ndërtimi i tyre ka qenë i thjeshtë. Mbi brigjet shkëmbore hidheshin trarë druri, të cilët përforcoheshin poshtë me këmbë prej druri, kurse shtrati i tyre shtrihej me dërrasa. Për ndërtimin e këtyre urave përdorej kryesisht druri i lisit. Këto ura gjendeshin kryesisht në rrjedhën e mesme të lumit, aty ku degët e tij kanë rrjedhur të qeta në terren fushor ose kodrinor.

DO NOT COPY

Dilaver KURTI

DO NOT COPY

LES PONTS EN PIERRE DE LA REGION DE MAT

RESUME

La région de Mat se trouve dans le massif central, entre les chaines des montagnes de Skënderbeg et celles de Dejë et Belgaj, étant reliée au bord de mer, à ses plaines et aux régions qui se trouvent derrière elle, au moyen des cols de montagnes. Au nord, la route traversait la gorge de Mat, là où le fleuve de Mat joint celui de Fand, ayant comme point de passage «Kulmen e Dervenit».

Au sud, la route qui partait de Tirana, après avoir passé à travers «Shkalla e Tujanit», entrait dans la première porte de la région de Mat, au col de Murrizë, descendait à Xibër où se ramifiait en deux artères dont l'une descendait face à la forteresse illyrienne de Xibër, tandis que l'autre passait de Xibër à Gur i Bardhë, au pont de Vashë sur le fleuve de Mat, à Klos, à Fani i Bardhë, au col de Buall et enfin à Dibër. L'autre porte principale qui passait à travers la région de Mat, était la route qui allait du Dyrrah antique à Verë, Prozë, Zgërdhesh, Cudh et passant à travers le Col de Shtamë continuait vers Mat, Urëselitëz, Frankth, Muzhakë, le col de Porte, Hurdha e Kaikes sur Mat, le pont de Banjë, Burgajet, colline Saint Pierre, Lis, la montagne Sainte Marie, Vigj, Stellush et continuait vers Dibër et Kosovë.

Ces routes servaient aux caravanes et aux quatres marchés de Mat, dont le plus ancien et le seul documenté en 1467 et au XVIIe siècles, est celui de Lis, qui en ce temps-là était le centre de la région, jusqu'en 1922. Les données du folklore et celles orales parlent de liens réciproques entre les marchés de Mat et ceux des régions d'Elbasan, Durrës, Tiranë, Krujë, Lezhë, Shkodër, Dibër, Kukës, Ohër, Monastère de Gostivar, Tetovë, Prizren, Gjakovë, Pejë et Prishtinë. Dans les marchés de la région de Mat on trouvait des produits agricoles et d'élevage, des poteries et du bois. C'est dans cette région qu'on préparait la poudre pour fournir les marchés des autres régions mentionnées ci-dessus.

Ici nous allons traiter des ponts qui se trouvent sur le réseau routier, reliant la région de Mat à celles voisines, des ponts qui sont étudiés sur place ou sur la base des données orales, dans le cas où il en manque des traces. Les ponts du réseau routier, qui traversait la région de Mat, se trouvent sur le courant supérieur du fleuve de Mat. Ils ont été construits en pierre ou en bois. Avec le temps, beaucoup d'entre eux sont tombés en ruines, ne laissant que quelques traces ou leur nom dans la mémoire des gens.

On dit que les ponts sont construits par les maîtres du pays, par ceux qui ont construit les habitations populaires. Pour la construction des ponts, tout d'abord on embauchait les maîtres et on assurait les matériaux de construction, tels la chaux conditionnée, au moins de trois ans et le bois pour la construction de la charpente. Etant donné que les ponts sont des constructions communes des gens d'un village, d'un quartier ou d'une famille, les matériaux de construction étaient assurés en commun, tandis que les frais du travail étaient payés au maître par divers individus.

Les ponts qui se conservent en bon état sont 9. Cinq d'entre eux se trouvent à Guri i Bardhë, tandis que les autres dans les villages de Klos, Dars, Patin et Gurrë e Vogël. Le peuple les connait sous les noms: pont de Vashe, pont de Skurë, pont de Kulmare, pont des Hoxha, pont d'Allaman, pont des Halilaj, pont de Shahin, pont de Saint Vendredi.

Pour la construction des ponts tout d'abord on choisissait l'endroit, là où passait la route, avec des détours, selon le terrain. Il fallait choisir un terrain rocheux avec de hautes ou de bas côteaux sur lesquels on creusait les fondations des pieds du pont. Plus tard, on élevait l'armature au-dessus de laquelle on construisait les voûtes du pont. Les ponts étaient construits avec des pierres calcaires ou sabloneuses gravées d'une forme quadratique d'une longueur de 50-60, d'une largeur de 40-45 cm et d'une épaisseur de 15-20 cm.

Le pont de Vashe se trouve sur le fleuve de Mat, entre les villages de Klos et Guri i Bardhë, avant que le fleuve sorte dans la vallée. Le pont relie les deux côtes du fleuve. Il a été le seul moyen de communication sur le courant supérieur de ce fleuve.

Le pont est composé d'un seul arc ayant sur le côté droit du courent d'eau une petite fenêtres. Les deux culées du pont sont disposées sur les côteaux rocheux du fleuve, la droite s'appuyant sur la montagne de Vërrith, la gauche sur la montagne de Dish (tab. 1-2). Le pont est d'une longueur de 11 m, ayant un espace de lumière entre les deux culées d'une longueur de 7m et d'une hauteur de 7m. L'arc du pont est construit d'une double voûte. Le pont de Vashe a été construit par Haxhi Hajrulla Skura, du quartier Mansaj de Guri i Bardhë. Il a vecu pendant le XVIIIe siècle.

Le pont de Skure *se trouve sur le torrent de Dish à Guri i Bardhë, quelques mètres à l'Ouest du pont de Vashe. Il est disposé sur deux bas versants rocheux des deux côtés du torrent. Il est formé d'un arc en plein cintre doté d'une double voûte. (tab. 11, 1-2).*

Le pont est construit avec des pierres calcaires blanches gravées d'une forme quadratique régulière. La même attention a été prêté pour la construction des deux voûtes, leur forme et leur épaisseur. L'espace entre les deux culées d'arc-boutant et les côtés, est rempli et nivelé de pierres. Le pont de Skure est d'une longueur de 9 m et d'une largeur de 2.50 m. L'espace entre les deux culées du pont est d'une longueur de 5.50 m et d'une hauteur de 5,50 m tandis que la voûte est d'une épaisseur de 0,90 m. La construction de ce pont remonte au XVIIIe siècle et au début du XIXe siècle.

Le pont de Kulmare *se trouve à Guri i Bardhë sur Shën-Dish. Il a été élevé sur un haut côteau rocheux d'une grande pente de gauche, à droite. C'est un pont construit d'un arc en plein cintre, à double voûtes échelonnées, dont les culées sont disposées sur deux rochers. Il est construit avec des pierres ponces d'une forme quadratique liées à sec. La longueur du pont est de 11m, la largeur de 2.50 m et l'épaisseur des voûtes de 1.50 m. C'est un des plus hauts ponts de la région de Mat. L'espace entre les deux culées du pont est d'une longueur de 8m et d'une hauteur de 14m. C'est un pont construit à la fin du XVIIIe siècle et au début du XIXe siècle.*

Le pont des Hoxhaj *(tab. IV, 1-2) se trouve dans le quartier Hoxhaj du village de Guri i Bardhë.*

Les pieds de ce pont sont disposés sur de bas côteaux rocheux. C'est un pont formé d'un arc échelonné en plein cintre à double voûtes, construit de pierres blanches calcaires gravées. Il est pavé de dalles de pierres et de bandes de pierres placées de travers, tout comme le pont d'Allaman à Klos. (tab. IX, 1). La longueur du pont est de 9m, le largeur de 2.50 m et l'épaisseur des voûtes de 0.90m. L'espace entre les deux culées du pont est d'une longueur de 5.50 m et d'une hauteur de 5.50 m. Ce pont a été construit à la fin du XVIIIe siècle.

Le pont des Hoxhaj *se trouve sur la partie supérieure du village de Guri i Bardhë. C'est un pont qui s'élève sur une voûte circulaire, l'un des plus petits ponts construit de pierre, d'une longueur de 6 m et d'une largeur de 1,85 m. L'epaisseur de la voûte est de 0.3 m tandis l'espace entre les deux culées du pont est d'une longueur de 1,2-1,8 m et d'une hauteur de 0,8 m. On dit que ce pont a été construit au début du XIXe siècle Mehmet et Ali Mikli.*

Le pont des Halilaj *est construit entre les villages de Dars, Bel et Fullqet sur l'affluent gauche du fleuve de Mat, appelé Shen i Xhabzës.*

Le pont est construit avec des pierres ponces gravées, en forme quadratique, liées avec du mortier de chaux, sur un terrain rocheux. Il était composé d'un seul arc et d'une petite fenêtre du côté droit. Le pont est doté d'une double voûte d'une épaisseur de 0,80 m. Les pierres de la première voûte qui forment le lit du pont sont traitées avec soins et sont de grandes dimensions. L'arc du pont est d'une longueur de 15m, tandis que l'espace entre les deux culées du pont est d'une longueur de 15m et d'une hauteur de 9m. Le pont est pavé de pierres et de dalles de pierres fluviatiles.

Le pont des Halilaj du point de vue de la forme, de la technique, des éléments architectoniques, diffère des autres ponts de la région de Mat. Son arc est très élargi et brisé au milieu, et le pont s'agrandit par l'adjonction d'un autre petit arc supplémentaire: C'est un des plus anciens ponts qui se conserve dans la région de Mat. Sa datation remonte au XVIIe-XVIIIe siècle.

Le pont d'Allaman *s'élève sur le torrent de Sheu i Bejnit. Il est composé d'un arc à double voûte. Comme dans les autres ponts, les pierres de la première voûte sont choisies et travaillées avec plus d'attention. Ce sont des pierres ponce, gravées d'une forme quadratique, liées avec du mortier de chaux.*

Le pont est pavé de pierres et de dalles fluviatiles, et tous les 80-100 cm des bandes de pierres sont placées de travers, en forme d'escalier. Le pont est d'une longueur de 16m. L'épaisseur de la première voûte est de 0,60m, tandis celle de la voûte supérieure de 0.50m. L'espace entre les deux culées du pont est d'une longueur de 11m et d'une hauteur de 5.50m. Les dimensions des pierres de la première voûte sont: 0,60m x 0,30m x 0,25m. En ce qui concerne la technique de la construction et ses dimensions, le pont ressemble à celui de Hoxhaj, à Guri i Bardhë. A part ces ressemblances, ces ponts ont quelques éléments communs qui appartiennent aux XVIIIe et XIXe siècle. Par ces ressemblances nous pensons que ce pont a été construit au XVIIIe siècle.

Le pont de Saint Vendredi *se trouve au pied de la montagne de Gurrë, entre les villages de Gurë e Vogël et de Frankth. On l'appelle ainsi parce que à ses voisinnages se trouvaient les ruines d'une église médiévale, qui portait le même nom.*

Le pont est construit sur un terrain montagneux, au pied de la montagne, sur deux hauts versants rocheux des deux côtés du torrent. Il est composé d'un arc circulaire et d'une double voûte. Le pont est construit avec des pierres blanches calcaires gravées en forme quadratique. Les pieds du pont s'appuient sur un terrain rocheux (tab. X. 2). Le pont de Saint Vendredi est d'une longueur de 10.50m, d'une largeur de 2.50m, tandis la voûte est d'une épaisseur de 0,80m. L'espace entre les deux culées du pont est d'une longueur de 6m et d'une hauteur de 9m. C'est un des plus hauts ponts de la région de Mat, après celui de Kulmate et des Halilaj. Sa con-

DO NOT COPY

DO NOT COPY

struction remonte au début du XIXe siècle. Du point de vue de la typologie et de la technique de construction, ce pont ressemble à ceux de Guri i Bardhë de Mat.

Le pont de Shahin se trouve sur le torrent Sheu i Madh, qui prend sa source à la montagne de Balgjajt. C'est un pont composé d'un arc à double voûte, construit avec des pierres ponce équarries liées avec du mortier de chaux. (tab. VIII.1-2). A cause du terrain où il s'élève, ce pont est plus petit par rapport aux autres. Il est d'une longueur de 6m, d'une largeur de 2m. L'espace entre les deux culées du pont est d'une longueur de 4,50 m et d'une hauteur de 7,60 m. Les deux voûtes sont d'une épaisseur de 0,80 m.

Vue la technique de construction et sa typologie, ce pont a dû être construit entre le XVIIIe et le XIXe siècle. C'est un pont, qui est conservé en bon état et qui continue de fonctionner même à l'heure actuelle.

Les ponts ruinés. A part les ponts mentionnés ci-dessus qui se conservent en bon état, il ya eu d'autres ruinés dont on ne conserve que les traces.

D'après les ruines, l'un de ces ponts se trouvait au nord du pont de Vashe, sur le fleuve de Mat. Les traces apparaissent sur la côte droite du fleuve. Quand ce pont a été ruiné, on a construit celui de Vashe. On ne connait pas l'époque de construction ni le constructeur, mais on sait qu'il est antérieur à celui de Vashe.

L'autre pont, sur le fleuve de Mat, se trouvait près des platanes séculaires de Klos, à l'endroit appelé «Pazari i Urës» (Le bazzar du Pont).

Le pont s'étendait sur la côte droite du fleuve actuel de Mat, allant vers l'Ouest, mais aujoud'hui ce fleuve est déplacé vers l'Ouest, remplissant l'espace de petits cailloux. On a pu trouver les traces de trois des pieds du pont. A l'Est, les traces des fondations du pied avaient les dimensions de 4 x 4 m (tab. XI, 2), à 22m de cet endroit, on trouve des traces de murs d'un autre fragment dont les dimensions sont de 2 x 2m. 10 m plus loin, on trouve un autre fragment appartenant peut être au pied ouest, avec les dimensions de 2 x 2m. D'après les données orales ce pont a été ruiné par les grandes inondations du début du XXe siècle.

Un autre pont ruiné se situait à quelques mètres, au nord, du pont actuel de la route automobile qui va de Klos à Bulqizë. Les traces se conservent sur le côteau rocheux à droite. Au village Bërshi sur le torrent de Sheu i Balës, affluent droit du fleuve de Mat, on trouve les traces d'un autre pont. Ses traces apparaissent, à quelques mètres au-dessus de la route, qui va de Burrel à Klos, sur la droite du torrent, tandis que sur sa gauche se conservent des traces de pavé.

Au-dessous du pont de Saint-Vendredi à Gurrë e Vogël, sur la même branche du fleuve de Mat, Luse, il y a eu un autre pont appelé le pont de Lezje. C'était un pont qui servait aux gens du village pour exploiter la forêt et le pâturage qui se trouvaient de l'autre côté du torrent. On dit que c'était la famille de Lasja qui a construit ce pont qui date de la même époque que celui de Saint-Vendredi. Ses ruines ne se conservent plus.

D'après les données orales, le dernier pont dont il ne reste aucune trace, se trouvait dans le village Frankth. Celui-ci aussi servait à la route qui reliait les deux marchés de Klos et de Komis. Ces ponts ont été ruinés et quand la route des caravanes et celle du marché de Klos, ont perdu leur importance, on ne les a plus reconstruits et entretenus, donc aujourd'hui on ne garde qu'un souvenir ou quelques traces.

Les autres ponts qui reliaient les villages entre eux, grâce aux précautions des villageois ont resisté et se conservent jusqu'à nos jours.

*
* *

De ce que nous venons de soumettre plus haut on peut tirer quelques conclusions, en ce qui concerne la construction des ponts en pierre de la région de Mat, la typologie et la date de leur construction. Les ponts de cette région sont construits par les gens du pays. Leur construction était conditionnée par l'épanouissement du marché et des routes qui étaient frequentées par les caravanes. La relation régionale Durrës, Tiranë, Mat, Dibër, créait une puissante artère par laquelle circulaient les marchandises et les caravanes.

La construction de ces ponts remonte au XVIIIe et au début du XIXe siècle, avec l'épanouissement des deux grands pachaliks albanais, celui des Bushatllinj à Shkodra et celui de Joannina. Du point de vue typologique et technique, les ponts de la région de Mat ont des traits communs avec les ponts de notre pays, tels ceux de Kruja, Librazhd, Shkodër, Tiranë etc.

Parmi les ponts mentionnés ci-dessus le plus long a été celui de Pazari i Urës.

DO NOT COPY

Nr. 2 1983

monumentet

DO NOT COPY

Emin RIZA

PËRVOJA E DERISOTME MBI QENDRIMIN KARSHI FAZAVE TË NDERTIMIT NË BANESËN POPULLORE.

Në vendin tonë ruhet një pasuri e madhe në lëmin e banesës popullore, e cila përfshin monumente të veçantë të kategorisë së parë në fshat e qytet, lagje në qytet-muze dhe qendra historike në disa qytete të vendit. Në ansamblet e përmendur, krahas monumenteve të kategorisë së parë, të gjitha ndërtimet e tjera, thuajse të gjitha banesa, janë cilësuar monumente të kategorisë së dytë. Ky cilësim në dy kategori është diktuar nga vlerat e këtyre monumenteve dhe si pasojë ndikon në kriteret e ndërhyrjeve restauruese. Kështu ndërsa në banesat e cilësuara monumente të kategorisë së parë, vlerësohen të gjithë elementët kompozicionalë, arkitektonikë e konstruktivë, në ato të kategorisë së dytë, vlerësohet vetëm pamja e jashtme e banesës si pjesë e ansamblit të vënë në mbrojtje.

Punimet konservuese dhe restauruese në gjininë e banesës popullore kanë ecur krahas gjurmimit, dokumentimit dhe vënies në mbrojtje të shembujve më përfaqsues. Punimet me karakter konservimi kanë filluar rreth viteve 60, kur ende numri i ndërtimeve të vëna në mbrojtje ishte relativisht i vogël. Me krijimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, në vitin 1965, ritmet dhe shkalla e ndërhyrjeve restauruese në banesën popullore pësuan një zgjerim e thellim të ndjeshëm. Kështu brenda një periudhe rreth 20 vjeçare, nga Sektori i Ndërtimeve Popullore të Institutit të Monumenteve të Kulturës janë kryer punime konservuese dhe restauruese të plota, apo të pjesshëm në një numër të madh monumentesh të kategorisë së parë dhe të dytë. Këto ndërhyrje kanë prurë një përvojë të mirë lidhur me qendrimet karshi monumenteve të kësaj gjinie të konsideruar, ashtu si gjithë të tjerat, në vlerën e tyre të dyfishtë si dëshmi historike dhe vepra arti. Në këtë artikull mbi bazën e kësaj përvoje do të bëhet një përpjekje për të parë parimet udhëheqëse lidhur me qëndrimin karshi fazave të ndërtimit në banesat, të cilat i janë nënshtruar punimeve restauruese. Padyshim kjo çështje përbën një prej problemeve themelore në çdo ndërhyrje,[1] që presupozon në radhë të parë një njohje të thellë të monumentit në zhvillimin e tij kohor, njohje kjo që duke e konsideruar e arritur, nuk do të trajtohet në këtë artikull.

Ashtu siç është bërë tashmë e qartë, banesa për vetë funksionin e saj, është ngushtësisht e lidhur me kushtet ekonomiko-shoqërore, pra me shkallën e zhvillimit dhe natyrën e shoqërisë, në një nivel të caktuar të saj. Si e tillë, ajo është kategori tepër evolutive në kohë, duke materializuar kështu programet e larme me kërkesa nga më të ndryshmet të shoqërisë klasore të së kaluarës. Kuptohet se banesa, si një ndërtim i kushtueshëm, nuk i shërben vetëm familjes që e ndërtoi, ajo i shërben shumë brezave, pra ka një jetë relativisht të gjatë. Në këto rrethana banesa pajtetër pëson ndryshime të shkallëve të ndryshme në mbarë përbërësit e saj themelorë, apo të dorës së dytë. Këto ndryshime përbëjnë dy kategori të dallueshme. Në të parën bëjnë pjesë ato që lidhen me shtesat, ndërsa në të dytën përfshihen riprekjet e ndryshme me karakter arkitektonik, konstruktiv, apo edhe funksional, të cilat synojnë t'i japin një formë të re trajtimit fillestar. Në mjaft raste shtesat e mëvonshme bëhen shkas edhe për ritrajtimin e mjediseve, apo elementeve të ndryshëm të banesës.

1) E. Riza, **Mbi kriteret për restaurimin e banesave popullore,** Monumentet, Nr. 11,
E. Riza, **Restaurimi i banesave popullore,** Tiranë, 1981.

Në përgjithësi rastet më të shumta të ndryshimeve në banesë lidhen me shtesat e mëvonshme. Këto shtesa diktohen përgjithësisht nga nevojat e reja të familjeve të rritura, ose edhe nga ndarjet eventuale të një familje. Këto rrethana paraqesin karshi banesës kërkesa të reja funksionale, të cilat bëjnë të nevojshme shtesa dhe ndryshime në formulimin kompozicional. Shtesat arrihen në dy mënyra, duke i vendosur ato përbri volumit fillestar të ndërtimit, ose duke i përfshirë brenda tij. Kuptohet se në rastin e dytë kemi të bëjmë vetëm me kthimin e ambienteve të hapura, të hajatit dhe çardakut, në sipërfaqe të mbyllura pjesërisht, apo plotësisht. Shembujt e rastit të parë janë një dukuri e përhapur në banesën shqiptare si në fshat ashtu edhe në qytet. Kur kemi të bëjmë me tipa relativisht të thjeshtë banesash, shpesh ndeshim në ndërtimin përngjitur banesës fillestare, të një banese, apo rrallë edhe më shumë se një të tillë, që përsërisin kompozimin e banesës fillestare. Krahas këtyre rasteve, në variantet e zhvilluara, përgjithësisht ndeshemi me shtesën e një, apo disa mjediseve të rinj. Në banesat e tipit të hapur me hajat e çardak, si dhe në volumet e hapura të tipeve të tjerë të banesës shqiptare, ndeshemi shumë shpesh në mbylljen e këtyre mjediseve, duke krijuar brenda volumeve të sipërmendur ambiente ndërlidhës, apo banimi. Kjo dukuri është tepër e përhapur veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe më pas, kur tipat tradicionalë të banesës shqiptare, po pësonin ndryshime me rëndësi, për t'iu përshtatur kërkesave të reja jetësore. Në sferën e shtesave duhen përfshirë edhe ato ndryshime në banesë, të cilat shkaktohen nga ndarja e familjes. Në këto raste përgjithësisht ndeshemi me hapjen e portave dhe shkallëve të reja, me ndërtime muresh ndarës për të kufizuar hapësirat që i përkasin secilës familje etj.

Dukuria e ritrajtimit të banesës shqiptare lidhet kryesisht me ato të ndërtuara gjatë mbisundimit të formacionit feudal të shoqërisë. Ritrajtimet kanë një gjërësi të madhe shtrirjeje[2] në përputhje me tipin e banesës dhe nivelin e zhvilimit ekonomiko-shoqëror të çdo qendre qytetare. Ritrajtimi i banesave, që lidhen me formacionin feudal të shoqërisë, ka prekur së pari ambientet më të papërpunuar të banesës si shtëpia e zjarrit, apo ka pasur si synim të kthejë ambientet e pabanuara të katit përdhe në ambiente të banuara. Krahas kësaj veprimtarie, e cila nuk prek skemën kompozicionale, një përhapje të gjërë ka dukuria e ritrajtimit tërësor, apo pjesor të katit të banuar, duke arritur kështu banesa në një kompozim, që shpesh bie ndryshime kompozicionale me rëndësi. Shembujt më të shumtë të këtyre ndërhyrjeve i gjejmë në tre lagjet-muze të Beratit. Kuptohet se tjetërsimi i skemës kompozicionale të banesës lidhet me futjen e elementëve të rinj, të kohës, si në trajtimin arkitektonik, ashtu edhe në atë konstruktiv. Së fundi takohen edhe raste kur objekt ritrajtimesh bëhen vetëm elementët e ndryshëm arkitektonikë, apo konstruktivë të banesës për shkak të degradimit, apo edhe të synimit për t'iu dhënë atyre një formulim të ri. Por, rasti i fundit është zakonisht i ndërthurur me të dy rastet e parë të ritrajtimeve në banesë. Përmbledhtas shtesat dhe ritrajtimet në banesën shqiptare janë një dukuri relativisht mjaft e përhapur, veçanërisht në trashëgiminë e ndërtimeve qytetare që lidhet me formacionin feudal të shoqërisë shqiptare të kohës. Banesa korçare e lidhur me formacionin kapitalist të shoqërisë, dhe e përhapur gjërësisht në qendrat qytetare, veçanërisht që prej fillimit të shek. XX, duke qenë relativisht e re në konceptim dhe e qëndrueshme në strukturën konstruktive, kuptohet se i është nënshtruar ndryshimeve të pakta. Këto ndryshime janë diktuar kryesisht nga nevoja për meremetime, apo zëvendësime të elementëve arkitektonikë, apo konstruktivë të dëmtuar. Nga sa parashtruam më sipër, kuptohet se thuajse në çdo rast, restauratorit që ngarkohet me restaurimin e një banese i del përpara problemi i qendrimit që duhet mbajtur karshi ndryshimeve që ka pësuar monumenti në kohë.

Përpara se të kalojmë në një shqyrtim analitik të përvojës së derisotme, nëpërmjet shembujve më të spikatur po parashtrojmë konceptet teorike të cilat kanë qenë në bazën e qëndrimeve, karshi këtij problemi. Kuptohet se kur jemi përpara një monumenti që ka pësuar ndryshime në kohë qëndrimet e mundshme janë: ruajtja e gjendjes ekzistuese, kthimi në gjendjen fillestare, apo kthimi në një fazë të ndërmjetme. Është e qartë se për dy qëndrimet e fundit, presupozohet studimi i thellë i monumentit, i cili nëpërmjet të dhënave të sigurta që ruhen në të, apo të plotësuara këto edhe me burime dokumentare, i ka bërë të qarta ndryshimet në kohë. Nga të tre këto qëndrime, ruajtja e monumentit në gjendjen që vjen në momentin e vënies në mbrojtje, është parimi që ka gjetur zbatimin më të gjërë në ndërhyrjet e derisotme. Duke u vlerësuar çdo shtesë, apo ndryshim i monumentit si kontribut i një periudhe dhe i

2) E. Riza, **Banesa qytetare shqiptare prej gjysmës së dytë të shek. XIX deri rreth fillimit të shek. XX,** Monumentet, 20, 1980.

DO NOT COPY

rrethanave të caktuara[3], ato përbëjnë dëshmi historiko-artistike që duhen ruajtur. Parimi i dytë, ai i kthimit të banesës që i nënshtrohet ndërhyrjeve restauruese, në gjendjen fillestare, apo në një fazë të ndërmjetme, ka gjetur një zbatim relativisht të kufizuar në praktikën e derisotme. Ai përgjithësisht është zbatuar në rastet kur faza fillestare ka paraqitur një vlerë të rëndësishme historiko-arkitektonike, apo kur shtesat kanë qenë bërë pa asnjë përkujdesje lidhur me respektimin e veprës, dhe në vetvete paraqesin vlera të parëndësishme. Pra ruajtja e gjendjes së monumentit, ashtu siç e ka prurë koha si dëshmitar i historisë, përbën rregullin, ndërsa kthimi në gjendjen fillestare, apo në fazë të ndërmjetme përbën përjashtimin[4].

Siç u përmend, vendimi mbi qendrimin karshi ndryshimeve në kohë të monumentit, duhet të ketë përpara studimin mbi veprën e dhënë. Kuptohet se në disa raste ky studim, megjithëse mund të arrijë bindshëm në përfundimin mbi identifikimin e shtesës, ai nuk është në gjendje të ndriçojë gjendjen fillestare të pjesës ku shtesa i është bashkangjitur strukturës origjinale. Shkaku duhet kërkuar në atë që shtesa ka qenë e lidhur me punime prishjeje të një pjese të strukturës origjinale, për të lidhur më mirë funksionalisht, apo konstruktivisht vepra. Në këto raste në praktikën tonë është përjashtuar kthimi në gjendjen fillestare nëpërmjet heqjes së volumit të shtuar. Si rast tipik mund të përmendim punimet e restaurimit në banesën e kthyer në muze etnografik të qytetit të Beratit, (Fig. 1), e cila është e tipit me çardak. Në një fazë të mëvonshme ndoshta të tretë, rreth gjysmës së dytë të shek. XIX, asaj i është bërë një shtesë në krahun lindor, e cila ruan trajtimin arkitektonik të kohës, krejt të ndryshëm nga ajo e fazës së parë, e cila tipologjikisht duket se i përket shek. XVIII. Vlera e veçantë e pjesës origjinale, do ta përligjte heqjen e kësaj shtese që është në mospërputhje të hapur me pjesën origjinale, një prej shembujve tepër të pakët të këtij varianti të banesës me çardak. Por zhdukja e çdo gjurme lidhur me gjendjen fillestare bënë që monumenti të ruhej ashtu siç vinte, madje të rindërtohej sipas dokumentacionit të plotë ekzistues, një ambient i rrënuar i shtesës, i cili cënonte vlerat estetike të veprës dhe vinte në rrezik qëndrueshmërinë statike të saj.

Krahas shtesave, në raste të tjera, relativisht të rralla, banesa i nënshtrohet ritrajtimeve të thella kompozicionale, brenda volumit ekzistues, apo duke



Fig. 1

u bërë shtesa të rëndësishme. Edhe në këto raste studimi nuk të çon më larg konstatimit të përgjithshëm të ndryshimeve, apo dhe disa saktësimeve të pjesshme, të cilat natyrisht përjashtojnë çdo mendim mbi kthimin në gjendjen origjinale të monumentit me anën e heqjes së shtesave.

Tashti vimë në rastet kur shtesat janë që përbëjnë volume të rinj, ose lidhen me krijimin e ambienteve brenda hajateve, apo çardaqeve, janë në një farë mënyre bashkangjitje në trupin e monumentit. Siç u përmend këtu janë mbajtur dy qendrime nga të cilët ruajtja e këtyre shtesave përbën zgjidhjet më të përhapura. Le të ndalemi më konkretisht mbi disa shembuj të përvojës së derisotme në këtë drejtim. Banesa në rrugën «U. Reso» Nr. 17, në lagjen «Dunavat» të Gjirokastrës, rezultoi se kishte pësuar një shtesë në vitin 1838. Banesa në fazën fillestare ishte e variantit të thjeshtë me një krah. Shtesa përfshinte tre ambiente në katin përdhe, ndërsa një në katin e banuar. Rindërtimi i banesës është bërë me mjaft shije, duke shkrirë në një të vetme të dy pjesët në mënyrë tepër origjinale. Oda e banimit në katin e

3) **Karta ndërkombëtare e konservimit dhe restaurimit të monumenteve dhe ansambleve monumentale,** Venecie, 1964.
4) C. Brandi, **Teoria del restauro,** Torino 1977, f. 35.

FOR NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

parë, shquan për vlera të veçanta për të arritur në datime të përafërta të banesave të tjera, në shumicën e tyre të padatuara. Është e qartë se këto shtesa ruanin vlera të rëndësishme jo vetëm si dëshmi historike e një rrugëzgjidhjeje për mbushjen e nevojave në rritje për banim të familjeve të kohës, por edhe vlera estetike si në trajtimin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm. Këto arsye bënë që gjatë punimeve të restaurimit (fig. 2) të respektohej shtesa e mëvonshme. Një shembull tjetër të ruajtjes së fazës së dytë të ndërtimit paraqet një kompleks banimi[5] në fshatin Klos Katund të rrethit të Matit. Në këtë shembull ndërtimit origjinal dykullësh i është shtuar më vonë një kullë e tretë, e cila siç e kemi përmendur është praktikuar si zgjidhje e frutshme kur banesa fillestare formohej nga tipa, apo variante të thjeshtë. Kuptohet se vlera e këtij kompleksi (fig. 3) si dëshmi historike e një rruge të veçantë për shtimin e sipërfaqes së banuar e bënte të domosdoshme ruajtjen e fazës së dytë.

Në një banesë fshatare[6] në fshatin Surrel të rrethit të Tiranës, banesa e fazës së parë përfshinte vetëm shtëpinë e zjarrit dhe hajatin përpara saj, ndërsa në një fazë të mëvonshme asaj i shtohet një bllok, dykatësh prej dy ambientesh me «burgun» e pa banuar poshtë, dhe odën e miqve sipër. Më vonë në sipërfaqen e hajatit janë ndërtuar dy ante dhe një ambient i vogël. Në këtë rast shtesa dykatëshe e lidhur organikisht me shtëpinë e zjarrit, paraqiste një zhvillim me interes të kësaj banesa, e cila megjithse e arritur më vonë ishte në frymën e tipologjisë së banesës së kësaj zone, prandaj ajo u ruajt. Në të kundërtën ambienti i sajuar në hajat dhe antet (me përjashtim të një fragmenti, i cili u ruaj për arsye të veçanta) u hoqën sepse dëmtonin rëndë funksionimin e këtij ambienti të rëndësishëm.

Shtesat e volumeve të rinj përbëjnë raste pak shumë të rralla, ndërsa ndërtimi i volumeve të mbyllura, brenda atyre të hapura të çardakut e hajatit është një dukuri tepër e përhapur. Siç është trajtua këtu jemi përpara një prirjeje e cila synon që tipologjia tradicionale e banesës shqiptare, të lidhe kryesisht me formacionin feudal të shoqërisë, t'i për shtatet kushteve të reja të jetës, si nën shtytjen faktorëve të gjërë shoqërorë, ashtu edhe të ne vojave të familjeve të veçanta në rritje. Shpesh, sa jimi i volumeve të rinj brenda volumeve të hapura shoqërohet me ritrajtimin e një apo disa ambien teve të banesës, pa përjashtuar këtu pamjen e jasht me. Kjo dukuri e cila për arsye të njohura shfaqe kryesisht në tipologjinë e banesës qytetare shqiptare përbën një dëshmi me vlera historiko-arkitektonik dhe si e tillë ajo duhet vlerësuar. Pikërisht pë këto arsye, në përgjithësi, banesat që kanë pësuc ndryshime të tilla janë ruajtur në gjendjen e re.

Banesa[7] në rrugën «N. Buhuri» nr. 120 në qyte

5) L. Suli, **Një banesë karakteristike trekullëshe në Klos Katund të rrethit të Matit,** në «Tradita ndërtimore në Shqipëri». 1981.,
6) L. Suli, **Restaurimi i tre banesave fshatare,** Monumentet nr. 11, 1977.
7) G. Samimi, **Studimi dhe restaurimi i një banese karakteristike në Berat,** Monumentet, nr. 5-6, 1973.

tin-muze të Beratit, sipas studimit që iu bë rezultoi me disa faza ndërtimi, të cila shkallërisht kishin bërë që monumenti nga një banesë e tipit me çardak të arrinte në një ndërtim të mbyllur karakteristik për gjysmën e dytë të shek. XIX. Ruajtja e këtyre shtesave ishte një qëndrim i drejtë sepse monumenti me ndryshimet që kishte pësuar në kohë paraqiste një dëshmi me vlerë për historinë e zhvillimit të banesës shqiptare. Një rast thuajse të njëjtë paraqiste banesa (Fig. 4) në rrugën «Tafil Skëndo» nr. 39, në qytetin e Beratit, e cila gjithashtu u ruajt me ndryshimet e mëdha pas një rindërtimi të thellë që kishte prekur si kompozimin ashtu edhe trajtimin e saj arkitektonik. Edhe në qytetin e Shkodrës ku banesa e hapur me çardak ka qenë tipi mbizotërues, shembujt e mbylljes së volumeve të hapura janë tepër të shpeshtë. Për të njëjtat arsye si në Berat, praktika e zakonshme në veprimtarinë restauruese, lidhur me këto monumente, ka qenë ajo e ruajtjes së shtesave. Një shembull tipik paraqiste banesa[8] në rrugën «Xhamia e Plumbit» nr. 27, në Shkodër. Ky monument gjithashtu kishte pësuar një shtesë volumi në sipërfaqen e çardakut që më parë shtrihej në krejt ballin e banesës. Kjo shtesë u ruajt, sepse ajo paraqiste një dëshmi me vlerë të kësaj dukurie me rëndësi. Për t'u përmendur është edhe rasti i banesës (Fig. 5) në rrugën «Myfit Reso» nr. 12 në qytetin e Gjirokastarës. Ajo i përket një prej shembujve më të përkryer të banesës së fortifikuar gjirokastrite të variantit me një krah. Siç tregojnë mbishkrimet[9] ajo është ndërtuar në vitin 1831, ndërsa në vitet 1865 dhe 1873 ka pësuar dy rindërtime, gjatë të cilave është mbyllur çardaku, duke sajuar në të një ambient dhe është përfunduar trajtimi i brendshëm i odës së miqve. Megjithëse ky shembull paraqet një arritje madhore në tipologjinë e banesës gjirokastrite, kthimi në gjendjen origjinale do të binte humbjen e një dëshmie të rëndësishme të zhvillimit në kohë të monumentit, e cila për më tepër ishte vendosur saktësisht në kohë. Së fundi në këtë parashtrim shembujsh me të njëjtën problematikë do të përmendim banesën[10] e kthyer në muze etnografik në qytetin e Krujës. Është fjala për një dëshmi të rrallë të një banese me çardak të mbyllur, në volumin e të cilit më vonë është sajuar një ambient. Ndërtimi i tij ka respektuar aq sa ka qenë e mundur, veprën dhe për më tepër në brendësinë e këtij ambienti ruhen disa piktura



Fig. 4



Fig. 5

Do not COPY

8) Sh. Prifti, **Restaurimi i një banese me çardak në Shkodrën e vjetër,** Monumentet, nr. 17, 1979.
9) E. Riza, **Qyteti-muze i Gjirokastrës,** Tiranë, 1981, f. 278-281.
10) E. Riza, **Studim për restaurimin e një banese me çardak në qytetin e Krujës,** Monumentet, nr. 9, 1975.



Fig. 6



Fig. 7

murale që paraqesin një krijimtari spontane, vërtet diletanteske, por jo pa vlera. Gjithashtu ambienti i ri duke u zhvilluar në kufijtë e sipërfaqes së një qoshku të gjërë, nuk dëmtonte shumë njësinë kompozicionale të kësaj vepre të rëndësishme. Për këto arsye kjo shtesë u ruajt.

Megjithëse ruajtja e fazave të ndryshme të ndërtimit përbën parimin më të zbatueshëm, në praktikën e derisotme ka gjetur vend edhe parimi i kthimit të monumentit në gjendjen origjinale plotësisht, apo pjesërisht. Ky parim i fundit është quajtur racional së pari kur zbatimi i tij ka nxjerrë, në dritë një shembull me vlera të veçanta, apo me përhapje të kufizuar në tërësinë e monumenteve që trashëgojmë. Këto raste lidhen përgjithësisht me hapjen e volumeve të mbyllura në çardaqet dhe hajatet. Së dyti kthimi në gjendjen e mëparshme është praktikuar kur shtesat dëmtonin vlerat tipologjike, estetike, apo të dyja së bashku, dhe në vetvete kishin vlera të pakta. Në këto raste ndërhyrjet e çlirimit kanë pasur të bëjnë me heqje volumesh të rinj, apo elementesh të ndryshëm arkitektonikë.

Banesa[11] në rrugën «Mihal Grameno» nr. 17, në qytetin e Korçës paraqet një shembull tipik të përkujdesjes për të arritur në një variant të banesës së hapur me vlera të veçanta për tipologjinë e banesës popullore në qytetin e Korçës. Studimi i monumentit dhe sidomos të dhënat e përftuara pas punimeve të hapjes në pjesën qendrore të kompozimit, nxuarën qartë se në katin e banuar kjo pjesë kishte qenë fillimisht e hapur, në formën e një qoshku të zhvilluar. Duke qenë se ky shembull paraqiste një zgjidhje me interes të veçantë, u vendos që kjo pjesë e banesës me punime çlirimi dhe pjesërisht plotësimi, mbi bazën e të dhënave të sigurta që afronte vetë monumenti, të kthehej në gjendjen origjinale, duke i rikthyer fondit të banesës popullore një zgjidhje me vlerë të veçantë. Ky veprim nuk u krye për disa ndryshime të tjera, të cilat nuk kishin prurë dëmtime me shumë rëndësi në tiparet kompozicionale të monumentit. Krahas këtij shembulli në qytetin e Korçës vitet e fundit janë restauruar edhe një sërë banesash të tjera[12], në disa prej të cilave kthimi i ambienteve fillimisht të hapura, në gjendjen e tyre origjinale, është kushtëzuar edhe nga numri relativisht i pakët i shembujve të banesave të hapura që ende ruhen në qytetin e Korçës, dhe që si të tilla marrin një vlerë të posaçme. Ky kriter natyrisht nuk ka cënuar aspak respektimin e të gjitha kushteve të domosdoshme për të mos rënë në shkeljen e parimeve të njohura për ndërhyrje të këtij lloji.

Krahas këtyre rasteve, nuk kanë munguar edhe ndërhyrjet që kanë pasur si synim çlirimin nga volumet e shtuara më vonë. Banesa (fig. 6) në rrugën «Zihni Toska» nr. 1, në qytetin e Beratit, e tipit me çardak kishte pësuar më vonë një shtesë volumi në pjesën perëndimore të saj, e cila ishte një improvizim pa vlerë që cënonte rëndë vlerat tipologjike dhe estetike të monumentit. Duke qenë shtesa në fjalë e këtij karakteri, u gjet me vend heqja e saj, duke e kthyer

11) P. Thomo, **Banesat e hapura në qytetin e Korçës dhe disa probleme të restaurimit të tyre,** Monumentet, 1, 1982.
12) P. Thomo, **Art. cit.**

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9



Fig. 10

monumentin në një gjendje ku dalin më qartë vlerat e tij autentike.

Në banesën me çardak të rrugën «Nikollaq Buhuri» nr. 36, në qytetin e Beratit, një prej shembujve më të arritur të variantit me çardak në qendër, në pjesën perëndimore të ndërtimit është shtuar një ambient i vogël, i cili kishte cënuar rëndë kompozimin origjinal. Duke qenë se ky monument ruan relativisht mirë gjendjen origjinale dhe shtesa në fjalë ishte një sajim pa asnjë përkujdesje lidhur me respektimin e kompozimit fillestar, ajo u hoq, duke i rikthyer monumentit vlerat e humbura nga kjo ndërhyrje.

Në praktikën e derisotme nuk janë të pakta edhe ndërhyrjet çliruese duke hequr elemente të shtuar arkitektonikë. Banesa (Fig. 7) në rrugën «Zenel Baboçi» nr. 12, në qytetin e Gjirokastrës, ndërtuar më 1825, është një shembull shumë i arritur i variantit me një krah, i cili është i pajisur me një nga kamerietë më të zhvilluara të llojit të mbyllur. Siç dihet gjithmonë këto kamerie janë të mbuluara. Edhe kamerieja në fjalë ka qenë e tillë, siç dukej qartë nga të dhënat që afronte monumenti. Duke qenë se mbulimi i kësaj kamerjeje cënonte rëndë vlerat tipologjike dhe arkitektonike të këtij monumenti të rëndësishëm, kjo shtesë u hoq. Në banesën (Fig. 8) e rrugës «Alqi Kondi» nr. 7, në Tiranë, e cila i përket banesës së mbyllur qytetare të gjysmës së dytë të shek. XIX, më vonë ishin shtuar një palë shkallë të jashtme, të trajtuara sipas formës së njohur dyfishe, mbi qemere cilindrikë, siç i gjejmë në banesat e hapura me çardak. Kjo shtesë me qëllime thjesht utilitare, megjithëse e përfshirë me shije në volumin e monumentit krijonte një kundërthënie të hapur me tiparet thelbësore të kësaj banese të mbyllur, gjithashtu qorronte dritaret e katit përdhe të pjesës qendrore të ndërtimit



Fig. 11

DO NOT COPY

që i bashkangjitej. Për këto arsye monumentit iu kthye gjendja fillestare me një veprim të thjeshtë çlirimi.

Në disa raste monumenti ka pësuar ndryshime të rëndësishme nëpërmjet disa fazave, ndër të cilat ajo e fundit është e tillë që ka dëmtuar vlerat tipologjike dhe në vetvete nuk ruan vlera të një rëndësie të tillë sa të justifikojë ruajtjen. Praktikisht në këtë rast kemi të bëjmë me kthimin e monumentit në një gjendje të ndërmjetme. Shembullin më tipik të këtij rasti e paraqet banesa-teqe në rrugën «Barrikada» nr. 115/1 në Tiranë, e cila u restaurua duke u çliruar nga faza e fundit e ndërtimit.

Përveç rasteve të paraqitura si shembuj të zgjidhjeve të drejta restauruese, ka edhe shumë të tjera, në të cilët duke u zbatuar e njëjta përkujdesje është arritur në përfundime që respektojnë drejt vlerat e dyfishta të monumentit. Megjithkëtë do të kishim ndonjë rezervë lidhur me disa raste ku për mendimin tonë mund të mbahej një qëndrim tjetër. Në radhë të parë mendojmë se në banesat me çardak të rrugës «Gaqi Karakashi» nr. 16 në Berat (Fig. 9) dhe asaj të rrugës «Astrit Toro» nr. 20 në Gjirokastër, kthimi në gjendjen e mëparshme duhej të thellohej. Respektivisht në banesën e parë, që përbën një shembull shumë të rrallë të banesës së hapur të variantit me çardak në ballë, me dy kthina banimi, heqja e ambientit të shtuar në hapësirën e çardakut dhe hapja e qoshkut të mbyllur më vonë do të rriste vlerat e këtij monumenti të rrallë. Në rastin e dytë, hapja e çardakut do të na afronte një shembull të pacënuar në tiparet tipologjike gjithashtu mjaft të rrallë, i cili qendron në grupin e varianteve të thjeshtë të banesës gjirokastrite. Edhe në banesën[13] e rrugës «Gaqi Karakashi» nr. 15 në Berat, mendojmë se hapja e qoshkut në çardak do të rriste vlerat e këtij monumenti të rëndësishëm. Në disa raste duhej marrë më shumë parasysh cënimi i njësisë stilistike të veprës, i cili pa qenë gjithmonë një synim për tu arritur, në rastin e dhënë mund të sigurohej me një ndërhyrje të thjeshtë. Kështu në banesën e Zekatëve[14] (Fig. 10) dhe atë të kthyer në muze të artit popullor (Fig. 11), të cilat paraqesin padyshim kulme të tipologjisë së banesës gjirokastrite, ballet e ambienteve të katit të fundit nga ana lindore, mund të ktheheshin në gjendjen origjinale.

Përfundimisht mund të pohojmë se deri më sot në përgjithësi është mbajtur një qëndrim i drejtë karshi fazave të ndërtimit të monumenteve të gjinisë së banesës popullore. Studimi i monumentit që do të bëhet objekt i ndërhyrjes restauruese, njohja e tipologjisë së banesës shqiptare, zotërimi i kritereve të restaurimit dhe diskutimet kolektive mbi bazë instancash të ndryshme, sipas rëndësisë së monumentit dhe shkallës së ndërhyrjes, janë garanci për një rritje të mëtejshme të kompetencës në zgjidhjen e kësaj problematike të vështirë.

13) B. Strazimiri, **Arkitektura dhe restaurimi i banesës së Bizbiqëve,** Monumentet, nr. 9, 1975.

14) E. Riza, **Arkitektura dhe restaurimi i banesës së Zekatëve në Gjirokastër,** Monumentet nr. 13, 1977.

Emin Riza

DO NOT COPY

L'EXPERIENCE ACQUISE JUSQU'A CE JOUR SUR L'ATTITUDE ENVERS LES PHASES DE CONSTRUCTION DE L'HABITATION POPULAIRE

RESUME

Dans notre pays, il est conservé une grande richesse dans le domaine de l'habitation populaire, incluant des monuments particuliers de première catégorie, dans les villes et villages, dans des quartiers de villes-musée et dans des centres historiques de certaines villes de notre pays. Dans les ensembles mentionnés, de pair avec les monuments de première catégorie, toutes les autres constructions, presque toutes des habitations, ont été qualifiées des monuments de seconde catégorie. Cette division en catégories a été dictée par les valeurs de ces monuments, et, en conséquence, influe sur les critères des interventions de restauration. Ainsi, si dans les habitations qualifiées de monuments de première catégorie, on apprécie tous les éléments compositionnels, architechtoniques et constructionnels, dans celles de seconde catégorie, on n'apprécie que la vue extérieur de l'habitation, en tant que partie constituante de l'ensemble mis sous protection.

Ces travaux de conservation et de restauration dans le domaine de l'habitation populaire se sont effectués de pair avec la recherche, la documentation et la mise sous protection des exemples les plus représentatifs. Les travaux de conservation ont commencé autour des années 60, lorsque le nombre de constructions mises sous protection était relativement petit. Après la création de l'Institut des Monuments de Culture, en 1965, les rythmes et le degré des interventions de restauration dans l'habitation populaire connut une extension et un approfondissement sensibles. Dans une période d'environ 20 ans, le secteur des Constructions Populaires de l'Institut des Monuments de Culture a effectué des travaux de conservation et de restauration complets ou partiels dans un grand nombre de monuments de première et seconde catégories. Ces interventions ont apporté une bonne expérience en ce qui concerne les attitudes envers les monuments de ce genre, considérés, tout comme tous les autres dans leur valeur double, en tant que témoignages historiques et oeuvres d'art.

L'habitation, par sa fonction même, est étroitement liée aux conditions économiques et sociales, donc au degré de développement et à la nature de la société à un niveau déterminé. En tant que telle, elle est une catégorie très évolutive dans le temps, en matérialisant ainsi les programmes variés d'exigences des plus diverses de la société de classes du passé. L'habitation, en tant que construction fondamentale, ne sert pas beaucoup aux générations, elle a donc une vie relativement longue. Dans ces circonstances, l'habitation subit sans doute des modifications de niveaux différents, dans toutes ses composantes fondamentales, ou de second ordre. Ces modifications constituent deux catégories bien distinctes. Dans la première, font partie celles relatives aux rajouts, tandis que dans la seconde s'incluent les efforts variés de caractère architectonique, constructionnel ou bien fonctionnel, visant à donner une forme nouvelle au traitement initial. Dans bien des cas, les rajouts ultérieurs, sont la cause de nouveaux traitements des volumes, ou bien des différents éléments de l'habitation.

En général, les nombreux cas de modifications de l'habitation sont liés aux rajouts ultérieurs. Ceux-ci sont dictés par les nouveaux besoins des familles. Ces circonstances imposent à l'habitation de nouvelles exigences fonctionelles, qui rendent nécessaires les rajouts et les modifications de la formulation compositionnelle. Les rajouts sont réalisés de deux façons, en les élevant à côté du volume initial de la construction, ou bien en les influant à l'intérieur de lui.

Les exemples du premier cas sont un phénomène assez répandu dans l'habitation albanaise aussi bien à la campagne qu'en ville. Lorsqu'il s'agit de types d'habitation relativement simples, on rencontre souvent une ou plusieurs constructions adjointes à l'habitation principale. A part ces cas, dans les variantes évoluées, on trouve le rajout d'une ou plusieurs pièces nouvelles. Dans les habitations de type ouvert à porche et tchardak, ainsi que dans les volumes ouverts des autres types de l'habitation albanaise, on relève souvent la fermeture de ces volumes d'habitation, ou de communication. Ce phénomène est très répandu, particulièrement, au cours de la seconde moitié du XIXe siècle, et par la suite, lorsque les types traditionnels de l'habitation albanaise subissaient des changements importants, en vue de l'adaptation aux nouvelles exigences vitales. C'est dans la sphère des rajouts que l'on doit inclure les changements de l'habitation, causés par la division de la famille. Dans ces cas-ci, on relève généralement l'ouverture de

portes et la construction de nouveaux escaliers, en élevant des murs de séparation en vue de limiter les espaces revenant à chacune des familles, etc.

En voici les conceptions théoriques, lesquelles ont été à la base des attitudes à l'égard de ce problème. Cela va de soi que lorsqu'on se trouve en face d'un monument ayant subi des modifications dans le temps, les attitudes possibles sont: la conservation de la forme existente, le retour à l'état initial ou bien le retour à une phase intermédiaire. Il est clair que quant aux deux dernières attitudes, il est présupposé l'étude approfondie du monument, qui, au moyen des données sûres qu'il recèle en lui, ou bien fournies en plus par des sources documentaires, présente nettement les modifications subies dans le temps. De ces trois attitudes, la conservation du monument tel qu'il arrives jusqu'à nous au moment de la mise sous protection, est le principe de base le plus largement appliqué dans les interventions entreprises jusqu'à nos jours. En considérant toute adjonction ou modification du monument comme la contribution d'une période et de circonstances déterminées, elles constituent des témoignages historiques et artistiques qu'on doit conserver. Le second principe, celui du retour de l'habitation, subissant l'intervention de restauration, à l'état initial, ou bien à une phase intermédiaire, n'a connu qu'une application relativement limitée dans notre pratique. Il a été appliqué généralement dans les cas où la phase initiale a présenté une valeur importante historique et architectonique, ou bien lorsque les adjonctions ont été réalisées sans aucun soin, quant au respect de l'oeuvre, et, en elles-mêmes, ne présentent pas de valeurs importantes. Donc, la conservation du monument, tel que le temps l'a amené jusqu'à nous, en tant que témoignages de l'histoire, constitue la règle, tandis que le retour à l'état initial, ou bien à une phase intermédiaire constitue l'exception.

La prise de l'attitude envers les modifications du monument dans le temps, doit disposer d'une étude sur l'oeuvre donnée. Dans certains cas cette étude, bien qu'elle puisse arriver à une conclusion sur l'identification de l'adjonction, n'est pas en état d'éclairer l'état initial de la partie où le rajout a été adjointe à la structure originale. La cause doit être cherchée dans le fait que l'adjonction a été liée à des travaux de destruction d'une partie de la structure originale, afin de mieux unifier l'oeuvre fonctionnellement et constructionnellement. Dans ce cas, dans notre pratique, le retour à l'état initial a été exclu. De pair avec les adjonctions, dans d'autres cas, relativement rares, l'habitation se soumet à des traitements nouveaux compositionnels plus profonds, à l'intérieur du volume existant, ou bien se voit adjoindre des rajouts importants. Même dans ces cas l'étude ne mène pas plus loin que la constatation générale des modifications, ou bien de quelques précisions partielles qui naturellement excluent toute idée sur le retour à l'état original du monument, au moyen de la suppression des adjonctions. Revenons maintenant au cas où les rajouts, constituant des volumes à l'intérieur des porches ou des tchardarks, sont d'une certaine manière des adjonctions sur le corps du monument. Dans ce cas, on a adopté deux attitudes, dont celle de la conservation de ces adjonctions constitue la solution la plus répandue. Les cas de rajout de nouveaux volumes sont plus ou moins rares, tandis que la construction de volumes fermés à l'intérieur des volumes ouverts du tchardak et du porche est un phénomène très répandu. On est là en face d'une tendance visant à ce que la typologie traditionnelle de l'habitation albanaise, soit liée principalement avec la formation féodale de la société, qu'elle s'adopte aux nouvelles conditions de vie, aussi bien sous l'effet des grands facteurs sociaux, que des besoins des familles particulières allant toujours croissant. Souvent, l'improvisation de nouveaux volumes à l'intérieur de volumes ouverts, est accompagné de nouveaux traitements de l'une ou plusieurs pièces de l'habitation, sans en exclure la vue extérieure. Ce phénomène, qui, pour des raisons bien connues, apparaît surtout dans la typologie de l'habitation urbaine albanaise, constitue un témoignage de valeurs historiques et architectoniques, et en tant que tel il doit être pris en considération. C'est précisément pour cette raison, qu'en général les habitations ayant subi de telles modifications ont été conservées à l'état nouveau.

Bien que la conservation des diverses phases de construction constitue le principe le plus applicable, dans la pratique on a appliqué aussi le retour du monument à l'état original, complètement ou en partie. Ce dernier principe a été qualifié de rationnel, tout d'abord lorsque son application à mis à jour un nouveau cas, aux valeurs particulières, ou bien à étendue limité dans la totalité des monuments hérités. Ces cas sont généralement liés à l'ouverture des volumes fermés dans les tchardaks ou les porches. Deuxièmement, le retour à l'état antérieur a été appliqué, lorsque les adjonctions endommageaient les valeurs typologiques, esthétiques, ou bien les deux ensemble, et lorsqu'elles-mêmes avaient peu de valeurs. Dans ces cas, les interventions de dégagement ont consisté à supprimer de nouveaux volumes, ou divers éléments architectoniques.

En conclusion, on peut admettre que jusqu'à nos jours, on a généralement pris une attitude juste à l'égard des phases de construction des monuments du genre de l'habitation populaire. L'étude du monument qui fera l'objet de l'intervention de restauration, la connaissance de la typologie de l'habitation albanaise, la maîtrise des critères, de restauration et les discutions collectives à diverses instances, selon l'importance du monument et du degré d'intervention, garantissent l'accroissement plus poussé de la compétence pour la solution de ces problèmes difficiles.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

Isuf SUKAJ

ARKITEKTURA E BANESËS ME HAJAT NË QYTETIN E KAVAJËS

Në qytetin e Kavajës deri në fund të shek. XIX është ndërtuar gjërësisht banesa e hapur me hajat në variante të ndryshme.

Deri në vitin 1944 arkitektura e saj nuk është trajtuar në ndonjë monografi ose përshkrim të veçantë. Autorë të ndryshëm si E. Çelebiu, Y. Muller, J. Han, K. Dhespoti dhe M. Kaucki[1], e kanë përmendur shumë pak tipin e kësaj banese, duke dhënë vetëm numrin e tyre dhe konstruksionin e mureve me gurë, qerpiç ose tulla pa përshkruar fare arkitekturën e saj.

Në vitin 1973 për plotësimin e studimit tipologjik të banesës në qytetet kryesore të Shqipërisë, E. Riza na jep një vlerësim përgjithësues për banesën popullore të Kavajës së bashku me ato të qyteteve të tjera të Shqipërisë së mesme, Elbasan, Tiranë e Peqin[2].

Qëllimi i këtij studimi është dhënia e një kuadri deri diku më të plotë të zhvillimit të arkitekturës së banesës popullore me hajat, të varianteve të ndryshme të saj dhe të shpërndarjes statistikore nëpër lagjet e këtij qyteti.

– Studimi bazohet në materialet e grumbulluara në vend gjatë punës për gjurmimin e disa banesave të tilla karakteristike që ruhen edhe sot në lagjet nr 2, 3, 4 dhe 5. – Megjithse këto banesa kanë pësuar ndryshime planimetrike, mund të nxirren përfundime të sakta, mbasi ndryshimet e tyre nuk janë bërë kudo njëlloj. Për plotësimin e studimit lidhur me numrin dhe përhapjen e varianteve të ndryshme të kësaj banese, ndihmuan të dhënat gojore të banorëve më të moshuar, të çdo lagjeje të qytetit.

Banesat e vjetra që ende ruhen sot nuk janë të datuara por sipas mendimit tonë ato i përkasin shekullit XVIII deri në fund të shekullit XIX.

Nga gjurmimi i përgjithshëm që i bëmë banesave të qytetit, nga të dhënat gojore dhe nga materialet fotografike që kemi, vërejmë se në këtë qytet përveç banesës përdhese të hapur me hajat, janë ndërtuar edhe banesa me dy kate me çardak e banesa të mbyllura të vogla e të mëdha me një e me dy kate me numër mjedisesh të ndryshëm. Meqenëse këto të fundit janë më të pakta në numër, në këtë artikull jemi ndalur vetëm në studimin e banesës përdhese me hajat, si banesë shumë e përhapur e tradicionale për këtë qytet.

*
* *

Kavaja si vendbanim me emrin fshati «Kavalje» përmendet përveç regjistrave osmane të sanxhakut

1. E. Çelebi, **Shqipnia para dy shekujsh,** Tiranë 1930, fq. 102.
Y. Muller, **Albanien Rumelien und die Osterreichisch. Montenegrinische Granze,** Prag, 1944, fq. 61.
J. Han, **Albanesische Studien,** Jena, vol I, 1854.
K. Dhespoti, **Përshkrim Gjeografik i Shqipërisë,** 1964, fq. 101 (1833-1834)
M. Kaucky, Mittelalbanische Stadt-und Wirtschafsbilder. në rev. «**Osterreichische Monatsschrift für den Orient**» 1916, nr. 1-16.

2. E. Riza, **Banesa popullore në disa qendra qytetare të Shqipërisë së Mesme,** Monumentet, Tiranë 1973, nr. 5-6, fq. 101.



Fig. 1

Arvanid[3] më 1431 e të sanxhakut të Elbasanit[4] më 1383 edhe në dokumentat e shekullit të XVI[të] ku cilësohet me emrin «borgo Cavaglia»[5].

Në shek. XVII[të] Kavaja u bë qëndër e re administrative[6].

Shtimi i shpejtë i popullsisë, rritja e shtresave zejtaro-tregtare krijoi kushte për një zhvillim të dukshëm ekonomiko-shoqëror. Rritja e forcave prodhuese i dha një hov ndërtimit të banesave, të ndërtimeve shoqërore e të kultit. Nga të dhënat e Çelebiut[7] më 1670, kuptohet se tashmë Kavaja ishte një qytet me zhvillim të mirë dhe një qendër e rëndësishme urbane.

Në gjysmën e dytë të shek. XVII me shtrirjen e ndërtesave të banimit gjatë rrugës së madhe, rrugës së lagjes Zguraj, rrugicave të tyre dhe me pazarin në qendër, qyteti i Kavajës kishte marrë fizionominë urbanistike. Tiparet kryesore të kësaj shtrirjeje u ruajtën edhe në shekujt XVIII dhe XIX por me ndryshime të dendësisë së ndërtimeve dhe arkitekturës së tyre.

Gjatë shek. XVIII Kavaja pati një zhvillim të më-

3. H. Inalçik, **Suret-i, defteri, Sançagi Arvanid,** Ankara 1954.
4. Defteri i Sanxrakut të Elbasanit nr. 66. Në drejtorinë e përgjithshme të tatimeve dhe Kadastrës në Ankara (arkivi i Institutit histori-gjuhësi).
5. K. Jireçek, Vlona në kohë të mesme, në rev. «Agimi» viti 1920 nr. 5 fq. 68.
6. Z. Shkodra, **Esnafët shqiptarë,** Tiranë, 1977 fq. 35.
7. E. Çelebi, **vep. cit,** fq. 103.

DO NOT COPY

tejshëm, ajo u bë një qendër me rëndësi zejtare dhe tregtare ku u zhvillua edhe sistemi i njohur esnafor[8].

Shtresa zejtare në jetën qytetare qysh në shek. XVIII, ashtu si në të gjitha qytetet e vendit tonë edhe në Kavajë luante një rol të dorës së parë, pasi përbënte grupin më të madh shoqëror[9].

Nga prodhimet zejtare në këtë qytet më i përmendur është punimi i enëve prej balte, të cilat trashëgojnë brez pas brezi forma të larmishme[10]. Frederik Vallish[11] shkruan se Kavaja ka dy mjeshtri mijëvjeçare atë të poçerisë dhe të punimit të zileve për tufat e bagëtive. Me enë balte Kavaja furnizonte pjesën më të madhe të Shqipërisë nëpërmjet filialeve që kavajasit kishin për shitjen e tyre në shumë qytete të tjera të vendit si në Vlorë, Fier, Lushnje, Durrës, Shkodër, Tiranë, Elbasan etj. Gjithashtu këtu ishin të zhvilluara edhe zejtaritë për punimin e tullave, të tjegullave, tekstileve të pambukta e të leshta, brezave prej leshi, qelesheve, veshmbathje, gurë mulliri e mokre etj[12]. Në rrjetin e qëndrave urbane të Shqipërisë së mesme, e përshkuar nga rruga e vjetër Egnatia, në afërsi të portit të Durrësit dhe me skelën e saj anekse, si qendër administrative e ekonomike, Kavaja luante një rol të rëndësishëm për zhvillimin e tregtisë së brendshme dhe të jashtme. Ajo me pozitën e saj në mes të fushave të begatshme të kultivuara me drithra, zarzavate e duhan[13], e rrethuar me vreshta e ullinj, me një blegtori të pasur në numër e me pyje të dendur rreth saj, luante një rol të rëndësishëm edhe për grumbullimin dhe eksportin e prodhimeve të ndryshme bujqësore. Lëvizja tregtare e mallrave që prodhonte dhe grumbullonte ky qytet, eksport-importi kryhej me anë të skelës së Durrësit dhe skelës anekse të saj që eksportonte sidomos drith me sasi të mëdha[14].

Pasoja e ecurisë së jetës shoqërore gjatë shek. XVII-XIX në këtë qytet u pasqyrua edhe me zhvillimin arkitektonik për ndërtimin e objekteve të ndryshme në përgjithësi dhe të banesës në veçanti. Rritja e forcave prodhuese në fushën e zejeve artistike plotësoi edhe kërkesën e shtresës së pasur të qytetit për ndërtimin e banesave me vëllime e sipërfaqe të mëdha. Për realizimin e arkitekturës së tyre u aktivizuan një numër i madh mjeshtrish popullorë për daltimin



Fig. 2

8. Z. Shkodra, **vep. cit,** fq. 291.
9. Z. Shkodra, **vep. cit,** fq. 54.
10. C. Patsch, **Das Sandschak Berat in Albanien,** Wien 1904, fq. 12.
11. F. Wallisch **Neuland Albanien und Franchsche Buchhandlung,** Stuttgard 1931 fq. 85.
12. G. Gibert, **Les pays d'Albanie et leur histoire,** Paris 1914, fq. 156-158.
13. J. Muljer, **vep. cit;** fq. 62
14. Z. Shkodra, **vep. cit,** fq. 305.

DOKTORATURA

DO NOT COPY



Fig. 3

e gurit, gdhendjen e drurit, pikturën, murale etj. Disa punime të zbatuara në tavane, trapazane, dollape në mure dhe elementë të tjerë arkitektonike me vlera, i trashëgojmë edhe sot në mjaft banesa të vjetra të këtij qyteti.

* * *

Qyteti i Kavajës është ndërtuar në një terren të rrafshët fushor me një zhvillim urbanistik i kompozuar sipas boshteve të dy rrugëve kryesore: rrugës së «Madhe» dhe rrugës së lagjes «Zguraj», fig. 1. Gjatë rrugës së «Madhe» janë zhvilluar ndërtimet e lagjes «Sallbeg» fig. 2 dhe të lagjes «Sharrë» fig. 3[15]. Rruga e lagjes «Zguraj» që formon afërsisht një kënd 90° me të parën nga ana perëndimore, lidhet në vazhdim të saj me lagjen e «Bukaqit» e cila sipas të dhënave gojore njihet si vendbanimi më i hershëm se lagjet e tjera. Të dhënat gojore pohojnë se banorët e lagjes së Bukaqit janë shpërngulur me dhunë nga autoritetet feudale të Kavajës për popullimin e shpejtë të këtij qyteti. Ato fillimisht janë vendosur në lagjen Zguraj (kjo mendojmë të ketë ndodhur në gjysmën e parë të shek. XVII, pra para vizitës së Çelebiut pastaj dora dorës në gjysmën e dytë të shek. XIX kur u ndërtua në Kavajë kisha e «Shën Kollit» ato janë shpërngulur përsëri duke u vendosur në rrugën e «Kishës» së lagjes «Sallbej».

Materiali i mbledhur gjatë gjurmimit i bazuar në gjendjen ekzistuese nuk na jepte mundësi të ndiq-

15. Për vizatimin e këtyre pamjeve të qytetit kanë ndihmuar studentët e degës arkitekturë Rudolf Shllaku, Arben Kamberi dhe Fatos Vraniçi.

nim zhvillimin e shpërndarjes së banesave në kohë të ndryshme në çdo lagje. Prandaj na u desh të bëjmë një analizë të hollësishme të numrit të banesave karakteristike të shpërndara në çdo lagje të paktën deri në fund të shek. XIX. Nga kjo pasqyrë analitike rezulton se 70-75% e numrit të përgjithshëm të banesave deri në fund të shek. XIX në këtë qytet kanë qenë banesa të hapura përdhese me hajat. Shpërndarja numerike e 597 banesave të tilla në tri lagjet e qytetit është me diferenca jo shumë të mëdha.

Nga ky studim del qartë se në të kaluarën edhe në qytetin e Kavajës, ashtu si në qendrat qytetare të Shqipërisë së mesme në Elbasan, Tiranë, Peqin[16], deri nga fillimi i shekullit tonë ka pasur një përhapje shumë të gjerë banesa e hapur përdhese e ndërtuar me variante të ndryshme. Duke i analizuar variantet një nga një nga më i thjeshti me një mjedis deri në variantin me katër mjedise, rezulton se përhapje më të madhe ka pasur varianti me dy mjedise, i cili në të tri lagjet varion nga 56-61% të numrit të përgjithshëm të banesave me hajat. Varianti me një mjedis zinte 22-25%, ai me tre mjedsie 11-18% ndërsa varianti me katër mjedise ka pasur një përhapje më të vogël se të tjerat 1-4%.

Nga kjo analizë nxjerrim të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me karakterin klasor që ka urbanistika dhe arkitektura. P.sh. rruga e Firës në lagjen Sallbej banohej kryesisht nga shtresat e varfëra të qytetit. Trojet e ndërtimit të saj që shtriheshin deri në bregun e përroit të Leshniqes kishin kosto më të ulët dhe nuk preferoheshin nga shtresat më të pasura të qytetit, prandaj numri i banesave me një mjedis në këtë rrugë arrin 44%. I njëjti fenomen ndodh edhe në rrugën e Foses të lagjes Sharrë dhe në pjesën e fundit të rrugës së lagjes Zguraj. Pra nëpërmjet përbërjes hapësinore të banesës, madhësisë së numrit të mjediseve, dallimit të tyre sipas funksioneve, shkallës së përpunimit të inteirierit, llojeve të materialeve të përdorura dhe vendit të zgjedhur për ndërtim, lexojmë diferencimin klasor. Nga studimi i banesave më të vjetra dhe i materialit të grumbulluar për hartimin e analizës së shpërndarjes së banesave (fig. 4), jemi të mendimit se zonat më të vjetra të banuara e të grupuara kanë qenë:

— Rruga e «Sarait», rruga e «Skolies» dhe pjesa e fundit e rrugës së lagjes «Zguraj», banorët e të cilave ruanin besimin e vjetër.

— Zona qendrore e rrugës së lagjes «Zguraj» dhe faqja perëndimore e kodrës së qytetit nga rruga e

ANALIZE E SHTRIRJES SE BANESES ME HAJAT

Në qytetin e KAVAJES

Deri në fund të shek. XIX

vendi	BANESA ME HAJAT ME 1 mjedis	2 mjedise	3	4	BANESA ME ÇARDAK
Rr.FIRES - L.SALI BEG	24	26	3	1	-
Rr MADHE - -- -- -- --	27	89	14	3	11
Rr. KISHES - -- -- -- --	7	24	9	-	4
RRUGICAT E L. ZGURAJ	44	95	32	1	14
Rr MADHE - L.SHARRE	32	49	19	2	6
Rr. FOSES - -- -- -- --	14	64	14	4	4
Shuma	148	347	91	11	39

Fig. 4

«Teqes» deri në rrugën e «Foses», të lagjes «Sharrë», të cilave i shërbente si faltore xhamia «Plake» e ndërtuar nga Ali Hajdari më 1561. Pas shpyllëzimit të drurëve të dendur në truallin ku u ndërtua kjo xhami dhe të zonës përreth saj, në kodrën ku ndodhet sot kulla e sahatit, u ndërtuan banesat e para për predikuesit e kësaj faltoreje.

— Të dy anët e rrugës së «Madhe» duke filluar nga hyrja e rrugës së lagjes «Zguraj» deri në rrugën e «Çaires».

— Zona e kryqëzimit të rrugës së «Madhe» me rrugën e «Firës», për banorët e së cilës ka qenë ndërtuar në vitin 1652 xhamia e Kaikut[17].

— Zona që shtrihet në fundin e rrugës së Fires (nga ana veriore e qytetit) përreth pusit të Dollanit ku sipas të dhënave gojore ka qenë ndërtuar xhamia e Dadadardhës.

Pazari si qendër prodhimi zejtar dhe për shitjen e mallrave formon bërthamën e kompozicionit planimetrik të qytetit. Ai u ndërtua në një kompleks të veçantë në mes të lagjeve të banimit duke i shërbyer atyre distancave të barabarta. Gjithashtu edhe lagjet e banimit të shpërndara dhe të ndërtuara në

16. E. Riza, **vep. cit,** fq. 102.
17. Mbishkrimet Turko-Arabe, përkthyer nga V. Buharaja arkivi i Institutit Historik-Gjuhësi.

BOTOSCOPY

terrene të rrafshta formojnë njësi të veçanta urbanistiko-arkitektonike të lidhura njëra me tjetrën me anën e dy rrugëve kryesore.

Përmbajtja e arkitekturës së banesës kavajase me hajat plotëson kërkesat funksionale të jetesës, të punës dhe të pushimit. Ajo është e pasur me shumë elementë të lashtë arkitektonikë si funksionalë ashtu dhe dekorative të trashëguar brez pas brezi.

Arkitektura e saj ruan të qartë ndikimin e prejardhjes së saj nga arkitektura e banesës fshatare nga e cila ajo lindi dhe u zhvillua. Ky ndikim shpjegohet me faktin se ky qytet lindi nga ekzistenca e fshatit Kavalje, numri i banorëve të të cilit në periudha të ndryshme të zhvillimit ekonomiko-shoqëror është rritur jo vetëm nga shtesa natyrore demografike por edhe nga shpërnguljet e fshatarëve të shpronësuar që vinin si mëditës të thjeshtë[18]. Nga ana tjetër një pjesë e mirë e këtij qyteti ushtronte profesionin e bujkut, kështu arkitektura e kësaj banese plotësonte njëkohësisht edhe kërkesat që kushtëzoheshin



Fig. 5

18. **Historia e Shqipërisë,** vol. I, Tiranë 1959, fq. 219-220.

DO NOT COPY



DOKTORATY

Fig. 6

me ekonominë bujqësore. Këto rrethana kanë influencuar në zgjidhjen e varianteve të ndryshme planimetrike të këtyre banesave dhe, në përcaktimin e madhësisë së oborrit ku shpesh herë ndërtoheshin objekte ndihmëse provizore për mbajtjen e prodhimeve bujqësore.

Në përgjithësi banesa popullore kavajase ndërtohet në një truall me sipërfaqe të konsiderueshme, i cili rrethohet me mure. Vendosjen e banesës mbi këtë truall e hasim në mënyra të ndryshme. Më i përhapur është varianti i formimit të oborrit përpara banesës nga ana ku është orientuar hajati, duke lënë vend për shtesa të mëvonëshme nga të dy anët ose vetëm nga njëra anë e saj. Kjo zgjidhje është karakteristike për banesat e ndërtuara në të dy anët e rrugës së «Madhe» ku trualli i ndërtimit është më i kursyer. Në banesat e ndërtuara gjatë rrugës së lagjes «Zguraj», rrugës së «Foses» dhe rrugës së «Firës», në shumicën e rasteve nga ana e qurit ato kanë pasur kopshtin për zarzavate ose me pemë frutore, i cili nuk rrethohej me mure.

Oborri përpara dhe anash banesës arrin lartësinë 1,70-1,90 m. Lidhja e oborrit me rrugën bëhej nëpërmjet portës, e cila ndërtohej në njërën brinjë të murit rrethues nga ana e rrugës. Porta përbën një element me rëndësi në tërësinë e këtyre banesave.



Fig. 7

DO NOT COPY

Ajo ndërtohej me përmasa të mëdha dhe trajtohej me përkujdesje ashtu si në të gjitha qytetet shqiptare[19].

Portat në banesat Kavajase në përgjithësi ndërtoheshin me konstruksione prej druri me dy kanata me gjërësi 2,40-2,80 m dhe me lartësi 2,60-3,40 m (fig. 5,6). Nga ana e rrugës ato përpunoheshin ndërsa nga ana e oborrit lihej në dukje skeleti mbajtës i kanateve. Lidhja e dërrasave me skeletin bëhej me kllapa dhe me gozhdë të punuara me hekur të rrahur. Në të dy kanatat e çdo porte vendoseshin doreza dhe trokitëse metalike. Të gjithë elementet metalike konstruktive dhe funksionalë të portave si gozhdët, dorezat, trokitëset, braca, çelësi etj. të punuar me hekur të rrahur nga mjeshtrit farkëtar vendas, paraqesin vlera artistike, të cilat të vendosura me kujdes secila në vendin e duhur shërbejnë edhe si elemente dekorative duke plotësuar bukur tërësinë e pamjes së portës. Hapësira e portës formohet nga dy mure tërthore ndaj murit rrethues. Mbi këto mure me gjatësi 2,40-2,80 m ndërtohet çatia e portës me katër kullime uji. Konstruksionin e çatisë së portës e mbulon një tavan i rrafshët i ndërtuar me dërrasa pishe. Në të dy anët e portës përgjithësisht ndërtohej nga një sofat me gurë të gdhendur që shërbenin për qëndrimin e të moshuarve në orët e mbrëmjes të stinës së verës (fig. 6).

Në murin rrethues ndërtoheshin edhe dy dyer të tjera të vogla me gjërësi nga 0,70 m, që shërbenin njëra për tu lidhur me oborrin e banesës fqinje dhe tjetra për tu lidhur me kopshtin përkatës.

Pusi për furnizimin me ujë në banesën popullore të Kavajës ndërtohej në afërsi të hajatit 3-6 m përballë tij. Grykat e puseve në përgjithësi ndërtoheshin me gurë të gdhendur por ruhen edhe puse me grykë të gdhendur prej një bloku të vetëm të punuar me ornamente, të cilat nuk punoheshin në vend.

Uji i pijshëm sigurohej nga puset e disa banesave që kishin ujë të mirë. Nëpër pika të tjera të lagjeve kishte puse me ujë të pishëm që i shërbenin banorëve të një zone dhe rrugicave. Nga këto më të përmendur kanë qenë pusi i «Dollanit» në rrugën «Firës», pusi i «Trojzes» në fund të lagjes «Zguraj», pusi i «Tafes» në lagjen «Sharrë» etj. Kodra në pjesën lindore të qytetit ka pasur gjithmonë burime me prurje të mjaftueshme uji të pishëm. Nga këto më i vjetër njihet burimi me emrin «Margullita» që ndodhej në kryqëzimin e rrugës «Foses» me rrugën e «Madhe». Më vonë duke filluar nga mesi i shek. XVII siç na njofton Çelebiu, në qytet me ujin e këtyre burimeve kanë qenë ndërtuar disa çezma.

Materiali analitik i mbledhur për studimin e banesës kavajase me hajat i pasqyruar në fig. 4 tregon qartë për përhapjen e madhe të saj në variante të ndryshme në të gjitha lagjet e këtij qyteti. Për plotësimin e këtij studimi ishte e nevojshme të bëheshin analiza të ndryshme të hollësishme planimetriko-vëllimore për të gjitha variantet në veçanti, analiza të cilat bënë të mundur të përcaktohet tipi më i vjetër i kësaj banese dhe evolucioni i zhvillimit të saj deri në fund të shek. XIX. Për këtë arsye u bë rikonstruksioni i disa banesave me një, dy, tre dhe pesë mjedise.

1. Varianti më i thjeshtë i banesës përdhese me hajat në Kavajë është ai **me një mjedis banimi,** të cilit përpara nga oborri i ndërtohet hajati dhe prapa quri. Mendojmë se ky tip i kësaj banese është nga format më të vjetra me koncepte kompozimi të njëjta me tipin e lashtë megaron. Siç shihet ky tip i lashtë i ndërtimit të banesave fillimisht njihej që prej shumë shekujsh si nga banorët e zonave kodrinore nga lindja edhe nga perëndimi i fushës ku shtrihet sot qyteti i Kavajës, ashtu edhe nga banorët e fshatrave të zonës fushore.

Nga studimi i shpërndarjes së banesave me hajat në këtë qytet (fig. 4) rezulton se deri në fund të shek. XIX kanë ekzistuar 148 banesa me një mjedis. Në këtë numër përfshihen banesa të veçanta dhe banesa të përngjitura të këtij varianti. Gjatë gjurmimit nuk hasëm ndonjë banesë të tillë të veçantë, mbasi janë transformuar, prandaj u detyruam të bënim rikonstruksionin e tre banesave të përngjitura secila me një mjedis banimi.

Rikonstruksioni i banesave të përngjitura me nga një mjedis Fig. 7 u bë nga banesat ekzistuese në rrugën «Përpjekja» Nr. 33, 35 dhe 37, të cilat sot janë të transformuara brenda konturit planimetrik fillestar. Nga studimi rezulton se në fillim është ndërtuar banesa me një mjedis që ndodhet në pjesën qëndrore, më vonë me shtimin e kurorave të tjera nga i njëjti trung familjar janë ndërtuar edhe banesat e tjera të përngjitura me nga një mjedis nga të dy anët e banesës së parë, të cilat janë ndarë me mure rrethues dhe kanë përkatësisht oborrin, portën, dhe pusin e veçantë.

Në tipin e banesës me një mjedis Fig. 7, gjithë jeta familjare kryhej në shtëpinë e zjarrit. Ky mjedis ka formë planimetrike drejtëkëndëshe me përmasa 6,6 x 6,10 m. me lartësi kati 3,10 m. Gatimi dhe ngrohja bëhet në «votrën e zjarrit». Në të tre banesat (fig. 7) ajo është vendosur afërsisht në mes të shtëpisë me

19. E. Riza. **Banesa popullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX,** «Monumentet» nr. 4, Tiranë 1972 fq. 146.

Dokument

distancë 1,80 m. larg nga muri tërthor në të djathtë ose në të majtë të derës së hyrjes. Vatra me përmasa 0,80 x 1,10 m ndërtohet me baltë të përpunuar dhe ngrihet 3-7 cm mbi kuotën e dyshemesë së shtëpisë. Mbi vatër në qendër të saj varej kamostra e punuar me hekur të rrahur në formë zinxhiri e cila fiksohej lart në trarët e çatisë. Kamostra shërben për varjen e enëve të gatimit dhe të ngrohjes së ujit mbi zjarr. Tymi nga mjedisi dilte jashtë nëpërmjet hapësirave të mbulesës, mbasi atij nuk i ndërtohej tavan.

Ndriçimi i shtëpisë së zjarrit bëhet kryesisht nga dy dritare me përmasa 0,80 x 1,10 m të cilat janë ndërtuar nga ana e hajatit. Për plotësimin me ndriçim të pjesës që nuk përfshihet nga rrezja e ndriçimit të dritareve, ndërtoheshin 3-4 baxho në çati. Sigurimi i dritareve nga brenda bëhet me anë të kapakëve prej dërrase me nga dy kanate për çdo dritare. Kanatet për të mos penguar lëvizjet dhe vendosjen e paisjeve në mjedis, hapen nga jashtë duke shfrytëzuar trashësinë e madhe të mureve prej qerpiçi. Nga ana e hajatit dritaret sigurohen me kafaz druri, më vonë ato janë zëvendësuar me shufra hekuri. Lidhja e shtëpisë së zjarrit me hajatin bëhej me anën e një dere me përmasa 1,10 x 1,85 m me dy kanata. Kjo është dera e jashtme dhe kryesore e banesës, e cila sigurohet nga brenda me anën e dy binarëve të fortë që rrëshqasin në dy kanale të hapura në mur. Lidhja e këtij mjedisi me qurin bëhet me një derë të brendëshme me përmasa 0,75 x 1,80 m.

Për veç vatrës elementet karakteristike funksionale të tjera kryesore në shtëpinë e zjarrit janë edhe sofati, sergjeni, dhe dollapet në mure. Sofati shërben për fjetje dhe për të qëndruar në kohën e lirë sidomos kur kishte vizitorë. Në banesat Fig. 7, Sofati ka qenë ndërtuar me përmasa 3,10 x 2,40 m me lëndë druri të sharruar i ngritur 55 cm nga kuota e dyshemesë së mjedisit dhe ka qenë vendosur ngjitur me muret pranë vatrës në skajin e kundërt të diagonales nga porta e hyrjes.

Sergjeni shërben për mbajtjen e enëve të gatimit dhe të ngrënies. Ai ka qenë ndërtuar me dërrasa e binarë me dy ndarje horizontale i mbështetur gjatë gjithë gjatësisë së murit tërthor pranë derës së hyrjes kryesorë. Për këtë arsye kjo derë gjithmonë ndërtohej me distancë jo më pak se një metër nga ky mur tërthor, majtas ose djathtas murit ballor të shtëpisë së zjarrit. Enët në sergjen vendoseshin në planin horizontal me tre radhë, për këtë arsye ai ndërtohej me gjërësi 0,60 m me ngritje nga kuota e dyshemesë 0,50 m ndarja e parë dhe 1,30 m ndarja e dytë. Enët e ujit mbaheshin në pjesën e fundit të sergjenit me gjatësi 0,70 m, pjesë të cilës i ndërtohej vetëm ndarja e parë.

Në faqet e dy mureve përballë dritareve dhe përballë sergjenit janë ndërtuar dollape të futur në mur. Këto dollape janë ndërtuar të hapur pranë vatrës, të mbyllur dhe të kombinuar mbi sofat. Përmasat e tyre janë të ndryshme. Të dy llojet e dollapëve me ose pa kanatë janë të përpunuar me elementë dekorativë prej druri të gdhendur.

Tjetër element dekorativ dhe funksional janë edhe parvazet të cilat fiksoheshin në lartësinë 2 m nga kuota e dyshemesë gjatë gjithë gjatësisë në tri faqet e mureve (me përjashtim të faqes ku ndodhej sergjeni) ato punoheshin me lëndë druri të sharruar kombinuar me gdhëndje.

Në banesën me një mjedis i gjithë aktiviteti i jetës familjare: si gatimi, ngrënia, fjetja, qëndrimi i familjes dhe pritja zhvillohej në «shtëpinë e zjarrit» ose tek e ashtuquajtura «shpia». Emërtimi i dytë «shpia», për këtë tip banese na duket më i drejtë, sepse aty përfshihen të gjitha funksionet e aktivitetit të jetës familjare. Vendasit në përgjithësi këtë mjedis edhe në variantet më të zhvilluara të kësaj lloj banese, e quajnë «shpia» dhe rrallë herë «shpia e zjermit» ose «shpi buke».

Përpara në hyrjen kryesore të banesave të përngjitura me një mjedis Fig. 7 është ndërtuar hajati i hapur me gjërësi 3,40 m dhe me gjatësi e lartësi sa ajo e shtëpisë së zjarrit. Hajati me këtë sipërfaqe të konsiderueshme dhe i orientuar nga veriu shfaqet si element i rëndësishëm funksional i banesës. Ai shërben si parahyrje e mbrojtur, si mjedis për përpunimin e produkteve bujqësore, për vendosjen e vegjeve prej druri dhe si mjedis jetësor për periudhën e nxehtë të verës. Konstruksioni i çatisë që mbulon hajatin mbështetet me shtylla prej druri të vendosura në distancë 2,25 m larg njëra tjetrës. Shtyllat në dysheme mbështeten mbi pllaka druri të latuar dhe të gdhendur me shije. Dyshemeja e hajatit njëlloj si ajo e shtëpisë së zjarrit është e ndërtuar prej dheu të punuar me ngjeshje dhe me një sipërfaqe të rrafshët. Kuota e dyshemesë së hajatit është më e ngritur se ajo e kalldrëmit të oborrit 10 cm.

Quri ndërtohet prapa shtëpisë së zjarrit dhe lidhet direkt me të. Ai shërben si aneks i banesës për depozitimin e produkteve ushqimore dhe të orendive të ndryshme shtëpijake. Në një kënd të tij ndërtohet nyja sanitare dhe «hamami». Gjërësia e qurit në banesat me një mjedis (fig. 7) është nga 2,10 m në banesat anësore dhe 2,90 në banesën e mesit. Ato mbulohen nga vazhdimi i flegrës së çatisë së shtëpisë së zjarrit, për këtë arsye lartësia minimale e tij në murin e jashtëm është 1,40 m.

2. **Ndërtimi me dy mjedise i banesës së hapur me hajat** i parë nga pikëpamja e kompozimit arki-

DOKTORATURË



Fig. 8

tektonik u zhvillua horizontalisht dhe lindi nga varianti me një mjedis duke i shtuar majtas ose djathtas shtëpisë së zjarrit një dhomë për fjetje. Kjo lloj banese ka pasur një shtrirje shumë të madhe në këtë qytet. Deri në fund të shek. XIX nga studimi i pasqyruar me Fig. 4 këtu numëroheshin 347 banesa të tilla.

Një shtrirje e tillë e kësaj lloj banese me diferencimin funksional të mjediseve shpreh kërkesat e përmirësimit të kushteve të jetesës të shtresës së mesme të këtij qyteti si rrjedhim i zhvillimit ekonomiko-shoqëror, dhe i fillimit të shthurjes së familjes patriarkale.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gjatë gjurmimit në të gjitha lagjet e qytetit, hasëm banesa të tilla me dy mjedise, të cilat ruajnë skemën planimetrike fillestare, por duke ndryshuar kudo shtëpinë e zjarrit, e cila me sipërfaqen e madhe të saj ka krijuar mundësinë e rritjes së numrit të dhomave. Materialin e mbledhur këtu nga studimi i disa banesave me hajat me dy mjedise do ta përmbledhim në përshkrimin e shembullit të dhënë në Fig. 8, i cili përmban të gjitha karakteristikat arkitektonike dhe funksionale të këtij varianti. Ky shembull tipik ndodhet në rrugën «R. Sukaj» nr. 51 dhe paraqet një banesë të thjeshtë me dy mjedise, shtëpinë e zjarrit dhe odën e miqve ose të fjetjes me hajatin përpara nga hyrja kryesore dhe qurin nga prapa. Banesa ruan në gjëndjen fillestare odën e miqve, hajatin, qurin dhe të gjithë muret mbajtëse që formonin shtëpinë e zjarrit. Rindërtimin e shtëpisë së zjarrit e kemi bërë me ndihmën e pronarit të banesës, të dhënat gojore të të cilit përputhen me të gjithë elementet arkitektonikë që kanë mbetur në dukje pas transformimit të saj.

Shtëpia e zjarrit ka po ato karakteristika planimetrike dhe vëllimore që kemi përshkruar për banesën me një mjedis. Këtu ndryshojnë pak vetëm përmasat planimetrike të saj (5,80 m x 5,50 m), të sofatit (2,50 x 2,40 m), të derës kryesore (1,70 m x 1,90 m), të dritareve dhe të dollapeve në mure.

Oda e miqve është mjedisi që trajtohet me më shumë elemente arkitektonikë e funksionalë e dekorativë në banesën kavajase, ashtu si në të gjitha banesat në qytetet shqiptare të kohës. Me banesën Nr. 51 Fig. 8; oda e miqve ruhet në gjendjen origjinale. Përmasat e saj janë 4,50 m x 4,30 m me lartësi kati 2,90 m. Ajo ka hyrje direkte nga hajati dhe nëpërmjet një tamburi të brendëshëm lidhet me qurin dhe me shtëpinë e zjarrit në kuotën e sofatit. Është ndërtuar me tavan e dysheme prej dërrasash me mure të suvatuara edhe të lyera me shërbet gëlqereje. Ndriçimi i saj bëhet nga dy dritare të hapura nga ana e hajatit. Mbyllja e dritareve nga brenda bëhet me kapakë prej druri që lëvizin në drejtimin vertikal sepse trashësia e murit është e vogël. Në murin përballë hyrjes kryesore është ndërtuar musandra, një element që e gjejmë kudo në të gjitha tipat e banesave të këtij qyteti. Dhoma është pajisur gjithashtu me katër rafte muri të trajtuara me dekore të ndryshme të gdhendur në dru me motive tradicionale. Tavani i saj është punuar prej druri i zbukuruar me gdhendje ashtu si raftet e murit dhe kanatet e musandrës. Brendia e kësaj dhome e kompozuar me shumë elemente arkitektonikë të zbukuruar me ornamente popullore tradicionale ruan vlera të larta artistike për këtë qytet.

Funksioni kryesor i këtij mjedisi është fjetja për pjestarët e familjes. Kur vinin miq ajo destinohej vetëm për pritjen dhe fjetjen e tyre. Njëkohësisht për fjetje shërbente edhe shtëpia e zjarrit.

3. **Banesa me tre mjedise banimi** u ndërtua nga nevoja për t'u siguruar dhoma fjetjeje kurorave të reja. Ky është varianti më i zhvilluar se ai me dy mjedise dhe ka pasur një përhapje relativisht të madhe. Deri në fund të shek. XIX numëroheshin 91 banesa të tilla. Ruhet po e njëjta skemë kompozimi por duke ndërtuar dy dhoma për fjetje nga të dy anët e shtëpisë së zjarrit. Nga banesat e këtij varianti që kemi parë këtu në vend, nuk kemi hasur raste të ndërtimit të shtëpisë së zjarrit në mes të dy dhomave të fjetjes, gjë që eliminon lëvizjet e tepërta të banorëve, kërkesë kjo funksionale e kompozimit planimetrik. Një shembull i këtij tipi është banesa Nr. 5 në rrugën «12 gusht», e cila ruan mirë skemën planimetrike fillestare. Riveluam këtë banesë për ilustrim sepse, ky është rasti i vetëm që kemi hasur në këtë qytet ku ruhet e paprekur shtëpia e zjarrit me të gjitha elementet e saj arkitektonike fig. 9. Pjestarët e familjes së kësaj banese edhe sot e quajnë këtë mjedis «shpia» megjithse ajo tani shërben vetëm si depo. Ajo ka përmasa të mëdha 6,40 m x 5,20 m, është përdhese e pa tavan.

Të tre mjediset të vendosura radhazi kanë secili nga dy dritare dhe derën kryesore të hyrjes nga ana e hajatit, i cili vazhdon gjatë gjithë gjatësisë së banesës. Hajati në këtë banesë është ndërtuar mbyllur nga të dy krahët me gjërësi 3,50 m, me një dysheme të ngritur 55 cm. nga kuota e oborrit. Një ngritje e tillë e dyshemesë së hajatit haset rrallë në të gjitha variantet e banesës me hajat të këtij qyteti, pasi zakonisht ajo ngrihet 10-15 cm.

Shtëpia e zjarrit dhe të dy dhomat e fjetjes kanë të ndara secila qurin përkatës ku janë vendosur dhe nyjet e tyre sanitare të veçanta. Të tre mjediset kanë lidhje të dyfishtë me njëri tjetrin. Ato komunikojnë nga brenda nëpërmjet dyerve që ndërtohen në muret e ndarjeve të qurit dhe nga jashtë nëpërmjet dyerve kryesore me hajatin. Në dhomën e miqve është ndërtuar një musandër dhe vatra e zjarrit me oxhak. Tavani dhe dyshemeja e saj janë punuar me dërrasa pishe. Dhomës tjetër të fjetjes i janë bërë ndryshime. Në fazën fillestare ajo ka qenë ndërtuar e njëjtë me dhomën e miqve po i mungonte vatra dhe oxhaku.

Kjo banesë ruan mirë dhe vendosjen fillestare të saj mbi truallin e ndërtimit. Ajo është ndërtuar në faqe përbri rrugës, përpara së cilës shtrihet oborri i rrethuar me mure.

Pusi për furnizimin me ujë është hapur në distancë 3,00 m larg shtyllave të hajatit në aksin e

DO NOT COPY



Fig. 9

banesës (fig. 10). Për shkurtimin e lëvizjeve të banorëve nga mjediset në oborr janë ndërtuar dy palë shkallë prej guri, nga të cilat njëra drejton lëvizjen për odën e miqve. Përbri pusit është vendosur një lug prej guri, i cili shërben për larjen e rrobave. Ngjitur me hajatin në drejtim të pusit është ndërtuar sqolli për larjen e enëve, i cili ngrihet në lartësinë 0,70 m mbi kuotën e dyshemesë së hajatit.

4. **Banesa me katër dhe pesë mjedise.** Ka pasur një përhapje të vogël në këtë qytet. Në fund të shek. XIX numëroheshin 11 banesa të tilla. Gjatë gjurmimit piketuam rivelimin e banesës Nr. 9 në rrugën «H. Balliu» e cila përmban pesë mjedise Fig. 11. Mirëpo nga studimi na rezultoi se kjo banesë nuk është ndërtuar e tillë që në fillim. Po kështu ka ndodhur edhe me banesat me katër mjedise me krijimin e fami-



Fig. 10

XOO ION OO









Fig. 11

DOZOK COPY

ljeve të reja janë shtuar dhoma të tjera ngjitur me të parat gjatë hajatit.

Banesa në fig. 11 sot ruan të pandryshuar tre dhomat nga ana e djathtë e saj, hajatin, qurin, dhe muret mbajtës të dy dhomave të anës së majtë. Është transformuar shtëpia e zjarrit (1) dhe është shtuar një dhomë tjetër anash në hajat ngjitur me odën e miqve. Në fillim, sipas të dhënave gojore, rreth vitit 1860, është ndërtuar banesa me dy mjedise, shtëpia e zjarrit (1) dhe oda e miqve, duke vendosur një faqe anësore të saj përbri rrugës nga e majta. Më vonë në vitin 1885 me shtimin e pjesëtarëve të familjes, ngjitur me të parën u ndërtua një banesë tjetër me dy mjedise. Shtëpitë e zjarrit u ndërtuan të ngjitura, ndërsa dhoma e fjetjes në vazhdim nga ana e djathtë. Shtesa tjetër është bërë më vonë. Çdo mjedis ka qurin e vet me nyjet sanitare përkatëse. Shtëpitë e zjarrit dhe oda e miqve (sot të transformuara) kanë qenë ndërtuar me po ato elementë arkitektonikë që kemi përshkruar, por me sipërfaqe pak më të vogël se shembujt e dhënë në variantet e tjerë. Ndriçimi i çdo mjedisi, me përjashtim të odës së miqve bëhet me nga dy dritare të hapura nga hajati dhe që sigurohen me kapakë prej druri. Hajati në këtë banesë arrin një gjatësi 25,50 m, gjërësi 3,80 m, lartësi kati 3,10 m dhe me dysheme të ngritur 10 cm. mbi kuotën e kalldrëmit të oborrit. Përpara nga hajati banesa ka oborrin ku është hapur pusi dhe prapa kopshtin për zarzavate dhe për pemë frutore.

– Banesa e hapur me hajat në qytetin e Kavajës gjatë shek. XVIII-XIX, është tipi mbizotërues, i njohur dhe e ndërtuar shumë kohë më parë. Në aspektin urbanistik ajo është ndërtuar në një truall me sipërfaqe të konsiderueshme duke pasur gjithmonë përpara oborrin, ndërsa prapa sipas rastit kopshtin për zarzavate e pemë.

Banesa zhvillohet në drejtimin horizontal, me hajatin përpara dhe qurin prapa gjatë gjithë gjatësisë së saj. Në të gjitha variantet embrioni hapsiror i saj është shtëpia e zjarrit rreth së cilës kompozohen mjediset e tjerë. Shtëpia e zjarrit është mjedisi kryesor i përbashkët i familjes me sipërfaqe relativisht të madhe, e cila kryen të gjitha funksionet e jetës familjare. Të gjithë mjediset i kanë dyert e hyrjeve kryesore dhe dritaret vetëm nga hajati. Karakteri klasor i arkitekturës së saj shprehet në banesat e thjeshta të shtresës së varfër dhe në banesat e mëdha të shtresave të pasura. Arkitektura e banesës Kavajase me hajat, ashtu si arkitektura popullore në përgjithësi, shquan për një ndërthurje të arritur ndërmjet funksionit e konstruksionit pa lënë mënjanë përkujdesjen për trajtimin e formës.

DOKTC COPY

Isuf SUKAJ

DO NOT COPY

L'ARCHITECTURE DE L'HABITATION A PORCHE DANS LA VILLE DE KAVAJA

R E S U M E

Dans la ville de Kavaja, jusqu'à la fin du XIXe siècle, on a largement construit l'habitation ouverte à porche, sous diverses variantes.

De différents chercheurs ont à peine mentionné le type de cette habitation dans cette ville, sans décrire son architecture. Ce n'est qu'en 1973, en vue de compléter l'étude typologique de l'habitation des principales villes de l'Albanie, qu'E. Riza donne une appréciation générale sur l'habitation populaire de Kavaja, de pair avec celle des autres villes de l'Albanie Centrale, Elbasan, Tirana et Peqin.

Cet article est écrit dans le but d'élargir l'étude sur le développement architectural de l'habitation à porche à Kavaja, sur les variantes de solutions et leur distribution numérique dans les quartiers de la ville.

L'étude est fondée sur le matériel recueilli sur place au cours du travail de recherche sur les anciennes habitations caractéristiques à porche, qui subsistent encore. Pour compléter l'étude sur la répartition statistique de ces habitations, ont contribué aussi les données orales des personnes âgées, habitants de la ville, de ses ruelles et de ses plus anciens quartiers.

Kavaja, en tant que centre habité, figure pour la première fois sous le nom «le village de Kavalje» dans les cadastres osmans de Sandjak Arvanid, en 1431. Au XVIe siècle Kavaja a connu un remarquable essor économique et social, elle est devenue un nouveau centre administratif de la région et un important centre de commerce, pour l'échange des marchandises. Pendant les XVIIe et XVIIIe siècles Kavaja s'accroit toujours, devenant non seulement un centre artisanal, mais aussi un important centre de stockage des céréales et de leur exportation.

Pendant la deuxième moitié du XVIIe siècle, avec l'étendue des habitations le long de la «Grand-Rue», de la rue du quartier Zguraj et de leurs ruelles, avec le bazar au centre, la ville de Kavaja avait conçu la physionomie urbaine, dont les traits principaux sont conservés, avec quelques modifications de la densité des constructions et de leur architecture, au XVIIIe et XIXe siècles.

La ville de Kavaja est construite sur un terrain plat, son urbanisme étant composé en conformité avec les conditions des deux rues principales: La Grand-Rue, et la rue du quartier de «Zguraj» (fig. 1). Le long de la Grand Rue se situent les constructions du quartier «Sallbej» et du quartier «Sharrë».

D'après les matériaux recueillis sur place pendant la recherche des anciennes habitations à porche, des habitations modifiées de ce type, ainsi que d'après les données orales on a établi le tableau analytique (fig. 4). donnant la répartition numérique de ce genre d'habitation dans chaque quartier de la ville, jusqu'à la fin du XIXe siècle.

De ce tableau analytique il résulte que dans cette ville, 70-75% environ de la totalité des habitations jusqu'à la fin du XIXe siècle, ont été des habitations à simple rez-de-chaussée, ouvertes et à porches. Elles étaient réparties dans trois quartiers, en ayant presque la même densité numérique. De cette étude il s'ensuit que dans le passé, dans la ville de Kavaja, ainsi que dans d'autres centres importants de l'Albanie Centrale, tels Elbasan, Tirana, Peqin, au début du XXe siècle a été largement utilisée l'habitation à simple rez-de-chaussée ouverte et à porche, construite sous diverses variantes. En analysant une à une chaque variante, depuis la plus simple, celle à une pièce, jusqu'à la variante à quatre pièces, il résulte que la plus répandue est celle à deux pièces, laquelle dans les trois quartiers compte 50-61% du nombre total d'habitation à porche. La variante à une seule pièce compte 22-25% celle à trois pièces environ 11-18%, tandis que la variante à quatre pièces est la moins répandue, elle compte 1-4% environ.

Par cette analyse nous obtenons d'autres données relatives au caractère de classe de l'urbanisme et de l'architecture. Par example la rue de Firë, au quartier «Sallbej», était habité surtout par les couches pauvres de la ville, parce que les terres qui s'étendaient jusqu'aux bords du torrent de «Leshnige» étaient à bon marché et n'étaient pas préférées par les riches. Il s'ensuit que les habitations à une seule pièce y comptaient environ 44%. Le même phénomène aparait le long de la rue de «Fose» du quartier de «Sharrë», ainsi que dans la dernière partie de la rue du quartier de «Zguraj». Donc, par l'intérieur de l'habitation, le nombre de pièces, leur distinction selon les fonctions, les ornements artistiques de l'intérieur, la nature des matériaux utilisés et l'endroit choisi pour la con-

DOKTORATURA

struction, on relève la différenciation de classe qui se reflète même dans le traitement architectonique de l'habitation. L'architecture de l'habitation à porche de la ville de Kavaja satisfait les besoins fonctionnels de la vie, du travail et du repos. Elle est riche en anciens éléments architectoniques tant fonctionnels que décoratifs, hérités de génération en génération. L'architecture de cette habitation conserve bien l'influence de l'architecture de l'habitation rurale dont elle est née et s'est développée. Cette influence s'explique par le fait qu'une bonne partie des habitants de cette ville étaient des laboureurs. Ainsi l'architecture de cette habitation satisfait aussi les besoins de l'économie agricole. En général, l'habitation à porche de Kavaja se construit sur une superficie considérable entouré d'un mur. Nous rencontrons l'emplacement de l'habitation sur ce terrain en diverses positions. La variante la plus courante est celle où la cour, sur laquelle donne le porche, se trouve devant la maison, laissant ainsi de la place aux adjonctions ultérieures d'un seul côté ou des deux côtés.

La cour était entourée d'un mur de pisé haut de 1,70-1,90 mètres. L'accès dans cette cour se réalisait par une grande porte (fig. 5,6) bien menuisée, comme celles de toutes les villes albanaises.

1. La plus simple variante de l'habitation à simple rez-de-chaussée à porche, est celle à une pièce, précédée d'une cour où se trouve le porche ayant derrière un annexe. Nous sommes de l'avis que cette habitation est des plus anciennes, pareille à l'ancien type «megaron»».

D'après l'étude de la distribution des habitations à porche (fig. 4), il résulte que jusqu'à la fin du XIXe siècle ont existé presque 148 habitations à une seule pièce. Dans ce chiffre sont comprises les habitations à part et celles conjointes à cette variante. Pendant les recherches, n'ayant pas rencontré une telle habitation à part, parce qu'elles étaient toutes transformées, nous étions obligés de faire la reconstruction de trois habitations conjointes à une seule pièce, dans la rue «Përpjekja» No. 33,35 et 37 (fig. 7). L'étude nous montre qu'au début on a construit l'habitation à une seule pièce qui se trouve dans la partie centrale, plus tard, avec l'agrandissement de la même famille on a construit les deux autres habitations à une pièce. Dans cette variante la famille menait ses activités dans la maison du «feu» à une planimétrie quadrangulaire, aux dimensions 6,6x6,1 m et une hauteur de 3,1 m. On y préparait la cuisine et on se chauffait près du foyer, placé à 1,80 m du mur latéral à droite ou à gauche de la porte d'entrée.

L'éclairage de la maison du feu était assuré en partie par deux fenêtres aux dimensions de 0,80 x 1,1 m construites du côté du porche. L'autre partie est éclairée par 3 ou 4 fenêtres à tabatière.

A part le foyer, la maison du feu possède d'autres éléments caractéristiques fonctionnels tel le sofa, le dressoir, les placards. Le sofa servait de lit et de lieu de repos surtout quand il y avaient des amis. Il était surtout en bois scié avec les dimensions 3,10 x 2,40 m, élevé 55 cm du plancher. Le dressoir qui servait à garder la vaisselle, était en planches et en poutres avec deux rangées horizontales, tout le long du mur latéral près de la porte d'entrée principale.

Les murs en face des fenêtres et des dressoirs sont couverts de placards.

Devant l'entrée principale de ces habitations se situait le porche ouvert d'un seul côté, large de 3,30 à 3,80 m, ayant la longueur et la hauteur de l'habitation. Le porche à superficie si considérable, orienté dans la plupart des cas vers le Nord, apparaît comme un important élément fonctionnel de l'habitation. On y traitait les produits agricoles, on y installait les métiers à tisser. Il servait à entrelier les pièces et comme un lieu de repos.

Derrière le bâtiment se trouvait une sorte d'annexe pour conserver les produits alimentaires et les outils de travail. C'était d'une largeur de 2-3 m avec la longueur de l'habitation sous le même toit ayant une hauteur minimale de 1,4 m.

2. L'habitation à porche à deux pièces, du point de vue de la composition architectonique s'est développée horizontalement et est née de la variante à une pièce ajoutant à droite ou à gauche une chambre à coucher. Cette habitation a eu une large étendue dans cette ville. D'après notre étude, jusqu'à la fin du XIXe siècle on en comptait 347.

Pendant nos recherches dans les quartiers de la ville, nous avons rencontré de telles habitations qui gardent le schéma de la planimétrie initiale, ayant transformé partout la maison du feu. L'example présenté (fig. 8) conserve toutes les caractéristiques architectoniques et fonctionnelles de cette variante. La maison du feu a les mêmes caractéristiques de planimétrie et de volume que l'habitation à une pièce. La chambre des amis (ou la chambre à coucher) dans l'habitation de Kavaja, comme dans toutes les habitations urbaines albanaises, est traitée avec plus d'éléments architectoniques fonctionnels et décoratifs. Le plancher et le plafond étaient construits en bois scié enduit et badigeonné. L'éclairage était assuré par deux fenêtres qui donnaient sur le porche. A l'intérieur il y avait quatre placards décorés comme son plafond, avec du bois sculpté.

3. L'agrandissement de la même famille a nécessité la construction de l'habitation à trois pièces, Jusqu'à la fin du XIXe siècle on en comptait 91. On a conservé le même schéma de composition et dans tous les cas la maison du feu est composée au centre ayant des deux côtés une chambre à coucher. Donc le centre de la composition était la maison du feu, une solution qui évitait beaucoup de mouvements inutiles à l'intérieur de la maison.

Les trois pièces qui se succédaient étaient éclairées chacune par deux fenêtres et une porte qui donnaient sur le porche, lequel occupait toute la longueur de l'habitation. Les trois pièces se reliaient par l'annexe qui lui aussi avait la longueur de l'habitation.

4. Les habitations à quatre et cinq pièces *ont été moins réuandues ques les autres variantes. Elle sont nées par l'adjonciton des chambres à coucher avec l'a'grandissement de la famille. L'example donné (fig. 11) a démontré qu'au début on avait construit une habitation à deux pièces, plus tard on a construit une autre maison de feu et une chambre à coucher, tandis que la cinquième chambre a été construite quelques années plus tard que la première adjonction. Le schéma de la composition était pareil à celui décrit plus haut.*

Pendant le XVIIIe – XIXe siècles, dans la ville de Kavaja, c'était l'habitation ouverte à porche qui dominait. Sous l'aspect urbaniste, elle était construite sur un terrain à superficie considérable ayant toujours devant la cour et derrière le potager et le verger.

L'habitation se développe horizontalement, au milieu du porche et de l'annexe qui ont sa longueur. Dans tous les cas la maison du feu est le noyau de son volume et tout autour d'elle se composent les autres pièces. La maison du feu constitue la principale ambiance grande et commune qui assure toutes les fonctions de la vie familiale. Toutes les portes et les fenêtres des pièces donnent sur la cour. Le caractère de classe de son architecture se reflète à l'habitation simple des couches pauvres et à la grande habitation des riches.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

KISHAT MESJETARE TË SHQIPËRISË SË MESME E TË VERIUT

Në këtë shkrim do të trajtojmë ndërtimet e kultit të krishter të Shqipërisë së Mesme e të Veriut, të cilat deri më sot kanë mbetur mënjanë botimeve tona. Pjesa më e madhe e tyre, për shkak të rrethanave historike, ruhet në gjendje rrënoje, të tjerat njihen nga dokumentacioni historik apo dhe toponimia.[1]

Njoftimet më të vjetra, edhe pse të pakta për këto monumente, gjenden ndër burime historike të periudhës mesjetare,[2] sidomos në relacionet që misionarët e të dërguarit e kishës së Romës dhe peshkopët e vendit, dërgonin gjatë shek. XVII mbi gjendjen në krahinat e vizituara.[3] Studimet e para të arkitekturës së këtyre ndërtimeve janë të fundit të shekullit të kaluar nga konsulli i atëhershëm austriak në Shkodër Teodor Ipen, i cili në një sërë artikujsh publikon mjaft nga këto monumente.[4] Veç tij, ose duke u mbështetur tek ai, për këto monumente flasin edhe një sërë studiuesish të tjerë të kësaj kohe. Gjatë viteve 20-40 të shekullit tonë janë bërë gjithashtu mjaft publikime lidhur me vendndodhjen e monumenteve të përmendura në dokumentacionin e mësipërm dhe në hartat gjeografike të kohës.[5]

Në këtë shkrim do të paraqesim rezultatet e kërkimeve tona në monumentet e ruajtura në këmbë apo në gjendje rrënoje, që përbëjnë një pjesë të vogël të ndërtimeve të dikurshme, duke i vështruar ato edhe në dritën e të dhënave burimore e historike, pa pretenduar për një shterim të problemit dhe parashtrim të të gjitha gjurmëve të ruajtura ende sot.

Trevat që trajtohen këtu përfshihen në antikitetin e vonë (shek. IV-VI e.s.) në dy provincat e perandorisë bizantine, atë të Epirit të ri me qendër Durrësin dhe atë të Prevalitanës me qendër Shkodrën. Për to,

---

1) Do të prekim këtu monumentet që ndodhen në trevat në veri të lumit Shkumbin duke pranuar për emërtime konvencionale Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut. Artikulli do të vijojë dhe në numrin e ardhëshëm.

2) Themeltare në to janë dhe përmbledhjet e dokumentave botuar në dy vëllimet e **Acta et Diplomata Res Albania e Mediae Aetatio illustrantia,** collagerunit et digesserunt, L. Thalloczy, C. Jirecek, E. Šuflfay, V. 1, MCM XIII Vindobonae, Vol, II, MCM XIII më tej **A.Alb.** I, II). Kohët e fundit A. Duellier **La façade maritime de l'Albanie au moyen àge, Durazzo et Valona du XI au XV Siècle.** Thesaloniki 1981, jep një sërë të dhënash burimore të panjohura deri më sot.

3) Këto janë botuar në origjinal në gjuhën shqipe nga I. Zamputi në Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë. 3. **Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut në shek. XVII.** v. I, 1610-1634. Tiranë 1963, v. II, 1634-1650 (Më tej **Relacione** 3,I dhe 3,II.

4) Th. Ippen, **Stare crkvene rusevine u Albaniji,** G.M.B.H. XI, 1899, dhe XII – 1900 dhe po ai **Stari spomenici u Albaniji,** G.M.B.H. XIV, 1902, po ai **Denkma ler verschiedener altersstufen in Albanien,** G.M.B.H. X. 1907, Wien, po ai **Skutari die nord – albanische kustenebene,** Sarajevo 1907.

5) M. Šufflay, **Die kirchenzustand in vorturkischen Albanien. Die Orthodoxe Durchbruchszone in katholischen Damne** Ilyrisch Albanische Forschungen... E Armao, **Localita chiese, fiumi, monti e toponimi vari di una antica carta dell Albania settentrionale,** Roma, 1933.

në këto treva, në fillim të shek. VI Hierokli jep qytetet që vijojnë: Dyrrahu, Skampini, Listron dhe Skeuptron, Skodra, Dioklea, Lissos.[6]

Kishtarisht ato përfshihen në dy metropole atë të Shkodrës me Lezhën dhe Dioklenë dhe atë të Durrësit me Skampinin; Listronin e Skeuptronin. Fillimisht këto janë në vartësi të kishës së Romës dhe deri në vitin 487 i administron vikarjati me qendër në Selanik, qendra e prefekturës së Ilirikut, ndërsa më vonë drejtpërsëdrejti Roma. Pas vitit 535 metropolia e Shkodrës varet nga Justiniana Prima e sapo themeluar nga Justiniani.[7] Si të tilla këto peshkopata ne i hasim në dokumentacionin historik deri në kapërcyellin e shekujve VI-VII (vitet 590-602) në letrat e papës Gregori I[8]. Më vonë për dy shekuj rradhazi, përmendet vetëm kryepeshkopi i Durrësit. Këto njoftime janë pjesmarrja në koncilet që zhvillohen në Kostandinopojë në vitet 691 dhe 787. Në të parën merr pjesë Sicini, që firmos në aktet e koncilit si peshkop i metropolisë së Durrësit[9]. Në të dytën peshkopi Nikifor dërgon murgun Joan ta përfaqësojë atë, si peshkop të provincës së Durrësit.[10]

Mospërmendja në dokumentacionin historik të qendrave të tjera peshkopale gjatë shek. VII, ndodh sepse për këtë shekull dokumentacioni është mjaft i rrallë nga që arkivi i papëve ka humbur.[11]. Po kështu mungesa në koncilet e mësipërme të peshkopëve të qendrave të tjera, nuk do të thotë se këto nuk janë më të tilla por se mjaft prej tyre janë futur në zona të thella e të sigurta dhe se vajtja e tyre në Konstandinopojë ka qenë mjaft e vështirë në kohën e dyndjeve të mëdha sllave.[12]

Me krijimin e Temës së Durrësit në fillim të shek. IX[13], në të cilën u përfshinë përafërsisht trevat e Shqipërisë së mesme dhe të Veriut, duket se u riorganizua dhe administrata kishtare. Nga pjesëmarrjet në koncilet e fundit të shek. IX dhe listat e fillimit të shek. X përmenden peshkopatat e Durrësit, Kunavisë, Stefaniakës. (në vitin 879)[14] dhe Elison (Lezha) (në listat e Leonit VI, vitet 902-907)[15] në rënien e mbretërisë së parë bullgare. Në vitin 970 nga luftrat me perandorin bizantin Jan Cimiskes, kemi një riorganizim të ri të kryepeshkopatës së Durrësit nga e cila varen 15 Peshkopata. Në Shqipërinë e Mesme e të veriut veç të mësipërmeve janë dhe ato të Tivarit, Ulqinit, Dokles, Polatit, Drivastit dhe Cernikut[16]. Sa kohë zgjati kjo administratë është e vështirë të përcaktohet, megjithëkëtë, në vitet 1010-20 në dy diplomat e Vasilit II[17] përmendet Cerniku në vartësi të Ohrit, ndërsa në vitin 1022 papa Benedikti III ia shkëputi Durrësit dhe ja lidhi Raguzës peshkopatat e Ulqinit dhe Tivarit[18]. Më vonë, në vitin 1089[19] kryepeshkopatës së Tivarit Diokle i vihen në vartësi peshkopatat e Ulqinit, Shkodrës, Drishtit dhe Polatit, ndërsa më vonë, në vitin 1120[20], këto i kalojnë Raguzës, për t'i rikthyer përsëri e përfundimisht kryepeshkopatës së Tivarit, në vitin 1199. Shekullit të XII i takon dhe koha e krijimit të peshkopatës së Arbërisë, që përmendet në disa akte kishtare.[21]

Me rënien e perandorisë bizantine nën sundimin e feudalëve latinë në vitin 1204, në territoret e Shqipërisë së mesme e të veriut krijohen një sërë peshkopatash të reja të lidhura me perëndimin katolik, ato të veriut nëpërmjet kryepeshkopatës së Tivarit, ato të Shqipërisë së mesme nëpërmjet Durrësit. Kështu krijohen peshkopatat e Sapës (1291), e Ballecit (para 1347) e Danjës (para 1361), e Vregos (para 1361), e Stefaniakes, (shek. XIV) e Kunavisë (rreth 1317) dhe e Lezhës, duke u shuar përfundimisht në gjysmën e dytë të shek. XIV kryepeshkopata ortodokse e Durrësit.

Kjo ndërthurje në kohë, me lëkundje të influencave dhe të administratës kishtare lindore e perëndimore ndikon dhe në arkitekturën e kishave të këtyre

---

6) Hieroclis – **Synecdemus,** Lipsiae, 1893, 652-654, 656.
7) L. Ducheshe, **L. Illyrium ecclesiastique,** B.Z. 1–1892, 548.
8) **A. Alb,** Dok. 36–47.
9) **A.Alb.** I, Dok. 49, 1 september 691-31, augusti 692.
10) **A.Alb,** I, Dok. 51, 24 septembres – 23 octobres 787.
11) L. Duchesne, **Vep. cit,** 532.
12) F. Dvornik, **Les slaves, Byzance et Rome au IX siècle.** Paris 1926, 238.
13) J. Ferluga, **Sur la date de la création du thème de Dyrrachium** Actes du XII Congrès International d'Etudes Byzantines, tome II, Beograd 1964, 90.
14) **A. Alb;** I; 57, Novembri 879.
15) H. Gelzer, **Ungedructe und ungesnugend veroffentichte Texte der noti tiae Episcopatum,** Abh, d; I, Cl, Akad, Wiss, bbXXI, 1901, 557-558. F. Dvornik, **Vep. cit,** 238.
16) **A. Alb,** I, IV.
17) **A. Alb,** I, Dok. 58, 599.
18) **A. Alb,** I, 61. M. Šufflay, **Kirchenzustande;** 199.
19) **A.Alb,** I, 68. M. Šufflay, **Vep. cit,** 201-202.
20) **Po aty,** 202.
21) **A.Alb;** I, 93.

POROTOPY

krahinave. Në këtë shkrim do të trajtojmë monumentet që ende ruhen të plotë apo në gjendje rrënoje, si dhe çka na kumtojnë udhëtarë e studiues të ndryshëm, për të arritur në përfundime më të plota mbi bazën e gjithë këtyre të dhënave materiale dhe burimore.

Nga periudha e hershme bizantine, shek. IV-V, kemi një numër të vogël monumentesh po në të njëjtën kohë të dhëna të mjaftueshme nga skulptura arkitekturale nëpërmjet gjetjeve të rastit[22], që na ndihmon të krijojmë një tabllo të qartë të zhvillimit të arkitekturës paleokristiane në këto treva. Deri më sot janë gërmuar bazilika në Tepe të Elbasanit[23], kisha në Tiranë[24] dhe bazilika e Arapajt[25]. Veç tyre kemi të dhëna për kishën e Shën Gjergjit[26] përtej Drinit në Lezhë, një bazilikë 3 nefshe ende e pagërmuar. Prej saj ka të ngjarë të vijë dhe një kapitel, sot në muzeun e rrethit, i datuar në gjysmën e dytë të shek. V. Gjithashtu kemi të dhëna për dy kisha të kësaj periudhe në rrethin e Matit. Njëra një bazilikë trenefshe me narteks[27], në Suç tjetra një kishë në Rrypë.[28]

Si dhe në fusha të tjera, edhe për studiuesit e arkitekturës së kultit mesjeta e hershme përbën një periudhë gjatë shekujve të parë të së cilës, mungojnë dëshmitë e drejtpërdrejta për monumentet. Për këto shekuj ka të dhëna të tërthorta si dhe një sërë fragmentesh arkitekturore[29]. Le ti vështrojmë fillimisht këto përpara se të kalojmë në paraqitjen e monumenteve të veçanta.

Në përshkrimin e luftrave midis trupave bizantine të Aleks Komnenit dhe atyre në vitet 1081-85, Ana Komnena na përmend disa monumente, siç është kisha e Shën Mërisë në kepin e Palit, e cila sipas saj është një faltore e ndërtuar prej kohësh në atë vend.[30] Po nga ajo mësojmë për kishën e Sh. Teodhorit, ndërtuar që në kohët e kaluara[31], për të cilën H. Myrto mendon se ndodhet në afërsi të fshatit Qerret, mbasi 600-700 m. larg bregut të detit në vendin që ruan toponimin «Kisha» në vitin 1901 u zbuluan themele dhe një arkë mermeri me monedha të shek. XI-XIV[32]. Në to janë gjetur rënoja muresh 40 m të gjata në drejtimin lindje perëndim, pjesë muresh me planimetri gjashtëkëndore, kolona si dhe qeramikë e shek. IV-VI.[33]

Një ndër zbulimet më me interes të kohëve të fundit është kisha e manastirit të Shën Mëhillit në Arapaj në shpinë të plazhit të Durrësit ku në tetor të vitit 1081 u dogj garda perandorake e Aleks Komnenit[34]. Monumenti është identifikuar së pari nga Hezei mbi bazën e toponimit Shën Mëhill të ruajtur në atë vend.[35] Gërmimet në të ende në vazhdim kanë nxjerrë në dritë një bazilikë të shek. V-VI, në përdorim përgjatë mesjetës.[36].

E një kohe me këto monumente është edhe kisha e Shën Kollit 4 stade larg Durrësit[37], që haset në të gjitha hartat e shek. XVI-XVII. Duke u nisur nga këto të dhëna H. Myrto mendon se kjo kishë duhet të ketë qenë në shkëmbin e Kavajës.[38]

Të gjitha këto monumente të antikitetit të vonë vazhdojnë të përdoren gjatë gjithë mesjetës, sigurisht me rindërtime të ndryshme. Kjo gjë ndodh ndër të tjera dhe gjatë shek. IV-VI janë ngritur një numër i madh ndërtesash kulti, një pjesë e të cilave mbeten

22) Veç koleksionit mjaft të pasur që ruhet në muzeun e Durrësit, dëshmi me rëndësi për rëndësinë e kësaj qendre me numurin e madh të monumenteve të saj, kemi gjetje në Grazhdan (Peshkopi), Shkodër, Lezhë, Prush, (Tiranë).
23) A. Meksi – N. Ceka, **Bazilika në Tepe,** Buletin arkeologjik, 3, 1973, 184-190.
24) A. Meksi, **Historia e Arkitekturës Shqiptare** (maket) Tiranë 1980, 202, fig.
25) S. Hidri, **Bazilika e Arapajt dhe mozaiku i saj,** Drita, 27-12, 1981.
26) F. Prendi, **Vendvarrimi i Skënderbeut,** Konf. II, Studimeve Albanologjike, Tiranë, v. I, 1969, 297-306.
27) Nga ajo është gërmuar vetëm narteksi, nën dyshemenë e të cilit kanë dalë disa varre mbuluar me qemer. D. Kurti, S. Duka, **Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në Suç të Matit,** Buletin arkeologjik, 5; Tiranë 1975, 124–135.
28) D. Kurti, **Një mbishkrim latin në Rrypë,** Studime historike, 3, 1970, 171-172.
29) A. Meksi, **Monumentet mesjetare të kultit dhe rrënjët e tyre në antikitetin e vonë,** Iliria 1-1983, 217-222.
30) Anna Comnena, **Alexias,** Lib-IV, 2, 132.
31) **Po aty,** Lib. IV, 6, 46.
32) LRey. **Repertoire topo-bibliografique,** Albania, 4, 193.
33) H. Myrto; **Mbi disa qendra arkeologjike ndërmjet Kavajës dhe Durrësit** Monumentet 7-8, 1974, 250-251, H. Myrto – **Hartë e monumenteve dhe e gjurmëve antike e mesjetare të rrethit të Durrësit,** Monumentet 1, 1982, 16.
34) Anna Comnenae, **Alexias,** I, Lib. IV, 147.
35) L. Heuzey, H. Daumet, **Mission Archéologique de Macédoine,** Paris 1876, 368.
36) S. Hidri, **Vep. cit,**
37) Anna Comnena, **Vep. cit,** Lib. IV, 5, 45.
38) H. Myrto, **Vep. cit,** 11-12.

FOTOKOPY

BOMOT COPY

në përdorim si rezultat i vazhdimësisë së banimit në këto treva të së njëjtës popullsi autoktone.

Le të kalojmë tani në paraqitjen e monumenteve të veçantë që ruhen të plotë ose në gjëndje rrënojë në Shqipërinë e Veriut dhe atë të mesme sipas qendrave kryesore (peshkopale) dhe ato më pak të rëndësishme në vartësi të tyre.

SHKODRA

Përmendja e parë e Shkodrës si qendër peshkopale në mesjetën e hershme i takon fundit të shek. X, në listat e perandorit Jan Cimiskës në vartësi të Durrësit, ndërsa që nga viti 1089 nën Tivarin[39] në vartësi të të cilit mbeti deri vonë. Për kishat e saj mesjetare, duke filluar nga shek. XIII, kemi një sërë të dhënash dokumentare. Monumenti më i vjetër që del në dokumentacion është Shën Mëria, kishë e françeskanëve, që Helena me të motrën ndërtoi në vitin 1288. Po kështu mësojmë se në vitin 1319 Don Andrea nga Shkodra, dërgon nga Raguza në Shkodër tre karpentierë për të rregulluar çatinë e koreve të kishës së Shën Stefanit[41]. Për të flitet sërish në vitin 1403, kur kërkohet mbulimi i saj[42]. Kishat e tjera që rezultojnë në regjistrin Venecian të viteve 1416-1417, janë: Shën Stefani, Shën Apolinari, Shën Kryqi, Shën Mëria, Shën Kolli, Shën e Premtja, gjithë shënjtorët dhe Shën Theodhori[43]. Me interes është dhe e dhëna e gjysmës së dytë të shek. XV se dërgohet në Shkodër, një arkitekt për të ngritur një kapele[44]. Marin Barleti, përmend në kala të Shkodrës, në veri të saj dhe në kodrën përballë të mbiquajtur pas rrethimit të vitit 1474 «Kodra e Pashës» këto kisha e kuvende. Shën Mëria, Shën Lazari, Shën Vlashi, Shën Kryqi, Shën Pjetri tek Rrota (kishë e ortodoksëve) dhe Shën e Premtja[45].

Sot në qytetin e Shkodrës ruhet vetëm katedralja e Shën Stefanit në kala, të cilën turqit e kthyen në xhami menjëherë me pushtimin e qytetit në vitin 1479[46]. Turqit që nga pushtimi e deri në mesin e shek. XIX (1858) nuk lejuan ndërtimin e asnjë kishe në Shkodër[47], prandaj me kohë humbën gjurmët e gjithë të tjerave. Udhëtarët na japin mbi bazën e kujtesës popullore vendndodhjen e Shën Mërisë, në këmbët e Kalasë, si dhe Shën Vlashin, në vendin e së cilës ngrihet më vonë hamami.

Kisha katedrale e Shën Stefanit në Shkodër[48]

Rrënojat e kishës katedrale të Shën Stefanit në kala përbëjnë një ndër monumentet më me vlerë të Shkodrës mesjetare. Ato ndodhen pranë mureve rrethues në anën veri perëndimore të kalasë. Kisha përbëhet nga naosi ambienti i altarit dhe hajati në anën jugore. Në këndin e formuar nga këto dy të fundit, bashkëngjitet minarja, e shtuar kur kisha kthehet në xhami. Me përjashtim të mureve të ambientit të altarit pjesërisht të rrëzuara[49], muret e vjetra ruhen në një lartësi të konsiderueshme, shenjë e braktisjes së vonë të monumentit dhe e nivelit të mirë të ndërtimit. Në periudhën e fundit kisha ka qenë përdorur si depo e garnizonit turk. Pjesën tjetër të kishës e përbëjnë naosi me ambientin e altarit, të dy në planimetri drejtëkëndëshe. Në naos hyhet nga porta në anën jugore. Ai është shtruar me pllaka të çrregullta guri. Në anën lindore naosi lidhej me ambientin e altarit nëpërmjet një hapsire të gjërë mbuluar me hark. Kjo sot është e mbyllur dhe ruan nga ndërtimi i vjetër krahun nga jugu ku kemi të plotë shpatullën, kornizën mbi të dhe fillimet e harkut, të mprehtë, si dhe pjesën mbi të në gjithë lartësinë e murit. Në anën veriore shpatulla ruhet në një lartësi të vogël dhe mbi të vazhdon muri i ri që mbyll kalimin për në ambientin e altarit.

Muratura e vjetër është ndërtuar me gurë të skuadruar lidhur me llaç gëlqere; me fuga të holla

39) **A. Alb,** 68, M. Šufflay, **Die Kirchenzustande,** 201-202.
40) **A. Alb.,** I, 646.
41) **A. Alb,** 509.
42) **A. Alb,** 735.
43) I. Zamputi, **Regjistri i kadastrës dhe koncesioneve për rrethin e Shkodrës,** 1416--1417, Tiranë, 1977, 1296, 6 ab, 3a, 2a, 6éb, 18a, 5ab, 6a?
44) D. Boskoviç, **Stari Bar,** Beograd 1962, 251.
45) M. Barleti, **Rrethimi i Shkodrës,** Tiranë; 1967, 52-72.
46) H. Hecquard, **Histoire et description de la** Haute Albanie ou Guegarie Paris, 22.
47) Po aty, 19, A. Degrand, **Souvenirs de la Haute Albanie** Paris 1901; 79.
48) Njoftimet e para për të i kemi Th. Ippen, **Skutari und die Norda lbanische kunstenebene,** Sarajevo, 1907, 20 ku jepet dhe një foto nga verilindja A. Degrand, **Vep. cit,** 78.
49) Në pamjen e sotme muret e ambientit të altarit i takojnë pjesërisht një restaurimi paraprak. V. Kamsi. **Kështjella e Shkodrës dhe restaurimi i saj,** Monumentet, 1, 1971, 168, Foto 4-5.

dhe në rreshta horizontalë, duke patur në brendësi një bërthamë gurësh të çrregullt ç'ka ka prurë shpesh herë rrëzimin e faqeve dhe meremetimin e tyre. Veçanti tjetër e gurëve është se ata janë më të gjatë se të lartë.

Muri verior i kishës, i ndërtuar me këtë teknikë, në anën e brendshme i takon i tëri ndërtimit të vjetër ndërsa në anën e jashtme pjesa që ruhet në lartësi më të vogël është rindërtuar me gurë të vegjël. Ky mur ruhet në gjithë lartësinë vetëm pranë ambientit të altarit. Pjesa tjetër është pjesërisht e rrënuar. Në këndin perëndimor, është një portë e murosur e mbuluar me hark të ulët prej tre gurësh të skuadruar. Nga muri verior ruhet një sipërfaqe e vogël muri me veshjen e jashtme me gurë të skuadruar të rrëzuar duke lënë në dukje bërthamën e murit që duket se mbushej pas ngritjes të rreshtave të faqeve.

Muri perëndimor i kishës është i ndërtuar me dy teknika që i takojnë dy fazave ndërtimore, pjesa e poshtme është ndërtuar me teknikën e vjetër ndërsa, pjesa e sipërme me gurë të vegjël e të çrregullt lidhur me llaç gëlqereje. Në fugën horizontale ndërmjet tyre, ruhen një sërë gjurmësh që të shtyjnë të mendosh për ndonjë dysheme ballkoni-mafil të ndërtuar në këtë anë, në një kohë ose më vonë se kthimi i kishës në xhami. Në anën e jashtme ky mur është i ndërtuar me gurë të skuadruar. Në qoshen jugore ka një pjesë që duket se është meremetuar kur është ndërtuar hajati sepse ka gurët të punuar me të njëjtën teknikë. Gjithashtu ky mur ka disa pjesë të vogla të restauruara.

Muri jugor i naosit, i cili ndan naosin nga hajati, ka dy duar ndërtimi. Nga faza e parë është pjesa në lindje, por jo në tërë lartësinë, pjesët nën dritare, qoshja jugperëndimore pranë portës për në kishë. Me sa duket kur është shtuar hajati, një sërë ndryshimesh i janë bërë këtij muri, mundet ndërkohë edhe të rrënuar. Të fazës së dytë janë porta për në kishë, tre dritaret me muret anash tyre e mbi to, deri në lartësinë e plotë. Mbi arkitra ka një hark shkarkues e dekorativ të ulët e të mprehtë, ndërtuar prej dy gurësh të zbukuruar në anë me një gërshet. Mbi to ka një rresht tullash për së gjati. Portali i gjërë sa arkitrau dhe i lartë pak mbi harkun rrethohet nga një gur i profiluar. Fusha është e ndërtuar me gurë të skuadruar e të puthitur mirë, që kanë anash një buzinë të gdhendur rrafshët. Portali është një element i trajtuar me kujdes dhe dëshmon për mjeshtrinë e ndërtuesve të fazës së dytë të kishës. Ai është marrë për model për portalet e hyrjes së parë dhe të dytë të kalasë, rindërtuar me marrjen e saj nga turqit, ku nuk mungojnë elementë të arkitekturës islamike[50].

Që të tre dritaret janë të mbuluara me hark të ulët prej gurësh të skuadruar. Muri anash tyre dhe mbi to, që i takon fazës së dytë të ndërtimit, është me gurë të vegjël në anën e brendshme dhe me gurë të skuadruar të ripërdorur në anën e jashtme lidhur me llaç të dobët dhe me fuga të trasha. Ky dallim tregon që muri në anën e brendshme, ose ka qenë i suvatuar ose i takon një meremetimi. Në anën e jashtme të këtij muri janë vrimat ku vendosen trarët e çatisë së hajatit.

Ambienti i altarit është me planimetri drejtëkëndëshe që takohet shumë rrallë në vendin tonë. Ai është i rrënuar dhe i mbushur deri në një farë lartësie me mbeturina ndërtimi, mbi të cilat ngrihet vetëm muri jugor. Ky mur ruan gjurma të rëndësishme për të njohur formën e dikurshme të këtij ambienti. Kështu në shpatullën jugore të pjesës që e lidh me naosin ruhet guri i parë i harkut të mprehtë që mbulonte këtë kalim. Në anën e brendshme të tij ruhet brinja e qemerit të kryqëzuar që mbulonte ambientin e altarit. Kjo brinjë del mbi një gur të profiluar të dalë konsol ndaj murit. Muri jugor ruhet sipas konfiguracionit të qemerit të mprehtë që mbështetej mbi të. Në të ruhet e dëmtuar një dritare e lartë, karakteristike për ndërtimet e arkitekturës romaniko-gotike të bregut lindor të Adriatikut. Një dritare të ngjashme me të kemi të plotë në kishën e Shirgjit. Mjaft elemente të saj ruhen në formë gjurmash në llaçin e muraturës së minares që i bashkëngjitet. Dritarja është me shpatulla të pjerrta në të dy anët, me një pjesë të drejtë në mes dhe mbulohet me hark të mprehtë.

Hajati, fugat e të cilit në takimin e tij me muret e kishës janë të qarta, dikur ka qenë i hapur në anën jugore. Në këtë anë ndodhet dhe hyrja për në të, mbuluar me hark si dhe tre hapësira të tjera sot të murosura në një kohë të papërcaktuar. Hajati është ndërtuar me gurë të skuadruar, të gdhendur pastër me një buzinë rreth 4 cm në anët, e njëjtë me atë të gurëve të portalit, shenjë e njëkohshmërisë së tyre.

Harkada e hajatit është ndërtuar me pilastra prej gurësh të skuadruar. Mbi to ka nga një gur të profiluar që del në rolin e kornizës, në të cilën ngri-

50) Ky portal i shtuar në muret e një rindërtimi të periudhës veneciane është marrë si i kësaj kohe. V. Kamsi, **Vep. cit.** 166. GJ. Karaiskaj, **5000 fortifikime në Shqipëri,** Tiranë, 1981, 152-154, Por ky zbukurim me harqe në formë lundre flet qartë për një rindërtim të bërë pas pushtimit turk.

Botim OBOD

hen harqet. Të katër harqet janë ndërtuar me të njëjtën mënyrë me gurë të skuadruar pak më brenda se faqja e murit mbi të. Ky mur përfundon horizontalisht dhe është ndërtuar me gurë të skuadruar të puthitur mjaft mirë me njëri tjetrin. Muri jugor i hajatit ka një shmangie nga vija e drejtë në pjesën nga lindja e cila nuk është ndërtuar me teknikë aq të rregullt sa pjesët e tjera.

Muri lindor i hajatit është ndërtuar me gurë jo shumë të skuadruar të vendosur në rreshta me tendencë horizontaliteti. Muri perëndimor, i cili në anën e jashtme është me këtë teknikë, në anën e brendshme nëpërmjet një fuge vertikale ndahet në dy pjesë. Pjesa nga jugu, e lidhur me arkadën dhe më e ngushta, është e ndërtuar me të njëjtën teknikë, pra i takon pjesës së vjetër. Pjesa nga veriu e ndërtuar me gurë të vegjël e të çrregullt është një meremetim i vonë i faqes së brendshme të murit ku janë dhe dy kamare.

Në këndin e formuar nga faqja jugore e absidës me planimetri drejtëkëndëshe dhe muri lindor i kishës, është ngritur minarja, e cila ruhet në tërë lartësinë. Ndërtimi i saj mjaft masiv do lidhur me kthimin e kishës në xhami. Bazamenti i minares katror në plan, është ndërtuar me gurë të skuadruar. Trupi tetëfaqesh i minares është ndërtuar me breza tullash e gurësh të skuadruar që këmbehen me njëri tjetrin. Kalimi nga bazamenti për tek trupi i minares bëhet me pjesë trekëndëshe. Në minare hyhet nga ana jugore nëpërmjet një porte mbuluar me arkitra guri dhe një hark shkarkues mbi të. Shkallët helikoidale të minares janë me gurë në pjesën e poshtme dhe tulla në pjesën e sipërme të minares.

Nga ky shqyrtim i monumentit në gjendjen e sotme rezulton se ai i takon tre fazave kryesore të ndërtimit. Ndërtimit të parë i takon salla me ambientin e altarit. Fazës së dytë i takon hajati dhe rindërtimi i murit jugor të kishës. Faza e tretë është kthimi i kishës në faltore të kultit mysliman. Sigurisht që krahas këtyre kemi dhe meremetime të ndryshme të mureve, rezultat i rrëzimit të veshjeve apo dhe rindërtime të çative siç është rasti i vitit 1403. Ndërtimi i thjeshtë planimetrik e vëllimor i kishës[51], muret e rrafshta, mbulesa mbi çati e naosit dhe me qemere të kryqëzuar i ambientit të altarit, që ka dhe të vetmen dritare, na shtyjnë të mendojmë për ndërtimin e kishës nën influencat e arkitekturës së urdhërit domenikan dhe françeskan[52]. Krahas kësaj, duke u nisur dhe nga teknika e ndërtimit me gurë të skuadruar, si periudhë e mundshme ndërtimi për fazën e parë duhet të jetë fundi i shek. XIII fillimi i shek. XIV. Faza e dytë e ndërtimit duhet ti takojë këtij shekulli. Për këtë flet forma e dritareve mbuluar me hark të ulët[53]; përpunimi me zbukurim në formë gërsheti i portës për në kishë.

Në pikpamje të arkitekturës katedralja e Shën Stefanit paraqitet me të gjitha karakteristikat e shkollës së veriut, që i takojnë arkitekturës romaniko-gotike. Ajo shquhet për ndërtim rigoroz e të pastër të muraturës së faqeve të jashtme, për vëllimin unik të brendësisë, për hedhjen vertikale si të naosit ashtu dhe të ambientit të altarit, për qemeret e brinjëzuar e harqet e mprehtë, për arkadat e hajatit.

Kisha e manastirit të Shën Sergjit e Bakut në Shirgj të Bunës – Shkodër.

Nga manastiri i dikurshëm mjaft i rëndësishëm dhe i përmendur në dokumentacionin historik, sot ka mbetur vetëm një pjesë e murit jugor të kishës, që dhe pse i mangët flet qartë për madhështinë e dikurshme të monumentit, objekt i përshkrimeve të udhëtarëve si dhe studiuesëve të veçantë. Përmendjen më të vjetër për të e kemi në vitin 1166 kur shugurohet altari i shën Trifunit në Kotor[54]. Vetë emri i vjetër i martirëve Sirian nga Sergiopolis (Rusafa) ka bërë të supozohet që kisha është ndërtuar së pari në shek. VI, nën Justinianin[55]. Edhe pse mbahet si një nga manastiret më të vjetra benediktine të bregdetit Adria-

51) Ndërtime të përafërta me të janë kisha e Shën Nikollës, (më vonë e Shën Markut) në Tivar, D. Boskoviç **Vep. cit,** 103, e datuar në gjysmën e dytë të shekullit XIII. Kisha e manastirit të Rotecit e datuar në shek. XIV. **Po aty,** 180, ashtu edhe kisha në Shas, Th. Ippen, **Stare crkvene Rusevinne u Albaniji,** G.M.B.H. XI, 1899, 18-20, Th. Ippen, **Jos nesto a starium crkvam u Sasu i Rubigu, G.M.B.H.,** X? 1902, 554, Fig. 8. Të tëra këto

52) B. K. Panagopoulos, **Cistersizn and mendicant monastiries in Medieval Greece,** kanë të përbashkët absidën kuadratike, teknikën e ndërtimit dhe ndërtimin e dritareve. Chicago – London; 1979, 64-65.

53) D. Boskoviç, **Stari Bar,** 101, (obj. 141) tab. LXI, LXII, a, D. Boskoviç – P. Mijoviç, M. Kovaçeviç, **Ulcin** I, Beograd 1981, 59, Tab. XXVII, 2-3.

54) **A. Alb,** I, 93, «Petro abbate sancto Sergii e Bachii».

55) K. Jireçek, **Das christliche element in der topografischen nomenklatur den Balkan» lander,** K. Akad. Wiss. B.D. CXXXV, Vien 1897, 51-53; M. Šufflay, **Kircshezustende;** 268, C. Mango; **The church of Saints Sergius and Bacchus at Costantinople and the alleged tradition of octogonal Palatine churches.** J.O.B.; 21, 1972, shën. 1.

DOKTORATURA

tik, dokumenti më i vjetër që e përmend si të tillë është i vitit 1405, kur abati Aleks i manastirit benediktin të Shën Sergjit e Bakut, transferohet si peshkop i Pultit[56].

Studimi më i plotë për të, ai i V. Koraçit[57], mendojmë se do të plotësohet më tej me të dhënat e përftuara nga studimi dhe vlerësimi në vend që iu bë në vitin 1980 mbetjeve të kësaj kishe, si dhe nga një sërë vërejtjesh e mendimesh të V. Kamsit[58].

Për vetë vlerën arkitektonike të kishës duke filluar nga shek. XVII një sërë udhëtarësh na flasin për të duke na e treguar në gjendjen konkrete, kështuqë sot është e mundur të përshkruajmë historinë e monumentit apo rrënimin e tij, në tre shekujt e fundit. Kështu së pari na flet për të Marin Bici në vitin 1614 si për ndërtesa të ngritura buzë lumit, shumë të madhërishme e të vjetra.[59] Peshkopi i Shkodrës D. Andreasi që e vizitoi atë në vitin 1623 na thotë «abacia e Sh. Sergjit ka kishën në këmbë e këmbanoren të rrënuar. Kisha është e bukur si ndërtesë, por si shpellë cubash»[60] d.m.th. e braktisur. Më tej për të na flet B. Orsini në vitin 1629, si një abaci katedrale[61]. Të dhëna të tjera për të na jep dhe P. Bogdani në vitin 1624 që shkruan se nga këmbanorja e saj shihej tërë fusha e Shkodrës.

Mbas këtij vështrimi të shkurtër të të dhënave të studimeve të deritanishme për monumentin, të shohim çka ruhet aty sot. Si kemi folur dhe më lart, me sa duket mbas një tërmeti të fortë të vitit 1949, u rrëzua dhe pjesa që ruhej e faqes perëndimore duke mbetur vetëm gjysma e murit jugor një pilastër e brendësisë të cilët me sistemimet pyjore të bëra përgjatë bregut të Bunës kanë shpëtuar përgjithmonë nga rreziku i marrjes nga lumi.

Muri jugor (pjesa që ruhet) është në këmbë në tërë lartësinë e dikurshme. Ai nëpërmjet tre pilastrave të ndërtuara prej gurësh të skuadruar e të gdhendur pastër në sipërfaqe ndahet në dy nike të mëdha të mbuluara me harqe të mprehtë prej gurësh të skuadruar[62]. Harqet ngrihen mbi pilastrat pas një kornize të profiluar prej guri të gdhendur.

Muratura ndërmjet harqeve është ndërtuar në teknikën e përzierë ku këmbehen një radhë gurësh me 4 radhë tullash. (26.5 x 13 x 4.5 cm). Me këtë teknikë ka qenë ndërtuar dhe muri perëndimor, siç shihet qartë në fotografinë e saj të dhënë nga Degrandi[63], ashtu edhe në pamjen e faqes perëndimore të dhënë nga Ippeni[64]. Në muraturë ruhen dhe vrimat e skeleve të vendosura në radhë horizontale çdo 1.20 m lartësi dhe 1.5 m larg njëra-tjetrës.

Pjesa ndërmjet harqeve është ndërtuar nga gjashtë radhë tullash e gurësh që këmbehen, ndërsa pjesa mbi harqet është ndërtuar vetëm me gurë (katër radhë). Mbi këtë brez është korniza prej gurësh të profiluar që përfundon muraturën. Në pjesën mbi kornizë ruhen ende tjegulla të çatisë të lidhura me llaç. Nëpërmjet një pastrimi të lehtë nxorëm në dukje xokolin që përbëhej nga dy radhë gurësh dhe katër radhë tullash.

Nga katër nike që ka pasur dikur faqja jugore ruhen të plota vetëm dy. Nga nikja e tretë ruhet vetëm një pjesë fare e vogël e murit dhe shpatulla e një porte. Kjo portë, hyrja jugore për në kishë, ka qenë mbuluar me hark të ulët nga i cili ruhen vetëm gjurmët në muraturë. Nikja e parë nga perëndimi ka një dritare mjaft të bukur, të lartë e të ruajtur tërësisht. Kjo dritare karakteristike për arkitekturën romanike gotike të bregdetit adriatik, është mbuluar me hark të mprehtë dhe me shpatulla të pjerrta si në anën e brendshme ashtu dhe në atë të jashtmen, duke pasur një pjesë të drejtë ndërmjet tyre si në Shën Stefanin e Shkodrës. Mbulesa me hark e dritares është ndërtuar me gur të gdhendur pastër me fuga sipas rrezeve. Shpatullat e dritareve janë ndërtuar me gurë e tulla në pjesën e pjerrët e me gurë të profiluar me dhëmbëza në faqen e jashtme. Të tillë gurë janë gjetur rastësisht dhe në qytetin e Shkodrës[65]. Në brendësi të kishës ruhet sot vetëm një

DO NOT COPY

56) **A. Alb,** II, A, 96.

57) V. Koraç, **Sv. Sergiji (Srç) i Vakh na Bojani,** Starinar, n, s, XII, Beograd 1961, 35-44, me bibliografinë e plotë për këtë monument.

58) V. Kamsi, **Një kishë e stilit romaniko-gotik në Shqipërinë e Veriut, kisha e Shirgjit,** (Kumtesë, sesioni IV, i I.M.K. Tiranë, 1980).

59) **Relacione,** 3, 1, Rel. 3. 259.

60) **Po aty,** Rel. 38, 395.

61) **Po aty,** Rel. 13, 321.

62) Deri sot nga studiuesit e mëparshëm është konsideruar se këto harqe janë gjysëm rrethor. Por, diametri i tyre rezultoi të jetë 4.96m ndërsa lartësia 2,85m përkundrejt rezes që ishte 2.48 m. Me sa duket ai është marrë si gjysëm rrethor, për shkak të mprehtësisë së pakët të harkut.

63) D. Degrand, **Vep. cit,** 95, këtë riprodhon Koraç, Fig. 3.

64) Th. Ippen, **Vep. cit,** Fig. 4; shih Koraç, Fig. 5.

65) V. Kamsi, **Vep. cit,** Të tilla dritare kemi në Ulqin, G. Boskoviç – P. Mijoviç, **Vep. cit,** Tab. XXI, 3 (obj. 42) që i takojnë pjesës së vjetër të ndërtesës (f. 46).

pilastër. Pilastri është me prerje drejtkëndëshe (1.19 x x 0.92 m) i ndërtuar me gurë të skuadruar. Në pjesën e sipërme ai ka në të katër anët një kornizë të lehtë mbi të cilën kemi një ngushtim të tij si tek pilastrat në mure.

Faqja e brendshme e muraturës ka edhe ajo pilastrat dhe niket e mëdha ndërtuar në mënyrë të njëjtë me anën e jashtme (i vetmi dallim janë pesë radhë me gurë në vend të katër rradhëve mbi harqet e mëdha. Muri përfundon me faqe vertikale, ndërsa pilastri në mur në atë nivel ruan thembrat e harkut që përfundonte në pilastrin e lirë. Përsa i përket faqes perëndimore me gjithë gjurmët e pakta kuptohet që nuk kishte harqe në brendësi, siç jepet në rikonstruksionet e planimetrisë së kishës.

Nga muri perëndimor i kishës ruhet pilastri i këndit jugor dhe rreth 1 m nga muratura. Formën e dikurshme të kësaj faqeje e kemi të dokumentuar nga fotografitë e Ippenit[66] në pamje ballore dhe në atë të Degrandit në pamjen jugperëndimore[67]. Në to shihet qartë se muri përfundonte me fronton duke pasur katër pilastra, nga të cilat 2 në këndet. Dy niket anësore ishin mbuluar me hark të mprehtë dhe pjesa ndërmjet dy pilastrave qëndronte e rrafshët deri në kornizën që mbyllte murin. Në pjesën e poshtme ishte porta kryesore për në kishë ndërsa në pjesën e sipërme një dritare dyshe me hark të mprehtë për secilën pjesë. Shpatullat dhe harqet e dritareve kanë qenë ndërtuar me gurë të skuadruar. Në anën jugore të frontonit ishte këmbanorja, muratura e faqes perëndimore është me radhë gurësh e tullash që këmbehen pilastrat, harqet që mbulojnë niket dhe pjesa mbi to janë ndërtuar me gurë. Duke parë këtë veçori në fotografitë e njohura jemi të mendimit që kemi të bëjmë me të njëjtën fazë ndërtimore sepse muratura e të dy faqeve është po ajo-pilastra me gurë të skuadruar e nike me gurë e tulla. Në këtë rast nuk jemi dakort me V. Koraç i cili vëren dy faza[68]. Për të pilastrat dhe harqet mbi to, dritaret e fasadës, perëndimore dhe pjesë të portalit janë të fazës së parë. Me këtë problem lidhen dhe interpretimet e dy mbishkrimeve të njohura, përsa i përket datimit të kishës, për çka do të ndalemi më poshtë.

Për arkitekturën e kishës e ndërtimin e saj vëllimor, ashtu si studiuesit përpara nesh, mbetet të mbështetemi tek botimet e mëparshme. Nga to mësojmë se kisha ishte një ndërtesë 3 nefshe e ndarë nga dy radhë me tre pilastra secila dhe me 3 absida në anën lindore, (njëra nga to ruhej kur vizitoi kishën Ippen)[69]. Na duket i drejtë rikonstruktimi që i bën kishës Koraç, mbështetur tek Deroko se ndërtesa mbulohej me çati druri dy ujëse ndërsa nga pilastrat në mure në ato të brendësisë kalonte një rrjet tërthor harqesh mbajtës të kësaj strukture të drunjtë.

Duke u nisur nga gjurmët në anën perëndimore të kishës që shihen qartë tek fotot e Degrandit kuptohet që përpara saj ka pasur një portik të hapur. Nga sondazhi në këndin jugperëndimor të kishës vumë re se ruhej pjesa e xokolit për këtë portal. Mundet që këtij i takonin dhe kolonat që gjendeshin pranë kishës.

Në këtë ndërtim vëllimor të kishës shihet qartë lidhja me kishat benediktine të Italisë së Jugut për nga vinin influencat perëndimore në vendin tonë gjatë shek. XII-XV[70]. Për vetë shkallën e ruajtjes së rrënojave të kishës ku mungon hyrja kryesore për në kishë në të cilën ishin dy mbishkrimet e njohura, problemi i datimit paraqitet i vështirë. Ne pajtohemi me botimin e tyre nga Koraç[71] të cilat i kemi krahasuar me gurët origjinalë që ruhen[72]. Kështu kemi mbishkrimin e Helenës për ndërtimin tërësor të kishës që përfundoi në vitin 1290 si dhe atë të Milutinit që e ndërtoi kishën nga themelet në vitin 1318. Koraç mendon se kemi të bëjmë me dy faza ndërtimi jo të largëta në kohë nga njëra tjetra dhe që i takojnë të njëjtës epokë[73], të cilat duhet të lidhen me të dy mbishkrimet, duke e kuptuar mbishkrimin e dytë jo për një ndërtim tërësor të kishës, nga themelet (gjë që vërehet dhe në Staronagoricino po me Milutinin).

Edhe qëndrimi ynë është i prerë, por ndryshe nga Koraç, ne jemi të mendimit se ndërtesa i takon një dore ndërtimore, në periudhën e ndërtimeve romaniko-gotike të bregdetit Dalmatin dhe të Shqipërisë veriore. Për këtë na shtyn studimi i mbetjeve të monumentit dhe dokumentacioni fotografik i vjetër, çka shpjeguam më lart. Arkitrau më datën 1318 për ne

66) Th. Ippen, **Vep. cit,** Fig. 4, Të cilën e rijep Koraç — Fig. 5.
67) A. Degrand, **Vep. cit,** 95, Koraç, Fig. 3.
68) V. Koraç, **Vep. cit.** 42,
69) Th. Ippen, **1900** Fig. 15, në të cilën jepet planimetria e kishës.
70) V. Koraç, **Vep. cit,** 42, S. Bettini, **Testimonianze di civilta e d'Arte in Albania,** Venezia 1939, 19, 24.
71) V. Koraç, **Vep. cit,** 41.
72) Mbishkrimi i Helenës ruhet në Muzeun Historik Kombëtar, ai i Milutinit në Muzeun Arkeologjik, të Tiranës.
73) V. Koraç, **Vep. cit,** 42.

DO NOT COPY

është në vendin e tij ndërsa për një rindërtim të vonë të portës duke vënë aty edhe mbishkrimin e Helenës nuk jemi të bindur. Për ne mundësitë janë këto: ose kisha i takon vitit 1318 dhe në këtë rast janë përfshirë në ndërtimin e saj vetëm porta e vjetër me shpatullat, ose kisha është ndërtuar e tillë në vitin 1290 dhe Milutini ka vënë mbishkrimin e tij në arkitraun e dytë ndërkohë bosh. Sidoqoftë ndërtesa i takon ndërtimeve të fundit të shek. XIII fillimit të shek. XIV, ndërtuar nga një atelje vendase, nga e cila njohim me mbishkrimin e dytë Petro Doknen nga Shkodra, një arkitekt i nderuar, saqë emri i tij vihej krahas një mbreti të tillë si Milutini.

DRISHTI

Në qytetin e dikurshëm të Drishtit **Drivastum-in** e burimeve historike njihen në dokumentacion këto kisha: Katedralja e Shën Mërisë (1353), Sancta Maria Vetus (1403), Shelbuemi (1399), shën Gjergji (1400), Shën e Premtja (1400) dhe shën Françesku (1404)[74]. Në dokumentat përmendet gjithashtu dhe shtëpia e Peshkopit (1251)[75], e cila parakupton një tërësi me katedralen, pavarësisht se me përmendjen e parë të sigurtë të peshkopatës së Drishtit, që i takon sundimit të perandorit Jan Cimiskes 969-976[76] duhet të fillojnë dhe ndërtimet kishtare të qytetit. Në Drisht gjetëm dy rrënoja: kapelën trekonshe në kala dhe një kishë një nefshe në rrugën që të ngjit për në kala.

Kisha Trekonshe.

Kjo kishë për të cilën së pari na flet Ippen[77] ngrihet e veçuar në një shpat shkëmbor në brendësi të kalasë, pranë mureve rrethues të anës lindore. Ajo paraqet një kapele muret e së cilës ruhen me një lartësi 1.5-2 m. Muratura është ndërtuar me gurë gëlqerorë të papunuar të vendosur në rreshta me tendencë horizontaliteti lidhur me llaç gëlqereje me rërë të imët me fuga të holla në anën e jashtme. Në brendësi mbushja e mureve është me gurë të thyer të vegjël. Muret janë ngritur drejtpërsëdrejti mbi tabanin shkëmbor. Në plan kisha paraqet një ambient drejtëkëndësh më të gjatë në drejtimin lindje-perëndim, me tre absida të njëjta në anët lindore, veriore e jugore. Nga to vetëm lindorja ka një dritare të ngushtë mbuluar dikur me hark prej të cilit ruhen thembrat. Planimetria jonë ka disa ndryshime nga ajo e Ippenit, se nuk paraqet murin perëndimor, të cilit sot i duket qartë forma edhe pse është rrënuar faqja e jashtme në pjesën e sipërme. Gjithashtu përfundojmë në mënyrë të rregullt dhe këndet e fillimit të absidave që nuk janë të prera 45° siç i jep Ippen. Në anën lindore kemi dy nike rrethore të vendosura në qoshet e murit lindor dhe një kamare në atë jugor.

Muret e tre absidave nuk ruhen aq sa të shihen fillimet e konkeve dhe po për të njëjtën arsye nuk mund të përcaktojmë mbulesën e dikurshme të kishës, në se është me kupole apo me çati druri. Jemi për këtë të fundit duke u nisur nga mungesa e rrëzimeve të shumta në brendësi të kishës.

Përsa i përket kohës së ndërtimit të kishës duke u nisur nga planimetria, teknika e ndërtimit të mureve mendojmë se ajo i takon shek. XI-XII.

Kisha një nefshe jashtë mureve.

Është buzë rrugës që të ngjit për në kala me mure pak të ruajtura. Paraqet një kishë me planimetri drejtëkëndëshe të zgjatur me absidë gjysëm rrethore në anën lindore me një dritare të ngushtë për ndriçim. Nga muri jugor ruhen vetëm xokoli dhe një rresht gurësh ndërsa nga muret e tjera kemi trakte me lartësi që shkojnë deri 1-1.5 m. Ato janë ndërtuar me grup të papunuar mesatar dhe të mëdhenj të lidhur me llaç gëlqeror me rër të ashpër e gurë të vegjël në pjesën e brendshme të murit. Duke qenë se kisha është ndërtuar në terren të pjerrët, muri verior për pjesën që ruhet është në rolin e murit mbajtës. Në kishë hyet nga porta në anën perëndimore, të cilës i ruhen vetëm shpatullat.

Ndërtimi i rëndomtë i kishës e bën të vështirë vendosjen e saj në kohë. Nga teknika e çrregullt e ndërtimit mendojmë se ajo i takon periudhës së parë së historisë të qytetit shekujve XI-XII.

Kisha e Shën Gjinit në Rashkullë të Shkodrës

Rënojat e manastirit të Shën Gjinit pranë fshatit Rrashkullë në fushën e Shtoit përbëhen nga pjesë të murit rrethues, që përfshijnë një sipërfaqe prej gati 1 ha, rrënojat e kishës dhe këmbanorja.

Përmendja më e hershme e kësaj kishe në dokumentacionin historik i takon vitit 1166, kur flitet për abatin e manastirit të Shën Gjinit (San Giobani in

74) **A. Alb,** II, respektivisht 99, 252, 615, 656, 745, 728, 615, 656, 745, 656, 728.
75) **A. Alb,** I, 203, 204.
76) **Po aty,** IV.
77) Th. Ippen, 190, fig. 19-20.

DO NOT COPY

Strilaleo)[78]. Më vonë në vitin 1356 në një letër nga Avinjoni që papa i dërgon peshkopit të Ballecit përmendet si manastir benediktin nën vartësi të diocezes së Drishtit të cilin e prishën ortodoksit.[79] Në vartësi po të Drishtit përmendet në vitin 1376 dhe në vitin 1403[80].

Mbi këtë monument na flasin fillimisht Marin Bolica në vitin 1614)[81] dhe më vonë Benedikt Orsini në vitin 1628[82]. Sipas tij, kisha e bukur dhe e punuar me mjeshtri është djegur nga turqit. Ai flet gjithashtu për këmbanoren e punuar me mermer llojesh të ndryshme e me shtylla trupore. Ajo çka paraqet me shumë rëndësi është e dhëna e tij për një mbishkrim latinisht, që ai pa në arkitraun prej mermeri të bardhë të portës së kishës.

Nga muri rrethues i manastirit ruhen pjesë në të gjitha anët ndërsa nga ndërtesat e dikurshme ka vetëm gjurmë në anën juglindore, në të cilën mendojmë se pamë dhe hyrjen e dikurshme për në manastir.

Kisha është me planimetri drejtëkëndëshe pak a shumë të zgjatur. Rrënojat e saj janë të mbuluara nga gurët e mureve të rrëzuara, dhe kështu mezi dallohen konturet e mureve. Në fillim të shekullit tonë ruheshin ende deri në njëfarë lartësie këndet veriperëndimore e jugperëndimore[83]. Pjesa që sot ruhet më mirë i takon mesit të murit lindor. Në gjendjen e rrënojave arritëm të dallojmë në se kisha ka pasur nartekse dikur apo jo. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë të papunuar të lidhur me llaç gëlqereje me rërë të ashpër. Në ndonjë vend gurët janë vendosur me tendencë horizontaliteti të radhëve duke pasur dhe copra tullash e tjegullash. Në kishë hyej nga porta në anën perëndimore, nga e cila ruhet në një lartësi të vogël shpatulla jugore. Në anën lindore ruhet absida që është gjysëm rrethore si në anën e brendshme ashtu edhe në të jashtmen. Në të tilla rrethana të gjetjes së monumentit e shohim të vështirë datimin e kishës pa gërmime arkeologjike. Duke u nisur nga dokumentacioni historik duhet të jetë e shekujve XI-XII.

Pranë këndit veriperëndimor të kishës ngrihet këmbanorja e lartë, e cila për nga teknika e mureve me gurë të punuar e të skuadruar ngjan me muret e fazës së parë në katedralen e Shën Stefanit në kalanë e Shkodrës. Këmbanorja është katrore në plan, me hyrjen në anën jugore të mbuluar për gjysëm nga materialet e rrënuara. Ajo siç tregojnë gjurmët e ruajtura të muraturës dikur mbulohej me hark të mprehtë. Kati i parë i këmbanores mbulohej me qemer cilindrik me prerje harku të mprehtë me formuese veri-jug. Nga ky qemer ruhen thembrat në murin lindor dhe perëndimor dhe gjurmët në muret verior dhe jugor. Mbi nivelin e qemerit muri ngushtohet në anën e brendshme. Në këtë lartësi në anën e jashtme të tij ka një kornizë gurësh gëlqeror të profiluar. Ky kat i poshtëm ndriçohet nga dritare të ngushta.

Më lart, muret ruhen të fragmentuara dhe duket se në katet e tjera, me shumë gjasë dy, këmbanarja ka pasur dritare apo hapësira me shtylla në mes. Në brendësi muratura ruan vrimat e skelave, dhe atje ku faqet janë rrëzuar shihet teknika e ndërtimit me dy perde gurësh të rregullt dhe një bërthamë qendrore të ndërtuar me gurë të vegjël.

Këmbanorja e kishës së Shën Gjinit ka përbërë një element me vlerë për siluetën e hijshme vertikale dhe ndërtimin e rregullt. Me të dhënat që ofron teknika e ndërtimit jemi për datimin e këmbanores si të fundit të shek. XIII. Në të mirë të saj është dhe gojëdhana që ia atribon ndërtimin e këmbanores mbretëreshës Helena të Rashës.[84]

Vau i Dejës (Shkodër) Kisha e Shën Mërisë[85]

Kjo kishë është ndërtuar në këmbë të malit të Dejës ku ndodhen rrënojat e qytezës dhe fortesës mesjetare të Danjës, që për herë të parë përmendet si qendër peshkopale në vitin 361.[86]

78) **A. Alb,** I, 93.
79) **A. Alb,** II, 119.
80) Po aty, 329, 728.
81) **Relacione,** 3/II, 261.
82) **Po aty,** 385.
83) Th. Ippen, **Stare crkveen rusevine u Albaniji G.M.B.H. XII, 1900,** 1 Fig. 14. Në të krahas të dhënave historike e një paraqitje të monumentit, autori gjithashtu shprehet se kisha ishte e katolikëve. Për këtë kisha shih. A. Degrand, **Vep. Cit,** 83, H. Hecquard, **Vep. cit,** 153-154, F. Cordignano, **Vep. cit,** 1929, V, III, 17-18, M. Shuflay, **Serbët dhe Shqiptarët.** Prishtinë 1968, 187, M. Sufflay, **Die kirchenzustahde....** 270.
84) F. Cordignano, **Vep. cit,** 1929, V, IV, 513.
85) Kisha del për herë të parë në vitin 1348 në diplomën e Stefan Dushanit dhënë manastirit të Shën Arkangjelit; **A. Alb** II, 46.
86) Përmendjen e parë të Danjës në dokumentacionin historik e kemi në vitin 1189 shih. **A. Alb,** I, 133. Ndërsa si qendër peshkopale duhet të jetë përpara vitit 1361, kur përmendet për herë të parë si e tillë **A. Alb.** II, 165, 28 octobris 1361. M. Sufflay, **Die kirchenzustande...** 216.

PO KOPJE COPY

Kisha e Shën Mërisë së Vaut të Dejës paraqet një kishë në nefshe me planimetri drejtëkëndëshe dhe absidë rrethore në anën lindore.[87] Në kishë hyet nga porta e vetme e saj e vendosur në anën perëndimore. Brendësia paraqet një vëllim mbuluar me qemer cilindrik me prerje harqesh të mprehtë, që mbështetet me një sistem harqesh mbajtës, harqesh të verbër dhe pilastrash. Nga tre pilastra janë në secilën prej mureve gjatësorë. Mbi këta përgjatë mureve tërthorë të kishës kalojnë harqe gjysëm rrethorë të verbër dhe në nivel më të lartë harqe mbajtës të mprehtë, që shërbenin për brinjë qëndrueshmërie. Me ritmin e tyre kjo tërësi pilastrash dhe harqesh përcaktonte dhe organizimin hapsiror të brendësisë së kishës.

Brendësia ndriçohet nga gjashtë dritare. Prej tyre nga dy kanë muret verior dhe jugor, njëra është në absidë dhe tjetra një dritare rrethore në frontonin e murit perëndimor.

Në anën e jashtme kisha paraqitet me një vëllim mjaft kompakt e simetrik dhe mbulohet me çati dyujse me tjegulla vendi. Muret verior dhe jugor kanë dy pilastra në qoshet dhe një në mes. Mbi ta mbas një kornize prej guri të profiluar ngrihen harqe të verbër. Në përputhje me trajtimin e përgjithshëm romaniko-gotik të kishës, kemi të bëjmë me harqe të mprehtë prej gurësh të skuadruar pastër. Në niket e mëdha e të rrafshta të formuara në këtë mënyrë, janë dritaret e përmendura më sipër të ndërtuara dhe ato me hark të mprehtë. E vetmja që ruhej plotësisht nga ndërtimi i parë, ishte dritarja nga lindja e faqes jugore.[88] Ajo ishte e ndërtuar me mermer të bardhë dhe përbën një dëshmi me vlerë për zbukurimet e përdorura në kishë dhe shijen arkitekturore të ndërtuesve të saj. Pragu i saj njëcopësh zbukurohej me një shirit trekëndëshash në pjesën e sipërme dhe me motive bimore të stilizuara në pjesën e poshtme. Me të njëjtën mënyrë janë zbukuruar si shpatullat ashtu edhe dy gurët e harkuar të mbulesës. Gdhendja e tyre vjen duke u shkallëzuar nga sipërfaqia e murit në brendësi të saj. Të dy faqet e mureve jugor dhe verior mbaronin me një kornizë horizontale gurësh të profiluar lehtë. Nën kornizën kemi një frizë harqesh të varur[89] (harqe lombarde) tipike për arkitekturën romanike, por që vijojnë të përdoren në zonat pranë si bregdeti dalmatin e prej andej në Kosovë, gjatë shekujve XIII-XIV.[90] Harqet mbështeteshin në gurë të gdhendur e të nxjerrë ndaj murit. E njëjta frizë dhe kornizë përfundon dhe zbukuron si frontonet e mureve perëndimor e lindor ashtu edhe absidën, duke i qarkuar ato pa u ndërprerë.

Muri perëndimor ishte trajtuar i rrafshët. Në qendër të tij ishte porta për në kishë mbuluar me arkitra guri i cili po të shihej me kujdes, nga ngjyrat e gurëve tregonte qartë që ishte rezultat i një rindërtimi për të cilin Dh. Dhamo mendon se duhet të jetë bërë në vitin 1862.[91] Porta tjetër dukej se përfundonte me hark të mprehtë brenda një trekëndëshi që me shumë gjasë i takonte portikut i cili dikur ishte përpara. Prej tij ruhej vetëm një shtyllë këndrejtë me kapitele të profiluara. Në frontonin e murit perëndimor, në nivelin e fillimit të çatisë së pjerrët ishte një dritare e rrumbullakët e tipit rozetë mjaft e dëmtuar dhe nuk ruante asgjë të vjetër në pjesën qendrore. Nën harkun e varur qendror të frontonit ndodhej një gur në të cilin ishte gdhendur një kryq rrethuar nga zbukurime me motive bimore.

Muret e kishës ishin ndërtuar me gurë gëlqerorë të gdhendur dhe të lidhur me llaç gëlqereje me fuga të holla në anën e jashtme, me një teknikë pra karakteristike për Shqipërinë e Veriut. Qemeri i kishës ishte ndërtuar me gurë çmërsi. Vetëm në murin perëndimor përdorej për zbulurim një gur me ngjyrë të kuqe, ndërsa në meremetimet e portës siç pamë është përdorur një gur me ngjyrë të çelët, i butë në përpunim. Kisha mbulohet me çati dyujse e tjegulla vendi, të lidhura me llaç gëlqereje për shkak të pjerrësisë së madhe të çatisë. Mënyra me të cilën qenë trajtuar muret është në përputhje me tërë arkitekturën e kishës.

Formulimi arkitektonik i anës së jashtme të kishës paraqitej interesant e me vlera. Ajo shquhej për ndërtimin kompakt dhe përpjestimet e goditura karakteristike për muret e rrafshta me dritaret të vogla, të cilave harkadat dhe sidomos harqet e varura u jepnin gjallëri e ritëm. Në të njëjtën kohë sidomos frizi me harqe lombardë jo vetëm që kurorëzonte mu-

87) Dh. Dhamo, **Kisha e Shën Mërisë në Vaun e Dejës,** Studime historike 3, 1964, 47-66.

88) Dh. Dhamo, **Vep. cit,** fig. 24.

89) **Po aty,** Foto 2. Në vendin tonë harqet e varura në formë të pastër i takojmë dhe në kishën e Kurjanit. A. Meksi. **Dy ndërtime trekonshe** Monumentet 7-8, 1974.

90) M. Vasiç, **Arkitektura i skulptura u Dalmaciji od pocetka IX, do poçetka XV vjeka,** Beograd 1922.

91) Dh. Dhamo, **Vep. cit,** 50-51. Ky rindërtim datohet nga mbishkrimi në një pllakë në niken mbi arkitraun. Në këtë kohë janë bërë dhe zëvendësime të disa harqeve të varur të fasadës kryesore, ndërtuar me gurë të verdhë. Gjithashtu bashkë me derën e re u ndërtua edhe hajati i cili shihet në fotografitë e fillimit të shekullit.

Botim

ret e kishës por edhe i njësonte ato që të perceptohej njëherësh e tëra dhe shikimi të lëvizte lirshëm në të. Tiparet dalluese të kishës janë karakteristike për arkitekturën romanike-gotike të vendit tonë. Të tilla elemente janë harqet e mprehtë, dritaret, muret e trasha me pilastra dhe punimi i tyre si dhe harqet e varur. Hapësira e brendshme e kishës ishte statike, ajo kapej njëherësh. Trajtimi me arkada i mureve dhe qemerit, absida në murin lindor, proporcionet vertikale bënin që brendësia të ishte po aq e arritur sa edhe ana e jashtme. Si në brendësi ashtu edhe në anën e jashtme nuk mund të lihet pa vërejtur fragmentimi i mureve në elemente më të vegjël e me hedhje vertikale që e bënin kishën jo vetëm të hijshme por edhe të duket më e madhe. Për kohën e datimit të saj, duke u nisur nga arkitektura. Dh. Dhamo mendon si cak të mundshëm fundin e shek. XIII[92] duke u bashkuar në këtë mënyrë me datimin e Ippen[93]. Në këtë mënyrë do të kishte mbështjetje gojëdhana që na jep Frang Bardhi, që e lidh ndërtimin e kishës me mbretëreshën Helena[94]. Në këtë rast është e kuptueshme që gojëdhana se kishën e ka ndërtuar Skënderbeu si kujtim për fitoret e tija ndaj venecianëve për kalanë e Danjës mbetet pa bazë reale veç rastit që i takon kishës së Shën Markut në Kala.[95] Duhet të bijem këtu edhe mendimet e S. Betinit që e ka quajtur këtë kishë më të re se ajo e Shirgjit.[96]

Kisha e shën Markut në Kala

Kisha e shën Markut ndodhet në majën e malit të Dejës buzë murit lindor rrethues të kalasë së Vaut të Dejës, qyteza e dikurshme e Danjës. Kisha përmendet së pari në dokumentacionin historik në vitin 1400[97]. Për të na njoftojnë udhëtarë të ndryshëm. Kështu Gjergj Bardhi duke folë për vizitën e tij të viteve 1631-32 na thotë se kisha është përtërirë tani shpejt dhe mbuluar nën kujdesin tonë.[98]

Monumenti ruhet me muret tërësisht në këmbë dhe pa çati. Ai paraqet në plan një drejtëkëndësh të zgjatur me absidën rrethore në anën lindore. Në kishë hyet nga dy dyer. Njëra në anën perëndimore mbuluar me arkitra prej gurësh sipas një harku të ulur dhe tjetra në anën lindore, një derë e vogël e mbuluar me hark gjysëm rrethor. Dyshemeja e kishës është shtruar me rrasa guri të formave të çrregullta. Ndërtesa u është nënshtruar disa rindërtimeve në kohë, të cilat në vija të përgjithshme mund të dallohen për nga ndryshimet në teknikën e ndërtimit. Muri lindor me absidën i takon ndërtimit të parë. Ai është ndërtuar me gurë të çrregullt lidhur me shumë llaç-gëlqeror e mbushës rëre të trashë, ku mbizotërojnë grimcat në ngjyrë të errët. Në fugat ka gurë të vegjël e copra tjegullash. Një fugë flet për një rindërtim që ka përfshirë murin verior të kishës dhe këtë pjesë të murit lindor. Ky mur është lidhur me llaç gëlqeror me rërë të imët ku mbizotëron ngjyra e bardhë. Vende-vende fugat mbulohen me llaç të ri ngjyrë gri të hapur.

Për sa na tregon teknika e ndërtimit, fazës së parë ndërtimore i përket dhe muri jugor i ndërtuar me të njëjtën mënyrë me gurë të papunuar, mesatarë e tek tuk e të mëdhenj lidhur me llaç gëlqeror të bollshëm me rërë të trashë dhe gurë të vegjël e copra tjegullash në fugat. Me gurë pak të punuar dhe të mëdhenj janë ndërtuar qoshet. Në pjesën më lindore të këtij muri është porta me hark të shkallëzuar gurësh dhe një shirit tullash mbi to. Duke gjykuar nga pjesa mbi harkun ndërtuar me gurë të vegjël dhe mënyra e punimit të gurëve të portës, priremi të mendojmë për një hapje të vonë të kësaj porte, ose rindërtim të saj.

Muri perëndimor i mbështetet shkëmbit, që është këtu deri në gjysmën e lartësisë së tij. Ai përfundon me fronton dhe ka gjurmë të dukshme të ngritjes së lartësisë së tij, dhe gjurmë suvatimi. Ai duket i ndërtuar njëkohësisht me muret lindor e jugor sepse në të shihen gurë të papunuar lidhur me llaç gëlqeror me gurë të vegjël e copra tjegullash në fuga. Ky mur në qoshet e të cilit kemi gurë të mëdhenj thuajse të skuadruar vijon për një farë lartësie dhe në anën veriore deri në një fugë të qartë në të djathtë të portës.

Përcaktimi i fazave të ndërtimit të murit verior paraqet një sërë vështirësish për shkak të ndërthurjeve të teknikave të ndryshme të ndërtimit. Qoshja nga lindja është e ndërtuar me gurë të mëdhenj pak a shumë të skuadruar. Në pjesën e poshtme të murit

92) Dh. Dhamo, **Vep. cit.** 53.
93) Th. Ippen, **Die gebirge des nordestxlichesn Albanien,** W. M. B. H. Sien 1908,, 71-72.
94) **Relacione;** 3/II Dok. 35.
95) A. Degrand, **Vep. cit,** 106-110.
96) S. Bettini, **Architettura bizantina,** Firenze 1936, 60-61.
97) **A.Alb,** II, 64, M. Sufflay, **Die Kirchenzusande. .,** 263.
98) **Relacione,** 3/1, 413, 293, **Relacione,** 3/1, 219/.

POVETQBK

më nga lindja kemi një zonë të ndërtuar me gurë të vegjël të çrregullt, me copra guri e tjegulla nëpër fugat. Mbi të kemi muraturë me gurë të skuadruar më të gjatë se të lartë, pak të puthitur me njëri tjetrin në faqen e jashtme, pra me fuga të pastra në ndonjerën prej të cilave përdoren dhe copra tullash. Trakti me këtë mënyrë ndërtimi shkon deri pranë portës. Porta dhe zona të vogla anash saj i takojnë një ndërthurje më të vonë. Ajo duket se rindërtohet me të njëjtin material me teknikë më të keqe d.m.th. me fuga të çrregullta. Shpatullat e portës përbëhen në secilën anë nga dy gurë të mëdhenj e të skuadruar, dy të sipërmit prej të cilëve kanë zbukurime në reliev. Porta mbulohet me hark të ulët, ndërtuar prej dy gurësh, mbi të cilët është një gurë horizontal i skuadruar që ka të gdhendur datën 1465. Këtë ne do ta quanim data e rindërtimit të portës sepse në të kundërt kjo datë nuk do të ishte në një gur të ri pa funksion struktural. Një mundësi tjetër është që edhe kjo datë të jetë e njëkohshme me portën e vjetër pra me teknikën me gurë të skuadruar. Në brendësi porta mbulohet me arkitra të rrafshët në të cilin shihen vrimat ku rrotulloheshin kanatat që mbërtheheshin ma ganxha në mur.

Me interes për ndërtimet e murit verior është dhe shikimi i anës së brendshme të tij. Muri i ndërtuar me gurë të skuadruar e ka anën e brendshme të së njëjtës dorë ndërtimore me pjesën e rindërtuar në qoshen verilindore, me gurë të çrregullt e llaç të imët në ngjyrë të bardhë. Kjo gjë na shtyn të mendojmë për rindërtim me gurë të skuadruar vetëm të faqes së jashtme të murit. Po kështu në brendësi vërejmë se arkitrau i portës dhe pjesa e murit mbi të janë të rindërtuara. Gjithashtu rindërtime vërehen dhe në muraturën me të cilën rrafshohen muret për rindërtimin e çatisë ashtu dhe ngritje të nivelit të frontonit në anën lindore.

Lidhur me datimin e kishës jemi të mendimit se ajo i takon shek. XIII-XIV për deri sa përmendet në fund të kësaj periudhe. Fundit të shek. XIV fillimit të shek. XV duhet ti takojë përdorimi i gurëve të skuadruar në faqen veriore, si rindërtim i anës jashtme të saj, rindërtimi i parë i së cilës duhet të jetë bërë ndërmjet dy të mësipërmeve. Me vitin 1465 duhet lidhur rindërtimi i portës kryesore. Siç tregon vetë monumenti ashtu edhe burimet, rindërtime të tjera më të vogla kanë prekur pjesët e sipërme të mureve dhe vetë çatinë.

Manastiri i Shën Sofisë së Gentës në Mazrek-Shkodër

Rrënojat e këtij manastiri të njohur nga dokumentacioni i shkruar[99] ndodhen në qendër të fshatit Mazrek ku njihen me emrin «Kisha e Shatit» në një truall me bimësi që përdoret sot si varreza e fshatit. Për to na kumton i pari Ippen[100] duke dalluar një kishë të madhe me këmbanore, një kapele dhe rrënojat e një ndërtese.

Në vendin më të lartë ruhet në gjendje të mirë një ndërtim në formë kulle, mundet këmbanorja, me planimetri katrore që lidhet me anën jugore me kishën me absidë drejtëkëndëshe. Nga gjendja e sotme e rrënojave mund të gjykohet për të si një ndërtesë dykatëshe me mure të trashë me gurë të papunuar në brendësi dhe me faqen e jashtme në dukje të ndërtuar me gurë të skuadruar e fuga të puthitura e gjurmët e brezave në brendësi. Në katin përdhes të saj janë tri hyrje, respektivisht në anën veriore. Dy të parat janë me shpatulla që zgjerohen në brendësi, ndërsa ajo lindore me paturë dhe me një prag në të cilin hipet me shkallë. Me interes në këtë portë të fundit janë një reliev në pjesën e poshtme të shpatullës së djathtë ku në një gur paraqitet një luan me pozën e vet tradicionale, me bishtin lart mbi trup por me kokë kali, si dhe një fragment guri ku kemi të gdhendur pjesë të një gërsheti me shirit të trefishtë të datueshëm në kufijtë e shek. IX-XI. Në arkitraun e portës ruhen dhe vrimat e boshtit të portës.

Kati i parë mbulohet me qemerë cilindrikë me prerje harku të mprehtë me formuese perëndim-lindje nga i cili ruhen thembrat në muret verior e jugor dhe gjurmët në muret verior e perëndimor. Qemeri është i ndërtuar me gurësh çmërsi e gurë gëlqeror që këmbehen çdo 1-2 apo tre radhë. Në mbarim të qemerit kemi në brendësi një dhëmbëzim dhe në anën e jashtme një kornizë të profiluar lehtë.

Në katin e sipërm hypej me sa duket me një shkallë të jashtme, nga e cila sot nuk kemi asnjë gjurmë, nëpër portën e ngushtë në anën veriore, mbuluar me hark të ulët. Në këtë kat pak mbi dysheme në anën jugore kemi dhe një dritare të vogël gati katrore mbuluar dhe ajo me hark të ulët. Po në këtë anë muri mbaron me fronton ndërsa çatia duket se është me strukturë druri. Nuk mund të vëmë re formën pak të ndryshme nga këmbanorja e kësaj ku-

99) **A. Alb,** II, A, 44, 4 iunii 1386, Abati i së cilës bëhet peshkop i Shurdhakut (Sardensis).

100) Th. Ippen, **1900,** 83-87, Fig. 1-5, Ne nuk mundëm të gjejmë në muret e rrënojave fragmentin e mbishkrimit me emrin e Uroshit (Rex Urosh që pa Ippen), **Po aty,** 84.

POZITIVOBY

lle, ndarjen e qartë të katit të parë nga kati i dytë, hyrjen nga jashtë tek ky i fundit që të kujton banesat e tipit kullë. Mundet që kjo formë të jetë kushtëzuar nga nevojat për një kalim të lirë drejt e në kishën e madhe.

Siç thamë edhe më lart kisha e madhe ka të përngjitur me anën perëndimore këmbanoren. Nga mënyra e ndërtimit të murit lindor të këmbanores nga lidhja e tij me atë jugor të kishës është e vështirë të përcaktosh në se kisha është më e vjetër, ndërtohet në një kohë me këmbanoren apo kur ndërtohet kjo e fundit kemi dhe meremetimet në anën jug-lindore. Kështu muri jugor në pjesën në perëndim të portës që ndodhet aty dhe që lidhet me kullën është mur i zakonshëm me gurë të papunuar ndërsa pjesa e sipërme me gurë të skuadruar. Një gjë e tillë është në favor të tezës së fundit që parashtrojmë më lart.

Nga kisha e madhe ruhen në një farë lartësie vetëm qoshet veri-lindore dhe jugperëndimore. Në pjesët e tjera muret ndiqen me mjaftë vështirësi ose janë gati rrafsh me tokën. Gjithashtu nuk dallohet forma e absidës përveç një muri në anën veriore të saj që të bën të mendosh se kemi një absidë drejtëkëndore. Për të përcaktuar pamjen e plotë të kishës si dhe një fazë më të vjetër të saj (për çka na shtyjnë fragmentet në portën e saj) do të duheshin gërmime arkeologjike.

Jo më pak e rëndësishme është dhe kisha dykatshe që ngrihet në juglindje të kishës së madhe në një nivel më të ulët të tokës. Nga ajo ruhet pjesa lindore në lartësinë e dikurshme, pjesa në drejtim të jugut si dhe gjurmë të pakta të mureve të tjerë. Nga këto arrijmë të dallojmë qënien e një porte në anën veriore (në këndin verilindor). Aty ruhet shpanulla nga lindja si dhe faqja e jashtme e murit perëndimor.

Kisha është ndërtuar me gurë të papunuar por me forma të rregullta drejtëkëndore e në rreshta horizontale që lidhen me llaç gëlqere të mirë. Në anën jugore dallohet që muri ndërtohet me një bërthamë mbushëse dhe dy perde veshëse. Edhe në brendësi të kishës muri është i ndërtuar me gurë të vendosur në rreshta me tendencë horizontaliteti të tyre. Të dy katet ndahen nga mbulesa me qemer ndërtuar me gurë të hollë të vendosur sipas rrezeve. Të dy absidat, janë gjysëm rrethore në plan dhe pa dritare. Në anën e jashtme ato përfshihen në një vëllim të vetëm. Absida e katit të poshtëm është më e madhe në brendësi dhe e vendosur më afër murit jugor. Ky është më i trashë në katin e poshtëm dhe dy absidat janë në të njëjtin aks. Mbulesat e tyre janë me çerek sfere ndërtuar me gurë në mënyrë të çrregullt, duke krijuar një dhëmbëzim atje ku fillojnë harkun..

Edhe në plan muri lindor dhe absida e kishës së sipërme janë me madhësi më të vogël se ato të katit të poshtëm. Muri lindor përfundon me fronton dhe duke u nisur nga trashësia e murit jugor mendojmë se kati i sipërm mbulohej me çati druri. Një veçanti tjetër që dallojmë, megjithë gjurmët e pakta, është se muri jugor ka trashësi më të vogël në pjesën që është rrënuar.

Ndërtimi vëllimor i kishës mund të merret me mend duke pasur vështirësi në përcaktimin e hyrjes për në katin e dytë. Ndryshimet në trashësinë e mureve në lartësi dhe në plan në këtë anë na shtyjnë të mendojmë për shkallë në mur, duke mos përjashtuar ndonjë zgjidhje tjetër.

Jemi të një mendje me botuesit e **Acta et Diplomata,** që identifikojnë në këto rrënoja manastirin e përmendur gjatë shekujve XIV-XV[101] Saneta Sophia di Genta, të dioçezës së Sardës (Shurdhahut), që nuk ndodhet larg prej këtu në anën tjetër të Drinit. Ky manastir duhet të ketë qenë një qendër e rëndësishme derisa përmenden abatet e saj kur emërohen si peshkop të Sardës.

Kisha e Shën Venerandës në Pllanë të Lezhës

Njihet me emrin e Shën Barbares apo Barbullës siç emërtohet nga vendasit. Ajo ndodhet në lindje të fshatit në pjesën më të lartë të tij. Përmendjet më të hershme për kishën në dokumentacionin historik i kemi në relacionin e Marin Bicit, i cili na përmend kishën e Shën. Barbares si kishë e mirë, për 500 vetë, me hajat të bukur përpara dhe këmbanë brenda kishës.[102]) Veç tij për këtë kishë na flasin dhe Benedikt Orsini[103] në vitin 1629 kur e quan si me të mirën e Shqipërisë, e më vonë Mark Skura[104] si kishën e peshkopatës së Krujës e rëmbyer nga ajo e Lezhës.

Kisha përbëhet nga hajati dhe naosi. Hajati nga materialet e përdorura, (tulla të vona) tregon qartë se i takon shekullit tonë dhe duket se ka zëvëndësuar të vjetrin që përmend M. Bici. Hajati i hapur rrethohet me arkada mbi pilastër me prerje katrore, muratura me tulla mbi të cilën shkon deri në nivelin e kishës.

101)Në vitet 1402 dhe 1434 **A. Alb,** II, 685, Shën 1; ku jepet si i Danjës A, 82, Shën 5.
102) **Relacione,** 3/I dok. 2, 131.
103) **Po aty,** dok; 22, 361, dok. 31. 401.
104) **Relacione,** 3/II dok. 36. 241. dok. 63, 325.

Fotokopy

Në të majtë e të djathtë të hyrjes ruhen dy afreska pasbizantine me vlerë.

Në sallë hyet nga porta në anën perëndimore nëpërmjet katër këmbë shkallëve. Një portë tjetër është në anën veriore. Ajo mbulohet me hark gjysëm rrethor ndërtuar me gurë të skuadruar. Salla përbëhet prej një vëllimi unik, të mbuluar me çati druri e tavan druri që përfundon në anën lindore me absidë gjysëm rrethore. Salla ndriçohet vetëm me katër dritare të ngushta e të larta në anën jugore. Ato mbulohen me hark të gdhendur në gurë të skuadruar. Shpatullat e dritareve janë gjithashtu me gurë të gdhendur. Në brendësi të kishës në të dy anët e portës perëndimore janë dy afreska të stilit perëndimor.

Në anën e jashtme kisha është trajtuar thjesht, me mure të rrafshta që përfundojnë me një kornizë prej një rrase guri të nxjerrë pak nga ana e murit të gdhendur. Muret janë ndërtuar me gurë të papunuar gëlqerorë dhe shtufi, të lidhur me llaç e gëlqere e rërë të ashpër. Në murin jugor të kishës janë dy rradhë të rregullta brimash të brezave të drunjtë të muraturës së vendosur çdo 1.80 m dhe 1.40 m në lartësi larg nga njëra tjetra.

Si në murin jugor ashtu dhe në atë verior për nga ndryshimi i materialeve dhe fugat e kontaktit dallohen qartë pjesët e vjetra nga shtesat e bëra në rindërtimin e hajatit në formën e tij të sotme. Një ndërtim shtesë ka qenë bërë dikur edhe në anën veriore të kishës. Nga ai ruhen muret në anën lindore, disa pilastra dhe një mur më i ri në anën veriore. Ky ambient në formën e një hajati ka qenë i mbuluar me çati me rrjedhje uji nga veriu.

Në anën lindore të kishës është absida gjysëm rrethore. Ajo është pa dritare dhe në pjesën e poshtme ka një mur përforcues që e vesh.

Në pikpamje të arkitekturës kisha është e thjeshtë. Ajo siç pamë karakterizohet nga muret e rrafshta e të ndërtuar me gurë të papunuar. Për të përcaktuar kohën e ndërtimit nuk kemi të dhëna të drejtpërdrejta burimore apo mbishkrimore. Për këtë, duke u nisur nga përmendja e saj në fillim të shek. XVII, si një ndërtim i vjetër, do ta lidhim me ndërtimet e shek. XIV.

Kisha e Shën Gjinit në Portin e Shën Gjinit

Mbi një breg pak të ngritur nga niveli i detit dhe rreth 200m larg tij ndodhen rrënojat e pakta të kishës së dikurshme të Shën Gjinit të Medës, të njohur nga burimet që në vitin 1416-17[105] dhe që i dha emrin dhe portit të njohur në antikitet me emrin Nymfeum, e njohur si një qendër panairi.[106]

Kisha është me planimetri drejtëkëndëshe me mure të rrënuara të ruajtura deri në lartësinë 1.70 m (qoshja jugperëndimore). Muratura e kishës është ndërtuar me gurë të mëdhenj të papunuar, me fuga të holla llaçi gëlqeror me mbushës të imët e zhavorr të imët, në të cilën ka vende vende dhe copra tullash (21 x 14 x 4 m) e tjegullash. Ruhet më mirë muri jugor, nga i cili shihen të dy faqet, absida rrethore në anën e brendshme (ana e jashtme është prishur) si dhe muri verior në anën e brendshme (ana e jashtme mbulohet nga rrënimet). Nga muri perëndimor ruhet shpatulla jugore e portës së hyrjes për në kishë në anën jugore.

Brendësia e kishës është e mbuluar nga rrënimet e mureve, dhe tjegullat e mbulesës. Ruhet dhe altari i vonë i ndërtuar me gurë. Në një pjesë të mureve shihen suvatime të vona të bëra me llaç çimentoje që na flasin për rindërtime që ka pësuar kisha.[107] Përcaktimi i tyre është i pamundur nga që ruhet vetëm pjesa e poshtme e mureve dhe siç është e kuptueshme janë rindërtuar pjesët e sipërme të mureve, mbulesa e çatisë dhe brendësia.

Lidhur me kohën e ndërtimit fillestar të kishës jemi të mendimit se i takon shek. XII-XIV kur fillon të përmendet së pari në dokumentacionin lustan.

Nenshat – Sapë

Themelimi i peshkopatës së Sapës në vitin 1291[108] njihet nga burimet historike[109], ashtu si dhe vendndodhja e saj e transmetuar nga relacionet dhe shënimet e udhëtarëve prej shek. XVII e këtej. Prej tyre mësojmë se selia e saj ndodhej në malin e lartë të mbiemëruar dhe mali i shën Mëhillit nga

105) **Regjistri,** 93/b, 94/ab, 95/a, 109/a, 111/b, 154/ab.
106) Z. Shkodra, **Kontribut për historinë e panaireve shqiptare,** S. H. 4; 1977, 151.
107) E. Armao, **Vep. cit,** 129.
108) **A. Alb,** 515-11 lunili 1291.
109) **Relacione,** 3/4, 413, Relacioni i peshkopit Sapës Gjergj Bardhi i vitit 1632, i cili thotë se ajo që rrënuar dhe ndërtuar nga themelet prej paraardhësve, të cilën ky e mbuloi. **Po aty,** 295, V. 1661, përmendet kjo kishë si seli e peshkopale dhe kisha tjetër, ajo e Shën Ëngjëllit një kapele në majën e malit mbi fshatin Hajme, të cilin ne nuk e vizituam por që ruhen rrënojat e palexueshme të saj.

DO NOT COPY

emri i katedrales së saj.[110] Me interes të veçantë është e dhëna e peshkopit të Sapës së Zadrimës Frang Bardhit në relacionin e tij mbi gjendjen në Zadrimë dërguar Romës në vitin 1641, sipas të cilës në këtë vend bashkëbanuan dikur zotërinjtë Dukagjinas me peshkopin e Zadrimës.

Kisha e shën Mëhillit

Në një rrafsht të lartë mbi shkëmbinj të thiktë dhe të mbrojtur nga erërat e veriut e verilindjes prej kreshte shkëmbore ngrihen të rrethuara nga bimësia dhe mjaft rrënoja të paqarta në formën e tyre, kisha dhe një banesë në perëndim të saj.

Kisha është e ndërtuar fare pranë shkëmbit, me planimetri drejtëkëndëshe të zgjatur. Muret e saj ruhen pjesërisht të rënuar. Kështu muri jugor si dhe ai perëndimor ruhen fare pak (0,60-1,00 m) ndërsa ai verior, që është dhe në rolin e murit mbajtës në terenin e pjerrët, ruhet nga 2 në 3 m. Në anën lindore është absida gjysëm rrethore pjesërisht e rënuar. Në kishë hyet nga porta në anën perëndimore, të cilës i ruhen fillimet e shpatullave si dhe nga një portë e brendshme në anën jugore, ku ruhet shpatulla nga lindja. Muret e kishës janë ndërtuar me gurë të papunuar të vendosur në radhë me tendencë horizontaliteti dhe të lidhur me llaç gëlqereje me rërë të ashpër. Gurët e përdorur janë të madhësisë mesatare me copëra gurësh e rrasash në fugat. Muri është ngritur mbi një xokolaturë. Në murin verior shihen gjurmë të qarta të suvatimit të dikurshëm.

Lidhur me kohën e ndërtimit të parë të kishës jemi të mendimit, që i takon fundit të shek. XIII. Për sa i përket rindërtimeve të saj gjurmët e këtyre ne nuk i pamë në murin verior, ndërsa në të tjerët ato mund të mos jenë ruajtur për shkak të lartësisë së pakët të rrënojave. Me sa duket këto rindërtime si zakonisht prekin pjesën e sipërme të mureve, pjesë të veçanta të tyre dhe sigurisht çatinë.

SPITEN-LEZHË

Kisha e Shën Aleksandrit në Bokian

Kisha e shën Llezhdrit vend i njohur pelegrinazhesh në shekullin e kaluar dhe e njohur në burimet që në vitin 1402[111] me emrin «San Alexandro in Collematia»[112], ndodhet në majën e kodrave shkëmbore mbi fshatrat Spiten e Zejmen (Bregu i Matës) prej nga sundon gjithë fushën bregdetare nga kepi i Rodonit në Shëngjin. Rrënojat e manastirit të dikurshëm benediktin përbëhen nga muri rrethues me hyrjet për në manastir në anën lindore nga konakët e rrënuar në një shesh pranë tyre, ndërsa në pjesën më të lartë brenda një rrethimi të veçantë që komunikon me këtë të fundit ndodhet kisha e rrënuar.

Kisha ruan në këmbë absidën me murin lindor, murin verior e atë perëndimor. Nga hajati që është ndërtuar buzë shkëmbinjve të thepisur në një kohë të dytë, ruhen tre pilastra me prerje katrore në anën veriore dhe gjurmët e të tjerave nën rrënojat e hajatit, çatia e të cilit me strukturë druri mbulohej me rrasa guri.

Në kishë hyej me sa dukej vetëm nga porta në anën perëndimore. Kjo ishte mbuluar me hark të shkallëzuar në anën e jashtme dhe arkitekturë druri në anën e brendshme. Mbi portë ruhet pjesërisht një nike, për rindërtimin e së cilës janë përdorur materiale të vjetra të një kornize të profiluar pak, që siç duket i takonte kishës më të vjetër. Muri verior i ruajtur deri në lartësinë e plotë ka të rrënuar vetëm pjesë pranë qoshes perëndimore dhe qoshen lindore. Ai është ndërtuar me gurë të punuar të nxjerrë nga formacione gëlqerorë të shtresëzuar. Në pjesën e poshtme janë përdorur gurë më të mëdhenj të lidhur me llaç gëlqereje me mbushës rëre të imët të përzier më të trashë, në fugat e të cilave ka rasa të vogla e gurë të vegjël. Pjesa e sipërme është ndërtuar me gurë më të vegjël dhe me fuga të mbushura keq me llaç. Mendojmë se pjesa e poshtëme duhet ti takojë ndërtimit të parë. Në këtë mur verior në brendësi është një nike e madhe pak e thellë e ndërtuar kryesisht me gurë çmërsi dhe me hark gjysëm rrethor po prej çmërsi.

Muri lindor me absidën është ndërtuar me gurë të gdhendur në pjesën e absidës pesëfaqëshe të lidhur me llaç me ngjyrë okër të errët. Duke gjykuar nga këto veçanti mendojmë se ajo i takon një rindërtimi të vonë. Në brendësi absida është gjysëm rrethore dhe, mbulesa e rregullt në formë çerek sfere është ndërtuar me gurë çmërsi. Harku në dukje i saj është gdhendur në mënyrë të shkallëzuar.

Nga gjendja rrënojë e ndërtesës e nga pamundësia e gërmimeve është vështirë të dallohen e ven-

110) **Relacione**, 3/II, 191, 201, ku thotë se ndërkohë (L64L) banojnë në Sapë (Nenshat) me shën Gjergjin si katedrale.

111) **A. Alb,** II, 30, l. 1402, M. Šufflay, **Die Kirchezustande,** 273. Kisha përmendet në relacionet e M. Skuros të vitit 1641, në **Relacione,** 3/II, 241.

112) F. Gordignano, **Antichi monastiri benedettini i le loro benemerenze sociali in Albania,** La civilta Cattolica, 1929, III, 27, 505.

DOKTORATURA

dosen në kohë rindërtimet e shumta të kishës. Pjesa më e madhe e tyre duhet ti përkasi shek. XIX. Ndërsa planimetria dhe forma vëllimore ripërsërit ato të ndërtimit më të hershëm, të ndërtuar gjatë shek. XIV ose dhe më përpara.

Kisha e Shën e Premtes në Balldre-Lezhë

Në kodrën ku ndodhet fshati i sotëm i Balldrenit kemi të ruajtur mirë kishën e shën e Premtes siç e quajnë vendasit apo San Veneranda sipas dokumentave[113]. Emri i fshatit takohet së pari në vitin 1416-17[114].

Kisha paraqet në plan një ndërtim drejtëkëndësh mbuluar me qemer të mprehtë me absidën gjysëm rrethore në anën lindore. Ky mur lindor vijon i rrënuar dhe në anën jugore ku në nivelin e tokës shohim një absidë të dytë. Po kështu drejt jugut vijon edhe muri perëndimor i kishës. Kufijtë jugorë të kësaj pjese të humbur të ndërtesës mund të nxirren me saktësi vetëm nga gërmimi arkeologjik.

Nga studimi i mureve dhe strukturave kuptohet që monumenti i është nënshtruar shumë ndryshimeve, me gjithëkëtë me që brendësia është e suvatuar nuk mund të arrihet në përfundime të plota. Në murin verior mbi muraturën e themelit me gurë gëlqerorë petashqu, që sot mbas gërryerjes së tokës janë mbi sipërfaqe, kemi një brez jo të vogël muri të ndërtuar me gurë çmërsi dhe me llaç gëlqereje me rërë mesatare. Mbi të kemi mur prej gurësh gëlqerorë lidhur me llaç gëlqeror me rërë të imët. Ky mur të jep idenë e një murature të vjetër të lidhur me atë të mëposhtmen, ndërsa pjesa e sipërme e faqes veriore që është e mbushur me gurë gëlqerorë duket e re. Në këtë pjesë të sipërme janë edhe dy dritare të ngushta mbuluar me arkitra të rrafshët guri. Dritarja më ngaperëndimi sot është e murosur. Në faqen veriore janë dy porta një nga perëndimi që mbulohej me hark të mprehtë me gurë të punuar e murosur, dhe porta më në lindje të saj e hapur në një kohë të dytë që mbulohet me arkitra të rrafshët.

Në anën lindore të kishës shohim të qartë themelin e zbuluar me gurë shtufi mbi të cilin kemi muraturën me gurë çmërsi. Mbi dritaren e ngushtë të absidës që për nga materiali i përdorur i takon një rindërtimi kemi të vendosur për arkitra një gur pak të dëmtuar me një mbishkrim me përmasa 49 x 14 cm. Në të, krahas formulës së zakonshme të kohës vërehet data 1462 (MCCCCLXII). Në pjesën e sipërme muri lindor ka riparime të bëra me gurë gëlqerorë që flasin për një ngritje të frontonit dhe për lidhje me murin e ri të anës veriore.

Vijimi i muraturës së vjetër në drejtim të jugut dhe absidës, e rënuar në atë anë flet për një kapele të dytë bashkëngjitur kishës. Nga kjo kapele ruhet si pamë dhe një fragment i murit të ngushtë mbuluar me hark të mprehtë. Ky mur ka shumë rindërtime që flasin për mbushje të vona të hapësirave që lidhin këto dy ambiente të naosit të dikurshëm.

Edhe në murin perëndimor që përfundon me fronton shihen gjurmë rindërtimesh të ndryshme. Është riparuar duke u ribërë porta me hark të mprehtë. Kemi një rindërtim të pjesës së sipërme ku është dhe një dritare. Për shkak të suvasë që mbulon në anën e brendshme muret dhe mbulesën me qemer të kishës mund të shihen në se krahas meremetimeve të pjesës së sipërme të mureve është ribërë tërësisht apo pjesërisht edhe qemeri.

Kisha paraqet një ndërtesë me vlerë për shkak të ruajtjes tërësore të saj, me ndryshime që flasin qartë për vjetërsinë e saj. Ne mendojmë se ndërtesa i takon shek. XIV me rindërtime të ndryshme njëri prej të cilëve dokumentohet me mbishkrimin e ripërdorur të vitit 1462.

Kisha e shën Stefanit në Blinisht të Lezhës

Kisha e shën Stefanit ndodhet në fushë në perëndim të fshatit larg tij duke shërbyer prej kohësh si varrezë. Ajo ruhet sot në gjendje rrënojë. Për të kemi një sërë të dhënash historike. Kështu Frang Bardhi në vitin 1642 na thotë se këtë kishë të vogël e ka ndërtuar Nikolla Dukagjini[115]. Kisha haset dhe në hartat e Koronelit të vitit 1670[116], ndërsa në vitin 1704 meret një ferman nga Stambolli për rindërtimin e saj.[117]

Ajo paraqet një ndërtesë me planimetri drejtëkëndëshe që përfundon në anën lindore me absidë

113) P. Bartl, **Quellen und materialen zur Albanischen Geschishte im 17 und 18, Jahrundert,** vol. II, Munchen 1975, 91, Zmajeviç e quan atë në gjendje të mirë dhe me një këmbanore.
114) **Regjistri,** 93/b, 94/b, 115/a.
115) **Relacione,** 3/IV, 209.
116) E. Armao, **Vep. cit,** 141.
117) P. Bartl, **Vep. cit,** I, 63, dhe II, 68.

POOR COPY

gjysëmrrethore pa dritare. Në kishë hyhet nga porta në anën perëndimore, dikur mbuluar me hark, nga i cili ruhen vetëm gjurmë të pakta. Shpatullat e portës janë me paturë e të ndërtuara me gurë të mëdhenj. Në to ruhet vrima për kataruan. Në brendësi porta ka qenë mbuluar me arkitrarë të rrafshët të cilëve iu shihen gjurmët në muraturë.

Në brendësi të kishës dhe në anën veriore kemi grumbuj rrënimesh. Muret perimetrale të kishës janë ndërtuar me gurë gëlqerorë, shtufi dhe çmërsi të lidhur me llaç gëlqereje me rërë të ashpër që ka tek tuk në fugat horizontale tulla (me përmasa 36 x 23 x x 8 cm, 35 x 28 x 5 cm, 28 x 28 x 4 cm, 32 x 27 x x 8 cm). Prej tyre ruhen tërësisht muri jugor, lindor dhe perëndimor ndërsa më pak ai verior, nga i cili është rrënuar gjysma nga perëndimi. Po me këtë material është ndërtuar edhe mbulesa në formë çerek sfere e absidës. Mbi murin jugor kemi tre radhë gurësh të lidhur me llaç gëlqereje me rërë të imët, që duhet ti përkasin riparimeve të vona që ka pësuar kisha, dy dritare të vogla në këtë mur jugor ndërsa një portë është e murosur në anën veriore të kishës. Muri perëndimor i kishës që është i mbuluar nga bimësia përfundon me fronton në kulmin e të cilit është një këmbanore me dy shtylla të vogla, hapësira ndërmjet të cilave mbulohet me hark. Një dritare e vogël është gjithashtu në mes të frontonit.

Në një kohë të dytë kishës i bëhet një transformim jo i vogël. Mureve i bashkëngjiten pilastra (nga 4 në muret verior e jugor), mbi të cilat me harqe ngrihet qemeri që mbulonte kishën. Sot edhe këto janë pjesërisht të rrënuara. Kështu ruhen tërësisht dy pilastra më në lindje të anës veriore dhe harku mbi të, si dhe tre nga pilastrat e anës jugore. Pilastrat janë ndërtuar me gurë të skuadruar në pjesën e poshtme dhe me çmërs në pjesën e sipërme. Edhe harqet janë ndërtuar me çmërs me dy radhë njëra mbi tjetrën. Nga qemeri që mbulonte kishën kemi vetëm fillimet e tij në pjesët ku ruhen harqet e muraturës mbi to. Muratura e kësaj faze ndërtimi është lidhur me llaç e gëlqere të bollshme e rërë të imët. Gjithashtu ky mur mbulon një nga dritaret e anës jugore. Gjatë ndërtimit të pjesëve të reja, në pjesën e sipërme duket se riparohen edhe radhët e sipërme të murit të vjetër sepse kemi një lidhje ndërmjet tyre në këtë nivel.

Me këtë rindërtim kisha nga një ndërtesë e rëndomtë me çati druri kthehet në një kishë mbuluar me qemer mbi harqe përgjatë mureve siç shohim në mjaft kisha të bregdetit gjatë fundit të shek. XIII-XIV. Është me interes të shtojmë se në një nga gurët e shpatullave të kishës është inçizuar data 1300, që duhet të jetë shkruar në një kohë të vonë. Në murin verior ruhen gjurmë afresku. Mendojmë se ndërtimi i parë duhet ti përkasi shek. XI-XII ndërsa rindërtimi fillimit të shek. XIV. Kisha gjithashtu siç tregojnë burimet ka pësuar riparime në shekujt e mëpasshëm.

Kisha e shën Kollit në Kakariq-Lezhë[118]

Rrënojat e pakta të kishës së shën Kollit ndodhen në të dalë të fshatit, në vendin ku sot ndodhen varrezat e tij. Mbetjet e kishës janë në masë të tillë që nuk mund të flitet për ndryshimet që ajo ka pësuar. Ruhet deri në një lartësi 1.30 m vetëm muri verior dhe ai i riparuar në pjesët e sipërme, ndërsa mure e tjera janë në nivelin e dyshemesë. Muret janë ndërtuar me gurë të papunuar. Nga vizitues të mëparshëm mësojmë se kisha është zgjatur në pjesën e përparme dhe ka pasur mjaft rindërtime. Absida në anën lindore është gjysëm rrethore.

Me rëndësi janë tre pilastra që iu ngjitën në një kohë të vonë murit jugor, për të cilat mendojmë se janë shtuar për të mbajtur mbi një sistem harqesh mbulesën me qemerë të kishës, që rindërtohet sipas modelit të kishës së Shën Stefanit të Blinishtit atypranë dhe duhet ti përkasi të njëjtës kohë, fillimit të shek. XIV, ka përputhet dhe me të dhënat e mbishkrimit të vonë[119]. Për rindërtimin që kisha pësoi në kohë të vona gjurmët materiale nuk na thonë gjë por na dokumentohet nga të dhënat historike.[120].

Vazhdon

---

118) Përherë kisha përmendet në Kadastrin e Shkodrës ku emërtohet zona me emrin Shën Kolli Kakariqi ashtu edhe fshati. **Regjistri** 92/b, 93/a, 145/b.

119) E. Armao. **Vep. cit,** 136.

120) Nga relacioni i V. Zmajeviçit kryepeshkop i Tivarit në vitin 1702, 3. P. Bartl, **Vep. cit,** II, 97, Mësojmë që kisha kishte dhe një këmbanore. Gjurmë të vogla të saj në këndin jug perëndimor të rrethimit të oborrit, në formë katrore me përmasa të planit X m.

DOKUMENTOHEN

DO NOT COPY

KISHA E SHEN STEFANIT – *Shkodër.*



Planimetria



Prerje tërthore



Prerje tërthore

0 1 2 3 4M

DO NOT COPY

KISHA E SHEN STEFANIT – *Shkodër*



Pamje nga jugu



Pamje nga veriu

0 1 2 3 4M

DO NOT COPY

KISHA E SHEN STEFANIT – *Shkodër*



Prerje gjatësore





0 1 2 3 4 M.

KISHA E SHEN STEFANIT – *Shkodër*









DO NOT COPY

KISHA E SHEN STEFANIT- *Shkodër*









DO NOT COPY

DO NOT COPY



PAMJE JUGORE

KISHA E SHIRGJIT - *Shkodër*



DO NOT COPY

KISHA E SHIRGJIT - *Shkodër*









RIKONSTRUKSION *Planimetrik*

DO NOT COPY

DRISHT - SHKODER



Kapela trekonkëshe





Kapela jashtë mureve





DO NOT COPY

KISHA E SHEN GJINIT - *Rrashkull*











DO NOT COPY

KISHA E SHEN MERISE
Vau Dejës - SHKODER





Planimetria





DO NOT COPY

KISHA E SHEN MARKUT.
kalaja e Vaut të Dejes – SHKODER



Planimetria





Pamje nga Veriu



DO NOT COPY

SHEN SOFIA E GENTES – *Mazrek*







DO NOT COPY

MANASTIRI I SHEN SOFISE GENTES – *Mazrek-Shkodër*

kapelë dykonkëshe



Planimetri e katit dutë







Planimetri e katit parë



Premtje TËRTHORE

SHEN SOFIA E GENTES - *Mazrek*









DO NOT COPY



KISHA E SHEN VENERANDES - *Pllanë* LEZHE





DO NOT COPY

DO NOT COPY

KISHA E SHEN MEHILLIT
NENSHAT (Sapa) - LEZHE









Planimetria

0 1 2 3 4 5 M



KISH E SHEN
ALEKSANDRIT
Bokian - Lezhe









KISHA E SHEN GJINIT
SHENGJIN

0 1 2 3 4 M

DO NOT COPY

DO NOT COPY

KISHA E SHEN E PREMTES - BALLDRE *Lezhë*







Pamje nga Veriu

0 1 2 3 4 5 M

KISHA E SHEN KOLLIT - *KAKARIQ - Lezhë*





Planimetria

DO NOT COPY

KISHA E SHEN STEFANIT
Blinisht - LEZHE











DO NOT COPY





KISHA E SHEN STEFANIT
Blinisht - LEZHE









Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

LES EGLISES MOYENAGEUSES DE L'ALBANIE CENTRALE ET DE L'ALBANIE DU NORD

R E S U M E

Dans l'Albanie centrale et celle du Nord se conservent un nombre considérable d'églises médiévales, en grande partie tombées en ruines, qui seront présentées dans cet article et dans l'article suivant.

Les plus anciennes données sur ces églises se trouvent dans des sources médiévales et surtout dans les rapports faits par les missionnaires et les envoyés de l'église de Rome, sur la situation dans les régions visitées par eux au XVIIe siècle. Les premières études reviennent à Theodore Ippen, qui a été le premier à faire connaître une série de monuments. Elles ont été continuées par d'autres chercheurs, pendant les premières décennies de ce siècle. Les contrées qui seront traitées dans cet article englobent les provinces de Prevalitane et du Nouvel Epire, dont les centres étaient les villes de Shkodra et de Durrës. Au début du VIe siècle, Hiérocle donne pour ces provinces les noms des villes ci-dessous: Skodra, Dioklea, Lissos, Dyrrah, Skampin, Listron et Skeupton.

En lignes générales, on connaît l'organisation ecclésiastique de ces contrées au Moyen-Age, avec ses oscillations entre l'église de Rome et celle de Constandinople. Pendant le XIe-XIIe siècles cette organisation se polarise entre deux archevêchés, celui catholique de Tivar et celui orthodoxe de Durrës, altérnant selon les circonstances historiques et l'intervention des féodaux d'Ouest dans ces contrées.

De la Haute Antiquité on conserve des monuments, ainsi que des traces ou des fragments de sculptures architecturales. De même, on a des données historiques sur la continuité de leur utilisation pendant le Moyen-Age, étant donné que ces contrées ont été continuées à être habitées par la même population autochtone. Nous allons commencer par la représentation des monuments des centres épiscopaux puis par ceux des autres centres qui en dépendent.

Shkodra

La documentation historique de Shkodra nous fait connaître une série d'églises telles: Sainte-Marie, Saint-Apollonaire, Sainte-Croix, Saint-Nicolas, Saint-Vendredi, Saint-Etienne, tous les saints tels: Saint-Theodhore, Saint-Pierre, Saint-Lazare, et Saint-Blasius. De ces églises on ne conserve que les ruines de l'église de Saint-Etienne qui est mentionnée en tant que cathédrale, en 1319. Ses ruines se situent près des murs d'enseinte, au nord-ouest de la forteresse de Shkodra. Elle est composée du naos, de l'autel, du porche et du minaret qui est une adjonction de l'année 1479, où la ville est prise par les turcs et l'église se convertit en mosquée. La première construction de l'église était faite de pierres équarries liées avec du mortier de chaux et avec de fines jointures dans les deux parois, avec du remblai de pierres irrégulières et une bonne quantité de mortier à l'antérieur. Le Naos était d'une planimétrie quadrangulaire avec deux portes, donnant vers le Nord et le Sud. A l'Est, se trouve l'abside quadratique, autrefois couverte d'une voûte croisée. On conserve aussi quelques parties d'une des fenêtres qui se trouvaient du côté du minaret. Au sud on a ajouté un portique avec des arcades construites avec des pierres équarries. Pendant son existence de plusieurs siècles, la structure de l'église a subi beaucoup de reconstructions, et un grand nombre de ses éléments se conservent en état de ruine, même de nos jours.

Le naos et l'abside appartiennent à la première phase de la construction au XII et au début de XIVe siècle. La deuxième phase de la construction, le porche et les reconstructions du mur méridional de l'église avec le portail qui donne accès au naos, remonte au XIVe siècle. Du point de vue de l'architecture, cette église représente toutes les qualités de l'architecture romaine-gothique. Elle se distingue par le traitement rigoureux et net des vues extérieures, par le volume unique de l'intérieur, par l'élévation verticale du naos et du volume de l'autel.

Saint Serge et Bacchus à Shirgj

Du monastère très connu et très important d'autrefois, il ne reste qu'une partie du mur méridional et un pilastre, à l'intérieur. L'étude la plus complète de ce monument appartient à V. Koraç. Nous pensons qu'elle est complétée davantage par les donnés fournies par l'étude des restes du monument.

La partie conservée du mur méridional s'élève de toute sa hauteur. On y conserve deux niches limitées par trois pilastres de pierres équarries, surmontées d'arcs qui ne sont pas en plein cintre, comme on les croyait, mais en ogive. Les niches sont construites avec des pierres et des briques en lignes qui s'alternent. C'est la technique utilisée même pour le mur d'ouest, dont on ne conserve que le coin méridional avec l'un des pilastares d'autre-fois. Par ces restes, ainsi que par les photos de Dengrand Ippen, nous sommes convaincus d'avoir à faire à la même période de construction.

L'étude des deux inscriptions de la construction de l'église affirme l'exactitude de leur publication par Koraç.

Drisht-(Drivastum)

A Drisht, centre épiscopal mentionné pour la première fois par Jean Tzimiskes (969-976) se conservent les ruines des deux des six églises connues par la documentation historique.

La chapelle à trois conques *se situe à l'intérieur de la forteresse, près de ses murs du côté Est. Les murs ruinés se conservent à une hauteur de 1,5-2 m. Sa planimétrie se distingue presque complétement et ne diffère pas beaucoup de celle publiée par Ippen. Les murs sont construits avec des pierres brutes liées avec du mortier de chaux, en rangées presque horizontales. D'après la technique de la construction des murs, nous pensons que l'église appartient aux XIe-XIIe siècles.*

L'église à une nef, *au dehors des murs, au bord de la route qui mène à la forteresse, se conserve en grande partie ruinée. Sa planimétrie est quadrangulaire, avec des murs bas, construits avec des pierres grossièrement taillées. Cela nous fait penser qu'elle appartient à la première période de l'histoire de la ville.*

L'église de Saint Jean à Rashkull (Shkodër). *Ce sont les ruines du monastère connu «San Giovannos in Strilalo» mentionné en 1166. Il ne reste que les bas ruines des murs de l'église construits avec des pierres brutes liées avec du mortier de chaux, et le clocher construit selon la technique de la fin du XIIIe siècle. Nous estimons que l'église appartient aux XIe-XIIe siècles.*

Vau Dejës (Shkodër)

L'église Sainte-Marie, *se situe au pied de la montagne de Denjë et se mentionne dans la documentation historique dès l'année 1348. C'est une église à une nef avec des pilastres dans les murs couverts de voûtes. A l'Est fait saillie une abside en forme semi-circulaire. A l'Ouest se trouvait la seule porte d'entrée de l'église. L'église était éclairée par six fenêtres. Les arcs en ogive des fenêtres sont décorés de rubans en triangle et de motifs floraux. La maçonnerie de l'église se terminait avec une corniche de pierres gravées au-dessus de laquelle se trouvait une frise d'arcs lombards. A l'Ouest, à l'endroit où la maçonnerie se termine par un fronton, se trouve une fenêtre.*

Les murs sont construits avec des pierres calcaires gravées, liées avec du mortier, avec de fines jointure à l'extérieur, selon la technique caractéristique de la fin du XVIIe siècle. Nous convenons avec Ippen et Dhamo qui datent l'église de la fin du XIIIe siècle.

L'église Saint Marc de la forteresse. *Elle s'élève sur le sommet de la montagne de Dejë, au bord du mur d'enceinte oriental de la forteresse de Danjë. Les murs de l'église se conservent élevés. Ils appartiennent à des reconstructions, dont on parle même dans la documentation plus récente. D'après la technique de la construction, les murs oriental, méridional et septentrional appartiennent à la première phase de construction, (au XIIIe et au XIVe siècles). Les pierres équarries du mur Nord, appartiennent à la deuxième phase de construction (fin du XIVe et XVe siècle). En 1465 on a reconstruit la porte Nord.*

Le monastère Sainte-Sofie de Genta à Mazrek de Shkodra

Au centre du village de Mazrek se trouvent les ruines du monastère, connu sous le nom de «l'église de Shat». A l'Est il y a une église à planimétrie quadrangulaire et à l'Ouest avant d'entrer à l'église la tour du clocher. Un peu plus bas, il y a une église à deux étages dont le premier est couvert d'une voûte cylindrique. On a trouvé un fragment de pierre gravé intéressant, où l'on aperçoit une tresse à trois brins, daté du IX-XI siècles qui doit appartenir à une construction plus ancienne. D'après la technique de construction, avec des pierres équarries, l'église et le clocher doivent remonter au XIIIe-XIVe siècles.

L'église Sainte-Vénérande à Pllone de Lezha. *C'est une église connue par les gens du pays sous le nom de Sainte-Barbara, mentionnée en 1610 par M. Bici comme une église pour 500 personnes. Elle est composée du naos, du narthex reconstruit pendant ce siècle et l'autel avec l'abside semi-circulaire. C'est une église construite avec des pierres calcaires brutes dont le mur méridional est percé de quatre fenêtres étroites. Il y a deux fresques intéressantes de style occidental, à l'intérieur du mur sud, et deux autres post-byzantines à son extérieur. L'église doit appartenir au XIVe siècle.*

L'église Saint-Jean, au port de Shëngjin-Lezha

Elle est construite avec des pierres brutes et des morceaux de briques et se conserve en état de ruine. On aperçoit les traces des nombreuses reconstructions qu'elle a subies. Elle a dû être construite aux XIIIe-XIVe siècles.

DO NOT COPY

Sappa-Nenshat de Lezhë. *La création de l'évêché de Sappe, en 1291, est connue par la documentation historique. L'église Saint-Michel s'élève au sommet de la montagne, portant le même nom. Il lui reste des ruines construites avec des pierres équarries liées avec du mortier de chaux. Sa planimétrie est quadrangulaire avec une abside semi-circulaire. En tant que construction, elle appartient au XIIIe siècle.*

L'église Saint-Alexandre de Bokian à Lezhë

Par la documentation historique elle est connue sous le nom de «San Alexandro in Vollmatia» (en 1400). Elle se conserve en état de ruine, sur un terrain rocheux au-dessus des villages Zejmen et Spiten. C'est une église à planimétrie quadrangulaire avec une obside circulaire. On aperçoit de nombreuses reconstructions, qui se distinguent bien sur les murs ruinés, construits avec des pierres de forme irrégulière. La plus ancienne construction remonte au XIVe siècle.

L'église Sainte-Venerande à Ballade de Lezhe

Elle se conserve entièrement malgré les nombreuses reconstructions, avec une planimétrie quadrangulaire, couverte d'une voûte en ogive avec une abside à l'Est. Les murs sont construits avec des pierres brutes. A la ocnstruction de l'abside, on a réutilisé une pierre daté de l'année 1462.

L'église Saint-Etienne à Blinisht de Lezhe

Elle est construite sur la plaine, près du village et à l'heure actuelle ne représente que des ruines. Les murs latéraux construits avec des pierres brutes, appartiennent à la première phase de construction (XIe-XIIe siècles). A la deuxième phase (XIVe siècle) appartiennent la construction des pilastres des murs au Nord et au Sud, des arcs qui les surmontent et de la couverture à voûte, tous ruinés à l'heure actuelle.

L'église de Saint-Nicolas à Kakariq de Lezhe

Il n'en reste que la planimétrie quadrangulaire avec de très bas murs. Pendant une deuxième phase (le début du XIVe siècle) on a construit des pilastres qui nous rappellent ceux de Blinisht.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Naum PRIFTI

ORGANIZIMI I VOGËL DHE TREVAT E MURATORËVE STINORË TË KOLONJËS

Zejtarët stinorë e shtegtimet e tyre kanë qenë dukuri e njohur në trevën e Ballkanit.

Kategoria më me interes e këtyre zejtarëve është e mjeshtërve, siç quheshin në mënyrë përmbledhëse, muratorët, karpentierët, skalitësit e gurëve e ndihmësit e tyre. Mjeshtrit niseshin me grupe të vogla në «gushto-vjeshtë», për të punuar gjatë periudhës së dimrit, në vendet ku kushtet klimaterike e lejonin këtë gjë. Si vende të përhershme shtegtimi qenë zona e butë e Ballkanit, pra Shqipëria bregdetare dhe e jugut, Gjirokastra, Delvina, Saranda, Konispoli, Bullgaria, Rumania kryesisht zona e Kostancës, Greqia e veçanërisht gadishulli i Kalkidisë dhe Mali Athos. Në gjuhën popullore ky i fundit thirrej Janoras, si shtrembërim i fjalës greke Ajon Oros (mali i shenjtë).

Organizimi i grupeve të muratorëve stinorë bëhej kryesisht në bazë fisi, ose dhe në bazë shoqërie. Muratorët dhe mjeshtrit kërkonin ose zgjidhnin shokë që të ishin afërsisht të një moshe e që kishin të njëjtin nivel profesional.[1)]

Grupet riorganizoheshin çdo vjeshtë për shkak të lënies së punës nga pleqtë, futjes së mjeshtrave më të rinj ashtu edhe faktorëve të tjerë, si pamundësia e një pjestari të grupit për ta ndjekur atë për arsye shëndetsore e familjare etj.

Grupet kishin zakonisht nga 6-8-10 vetë e shumë rrallë kapërcehej kjo shifër. Bazën e grupit e përbënin mjeshtrit me numrin e tyre gjithmonë çift. Pra katër muratorë e një a dy ndihmës apo gjashtë muratorë dhe dy a tre ndihmës. Kjo qe e kushtëzuar nga karakteri i punës së muratorit, për të punuar çift një në anën e jashtme të murit dhe tjetri nga brenda. Në faqen e jashtme lihej kurdoherë muratori më me përvojë ndërsa në anën e kundërt mund të punonte edhe një mjeshtër me kualifikim më të ulët. Punët e ndihmësve ndaheshin sipas nevojave të vendit të punës. Një ndihmës duhej të furnizonte me baltë e llaç dy çifte muratorësh, një tjetër sillte, ndërsa një gatuante baltën. Kishte edhe raste kur një ndihmës caktohej për të punuar me kafshët duke mbartur gurë, baltë ose ujë. Grupet krijoheshin të vogla që të ishin të manovrueshme, të mund të ngulitesin me lehtësi dhe të merrnin përsipër dhe punë të vogla.

Mjeshtrit detyroheshin të banonin e të flinin në strehime të ngushta e në kushte higjenike të vështira. Atyre u lëshohej për strehim ndonjë katua a plevicë ku ato flinin e gatuanin. Rrobat e fjetjes i mbartnin me vete kudo që shkonin me anë të kafshëve, të cilat sipas nevojave i përdornin edhe për punë. Vendi i fjetjes dhe mënyra e gatimit, «buka», zgjidhej me punëdhënësin. Sipas marrëveshjes përcaktohej pagesa, afati i përfundimit të punimeve, vendi i fjetjes, etj. Në rastet kur i zoti, merte përsipër gatimin, kjo hynte në llogari dhe pagesa pësonte zbritje.

Punët zakonisht merreshin me qesim (akord). Zotëronte mendimi se mjeshtrit me mëditje punonin ngadalë dhe e zgjatnin artificialisht kohën e punës. Kurse me akord ishin të interesuar të punonin me orë të gjata e ritme të lartë. Norma nuk njihej dhe dita e punës zgjatëte aq sa edhe drita. Në pranverë fillonte e mbaronte me diellin, me një pushim të vogël në drekë. Për çdo mosmarrëveshje punëdhënësi kishte të

1) «Shokët mundoheshin t'i zgjidhnin të barabartë me veten që puna të ecte njëlloj» tregon Pando Joti – një nga muratorët që ka punuar një kohë të gjatë në Malin e Shenjtë.

bënte vetëm me kryemjeshtrin, me të cilin qe lidhur kontrata me gojë e me shkrim. Me punëdhënës privatë e për ndërtime të vogla nuk bëheshin kurrë kontrata me shkrim, prandaj edhe nuk kanë mbetur gjurmë nga këto dokumenta, sepse si punëdhënësi ashtu edhe mjeshtrit nuk kishin dëshirë që të ngatërroheshin me administratën turke e organet e gjyqit kur lindnin mosmarrëveshje. Muratorët e respektonin kontratën, në radhë të parë për të ruajtur emrin dhe nderin e tyre. Kryemjeshtrit që gëzonin emër të mirë siguronin punë me lehtësi, thërriteshin e kërkoheshin kudo, prandaj ata qenë të interesuar t'i mbaheshin fjalës së dhënë. Kur ndërmernin punë me karakter publik, ndërtime objektesh administrative, shtrime rrugësh, atëhere firmosej kontrata me autoritetet e caktuara.

Në Malin e Shenjtë marrëveshja lidhej ndërmjet igumenit dhe kryemjeshtrit[2]. Kryemjeshtri qe përgjegjës dhe organizator, njeriu që e udhëhiqte dhe kujdesej për mbarëvajtjen e grupit dhe për secilin pjesëtar. Ai duhej të siguronte punë, strehim, t'i caktonte detyrat gjithësecilit, e t'u jepte shpërblimin sipas meritave dhe punës. Kryemjeshtrit i qe njohur e drejta të merrte një shpërblim më të madh, sepse ata në kuptimin e saktë qenë «teknikë» të mesëm ndërtimi e në shumë raste bënin edhe punën e inxhinjerëve të ndërtimit, duke zgjidhur probleme të ndryshme projektimi e zbatimi.

Për një kohë të gjatë Mali i Shenjtë tërhoqi shumë mjeshtër stinorë nga Kolonja, druvarë e qymyrxhinj nga Devolli, argatë nga vendet e tjera të Ballkanit, Greqia, Bullgaria, ikonografë, gdhendës druri, piktorë. Mjeshtër të tjerë punonin dhe në një sërë qytetesh Greke[3].

Në kohën kur filloi lëvizja patriotike për zgjimin e ndjenjave kombëtare, muratorët stinorë filluan të përfshiheshin në këtë lëvizje. Klubet dhe shoqëritë shqiptare jashtë atdheut filluan të tregojnë interes të veçantë për mjeshtrit dhe argatët stinorë dhe ata i shërbyen çështjes kombëtare me besnikëri duke sjellë në atdhe libra shkollorë, gazeta e duke u bërë edhe vetë propagandistë të ideve kombëtare[4].

Muratorët stinorë niseshin pas festës së Shën Mitrit, pra në fund të muajit tetor, sipas kalendarit të vjetër, ose në fillim të muajit Nëntor dhe ktheheshin në fund të Qershorit, në prag të punëve intesive të verës. Kur nuk arrinin të mbaronin punën që kishin marrë përsipër, a kur nuk arrinin të mblidhnin a të kursenin një farë të hollash, qëndronin edhe më gjatë.

Burrat në mërgim nuk e kishin të lehtë. Jeta e mundimshme, mungesat e mëdha, puna e rëndë dhe kushtet e vështira, sëmundjet e aksidentet dëmtonin rininë dhe shëndetin e tyre. Një pjesë mbeteshin përgjithmonë në ato vende të largëta[5].

Përvetësimi i mjeshtërisë bëhej në dy mënyra: Kur ustai e kishte të afërm ndihmuesin, djalë, nip a vëlla më të vogël, e vinte nga pak në punime muri duke i qëndruar pranë e duke e këshilluar. Kur ndihmuesit qenë më të largët, askush s'kishte interes t'u mësonte zanatin[6].

Mjeshtrit ndanin punën midis tyre, në skalitës e muratorë. Skalitës bëheshin mjeshtrat më të mirë

2) Th. Naçi tregon:
«Gjyshi im Gaqi Naçi qe kryemjeshtër dhe skalitës. Këta tanët kishin zënë punë në Manastirin e Qillandarit (Hilandar). Qenë katër vëllezër dhe të katër punonin muratorë.

3) Paskal Vodica në shënimet e tij shkruan: Midis viteve 1891 ose 1892 kur unë isha 10-11 vjeç, im atë punonte si murator në qytetin e Kavallës (Greqi). Atje ishin gjithashtu edhe vëllezërit e minj të mëdhenj, të cilët punonin bashkë me babanë. Kështu më morën edhe mua atje.

4) Në Kavallë kishim një klub tonin — shkruan Paskal Vodica — ku mblidheshin gjithnjë më të rinjtë shqiptarë që ndodheshin atje. Në këtë klub çdo mbrëmje lexonim libra shqipe, që na i dërgonin nga Klubi i Selanikut. Librat që lexonim ne atje ishin të Çajupit, të Naim Frashërit, Samiut etj. Në Kavallë punonim katër muajt e dimrit dhe katër muajt e verës shkonim në fshat, ku mirreshim me punë bujqësore.

5) Edhe sot në Kolonjë dëgjohet shprehja «Do të vijë, kur të vijë vare e blusharëve» Kjo shprehje kishte kuptimin s'ka për të ardhur kurrë.
Blusharët të njohur si puntorë të mirë të mademeve të gurit, merrnin me vete varetë e mëdha, po kur ktheheshin në verë, varetë i linin atje, nuk i merrnin kurrë me vete.

6) Dhimitër Note tregon:
«Ne fëmijët që mbanim baltë e llaç, e që donim të mësonim zanatin, kur mjeshtrit hanin drekë e bënin ndonjë pushim të vogël, shkonim te muri dhe vendosnim tre katër gurë, pastaj iknim dhe rrinim me veshë ngrehur a do t'u binte në sy mjeshtërve kur të fillonin punën e çdo të thoshin. Në se gurët na i rrëzonin, e fillonin të bërtisnin kjo tregonte se si kishim vendosur mirë, në se nuk i binte në sy a nuk thoshin gjë, gëzoheshim se ishim në rrugë të mbarë».

DO NOT COPY

sepse skalitja kërkonte duar të shkathta, sy të mprehtë e shije të hollë.

Me gdhendjen e gurëve të qosheve, të kapiteleve, të portikëve e të harqeve për dritare a porta, mjeshtrit merreshin kryesisht në dimër, kur koha qe e keqe e s'mund të punohej jashtë. Gdhendjet bëheshin në kapanone të veçantë, në hajate e në strehime të rastit. Skalitësit, apo gurgdhendësit qenë relativisht të shumtë. Mbi këta ngriheshin një kategori e veçantë e mjeshtërve, të atyre që merreshin me vizatimin e figurave e të qënieve zoomorfe e përrallave mbi sipërfaqen e gurit. Këta qenë mjeshtrit popullorë të basoreliefëve në gur, punime të të cilëve gjenden në ndërtesa kulti e kryesisht në portat e shtëpive.

Punë të mjeshtërve shqiptarë, të artistëve popullorë të panjohur, kanë mbetur kudo brenda kufijve të Perandorisë Osmane, e shpesh edhe jashtë saj. Po s'ka dyshim se një pjesë e mirë e këtyre punimeve duhet të gjendet në Malin e Shenjtë e në Stamboll. Ka të ngjarë të jenë ruajtur dhe marrëveshjet midis manastirëve dhe kryemjeshtrave.

Shtegtimet e muratorëve stinorë u bënë shkak edhe për ngritjen e fshatrave shqiptarë brenda Perandorisë e jashtë saj. Sigurimi i një pune të përhershme, plotësimi i nevojave ekonomike, pasiguria e jetës në Shqipëri, kryengritjet e vazhdueshme, taksat e rënda, shtypja e dyfishtë nga ana e administratës dhe e bejlerëve vendës, i shtynë shumë muratorë të merrnin edhe familjet me vete e të ngriheshin si fis a mëhallë. Kështu shpjegohen disa ngulitje kolonjarësh në Bullgari, Ukrainë e Greqi dhe shtimi i tyre me të riardhur në shek. e XIX.

Rruga tjetër është ajo e njerëzve të armatosur që afronin shërbimin e tyre me armë[7].

Itinerari më i praktikuar qe rruga Ersekë-Korçë-Follorinë-Selanik. Por Korça mund të lihej edhe mënjanë kur zgjidhej rruga që priste më shkurt, Kolonjë-Nikolicë-Follorinë-Selanik. Në Malin e Shenjtë, arrihej me anë të rrugës detare nëpërmjet skelës së Dhafnos dhe me anë të kontinentit duke kapërcyer malet e Orsosë. Por Selaniku shërbente si pikë nga ndaheshin rrugët për më në lindje në Stamboll për të shkuar në Varna, Kostancë e Odesë. Në rrugët e tyre të mërgimit muratorët kolonjarë kanë shkuar duke ndjekur punën thellë Siberisë duke marrë pjesë në hekurudhën transiberiane deri në Irkutsk e Vladivostok. Disa prej tyre si Kristo Dafo, Ligor Thodhosi u kthyen në vendlindje pas Revolucionit të Tetorit.

Rruga tjetër nga niseshin muratorët kolonjarë qe Kolonjë-Leskovik-Konicë-Janinë e më tej. Kurse brenda vendit ndiqej rruga e karvaneve gjatë Grykës së Vjosës, Kolonjë-Leskovik-Çarshovë-Përmet-Këlcyrë-Tepelenë-Gjirokastër, ose ndiqej rrjedha e Osumit, për të dalë në Çorovodë e në krahinën e Beratit.

Më pakë ose aspak riheshin rrugët drejt Veriut e Veriperëndimit për shkak se ajo trevë mbulohej nga muratorët gollobordas.

Muratorët udhëtonin me kafshët e tyre, me kuaj, gomarë e mushka. Preferoheshin mushkat si kafshë me rezistencë e të afta për të mbajtur më shumë ngarkesë. Kthimi i kafshëve në shtëpi gjatë verës, për transportimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore, qe një arsye tjetër e fortë që kishte për të mbajtur rregullsinë e shtegtimeve stinorë.

Te muratorët kolonjarë gjuha e fshehtë profesionale doganeja nuk pati përhapje për shkak se ata kanë punuar në treva të huaja, ku gjuha shqipe nuk njihej. Kështu që nevoja e doganës nuk ndihej fare. Në të folurën e tyre hynë vetëm elemente e shprehje të kësaj gjuhe të fshehtë, që përdorte sintaksën, gramatikën dhe leksikun e gjuhës shqipe, por me kuptime të tjera.

Luftrat ballkanike dhe lufta e parë botërore prunë tronditje të mëdha në shtegtimet e muratorëve stinorë. Pasiguria e jetës, shqetësimi për fatin e familjeve, dyndjet e ushtrive të huaja i bënë kalimet, në mos të pamundura, tepër të vështira. Në fillim të shek. XIX filloi kurbeti i largët i Kontinentit Amerikan dhe Australian e një pjesë e mirë e forcës së gjallë punëtore, mori drejtim të ri. U braktisën rrugët e vjetra, tradicionale dhe ajo mënyrë organizimi stinor e mjeshtërve. Ndryshon koha e qëndrimit dhe karakteri i punës.

Shtegtimi i muratorëve u praktikua brenda vendit dhe në vitet e parë, pas çlirimit, kur nevojat e ndërtimit e të rindërtimit të banesave të shkatërruara e të djegura nga lufta, qenë të mëdha.

Ndërtimet e vrullshme që filluan në çdo rreth të vendit dhe frontet e mëdha të punës që hapi sistemi socialist, i dhanë fund njëherë e përgjithmonë shtegtimit stinor.

Jeta e muratorëve stinorë në të kaluarën ka qenë tepër e vështirë, e mundishme dhe me privacione të mëdha. Ata vetë e dinin këtë gjë që kur thoshnin «Vëre çekanin në këmbë, sa është hija e tij në diell, aq është prokopia e muratorëve».

7) Në këtë kategori nuk hyjnë vetëm myslimanët, por edhe të krishterët. Martallozët qenë të krishterët e armatosur që kishin si profesion luftën. Një dëshmi e tillë e sjellë edhe nga Fan Noli në autobiografinë e vet, kur përmend shkakun e shpërnguljes nga të parët e fisit, por koha e shpërnguljes sipas gjithë rrethanave është e vonshme dhe kurrsesi, para pushtimit turk.

Dokument

Naum PRIFTI

DO NOT COPY

LA PETITE ORGANISATION ET LES CONTREES DES MAÇONS SAISONNIERS DE KOLONJA

RESUME

La migration des artisans saisonniers a été un phénomène bien connu dans la zone des Balkans. La catégorie la plus intéressante de ces artisans est celle des «maîtres», tel que l'on appelat brèvement les maçons, les charpentiers, les graveurs de pierre et leurs assistants. En hiver, ces maîtres partaient travailler en petits groupes dans des pays à conditions climatiques favorables. Les principaux pays où s'effectuait la migration étaient les régions au doux climat des Balkans telles: la riviera et l'Albanie du Sud (Delvina, Saranda, Konispol), la Bulgarie, la Roumanie (surtout la région de Constantza), la Grèce (particulièrement la montagne d'Athos).

Les groupes de maçons saisonniers étaient organisés sur la base de famille ou de camaraderie. Les maçons et les maîtres choisissaient des camarades ayant à peu près le même âge et la même qualification professionnelle.

Les groupes se réorganisaient chaque année à cause des vieillards qui se retiraient du travail et des jeunes gens qui s'engageaient à leur place, ainsi qu'à cause d'autres facteurs tels les maladies, les soucis familiaux etc.

Les groupes se composaient régulièrement de 6 à 10 personnes et c'est rarement qu'ils dépassaient ce chiffre. Le nombre pair des maîtres constituait la base de ces groupes.

Les maîtres étaient obligés d'habiter des étables ou des palliers, dans des conditions difficiles. Ils transportaient leurs couvertures partout où ils allaient au moyen des bêtes de somme qu'ils utilisaient quelques fois même pour leur travail. Le logement et les moyens de préparer les repas se fixaient avec l'embaucheur. Dans le contrat on précisait les appointements et le délai des travaux.

D'habitude les maîtres travaillaient à forfait, car dominait l'idée que les maîtres à dessein travaillaient lentement, afin d'allonger de manière artificielle la durée du temps de travail à forfait, les poussaient à travailler plusieurs heures par jour à rythmes rapides. Tout litige devait être résolu par le patron et le contremaître, qui avait accepté oralement et signé le contrat. Quant il s'agissait de petites constructions avec des employeurs privés, on ne passait pas de contrats écrits, parce que le patron et les maîtres ne voulaient pas se mêler avec l'administration turque et la cour en cas de mésentente. Les maçons respectaient le contrat, parce qu'au premier lieu ils ne voulaient pas mettre en question leur honneur et leur nom. Les contremaîtres, qui jouissaient d'une bonne réputation trouvaient facilement du travail, ils étaient appelés et désirés partout, donc, il était dans leur intérêt de tenir leur parole. Quand il s'agissait de travaux de caractère publique, de constructions d'objets administratifs, de pavage de rues, le contrat était signé par des autorités désignés.

Pendant une longue période la Montagne d'Athos a attiré beaucoup de maîtres saisonniers de Kolonja, des bûcherons et des charbonniers de Devoll, des ouvriers agricoles des autres pays des Balkans, de la Grèce, de la Bulgarie, des iconographes, des graveurs de bois et des peintres. Des maîtres travaillaient aussi dans d'autres villes grecques.

Les façons saisonniers partaient après la fête de Saint Déméter, donc à la fin du mois d'octobre, ou le début du mois de novembre, selon l'ancien calendrier, et retournaient à la fin du mois de juin, à la veille des travaux intensifs de l'été. Quelquefois, quand ils ne pouvaient pas terminer à temps les travaux entrepris, ou quand ils n'avaient pas gagné une somme suffisante, ils y restaient plus longtemps.

Le travail était partagé entre graveurs et maçons. Les graveurs étaient les meilleurs maîtres, parce que la gravure exigeait des mains habiles, des yeux experts et des goûts délicats. En hiver, à cause du mauvais temps, on gravait les chapitaux, les portiques, les arcs des portes et des fenêtres dans des étables ou des logements occasionnels.

Les graveurs travaillaient en grand nombre. Entre eux se distinguait une catégorie particulière de maîtres, qui s'occupait des dessins, des figures et des êtres zoomorphes des contes, sur la surface de la pierre. C'était les maîtres populaires des bas-reliefs en pierre dont les travaux se trouvent dans des constructions de culte et particulièrement sur les portes des habitations.

Des travaux des maîtres albanais, des artistes populaires inconnus, sont restés partout à l'intérieur des confins de l'Empire Ottoman, et souvent même à l'extérieur. Il n'y a pas de doute qu'une bonne partie de ces travaux doit se trouver dans la Montagne d'Athos et à Istanboul.

Les maçons voyageaient un utilisant leurs bêtes, des chevaux, des ânes, des mulets. Le retour de ces bêtes dans leur pays pendant l'été pour le transport et le traitement des produits agricoles, était une autre forte raison pour maintenir la régularité des migrations saisonniers.

DO NOT COPY

Fatbardha SHKUPI

ZBUKURIMORJA E NDËRTIMTARISË SË KULTIT NË QYTEZËN E VITHKUQIT GJATË SHEKUJVE XVIII-XIX

Mbi shpatin e malit të Rongajës të rrethuar me kodra të blerta pyje ahu, dushku e plepi, me lugina plot shkurre e prroje ndodhet fshati Vithkuq.

Në këtë qendër jeta kulturore u gjallërua nga fundi i shek. XVII e fillimi i shek. XVIII. Kushtëzues për këtë ngritje dhe faktor vendimtar ka qenë zhvillimi ekonomik i vendit, rritja e ekonomisë qytetare që përfshiu dhe fshatrat. Në këtë kohë u themelua Akademia e Voskopojës më 1774 e si pasojë u kryen ndërtime arsimore e kishtare edhe në Vithkuq. Për shkaqe të njohura në vitin 1769 u shkatërrua Voskopoja dhe Vithkuqi u këmbye në gjendje fshati.[1] Rreth fundit të shek. XVIII Vithkuqi kishte një popullsi prej 8000 banorësh. Pësoi shkatërrim më 1769--1781, një djegie të dytën më 1819 nga feudalët, dhe një të tretë në vitin 1823 që rrafshoi fshatin. Që atëhere popullsia u shpërnda nëpër qytete të tjera dhe nuk pati mundësi të kryente ndërtime më të rëndësishme se ato që kanë arritur deri tek ne.[2] Ndarja e vendit në dy pashallëqe të mëdha ndikoi shtrirjen e Ali Pashë Tepelenës mbi këto krahina nga vitet 1788 deri 1822. Duke u forcuar feudoborgjezia vendase, përkrahëse e pashait, lindën tek ajo kërkesa për mirëqënie dhe jetë më të kulturuar, si pasojë e zhvillimit të ri ekonomik të cilit i përgjigjen banesat e zbukuruara dhe ikonabartësit e gdhendur.

Qyteza e mëparshme e Vithkuqit del në pah herë pas here në dokumentat kishtare si qendër e zhvilluar kulturore. Nga kjo qendër lindën disa vehtje të shquara si Evstrat Vithkuqari, Anastas Mihal Andrea që ripërtëriu kodikun e Korçës e të Selasforit më 1826 e të tjerë që ndihmuan me të holla ngritjen e vatrave të ndryshme kulturore si në Vithkuq, ashtu dhe në Korçë.[3] Por Vithkuqi siç del nga regjistrat osmane[4] ka qenë një qytezë e rëndësishme që në shek. XVI. Sipas vrojtimeve tona zbukurimorja e ndërtimtarisë së kësaj krahine si në faltoret ashtu dhe në banesat popullore u zbatua nga dora e të njëjtave grupe mjeshtrish që në shekujt XVII-XVIII.

Në Vithkuq afreskët ku shihen drethka zbukuruese me motive trashëgimore i kanë pikturuar disa piktorë të njohur për veprat e tyre si: Qirko, Panajoti, mësues Kostandini, Kostandin Jeromonaku, Kostandin Shpataraku e Kostandin e Athanas Zografi.[5]

Në Vithkuq nga 14 kisha janë ruajtur vetëm 7 ndër të cilat 4 të dëmtuara: Shën Vangjelizmoi, Manastiri i Shën Minait, Shën Thanasi e Shën Gjergji dhe tri të mbajtura mirë: Kisha e Shën Mërisë, Shën Mëhilli dhe Manastiri i Shën Pjetrit e Pavlit.

Sipas historisë së zhvillimit, ikonabartësit në

1) P. Pepo, **Kodiku i Korçës dhe i Selasforit** – Tiranë 1979. Arkivi i Institutit të Historisë, fq. 23. mbi zhvillimin e Kulturës e më vonë shkatërrimin e parë të Vithkuqit.
2) P. Pepo. – **Vep.cit,** fq. 25, 224 mbi shkatërrimin e Vithkuqit herën e dytë.
3) P. Pepo – **Vep.cit,** fq 415 – Zhvillimi i Vithkuqit, Evstrat Vithkuqari.
4) Livai Pasa – **Defteri Musafal** – (Nahija e Korçës, Defter Nr 52) Në arkivin e drejtorisë së përgjithëshme të tapive të kadastrës – Ankara.
5) Dh. Dhamo – **Piktura mesjetare të Vithkuqit,** material në Arkivin e Institutit të Historisë.



Fig. 1a Ikonabartësi i Kishës së Shën Mërisë

fillim paraqiteshin si mure me dyer e kamare të pikturuara. Të tillë i gjetëm në kishat e Shën Vangjelizmoit, Shën Minait, Shën Thanasit e Shën Gjergjit.

Zbukurime gardhuese, gërshetuese, nuk u punuan në fshatin Vithkuq. Këto lloj ndërtimesh mbetën të kufizuara vetëm në viset sllave.[6]

Nga fundi i shek. XVII dhe fillimi i shek. XVIII zbukurimoren e gjejmë të zbatuar në ikonabartësit e kishave të Shën Mërisë e Shën Mëhillit, ndërsa nga mezi i shek. XVIII e fillimi i shek. XIX në kishën e Shën Pjetrit e Pavlit.

Kisha e Shën Mërisë e cila ndodhet në krahun e djathtë të fshatit mbi pjerrtësinë e kodrës është një anijatëshe. Ikonabartësi i saj paraqitet i daltuar me një derë të bukur të pajisur me ballzinë. Anash tij janë vendosur gjashtë ikona dhe gjashtë pano. Sipër tyre shtrihet brezi i zbukuruar mbi të cilin renditet atika me dy rreshta ikonash të vogla. Në rreshtin e parë ndodhen 17 ikona, mbi qendrën e tyre qëndrojnë dragonjtë me kryqin e madh sipër. Anash janë modeluar 12 harqe të vegjël nga 6 për çdo krah me gjysmë diej që bartin ikona. Ikonabartësi pjesërisht është i dëmtuar, përmasat e tij janë 5.06 m me 2.86 m. Ai është i praruar mbi fushë të kuqe koral dhe të kaltër kobalt me përmasa të vogla që i japin hijeshi (fig. 1 a). Në krahun majtas derës së bukur janë vendosur dy pano dërrase të pikturuara me zbukurime lulëzore të kuqe kadmium, të kaltra kobalt e të blerta permanent me vijëzime të zeza mbi fushën e praruar. Në pjesën e mesme të ikonabartësit ruhen katër ikona të mëdha majtas e dy djathtas. Dera e bukur paraqet ballzinën e stolisur me biskatë e zymbyla; në të dy anët e ballit shihen pëllumba që çukasin kokrra rrushi. Zymbylat rrethohen me dredhëse të gjethëzuara. Kufiza e poshtme e ballzinës mbulohet me kinda të gërshetuar që krijojnë hark të valëzuar sipas mënyrës së gotikës islamike të mesdheut (stil flakëronjës). Në të dy anët e derës së bukur janë vendosur dy gjysmështyllëza të cilat pak para bazës përfundojnë mbi dy mbështetëse gjysmë kupa që mbajnë dy poça lulesh të shoqëruar me gjethe, nga ku shpërthejnë tufëza trigjethëshe të kapërthyera, të lidhura me bistakë e veshë rrushi. Dera e bukur përbëhet nga dy flegra të ndara në tri pjesë me ndër-

6) Z. Licenoska — **Makedonskata Crkovna rezba vo XVIII u XIX vek,** «Glasnik na etnoloskiot muzej», Skopje 1960, fq. 82-83.

DO NOT COPY

prerëse. Në pjesën e sipërme janë vendosur tri ikona të rrethuara me bisqe, të ndërprera nga një shirit i gungët. Ndarsja e poshtme mbulohet nga dy ikona anash të cilave rradhiten tulipanë të mbivendosur.[7] (fig. 1b). Dera e bukur në mes përshkohet nga një ndarëse e veshur me lulëza të krahaskëmbyera me dredhëse. Sipër ballzinës shtrihet një bandë e zbukuruar me gjethe shpatullgjëra, bistakë e vile rrushi. Në mes është vendosur kryqi i rrethuar me kufizë shumëkëndore të cilën e mbajnë dy grifonë të përballshëm me putrat e tyre. Ky zbukurim përsëritet në të gjithë faqen i shoqëruar me fazanë e luanë. Sipër bandës rreshtohen dy rradhë të ikonabartësit të vogël. Radha e parë e ndërtuar disa kohë më vonë, na jep dy gjëndje daltimi në krahun e majtë ku shihen shtatë ikona të përkufizuara nga sipër me shtatë harqe, dhe një shirit i gërshetuar ku mbështetet radha e dytë që mban gjashtë ikona të kurorëzuara me gjashtë gjysmëluleqerthuj në vend të harqeve. Në mes të harqeve në trombat e këndeve dallohen lulëza trigjethëshe. Në pjesën e mezit gjinden tri ikona të vogla të mbyllura me harqe të mprehët mbi të cilat ngrihet kryqi i madh i shoqëruar prej katër dragonjëve e dy grifonëve që shtypen prej tij.[8]

I gjithë kompozimi kufizohet nga shirita bisqesh rrethorë me tri gjethëshe tërfili të cilat nuk i kemi gjetur ende në ndonjë ikonabartës tjetër.

Ikonabartësi i takon grupit të daltimit të cekët petashuq. Është punuar në dru plepi të veshur me shtresë allçiu e shkumsi të gatuar me të bardhë veje dhe të lyer me ar, sipas të dhënave të mjeshtërve vendas. Në këtë ikonabartës kanë punuar dy mjeshtër. Më i vjetri ka daltuar derën e bukur dhe ikonabartësin e vogël të anës së majtë. Pjesa tjetër e mezit dhe dragonjtë e mezit të kryqit janë gdhendur nga mjeshtri që punoi kishën e Shën Mëhillit. Mënyra e daltimit i takon ndërkohës së parë të zhvillimit të ikonabartësve të lulëzuar sipas llojit të barokut ballkanas me renditje të thjeshtuar ikonash, përfytyrimesh e brezash zbukurimi.

Mbi ballin e ikonabartësit janë vendosur tetë ikona të mëdha nga katër në të dy krahët e derës së bukur, dhe dy rreshta ikonash të vogla, i pari mban 17 ikona, e i dyti 12 ikona. Mbi to vendoset kryqi i madh. Bisqet e drethkave trajtohen me tërfil të lulëzuar. Ky lloj ikonabartësi gjen simotrat e veta në Greqinë e Veriut, në krahinën e Vardarit dhe në rrethin e Tërnovës së Bullgarisë të banuar prej shqiptarësh si Arbanasi. Veçantitë e tij i dallojmë në brezat e gjërë të pasuruar me fletë lëpjete e akasje si trajta e shtrirë e harkut të derës së bukur, flegrat e së cilës mbulohen me drethka tërfili që duke u ndër-



Fig. 1b Dera e bukur e ikonabartësit

PROTOCOPY

7) F. Shkupi – **Dekoracioni i banesës populllore në qytetin e Shkodrës.** Monumentet, 12, 1976, fq. 196-204.
8) Shih. O.M. Dalton – **Byzantine art and arkeology,** Oxford, 1911, fq. 706-707.



Fig. 2a Ikonabartësi i kishës së Shën Mëhillit



Fig. 2b Ballzina e derës qendrore

DO NOT COPY

thurur sajojnë kufiza të luhatura që rrethojnë ikonat e vogla.

Teknika e gjendjes zbatohet me daltë të thellë tejkaluese e cila në disa pjesë paraqitet e tejdukshme, diku mbështetet mbi faqe dërrase. Ballzina e derës e zbukuruar me të njëjtat motive si brezi i sipërm përshkohet me bedena të dhëmbëzuar në harkun e poshtëm ndërsa sipër paraqitet e thjeshtë pa drethka ndërprerëse.

Mjeshtrit që daltuan, sipas gojëdhënave të popullit, ishin shqiptarë të ardhur nga krahina e Kosturit dhe Kolonjës. Studimet në të ardhmen do të ndihmojnë për të gjetur veprimin e tyre edhe në vise të tjera.

Ikonabartësi i dytë me vlerë i daltuar pothuaj njëkohësisht me të parin ndodhet në kishën e Shën Mëhillit në të dalë të fshatit Vithkuq (fig. 2a). Kjo kishë u ndërtua nga fundi i shek. XVII. Data e piktürimit të saj të parë është viti 1712 nga piktorët Qirko dhe Panajoti.[9] Kisha e Shën Mëhillit paraqitet tri anijatëshe me një kube qëndrore dhe dy kubëza anësore në secilën anijatë. Kuptohet që ikonabartësi u daltua gjithashtu brenda kësaj kohe përpara kishës së Shën Thanasit të Voskopojës e cila mban datën 1724, ndërsa ikonabartësi i vjetër i kishës së Shën Kollit të Voskopojës u daltua në vitin 1743. Mjeshtri i shquar e daltoi ikonabartësin e kësaj kishe sipas një lloji të ri ku paraqiten gërshetime gjethesh lëpjete dhe akasje të kokrrizuara. Në tërësi ikonabartësi është ruajtur mirë me përjashtim të prishjes së dy ikonave të vendosura djathtas derës së bukur e pesë të vëna majtas, si dhe disa rrypave të ngushtë të shkëputur nga panotë e poshtme.

Ikonabartësi i Shën Mëhillit është daltuar në mënyrë të përafërt kompozuese me atë të Shën Mërisë veçse me përmasa të mëdha, 9.10 m me 4.90 m dhe lartësi të kryqit të madh 0.90 m.

Në pjesën e poshtme përmban tri dyer të bukura të shoqëruara prej 10 ikonash të vendosura në të dy anët e derës qendrore. Ndën ikonat ndodhen panotë e pikturuara. Sipër tyre shtrihet brezi i zbukuruar mbi të renditen dy rreshta ikonash të vogla të atikës sipër të cilave ngrihet kryqi i madh. Ikonabartësi është daltuar sipas stilit zbukurues të shek. XVII i cili vazhdoi deri në mezin e shek. XVIII. Dera e parë mban një ballzinë baroke të kufizuar me kinda që paraqet tufëza gjethesh të ndërthurura me fletë tërfili e zogj fazanë të vendosur përballë njëri tjetrit, pranë pemës së jetës.[10] Pas tyre shihen dy fazanët e tjerë me krye të kthyer që duan të çukasin kokrrat e rrushit. (fig. 2b). Nga mezi i pemës së jetës lakohen dy bistakë që ngrihen mbi dy zambakë. Anash dyerve dhe të dhjetë ikonave të mëdha janë zbatuar rrypa të zbukuruar me zemërza, zymbylka, shermashekë e tërfil të valëzuar, të cilat përfundojnë me krejsa si shqiponja dy krenare. Kështu i gjejmë

9) M. Arapi — Punimet konservuese restauruese në kishën e Shën Mëhillit të Vithkuqit në vitin 1981 (Dorëshkrim i arkivit të Institutit të Monumenteve, fq. 5).

10) O.M. Dalton — **Vep.cit,** fq. 669-700.

DO NOT COPY



Fig. 3a Dera e bukur qendrore

dhe në Manastirin e Rilës.[11] Dera e bukur qendrore mbi dy flegrat ruan katër ikona të vogla, dy nga poshtë, një në mes e një sipër. Duke u mbyllur ato trajtojnë një hark vezak tip lundërze (fig. 3a). Secila flegër ndahet me zambakë, topçe, gjethe lëpjete të lakuara e të përshkuara me rruaza pranë të cilave shihen fazanë që çukasin kokrra rrushi (Fig. 3b). Në pjesën e mezit drethkat ndërlikohen me bisqe tërfili e palmeta rreth ikonave ndërsa në fund rrotull harqeve të dy ikonave të vogla janë krijuar zemërza që mbyllin lule, anash të cilave shihen zambakë.

Disa nga ndërshtyllëzat e ikonave të mëdha paraqesin drethka me lulëza e tulipanë që shpërthejnë nga poçat lulembajtës.

Dera e dytë majtas qendrës ruan një ballzinë harkore të kufizuar me kinda që paraqet tufëza lë-



Fig. 3b Pjesëz e derës qendrore

11) K. Miatiev – Rilsij Monastir – Sofia, 1957, fq. 59. Për shqiponjat kariatide.
J.G. Hahn – **Albanesische studien,** Jena, 1854, fq. 229.



Fig. 4a Ballzina e derës së majtë

pjete, tërfili, tulipanë e katër fazanë ndër të cilët dy qëndrojnë pingul në skaj e dy në qendër përballë njëri tjetrit rreth pemës së jetës. Rrypat janë vendosur anash kafshëve të përballshme e janë zbukuruar



Fig. 5 Krejs i pikturuar i kishës së njëjtë

me bisqe të valëzuar në kahe të kundërta duke trajtuar zemërza që mbyllin tulipanë. Në krye të ndarseve janë vënë krejsa prej zymbylash (fig. 4a). Në këtë pjesë mungojnë flegrat.

Dera e tretë djathtas qendrës shfaq zbukurime të afërta me derën e parë, veçse mbi ballin e saj shihen zogjtë gjatë çukitjes së kokrrave të rrushit me fletra të shpërvjelura në skaj, kurse ata të mezit, me shpinë ndaj njëri-tjetrit.

Sipër dyerve është zbatuar brezi i cili përshkohet prej drethkash të fuqishme, gjarpinj[12], boçe pishe, tulipanë, tërfil, lëpjeta, zogj, fazanë, lule dele. Në mes të brezit shihen dy dragonj përballë me flatra të hapura që ruajnë pemën e shenjtë. Poshtë kraharorit të tyre janë daltuar dy shënjesa diellore me 9 petla, helika mbi fushën e kuqe.[13] Këto zbukurime janë lyer me varak dhe janë daltuar mbi shtresa të kuqe që duken si vermilion e të kaltra kobalt, sipas stilit barok. Mbi brezin e zbukuruar ndodhet atika me 32 ikona në radhën e poshtme e 31 në rradhën e sipërme. Secila ikonë e vogël ruan një gjysmë diell me hark në rreshtin e poshtëm që na kujton brerorën e Kostandinit.[14] Në mes të harqeve vizatohen arabeska. Radhës së dytë të atikës i mungojnë gjysmë-diejt. Ndërsa ikonat e radhës së parë ndahen me shtyllëza dredhëse gjethesh, ato të radhës së dytë ndahen me shtyllëza kordoni. Në mes të harqeve të ikonave të radhës së dytë valëzohen tufëza trigjethëshe. Sipër atikës vendoset një brez i dytë me kinda-bedena e lule zambaku tri fletëshe. Kryqi i madh është zbukuruar me pesë lulonja si rreze në tri krahët, dy antefiksa anash të ngulura në gojën e dy dragonjve të cilët trupëzohen në bishtin e dy përbindëshave me fshatra që mbajnë kryqin (shih fig. 2a). Të gjitha këto zbukurime janë praruar me varak të artë. Në kishë ndodhet një amvonë i pikturuar me poça lulesh të kuq e gjethesh të blerta mbi fushë të bardhë. Shtyllëzat e anijatave paraqesin krejsa të pikturuar me drethka ngjyrë gruri, të kuqe e të kaltra mbi fushë të zezë, që rrethojnë krerë luanësh të hirtë (fig. 5). Mbi kubetë e anijatave gjetëm përfytyrimin e një ëngjëlli serafin të sajuar nga mbivendosja e dy helikave dyfletëshe[15] me kahe të kundërta që simbolizonin diellin tek fiset ilire.[16]

12) J.G. Hahn – **Vep.cit,** fq. 234 – gjarpri Vitore tek shqiptarët është gjeniu i shtëpisë.
13) M. Tirta – **Elemente të kulteve ilire tek shqiptarët** – «Kuvendi I i studimeve Ilire», Tiranë, 1972, 281-302. Mbi helikat diellore.
14) U. Fracasini – S.V. Aureola, Treccani vol 32, fq. 54 – Mbi prejardhjen e brerores.
15) G. D'Alviella – **La migration des symboles,** Paris 1891; fq. 27, 80 223 ku paraqiten helika me 3-4 rrahëse në dy kahe.
16) A. Stipcevic – **Kukasti kriz kod starih iliria,** në «Gjurmime Albanologjike, Prishtinë 1970, fq. 109-127.

DO NOT COPY



Fig. 6 Serafin në trajtë helike

Përfytyrime të tilla ne shohim dhe në pjesët e daltuara të ikonabartësve (fig. 6).[17]

Në krahasim me ikonabartësin e kishës së Shën Mërisë ky i fundit është më i pasur. Ndërsa drethkat e derës së bukur të kishës së Shën Mërisë lëvrijnë me shkathtësinë e bisqeve gjarpërorë që mbështjellin tërfilin, daltimet e Shën Mëhillit rrëshqasin me përtim në mënyrë më të ngathët. Tri gjethet e lulëzat paraqiten të plogështa dhe përfytyrimet shtazore të shtangëta.



Fig. 7 Vizatime motivesh të ikonabartësve në kishat Shën Mëri e Shën Mëhilli

Gjarpërimi i bisqeve në këtë ikonabartës shfaqet më i harmonizuar dhe më i përcaktuar se ai i Shën Mërisë. Një bashkërenditje e tillë e zbukurimores i jep ikonabartësit fuqinë e një përmendoreje (fig. 7). Duke shtjelluar ikonabartësit e më sipërm ne vumë re në të dy duar gdhendëse që punuan në kishën e Shën Mërisë. Mënyrën e punimit të drurit të ikonobartësit të kishës së Shën Mëhillit, ne e gjetëm tek gdhendjet e kishës së Shën Gjergjit në Barmash të Kolonjës, tek kisha e Shën Kollit në Dhivër të Sarandës, në kishën e Shën Gjergjit të fshatit Kato Gramatiko të Pelës së Greqisë si dhe në disa kisha të rrethit të Gjirokastrës.[17]

Fundi i shek. XVII dhe fillimi i shek. XVIII njihen si kohë të një zhvillimi të lartë të artit zbukurues si



Fig. 8 Pjesëz e ikonabartësit të kishës «Burimit Jetëdhënës»

argjendaria, qëndistaria dhe drugdhendja krahas pikturës murore. Mjeshtër të njohur nga Opari, Kolonja e Dibra drejtoheshin për në Malin e Shenjtë të Kalkidikës ku pasuronin përvojën e tyre trashëgimore me stilet e kohës dhe trajtat e përcaktuara kanonike, sipas të cilave do të zbatoheshin ikonabartësit e rinj. Por diçka do mbetej gjithmonë në kujtesën e popullit se këta mjeshtër nuk qenë zbatues të thjeshtë modelesh të prodhuara në një manastir të Malit Athos. Shumicën e modeleve ata e krijuan vetë.

Shumë prej mjeshtërve ndërtues, gurskalitës e piktorë «shqiptarë si kombësi dhe shqipfolës» prej Gramozi u larguan në kohën e Ali Pashë Tepele-

17) N.K. Moucopulos, **Iklisies tu nomu Pelis.** Thesaloniki, 1973, fq. 33, 2, 207, 210. Kisha e Shën Gjergjit në Kato Gramatika.

DO NOT COPY

nës drejt Fllorinës ku edhe sot jetojnë pasardhësit e tyre. Fshatrat Negovan e Bellkamen vazhdojnë të jenë qendrat më të rëndësishme të mjeshtërisë së ndërtimit në Prefekturën e Fllorinës.[18] Të dhënat e rrethit të Kolonjës dëshmuan se gdhendësi i dyerve me akasje ishte vendas nga një fshat shqiptar.

Nga fundi i shek. XVIII një grup mjeshtërish të aftë rifilluan të zbukuronin ikonabartës të rinj me të cilët pajisën kishat e mëdha si Manastiri i Shën Pjetrit të Pavlit që u ndërtua mbi një kodër të vogël



Fig. 9 Ikonabartësi i kishës së Manastirit të Shën Pjetrit e Pavlit

në afërsi të Vithkuqit dhe është vepra e fundit ndërtimtarisë artistike.

Kisha me të njëjtin emër ka trajtën e kryqit m kube në mes dhe tri anijata, është e tipit baziliko

Biblioteka e këtij manastiri ka qenë e pasur m libra të shtypura në Voskopojë dhe dorëshkrime gre qisht të shkrimtarëve shqiptarë Theodhor Kavaljoti Kostandin Cepi. Ky manastir u ndërtua në vitin 173 kurse kisha kryesore, në vitin 1764. Mbi krye të derë së bukur të ikonabartësit gjëndet një datë prarin e kryer më 1773. Ikonobartësi është ndërtuar brend këtij dhjetëvjeçari nga dora e mjeshtër Dhimitrit cili sipas të dhënave të kodikut të Korçës dalt ikonabartësin e kishës së burimit jetëdhënës pran metropolisë së Korçës në vitin 1756 (fig. 8).[19] Ng dokumentat e kodikut morëm njoftim se mjeshtër Dh mitri i cili ka punuar dhe ka drejtuar ngritjen e ikc nabartësit të kishës Katedrale të Korçës «Burim jetë dhënës» përmendet midis dhuruesve të pasurive t ndryshme që përfshihen dhe ikonabartësin e tij dc methënë ishte paguar vetëm për lëndën e druri Gdhendjet e ikonabartësit të mësipërmë ruajnë ngjc shmëri të përpiktë me ato të kishës së Shën Pjetrit Pavlit në Vithkuq. Për këtë dëshmojnë dhe pleq e fshatit.

Faqja e ikonabartësit të kishës së Shën Pjetr përbëhet nga 11 harqe të zgjatur, 10 nga të cil janë plotësuar me ikonat e mëdha. Ndryshe nga c të parët është trajtuar me tri ballorë me shatore zbukuruara, dy banda të rrumbullakta, një rresht pr 17 ikonash të vogla. 10 ikonat e mëdha janë rrethu nga harqe të kufizuar me shtyllëza të lulëzuara e kre sa shqiponjash. Në secilin hark janë vendosur par që përshkruajnë ngjarje nga mitologjia, bibla e apo kalipsi. Mbi të ndodhet një derë e bukur. Daltim janë punuar thellë, ndonjëherë si trupore të rrumbu llakta dhe përfytyrimet njerëzore shprehin gjallëri lëvizje të larmishme. Temat e zhvilluara shpesh jan bazuar në minjiaturat e teksteve fetare ose artistil të kohës kurse mënyra e daltimit tregon cilësitë dh aftësitë vetiake për secilin mjeshtër të papërsëritësh me e të pagabueshme. Përmasat e tij janë 9 m x 4.90 m duke shtuar lartësinë e kryqit të mac 0.80 m. Tek çdo hark në pjesën e fundit ndodhet n pano katrore e kufizuar me drethka gjethesh e lules të lyera me varak mbi fushë të kaltër. Vetë pano është e kuqe sipër saj vendoset një bandë e saju me përfytyrime njerëzore në lëvizje të fuqishme c

18. N. Moucopulos – The popular architecture of Verria-Athinai 1967 fq. 104-107.
19) P. Pepo – **Vep.cit,** fq. 20-25, Manastiri i Shën Pjetrit e Pavlit në Vithkuq ku flitet për mjeshtër Dhimitrin.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10 Harqet gjysmëhëna me datën e prarimit ku shihen serafinë triake



Fig. 11 Pjesa qendrore e ikonabartësit



Fig. 12 Atika me ikonat e vogla

hedhin valle ose kryejnë veprime biblike si libacionet të shoqëruara me zogj e kafshë (fig. 9). Mbi bandë qëndron ikona e kufizuar nga një rryp i stolisur me luledredhëse, poça e burbuqe lindëse. Sipër rrypit harkohet gjysmëhëna që mban një medalion me kokë ëngjëlli të rrethuar prej gjashtë flatrash fluturimthi, motiv i ngjashëm me mbivendosjen e dy tri skelëve (helika trifletëshe) me kahe të kundërta si përmendëm më lart për kishën e Shën Mëhillit (fig. 10). Gjysmëhëna përshkohet nga një kornizë zambakësh. Sipër harqeve rrëshqet një brez i dytë i daltuar me trëndafila të artë mbi fushë të kuqe.

Harqet ndahen në mes tyre me shtyllëza gjysmë-cilindrike të përshkuara me blloqe e bisqe lule zhabine të bashkërenditura me drethka e zogj fazanë. Shtyllëzat në pjesën e poshtme janë shumëkëndëshe dhe paraqesin poça ku shpërthejnë tufëza lulesh. Në krye shtyllëzat gjysmë cilindrike përfundojnë me krejsa të zbukuruar nga tri radhë gjethesh të përkulura. Mbi të janë daltuar shqiponjat parandorake me flatra të hapura që shtrëngohen prej gjarpërinjve me të cilët luftojnë ashpër duke i kafshuar me sqep të hapur si në legjendat homerike (fig. 11)[20]. Sipër shqipo-

20) L. Hautcoeur – **Vep.cit,** fq. 287 – Shqiponjat që ngjitin shpirtërat e mbretërve në Amshim.

DO NOT COPY



Fig. 13 Kryqi i madh dhe shqiponjat



Fig. 15 Panoja e pestë «Çentauri»

njave janë ngujuar tri ancake ku mbështetet brezi me fushë të kaltër e drethka gjethesh që çukasin mollë. Pas brezit shtrihet banda me sipërfaqe të rrumbullaktë ku janë vendosur 11 medalione me portrete shenjtorësh të rrethuar prej bistakëve të hardhisë së rrushit, që ishte simbol i Bakut dhe kaloi në krishtërim[21]. Mbi bandë shtrihet atika e përbërë nga dy radhë ikonash të vogla. Rreshti i parë mban ikonat të rrethuara prej 17 harqesh e dy afreska, duke trajtuar në këtë mënyrë tri ballorë ikonabartës (fig. 12).

Dy anësoret paraqesin harqe të zbukuruar me nga një medalion ikone rreth së cilës shtjellon drethka të mëdha me gjethe e trëndafila kurse në pjesën e anijatës qëndrore mbi ikonat e vogla shtrihet një bandë e dytë me sipërfaqe të rrumbullt e ngjashme me të parën. Sipër bandës ngrihet kryqi i madh i kufizuar me buzina të arta i shoqëruar nga dy antefiksa që bartin ikona, me kufiza baroke, njëra ndër ato është zhdukur. Ndën to janë daltuar dy grifonë të artë mbi të cilët dy gjarpinj të shkathët sulmojnë



Fig. 14 Panoja e katërtë «Meduza»



Fig. 16 Banda e shtatë «Heroidi e Salomea»

21) W. Tomaschek, **Brumalien und Rosalien,** Wien 1869 – festat e bakut e të Saturnit, me hardhin e rrushit.

shqiponjat me kokat e kthyera djathtas e majtas (fig. 13).

Duke shtjelluar harqet veç e veç në pjesën e ikonabartësit të madh, vumë re një dorë të dytë gdhendësi pak më të ngrirë dhe më grafike që e unjisin me atë të mjeshtër Dhimitër Dibranit i cili duhet t'i ketë plotësuar këto pjesë më vonë. Si thamë, harqet e mëdha në anën e poshtme përmbajnë pano të zbukuruara me degëzime e përfytyrime të gjalla njerëzore e shtazore të zbatuara brenda kufizash të luhatura si kartusha dhe mbi bandat poshtë ikonave. Gdhendjet e ikonabartësit të kishës së Shën Pjetrit e Pavlit sipas shqyrtimit të teknikës së punimit kanë ngjashmëri me skalitjet e drunjta të kishave të Samokovit në Bullgari të zbatuara prej mjeshtërve Andon e Athanas.[22]

Panoja e parë vizaton një zog mbi mollë, banda sipër saj dy zogj të kundërvënë. Panoja e dytë krijon një kalë mbi dy mollë dhe banda e saj një drethkë me zogj. Panoja e tretë tregon një çentaur me topuz



Fig. 17 Panoja e tetë shqiponja mollë ngrënëse.



Fig. 18 Dera e bukur.

e fazanë, banda sipër, gjashtë zogj në mes të luleve. Panoja e katërt mban një meduzë sirene me një trup e dy bishta peshku të cilat i përfshin me dy duar dhe ka një kurorë guaskë në krye, rrotull saj katër fazanë ndërsa banda paraqet zogj e kafshë pylli në mes të tufëzave (fig. 14). Panoja e pestë pasqyron një çentaur të dytë që me një dragua të rrethuar me fazanë e drethka kurse banda përshkruan një festë dioniziake me bakante të dehura rreth tryezës duke vallëzuar pranë garpërit zagreus të shoqë-

22) A. Cilinguirov, **Drvopezbutana metropolitskata Cerkva v Samokov,** Sofia 1964 — Krahasohen gdhendjet e kishës së Shën Pjetrit e Pavlit me ato që kanë punuar mjeshtrit Andon e Athanas në Samokov.

DO NOT COPY



Fig. 19 Ballzina e derës.



Fig. 20 Pjesëz e ikonabartësit të kishës së Shën e Premtes në Përmet.

DO NOT COPY

ruar me zogj (fig. 15). Te panoja e gjashtë duket një drenushe kurse te banda e saj disa njerëz që munden në mes tyre. Panoja e shtatë riprodhon një bari mbi kalë, ndërsa banda Herodin dhe Salomenë të veshur me kostum shqiptar me kokën e prerë të Joan pagëzorit në pjatë rreth të cilave sillen zogj, drenusha e kaproj, simbole të Shën Mërisë (fig. 16). Te panoja e tetë shohim një shqiponjë që ha katër mollë e shoqëruar prej dy zogjsh ndërsa te banda dy zogj përballë njëri-tjetrit (fig. 17). Panoja e nëntë vizaton një zog mbi dy mollë duke ngrënë një mollë të tretë dhe banda e sipërme, bisqe të dredhura me gjethëza rreth medalionit. Panoja e dhjetë jep një zog në fluturim dhe banda e saj një medalion të rrethuar me bisqe. Gjysmëhënat e harqeve të mëdhenj janë daltuar me zbukurime të ngjashme, në tërësi paraqesin dy zogj në krye e dy anash medalioneve me gjashtë flatra (shih fig. 10). Gjysmëhëna e shtatë në vend të zogjve gdhend dy grifonë, e teta dy ujqër e dy zogj, ndërsa e nënta zogjtë i mban me kokat poshtë duke çukitur. Motivet që përmendëm më sipër ndeshen në ikonabartësit e Ballkanit si veçori e kësaj treve ku gdhendësit kryesisht kanë qenë shqiptarë[23]. Zëvendësimi i rrushi, me mollë dy-

23. — V. Puzanova — **Shënime mbi artin shqiptar në shek. XVIII,** Buletini Shkencave Shoqërore Nr. 3 1967. Fq. 55 Lidhur me paraqitjen e Salomesë që mban kokën e Joan Pagëzorit në pjatë në kishat e Voskopojës.

shohet për karakterin vendas të gdhendjeve ku molla mund të jetë totem krahinor.

Në pjesën qendrore të ikonabartësit ndodhet dera e bukur e qarkuar me hark barok (fig. 18). Ajo është e përbërë nga flegra të cilat mbajnë 10 ikona të vogla. Dy prej tyre në pjesën e sipërme, duke u afruar flegrat trajtojnë një hark vezak. Rreth ikonave degëzohen bisqe me dredhësa helika që shtjellohen rrotull dy krerëve skifteri. Sipër ikonave dallohen dy krerë shqiponjash të rrethuara nga dhjetë zogj që lëvizin në drejtime të ndryshme duke çukitur kokrra. Në mes të zbukurimeve është daltuar një kalë[24]. Dera kufizohet me buzinë gjethesh të trajtuara në plotim të lartë. Mbi buzinë shihen zogj të tjerë, dy minj are, dhe dy koka grifonësh të egërsuar që vështrojnë drejt tyre. Flegrat ndahen nga një rryp gjysmëcilindrik të përshkuar me gjethëza dredhëse e trëndafila të egjër.

Mbi harkun e derës shfaqen dy ëngjëj që sjellin kishën si dhuratë. Përkrah tyre dy luanë luftojnë kundër dy hidrave. Sipër tyre fluturojnë dy zogj të rrethuar me drethka e hardhi (fig. 19).



Fig. 21 Pjesëz e derës së bukur të kishës së Shën Pjetrit e Pavlit në Vithkuq.



Fig. 22 Lëçitësi i ri

Nga të dhënat e rrethit të Përmetit mjeshtri Dhimitër ka kryesuar punimet e ikonabartësit të kishës së Shën Premtes, daltimet e së cilës ngjajnë me ato të «Burimit Jetëdhënës» (fig. 20). Ky mjeshtër ka qenë shqiptar nga Konica e Janinës. Sipas mënyrës së krahasimit të llojkëmbimeve zbukuruese të ikonabartësit të kishës së Shën Pjetrit të Vithkuqit me ato të kishës së Burimit Jetëdhënës diktuan veprimin e së njëjtës dorë (fig. 21). Ikonabartësi i kishës së Shën Pjetrit u skalit menjëherë pas mbarimit të punimeve në kishën e Korçës. I njëjti mjeshtër daltoi ikonabartësin e kishës së Shën Prodhromit dhe të gjitha pjesët e ikonabartësve të rinj të kishave të Shën Kollit, Shën Mërisë e Shën Thanasit të Voskopojës. Veç këtyre mjeshtër Dhimitri ka daltuar tri ikonabartës të tjerë me rëndësi në Shqipërinë e Jugut.

24) S. Reinach – **Vep.cit**; Tom III, Paris, 1915, fq. 120 – Ilirët therorizonin çdo 9 vjet katër kuaj për Poseidonin.

DO NOT COPY



Fig. 23 Ballori i lëçitësit të ri.



Fig. 25 Froni i peshkopit



Fig. 24 Tamburi i lëçitësit



Fig. 26 Ballori i fronit

DO NOT COPY



Fig. 27 Shtyllëzat e fronit.



Fig. 29 Tamburi i epistrofeut



Fig. 28 Krahoret e fronit.

Mjeshtrit e mirënjohur Nikolla Dibrani, i biri Dhimitri, Nauni nga Lavdari i Oparit, Ristan Foti prej Arrëze dhe Andon Korfjoti përvetësuan ndikime të fuqishme prej artit të tij. Vepra e Dhimitër Koniciotit ruante në vetvete diçka mjeshtërore, më të lirë e më të ndjeshme në mënyrën e kumtimit të zbukurimores mbi gjethnajet e së cilës shihen mbresa dritë-hije të Ilojit pikturor sipas lëvizjes së trigjethëshit të Lisit të kuq.

Sipas të dhënave mjeshtri grek Andon Korfjoti kishte ardhur në Korçë për të mësuar mjeshtrinë e drugdhendjes bashkë me të tjerët pranë punishtes së gdhendësit të shquar. Ikonabartësi i kishës së Shën Pjetrit i përket Ilojit të tretë të zhvilluar të kësaj gjinie e cila pasurohet me zbukurime të daltuara thellë sipas stilit rokoko dhe nuk është prishur.[25]

Sipas të dhënave kishat ngriheshin me të hollat e vjela në gjirin e popullsisë së krahinës prej Metropolisë së Korçës, prandaj ka të ngjarë që ikonabartësit e Vithkuqit të kenë qenë dhurata të detyruara ose të paguara me çmime të ulta. Zakonisht një ikonabartës i Ilojit të Vithkuqit nga të dhënat e popullsisë afër kishave gjatë shek. XIX kushtonte 1500 deri 2000 grosh. Megjithatë vlera e ikonabartësit në fjalë nga fundi i shek. XVIII ishte 600 grosh, shumë e përafërt me atë të kishës së Shën Gjergjit në Prizren i cili u daltua nga fillimi i shek. XIX prej Pjetër Filipit.[26]

Për shkaqe të largimit të popullsisë së zhvilluar nga fundi i shek. XVIII dhe fillimi i shek. XIX, në fshatin Vithkuq nuk u ndërtua më ndonjë vepër që t'ia kalonte ikonabartësit të kishës së Shën Pjetrit me përjashtim të një lëçitësi dhe të një froni peshkopi të gdhendur nga dora e mjeshtër Dhimitër Dibranit që iu përshtatën kësaj kishe. Mendojmë se mjeshtri i mësipërm e njohu Dhimitrin nga Konica në moshë të re kur shkonte pas të jatit të tij Nikollës dhe se ai jetoi për kohë të gjatë duke punuar dhe pas vdekjes së mjeshtrit prej të cilit Nikolla mësoi artin e të daltuarit.[27]

Lëçitësi i ri (Proshkinitari) (fig. 22) përbëhet nga dy pjesë, e sipërmja është ndërtuar me katër harqe trillapëshe që mbështeten mbi katër shtyllëza me krejsa gjethesh, ballzinat e harqeve janë zbukuruar

25) M. Oxborn, **Die Kunst des Rokoko**, në «Propilaen» Kunst Geschihte» Berlin, 1929, fq. 32, 137, 139, 141, 144.

26) V. Puzanova — **Vep.cit,** fq. 49. Ku përmend sipas të dhënave të Ilo Mitkë Qafëzezit se ikonabartësi i daltuar i Manastirit të Shën Pjetrit e Pavlit në Vithkuq kushtoi 600 grosh.
Z. Licenoska **Vep.cit,** fq. 110 — Ikonobartësi i Kishës së Shën Gjergjit të Prizrenit u punua për 500 grosh dhe qe vepër e Pjetër Filipit.

27) Nikolla Dibrani kompozon në të njëjtën mënyrë si Dhimitër Konicioti. Emri i tij u gjet i shkruar në fshatin Lashovë të Leskovikut.

DO NOT COPY



Fig. 30 Epistrofeu



Fig. 31 Shatorja e Epistrofeut.

DO NOT COPY

me helika dredhëse (fig. 23). Në pjesën e poshtme ndodhet tamburi ku vendosen katër pano të zbukuruara me poça lulembajtës e shtjellëse që valëzohen deri lart në trajtë helike. Anash kufizohen me gjysmë shtyllëza këndrejtë me lajle të cilat peshojnë mbi trupat e dy bishave (fig. 24).

Froni i peshkopit është ndërtuar në tre pjesë. Mbi krye duket një shatore e vogël gjashtëkëndore me tufëza trëndafili në çdo faqe të kufizuara prej shtyllëzash e gjethesh të mbivëna (fig. 25). Pjesa e dytë qëndrore përbëhet nga tri harqe trillapëshe të zbukuruar me gjethëza helikashtjellëse e një kufizë bedenash. Në këndet harqet ndërpriten prej shtyllëzash të përshkuara nga vargëzime gjethesh. Mbi ballzinat e harqeve rreshtohen nga tri metope trëndafilash (fig. 26). Shatorja mbështetet mbi katër shtyllëza cilindrike lakore si kordon me lulëza, zog që çukasin e kafshë pylli që përfundojnë në krejsa si spiranca (fig. 27)[28]. Ana e poshtme e fronit paraqet medalione ikona, të rrethuara me drethka, helika e zogj fazanë që çukasin lule. Krahoret përshkohen nga tufëza gjethesh që lakohen sipër, rrethlafshës së një shqiponje e cila mban në sqepin saj një tufëz trëndafila. (fig. 28). Froni mbështetet mbi trupat e dy luanëve. Në kishën e Shën Pjetri gjënden dhe pjesëza të shkëputura të së njëjtës dorë si ballore froni.

Gdhendës Dhimitër Dibrani nga Magarova e Manastirit krijoi disa ikonabartës në Shqipërinë e Jugut. Daltonte tufëza trigjethesh e lule të shkathtë me rregullsi e mjeshtri teknike duke i dhënë veprave të tij madhështi e zyrtarizëm sipas stilit të fundit të

28) K. Miatiev-K. Kristov, **vep.cit,** fq. 293; 300; 308, ku shihen fronet e lëçitësat e daltuar nga mjeshtër Athanasi dhe Pjetër Filipi të cilët kanë ngjashmëri me simotrat e tyre të kishës së Shën Pjetrit e Pavlit në Vithkuq.

shek. XVIII (direktorat) e fillimit të shek. XIX (perandorak).

Mbi epistrofeun e lashtë pjesa e poshtme e të cilit është daltuar në mënyrë të cekët me bistakë e gjethe hardhije (fig. 29) punoi mjeshtër Andon Korfjoti duke i përshtatur një shatore të re. (fig. 30). Pjesa e sipërme është e ndërtuar me një kube të zbukuruar si këmbanë e cila qëndron në krye të kësulës gjashtëkëndore të pajisur me tufëza trilulesh e shtyllëza të vargëzuara gjethesh të mbivëna, pas të cilave rreshtohen katër pano të pajisura me tufa trëndafilash e krerë zogjsh si ancake. Mbi to janë vendosur ballorë të lakuar që përfytyrojnë zogj të kundërvënë në të dy anët e një bisku trëndafili që na kujton pemën e jetës (fig. 31).

Shatorja mbështetet mbi katër shtylla hollake me krejsa të përdredhura, shtatin e të cilave e mbulojnë lulevarse me trëndafila. I njëjti mjeshtër ka gdhendur fronin e peshkopit në kishën e Shën Kollit të Voskopojës.

Jehona e veprave të mjeshtër Dhimitrit nga Konica arriti deri në malësitë e Dibrës e të Rekës. Mjeshtrit e Mijakut që ndërtuan disa vepra në Shqipëri u njohën me grupin e Dhimitrit në kishat e Myzeqesë ku mjeshtër Dhimitri ka kryer disa vepra me rëndësi.

Në ikonabartësit e Shkupit e të Dibrës të gdhendur prej mjeshtër Pjetër Filipit nga Reka dhe grupit të tij ndjehen thellë gjurmët e teknikës së punimeve të artistëve korçarë.

Mali i Shenjtë ku mërgonin artistët e të gjithë vendeve ballkanase fsheh pa dyshim të vërteta të pamohueshme për historinë e artit të zbukurimit se aty kanë punuar shumë mjeshtër oparakë e kolonjarë si mësim dhënës, sipas njoftimeve gojore të popullsisë së Korçës e Kolonjës. Aty dibranët bashkëpunonin me korçarët prandaj nuk gabojmë kur themi se gollobordasit, rekasit e matjanët e kishin Korçën më afër se Malin Athos dhe këmbenin përvojë të cilën ja kalonin vendeve të tjera ku në të njëjtën kohë mësonin stilet e reja.

Tek mjeshtrit e mëdhenj karakteri kombëtar i daltës së tyre doli në pah kryesisht në mënyrën e ashpër të gdhendjes, sipas krahinës, trajtimit të gjetheve të posaçme për secilin mjeshtër dhe lëndën e drurit të tërhequr nga pyjet përreth.

Duke analizuar ikonabartësit e fundit të shek. XVIII e fillimit të shek. XIX e duke i krahasuar me atë të kishës së Shën Pjetrit në Vithkuq del se këto vepra arti të drugdhendjes arritën deri tek ne si përkryerje e vazhdimësisë artistike që sollën shekujt me stilet e tyre përkatëse, ku u shkrinë motive të njohura të pellgut mesdhetar.

Sipas pohimeve të autorëve të ndryshëm dhe nga të dhënat gojore të popullit jemi të bindur se veprat më të shquara të drugdhendjes në ikonabartësit e kishave dhe brenditë e banesave popullore janë punuar prej shqiptarëve gjatë shekujve XVII, XVIII, XIX, XX, në qendrat kryesore të Ballkanit e Turqisë. Për këtë arsye nuk është e vështirë të gjinden tiparet e veçanta të kombit tonë brenda stilit shqiptar në gjirin e artit pasbizantin. Në radhë të parë gjethëzimet e lisit, të dushkut, të hardhisë, të lëpjetës, dafinës, akasjes janë zbatuar pikërisht nga mjeshtër në fshatrat e të cilëve kjo lloj bimësie pyllëzon vendin. Në disa raste drunjtë me gjethe zbukurues ndodheshin afër kishave dhe kanë frymëzuar gdhendjet. Lënda e drurit me të cilën punoheshin ikonabartësit e Shqipërisë së Jugut në të shumtën e rasteve përbëhej nga halorë ose arra, me ndonjë përjashtim përdorej plepi dhe blushi. Druri për të ndërtuar ikonabartësit e Vithkuqit u tërhoq nga pyjet përreth ku gjindeshin trungje të lartë plepash.

Bien në sy gjysmërrathët e harqeve të rrezatuar si diell. Drethkat në të shumtën e rasteve paraqesin kompozime gjethesh në trajtë helike.

Zbatohet më shpesh nga mjeshtrit shqiptarë lufta e shqipes, lejlekut e kaprollit kundër gjarpinjve. Në tërësi figurat njerëzore paraqiten të veshura me kostume kombëtare shqiptare. Ka raste kur në vend të rrushit kafshët e zogjtë hanë mollë. Njihet mënyra e daltës për secilin mjeshtër dhe gdhendjet me lëvizje të ndërlikuara që dallohen vetëm në fushën e veprimit të artistëve Shqiptarë. Brezat zbukurues me sipërfaqe të rrumbullaktë përshkohen me drethka si *S* vazhduese dhe harqet e mëdha pajisen me serafinë shumë krahësh mbi skena si darka e fshehtë. Krejsat e shtyllëzave janë gdhendur me shqiponja flatra shpërvjelura të lira ose të kacafytura me gjarpërinj. Panotë shprehin ngjarje nga mitologjia të përshtatura riteve të krishtera. Harku i derës së bukur në krye ruan figurën diellore ballori i saj pasurohet me motive lulëzore e shtazore kurse dera vetë mban një antefiks në trajtë shqiponje dy krenare.

Ikonabartësit janë mbuluar me rrëshirë të shkrirë në naftë e vaj ulliri. Prarimi është kryer me ar të pastër, rrallë kemi ndeshur varakosje argjendi. Të njëjtat trajta i takojmë mbi lëçitësat, fronet dhe amvonet tek të cilët mjeshtrit kanë nënshkruar emrat e tyre.

Pikat e përbashkëta me ikonabartësit e vendeve të tjera i gjejmë tek bandat sipër panove mbi të cilat vendosen engjëj që bartin kurora peshkopore të shoqëruara me fazanë. Ndër brezat zbukurues e flegrat e dyerve të bukura gdhenden vile rrushi ose

POZITIVE COPY

boçe pishe që rrethojnë grifonë leokornë dhe zogj fantastikë. Kryqet e mëdhenj mbi ballorët e shatoreve që shtypin dragonj gjënden kudo në truallin e perandorisë bizantine. Motivet gjeometrike ruajnë trajta kristalesh diamanti, vezore e shëgjetore në shumicën e kishave të Ballkanit. Trajtat e përgjithëshme të ikonabartësve me panotë, bandat, ndërshtyllëzat, harqet, dyert e bukura, atikën dhe tri shatoret e sipërme i ndeshim në të gjithë Ballkanin. Në këto trajta ne dallojmë arkitekturën e faltoreve paleokristiane.

Vlerat artistike të ikonabartësve të Vithkuqit i shohim në karakterin kompozues të zbukurimores. Ndërsa gdhendjet e kishës së Shën Mërisë paraqiten me lirizëm e shkathtësi vizatimi, ato të kishës së Shën Mëhillit ruajnë një dukuri parade me trajtimin e përmbajtur të drethkave e paraqitjeve shtazore.

Në të kundërt daltimet e ikonabartësit të kishës së Shën Pjetrit e Pavlit krijojnë në përgjithësi përshtypjen e zgjidhjes kompozuese me dritë hije të theksuara të cilat i japin drethkave shtjellime pikturore. Gjethet e përkulur si freskore krijojnë valëzime të këndëshme ku mishërohet shija estetike e mjeshtrit popullor.

DO NOT COPY

Fatbardha SHKUPI

DO NOT COPY

L'ART DECORATIF DANS LA CITE DE VITHKUQ, AU COURS DES XVIII ET XIX SIECLES.

RESUME

Sur le versant de la montagne de Rongaje, entouré de collines verdoyantes, de vallées et de torrents, se situe Vithkuq.

La ville de Vithkuq est mentionnée dans des documents, tel que le codique de Korça et Selasfor et le registre «Mufasal» de la région de Korça, en tant qu'un centre développé, avec des écoles, depuis le XVIe et XVIIe siècles, et des hommes célèbres comme Evstrat Vithkuqari et Anastas Mihal Andrea, qui ont édité le codique. Etant donné que la décoration des temples et des habitations s'est réalisée par les mêmes maîtres, à Vithkuq comme dans les autres régions, nous allons analyser leur travail en étendue. A Vithkuq les fresques et les icônes placées sur les iconostases ont été faites par des peintres renommés tels: Qirko, Panajoti, le maître Konstandin, Konstandin Jeromonaku, Konstandin Shpataraku, Konstandin et Athanas Zografi.

Des quatorze églises il en subsiste sept, parmi lesquelles ont été endommagées les suivantes: l'église Saint Evangélisme, le monastère Saint Mina, l'église Saint Athanase et Saint George. Elles avaient des iconostases en pierres aux portes et aux niches couvertes de peintures. Les trois autres églises: Sainte Marie (Notre Dame), Saint Michel et Saint Pierre et Paul se conservent en bon état.

Les décorations des églises Sainte Marie et Saint Michel appartiennent au XVIIIe siècle tandis que celles du monastère Saint Pierre aux XVIIIe-XIXe siècles. L'église Sainte Marie est composée d'une nef. Sur son iconostase dorée, sur un fond rouge et bleu, de petites dimensions, on remarque des panneaux de peintures. Elle est composée d'une porte, de six grandes icônes, de l'attique avec deux rangées de petites icônes et la grande croix. Le fronton de la porte est décoré de jacinthes et d'oiseaux becquetant. Ses contours flamboyants du style gothique-islamique se limitent par des sémi-colonnes décorées de porte-fleurs et de grappes de raisin. La belle porte est composée de deux battants divisés en troi parties où s'apperçoivent six icônes entourée de lys, séparées d'une ligne de rinceaux. Au milieu des rinceaux apparaissent des lions et des faucons. Le style appartient à la première période du baroque des Balkans. Elle est mince, étendue et à traitement transparant. Dans la partie centrale sont placées huit grandes icônes, ainsi que deux rangées, respectivement, de dix-sept et douze petites icônes, surmontées de la grande croix.

La deuxième iconostase qui a été gravée en même temps que la première, construite vers la fin du XVIIe siècle, se trouve à l'église Saint Michel. Les peintures sont faites en 1712 par les peintres Qirko et Panajoti. Son iconostase a été gravée en même temps que celle de l'église Saint Athanase de Voskopoja, construite en 1724, et que celle de l'église Saint Nicolas de la même ville, datant de l'année 1743. L'église Saint Michel a trois nefs, une coupole centrale et deux latérales. Sur l'iconostase le maître a gravé des feuilles d'oseille et d'accacia granulées. Cette iconostase est bien conservée. Elle est composée de trois belles portes, dix grandes icônes, une frise décorée au dessus de laquelle sont deux rangées de petites icônes et la grande croix.

Les portes sont ciselées selon le style du XVIIe – XVIIIe siècles. Elle a trois portes. La première surmontée d'un linteau, est ornée de trefles et d'oiseaux affrontés autour de l'arbre sacré. Derrière eux se trouvent deux faisans becquetant des grains de raisin. Des grappes s'inclinnent de l'arbre. Les colonnes sont pleines de bandes ornées de rais de coeur, de lys, de lierres et de trefles ondulés. Au dessus se rangent des aigles bicéphales.

La belle porte centrale, forme un arc en ogive. Elle est parsemée de feuilles d'oseille granulées et de palmettes. Les intercolumnas sont ornés de vases porte-fleurs.

La deuxième porte à droite, à part les autres motifs, présente deux faisans dressés aux coins et deux autres au milieu du fronton. La troisième porte conserve les mêmes motifs que la première, mais ses oiseaux latéraux ont déployé leurs ailes.

L'iconostase de l'église Saint Michel, est plus riche que celle de l'église Sainte Marie. Il existe une certaine harmonie entre les rameaux munis de figures, donnant à l'iconostase la puissance d'un monument.

Ces iconostases sont gravées par deux maîtres. Les ciselures de l'iconostase de l'église Saint Michel sont faites de la même manière que celles des iconostases de l'église Saint Nicolas, à Barmash de Kolonja, de l'église Saint Nicolas à Dhivër de Saranda et de l'église Saint George du village Kato Gramatiko, à Pella de la Grèce.

Les XVIIe et XVIIIe siècles sont connus comme l'époque du grand développement des arts appliqués. Les maîtres d'Opar,

de Kolonjë et de Dibra, allaient à la montagne d'Athos pour apprendre les styles, selon lesquels ils allaient réaliser les nouvelles iconostases. Ils n'ont pas été de simples exécuteurs, mais des improviseurs des iconostases renommées des Balkans, aux XVIIe-XXe siècles.

Les chercheurs slaves les ont nommés «taljadure epirotos» tandis que les grecs ont témoigné qu'ils étaient des tailleurs de pierre albanais, des albanophones originaires de Gramoz, qui ont travaillé en Thesalie et à Florina.

Vers la fin du XVIIIe siècle on a commencé à construire d'importantes oeuvres, tel que le Monastère Saint Pierre et Paul, situé sur une petite colline, qui est la dernière oeuvre de l'art ornemental de cette région. Cette église est en forme de croix, avec une coupole et trois absides. La bibliothèque était riche en livres et manuscrits des écrivains Théodhor Kavaljoti et Konstandin Cepi. Le monastère a été construit en 1736, tandis que l'église en 1764. Au dessus de la porte se conserve la datation du dorage, en 1773, laquelle témoigne que l'iconostase a été construite au cours de cette décennie-là par le maître Dhimitër, qui, selon les données du codique de Korça, a construit aussi l'iconostase de l'église de la Source vivifiante, en 1756.

L'iconostase est composée de 11 arcs dôtés de panneaux carrés, entourés de rinceaux enduits de vernis, sur un fond bleu.

Tous les maîtres qui y ont travaillé, ont utilisé leurs propres techniques. Les bandes au dessus des panneaux représentent des figures solides de danseuses ou de contes bibliques. Les piliers ont une base polygonale, tandis qu'au dessus, ils sont munis de chapiteaux à trois feuilles où l'on apperçoit des aigles, qui égorgent des serpents, comme dans les légendes hommériques. Au dessus se trouvent des oiseaux becquetant des pommes qui sont surmontés d'une deuxième bande arrondie avec onze médaillons, et plus loin l'attique avec une rangée de dix-sept icônes. Puis on a traité trois frontons d'iconostases, ornés de roses, tandis que celui du centre présente des griffons et deux serpents, qui attaquent deux aigles bicéphales. Cette iconostase a été réalisée par deux maîtres. La deuxième ciselure ressemble à l'oeuvre de Dhimitër Dibrani. Le premier panneau représente un oiseau sur une pomme, surmonté de deux oiseaux affrontés, le deuxième un cheval sur deux pommes le troisième un santaure et le quatrième une méduse. Les bandes au dessus présentent des oiseaux.

Dans le cinquième panneau on apperçoit un combat entre un centaure et un dragon, tandis que la bande décrit une fête dionisiatique. Sur le sixième panneau, il y a un chevreuil et sur la bande deux lutteurs, sur le septième, un berger à cheval, tandis que sur la bande Hérode et Salomé, avec la tête de Jean-Batiste dans une assiette. Salomé est vêtue d'un costume national albanais. Sur le huitième panneau, on voit un aigle, becquétant quatre pommes, sur la bande deux oiseaux affrontés. Le neuvième panneau présente un oiseau sur deux pommes, becquetant une troisième, et la bande est couverte de fleurs. Le dixième panneau présente un oiseau qui vole, et la bande un médaillon avec des feuilles. Les semi-lunes représentent toutes des séraphins à feuilles multiples. Tous ces symboles et motifs, nous les rencontrons dans les Balkans, où les principaux maîtres ont été des albanais.

Au centre se trouve la belle porte baroque, avec deux battants, qui forment ensemble un arc ogival. Ils sont couverts de rinceaux et d'hélices où l'on apperçoit des protomes d'aigles, des oiseaux et un cheval. Sur la porte on voit aussi des griffons et des rats. Au dessus de l'arc de la porte il y a des anges portant l'église, comme cadeau. Tout près, deux lions luttent contre des hydres, tandis qu'au dessus se rangent des oiseaux sur des vignes.

D'après les données provenant de la ville de Permet, le maître Dhimitër y a gravé l'iconostase de l'église Saint Vendredi, qui ressemble beaucoup à celle de la Source vivifiante. L'iconostase de l'église Saint Pierre a été commencée tout de suite après. C'était un maître albanais de Konitsa de Jannina. Il a fait quelques travaux à Voskopojë au Sud de l'Albanie. Quelques autres graveurs de pierre, tels Nikolla Dibrani, son fils Dhimitër, Nauni de Lavdar d'Opar, Ristan Foti d'Arrëza, ont été instruits auprès de lui. La technique de la ciselure représente des contrastes ombre-lumière, qui s'harmonisent comme dans la peinture de chevalet. Cette iconostase appartient au troisième type de ce genre, qui s'enrichit d'ornements en haut relief selon le style rococo. D'après les données les églises se construisaient avec les dépenses de la population de la région.

Le maître très doué, Dhimitër Dibrani de Mogarova, a réalisé quelques iconostases dans l'Albanie du Sud. Il sculptait des touffes de feuilles trilobées régulières appartenant au style officiel de la fin du XVIIIe siècle et du début du XIXe siècle.

La partie supérieure du pupitre ancien est sculptée par le maître Andon Korfioti. Elle est composée de cubes en forme de cloches accompagnés de fleurs triples, quatre panneaux et quatre frontons courbés qui représentent des oiseaux affrontés des deux côtés de la rose. La statue est appuyée sur de minces piliers couverts de lierres. Le même auteur a ciselé le trône de l'évêque de l'église Saint Nicolas de Voskopoja. Les oeuvres de Dhimitër, originaire de Konitsa, ont fait écho jusqu'à Dibra. Les maîtres de Mijak, qui ont construit quelques iconostases en Albanie, ont vu de près son travail à Myzeqe.

Dans les ciselures de Pjetër Filipi, réalisés à Shkup et à Dibër, on sent l'empreinte de la technique des artistes de Korça. Le Mont Athos cache sans doute quelques données sur l'histoire de l'art ornemental parce que c'est là qu'ont travaillé beaucoup de maîtres des régions de Kolonja, d'Opar et de Dibra. Ils y ont connu de nouveaux styles, en échangeant leur expérience avec l'un l'autre. C'est pour cette raison que nous disons que Korça a été plus proche de Dibra que le Mont Athos. Le ciseau des maîtres renommés albanais se distingue par le rude caractère de la technique, selon les régions, par le traitement des feuilles spéciales et par le bois assuré dans les forêts voisines.

BOZOTOR

D'après les aveux de divers auteurs les données orales, les ornements des habitations et des églises pendant les XVIIe-XVIIIe-XIXe-XXe siècles dans les Balkans et en Turquie ont été réalisés par les albanais. Ainsi, nous allons mettre l'accent sur les traits particuliers du style albanais, qui apparaît dans leurs oeuvres.

Les types de feuilles gravées sont inspirées par la région où les maîtres habitent, ou bien par celle où le travail s'effectue. La matière première épineuse est assurée généralement dans les forêts voisines. A Vithkuq on utilise le peuplier de la région. Les semi-lunes des arcs sont dessinés en rayons de soleil, les rinceaux représentent des hélices ou des swastika. Les aigles, les cigognes et les chevreuils se battent contre les serpents. Les saints sont vêtus de costumes nationaux. Quelquefois les vignes sont remplacés par les pommes, lesquelles d'après notre avis peuvent être le totem de la région. Chacun des maîtres garde sa particularité dans son métier. Les compositions sont traitées avec une habileté particulière aux maître albanais des régions du sud. Les grands arcs conservent des séraphins à plusieurs ailes. Les chapiteaux des piliers sont gravés avec des aigles à ailes déployées qui s'égorgent avec des serpents. Les panneaux expriment des événements de la mytologie illyro-grecque adaptés au christianisme. L'arc de la belle porte conserve le soleil, tandis que la porte un antéfixe en forme d'aigle bicéphale. L'iconostase est peinte de résine diluée dans du pétrole et de l'huile d'olive.

Les traits communs avec les autres pays se remarquent dans les bandes au dessus des panneaux qui représentent des anges, porteurs des couronnes de l'évêché, dans les ornements avec des vignes et des cônes de pin, avec des griffons, dans les grandes croix qui écrasent des dragons, dans les motifs géomètriques tel le cristal de diamant etc. En général les principaux traits des iconostases, on les trouve dans tout les Balkans.

Les valeurs artistiques des iconostases de Vithkuq s'apperçoivent dans le caractère du travail, dans l'église Sainte Marie, l'ornementation est appliquée avec lyrisme et habileté. L'iconostase de l'église Saint Michel garde le caractère de parade dans la présentation des ornements.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

Petrit BASHA

UJËSJELLËSI I PRRENJASIT NË SULOVË TË GRAMSHIT.

Krahina e Sulovës shtrihet në krahun e majtë të lumit Devoll të rrethit të Gramshit. Burimet natyrore pranë qendrave të banuara, nuk janë të shumtë prandaj për furnizimin me ujë të popullatës janë përdorur çezmat me burimet kryesore pranë qendrave të banuara, puset që bëheshin pranë banesave të banorëve e në rast të pakët ujësjellësit.

Për vetë kushtet e territorit puset kanë qenë në një numër të konsiderueshëm qysh 2-3 shekuj më parë. E mbështesim këtë mendim në 3 puse që kanë qenë vite më parë në Prrenjas, njeri prej të cilëve është meremetuar e funksionon edhe sot. Pusi në fjalë është rreth 25 m i thellë në majën e kodrës në lagjen Bërdëllimë. Ai u zbulua rastësisht para 40-50 vjetëve. Në furnizimin me ujë të banorëve kanë shërbyer edhe çezmat. Për vjetërsinë e tyre flasin edhe toponimet si Çezma e Zonjës e Çezma e Beut në Tunjë, Çezma e Brahim Beut në Prrenjas etj.

Ujësjellësi i Prrenjasit furnizonte me ujë «kalanë» e Haxhi Beut në Prrenjas. Ai ka formën e një trapezi me përmasa 52 x 30 x 92 m. Në disa pjesë muri 0.95 m i gjërë i pajisur me shumë frëngji ka lartësinë e dikurshme 3.30 m. Ky mur si dhe fragmentet e murit të ujësjellësit në vendburimin e ujit, janë të lidhur me llaç.

Haxhi Beu ishte i lidhur me Ahmet Kurt Pashën e bashkëpunonte me të. Nga një dokument i kësaj kohe mësojmë se Karamahmut Pashë Bushatlliu në luftimet kundër Sanxhakut të Vlorës u ndesh me Haxhi Beun që ishte i lidhur me Ahmet Kurt Pashën e Beratit. Si pasojë mendojmë se ujësjellësi është ndërtuar pas viteve 1750 pra në gjysmën e dytë të shek. XVIII.

Ujësjellësi është vendosur në shpatin lindor të kodrës Bregu i Drizës që bën pjesë në vargun e kodrave që fillon në bërrylin e Devollit në Gostimë e deri në Lumas të Beratit, me drejtim Veri-Jug (Fig. 1).



Fig. 1

Pjesa më e madhe e këtij vargu, në lartësinë mbi 600 m përbëhet prej shkëmbinjsh gëlqerorë e të varfër në bimësi. Burimi i këtij ujësjellësi ndodhet disa qindra metra poshtë këtij brezi, në tokë të butë, në

vendin e quajtur Rrëkeja e Mongët në fshatin Grekan, në lartësi 550 metra mbi nivelin e detit. Këtu edhe sot e kësaj dite pranë shpatit të kodrës 60 m larg vendit të mëparshëm të burimit ndodhet një burim që nuk shteron as gjatë verës.

Vendi nga kalon ujësjellësi është në përgjithësi shkëmbor e jo shumë i thepisur. I vështirë është terreni rreth 400 m në jug të burimit ku ujësjellësit i është dashur të kalojë nëpër shkëmb. Më pas ujësjellësi kalon në tokë të butë deri sa arrin në «Kala». Në disa vende ujësjellësi ka kaluar dhe në luginëza të vogla. Gjurmët e ujësjellësit ndodhen



Fig. 3



Fig. 2

në vendin ku bashkohen dy rrëketë e fillojnë drejt JL rrugën për tu bashkuar me përruan e Grekanit. Muri ruhet në një gjatësi 70 m dhe ka trashësi 0.70 m. Muri është me gurë e pllocakë të lidhur me llaç të një cilësie të mirë. Mbi 60 m më poshtë murit të parë ruhet mirë një pjesë tjetër e murit mbrojtës. Dhe ky mur është lidhur me llaç dhe i ndërtuar me pllocа që arrijnë deri 1 x 0,7 x 0,15 m, Ai ndodhet 0.70 m lart shtratit të rrëkesë, ka një gjatësi prej 10 m, lartësi 2 m e gjërësi 0.70 m. (Fig. 2).

Në afërsi të «Kalasë» tubat janë futur pa ndonjë muraturë apo përforcim. Por në rrëketë e vogla janë ndërtuar mure mbrojtëse me gurë të mëdhenj për kalimin e tubave.

Ujësjellësi i Prrenjasit që nga vendi ku buronte tek Rrëkeja e Mongut siç e quajnë vendasit e deri tek «Kalaja» ka një gjatësi 1200 m. Ujësjellësi nuk kalon sipas izoipseve po i ndërpret ato në shumicën e rasteve. Rruga që përshkonte është Rrëkeja e Mongët (burimi), Kopshti i Hysës, Gjollët e Bedinit, Kopshti i Zylyfit, Karume – Arra e Metes – Çezma e Rufonit – Figu i Bardhë – Rruga e Kulës «Kala».

Qarkullimi i ujit në ujësjellësin e Prrenjasit kryhej me tuba qeramikë (Fig. 3). Disniveli mes vendit të burimit të marrjes së ujit dhe skajit jugor ku është vepra e marrjes (çezma) është rreth 150 m. Pra tubacioni punonte me presion. Gjatësia e tubave arrin nga 33 cm deri 36 cm. Lidhja e tubave është bërë me futjen tek njëra tjetra, mashkull e femër. Lidhjet e tubave visheshin me llaç prej gëlqereje të pastër të stazhionuar. Trashësia e pareteve është nga 12 deri në 20 mm.

DOKOTOBY

Petrit BASHA

L'AQUEDUC DE PRENJAS A SULOVE DE LA REGION DE GRAMSH

RESUME

L'aqueduc se trouve sur le versant Est de la colline «Bregu i Drizës», qui fait partie de la série de collines commençant au détour du Devoll à Gostinë et allant jusqu'à Lumas de Berat, dans le sens Nord-Sud.

La plus grande partie de cette chaîne de collines à 600 m d'altitude, est composée de rochers calcaires où pousse une faible végétation. La source de cet aqueduc se trouve à quelques centaines de mètres au dessous de cette hauteur, à «Rrëkeja e Mangët», dans le village Grekan, sur une hauteur de 550 m au dessus du niveau de la mer. Même à l'heure actuelle, près du versant de la colline, à 60 m de la première source, on trouve une autre qui ne tarit pas même en été.

Presque tout le trajet que suit l'aqueduc est composé de rochers peu abrupts. A 400 m au sud de la source, l'aqueduc a dû passer à travers le rocher, puis il suit la direction de la «Forteresse» dans un terrain molleux. Quelquefois l'aqueduc traverse de petits vallons. Les traces se situent là où deux ruisseaux se joignent, en continuant vers le Sud-Est, pour atteindre enfin le torrent de Grekan. Le mur est conservé à une hauteur de 70 m et à une épaisseur de 0,70 m. Il est construit avec des pierres et des dalles liées de mortier de haute qualité.

A plus de 60 m au dessous du premier mur, se conserve en bon état une autre partie du mur de défense, construit de dalles, ayant les dimensions 1 x 0,75 x 0,15 m et de mortier. Il se situe à 0,70 m en dessus du lit du torrent ayant une longueur de 10 m, une hauteur de 2 m et une largeur de 0,70 m.

Près de la «Forteresse» les tuyaux sont introduits sans aucun renforcement. Dans les petits ruisseaux pour faire passer les tuyaux on a construit des murs de défense avec de grosses pierres.

L'aqueduc a une longueur de 1 200 m depuis sa source jusqu'à la «Forteresse». Il ne suit pas les isohypses, il les entrecoupe dans la plupart des cas.

L'eau y circulait dans des tuyaux de céramique. Entre la source et l'extrémité méridionale, où se trouve la fontaine, il y a une différence de niveau de 150 m, donc le tuyau fonctionnait sous pression. Les tuyaux sont d'une longueur de 33-36 cm. Ils sont introduits l'un dans l'autre. Les joints sont couverts de mortier de chaux. L'épaisseur des parois est de 12 à 20 mm.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

NDREQJE GABIMESH

Faqe	Rrjeshti	Kollona	Si është	Si duhet të jetë
29	38		sont	son
30	—	—	Dilaver Kurti	Ali Muka
49	7	2	janë	—
78	3,4	2	në rënien e mbretërisë bullgare. Në	Me rënien e mbretërisë bullgare në
78	11	2	1010 – 20	1019-20
120	citimi 4	—	katër muajt e dimrit	tetë muajt e dimrit
121	18	2	doganeja	dogançeja
124	10	2	biskatë	bistakë
126	3	1	gjendjes	gdhendjes
127	5	2	secila flegër ndahet me zambakë	secila flegër ndahet në tri pjesë. Në të sipërmen paraqiten drethka me zambakë.
127	citimi 11		Rilsij	Rilskij
128	3	2	fig. 4a	fig. 4
128	3	2	fshatra	flatra
131	fig. 11	—	Pjesa qendrore e ikonobartësit	Atika me ikonat e vogla.
131	citimi 20	—	vep.cit.	Histoire de l'art de la magie a la religion Paris 1959.
132	2	1	e drethka gjethesh që çukasin mollë	e drethka gjethesh e zogjsh që çukasin mollë.
132	1	2	prej 17 harqesh e dy afreska	Prej 17 harqesh e dy gjysëm harqesh bri aniatave ku ndër-priten qemeret e pikturuar me afreska
133	7	2	që me një dragua	që lufton me një dragua
135	fig. 21	është	vendosur me kokë poshtë	
137	fig. 28	është	vendosur shtrembër	
139	18		blushi	bushi

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë

